

FEJA

IME E BUKUR

1

MËSOJ ADHURIMET E MIA



Përgatitën për botim:

Alban Kali
Ermal Nurja
Evans Drishti

Redaktoi:

Islam Dizdari
Xhahid Bushati
Ermira Alia

Dizajn:

Bledar Xama

© Shtëpia Botuese Progresi

SHKODËR 2011



Adresa: Rr: Studenti / Sheshi "2 Prilli"
Shkodër / Shqipëri
Mob: +355 (0) 67 20 86767

PARATHËNIE

Falënderimet i qofshin Allahut, që na nderoi me Islamin, fenë tonë të bukur.

Paqja dhe përshëndetja, qofshin mbi Profetin tonë të dashur, Muhamedin (a.s.), i cili ua mësoi njerëzimit fenë duke e jetuar atë, gjithashtu mbi familjen dhe shokët e nderuar të tij!

Të dashur fëmijë!

Dashuria për Allahun është thelbi i fesë sonë. Allahu i Lartmadhëruar e ka krijuar zemrën për të dashuruar.

Ai dëshiron që ta duam fenë tonë, Pejgamberin dhe të dashurit e tij, si dhe të ecim në rrugën e tyre.

Dashuria lind në zemër dhe më pas pasqyrohet në sjelljet dhe veprimet tona. Dashuria për Allahun, si dashuria më e madhe, zë vend më shumë në zemrat tona. Më pas, kjo dashuri na mëson të bëhemi njerëz të mirë dhe të zbatojmë urdhrat dhe ndalesat e Allahut. Sjelljet e hijshme dhe adhurimet tona rrisin besimin dhe dashurinë tek ne.

Të dashur fëmijë!

Rrugëtimi i besimit islam, filloi me Pejgamberin tonë të dashur dhe vazhdoi, brez pas brezi, deri në ditët tona. Çdo brez u përpoq, me sa kishte mundësi, ta jetonte dhe t'iu përcillte atë brezave të ardhshëm. Kështu, njohuritë mbi fenë islame arritën gojë më gojë, dorë më dorë dhe zemër më zemër deri tek ne.

Ne e dimë që ju e doni shumë Krijuesin, Allahun e Lartë, Pejgamberin Muhamed (a.s.) dhe fenë tonë të bukur. Edhe ne ju duam shumë! Dëshirojmë që ju, bijtë tanë, ta mësoni sa më mirë fenë tonë të dashur.

Ju jeni e ardhmja! Të gjitha vlerat tona materiale dhe shpirtërore pas një kohe do të kalojnë në përgjegjësinë tuaj. Ju do ta merrni prej nesh dhe do ta vazhdoni më tutje rrugëtimin e shenjtë të besimit islam, që filloi së bashku me Pejgamberin e dashur. Prandaj, ajo që na takon neve, si më të mëdhenj, është t'ju përgatisim për këtë detyrë të shenjtë dhe t'ju përcjellim juve mesazhet hyjnore të fesë sonë.

Në përgatitjen e këtij libri, që është një mirësi e Allahut, u konsultuam me disa libra të shkruar më parë dhe përfituam prej tyre. Nga ana tjetër, me anë të këtij libri, ne dëshirojmë t'iu dhurojmë një tjetër kënaqësi dhe shije, botës suaj shpirtërore dhe asaj diturore. Në përgatitjen e këtij libri patëm kujdes:

- Çdo temë të fillojë me një tregim, në mënyrë që dashuria dhe interesi juaj ndaj njohurive fetare të vijë duke u shtuar.

- Të vendosen brenda kornizash ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit, që janë burimet më të rëndësishme të fesë islame, me qëllim theksimin e tyre.

- Asnjë nga urdhrat dhe ndalesat e fesë sonë nuk janë pa vlerë dhe të gjitha kanë urtësi të shumta. Njohja e mirësive dhe dobive të tyre do të na shpjerë në përmbushjen e urdhrave fetarë më me dashuri dhe bindje. Prandaj ne u munduam të përmendim çfarë përfitojmë nga çdo adhurim, si dhe urtësitë dhe dobritë e çdo urdhërese.

- Në fundin e çdo kapitulli, përdorëm metodën “pyetje – përgjigje”, në mënyrë që ju të kuptoni më mirë temat e trajtuara.

- Ilustruam temat me vizatime, sepse e dimë që ju i pëlqeni shumë ato.

• U përpoqëm të përcjellim në botën tuaj shpirtërore kujtime të ëmbla nga jeta e pejgamberit Muhamed (a.s.), e shokëve të tij besnikë dhe e dijetarëve të historisë islame.

• Njohuritë i kemi dhënë herë pas here me tabela dhe me forma të ndryshme.

• Në fund të çdo teme kemi vendosur pyetësorë me anë të të cilëve ju do të mund të kontrolloni njohuritë e fituara.

• Ne vendosëm në tekst lutjet që ka bërë Pejgamberi ynë, me qëllim që edhe ju t'i mësoni ato.

Zemra juaj u mbush të me besim (iman), jeta juaj me Islam dhe shpirti juaj me mirësi (ihsan)! Engjëjt qofshin bashkudhëtarët tuaj, ndërsa njerëzit e mirë qofshin shokët dhe miqtë tuaj! Allahu i Lartë ju ndihmoftë!

Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju!

PERMBAJTJA

ADHURIMI / 9

Tregim: Gostia në Saraj	10
Ç'është adhurimi?	12
Pse adhurojmë?	13
Tregim: Falënderoj Allahun.....	14
Ç'përfitojmë nga adhurimet?.....	16
Pyetjet	17

DETYRAT DHE PERGJEGJESITE E MUKELEFIT / 19

Tregim: Rruga për në xhennet.....	20
Përgjegjësitë me të cilat na ngarkon feja	21
Normal juridike fetare.....	22
Kushtet e Islamit.....	25
Poezi: Kushtet e Islamit	25
Burri nga Nexhdi.....	26
Pyetjet	27

PASTERTIA / 29

Tregim: Gruaja që pastronte shtëpinë e Allahut	30
Feja Islame dhe pastërtia	32
Poezi: Pastërtia dhe myslimani	33
Llojet e pastërtisë.....	34
Poezi: pastërtia dhe shëndeti.....	37
Cila është marrëdhënia ndërmjet pastërtisë dhe adhurimit?	38
Pejgamberi ynë i jepte rëndësi pastërtisë.....	39
Poezi: Pastërtia	40
Pyetjet	41

ABDEST - GUSEL - TEJEMUM / 43

Tregim: Abdesti pastron gjynahet.....	44
Abdesti.....	46
Çfarë është abdesti?.....	46
Çfarë nuk mund të bëjmë pa abdest?.....	46
Si marret abdest?.....	46
Tregim: Burimi i ftohtë	48
Dobitë e abdestit.....	50
Cilat janë farzet e abdestit?.....	51
Për çfarë duhet të kujdesemi gjatë marrjes së abdestit në mënyrë që të veprojmë në përputhje të plotë me sunetin e Profetit (a.s)?	52
Çfarë e prish abdestin?.....	53
Drita e ymetit Muhamedi	53
Gusuli	54
Çfarë është gusuli?	54

Çfarë nuk mund të bëjmë kur na mungon gusuli?	54
Cilat janë farzet e gusulit?	54
Kur duhet të marrim gusul?	55
Si merret gusuli?	55
Çfarë fitojmë nga gusuli?	56
Çfarë nuk është e pëlqyeshme të bëhet gjatë marrjes së gusulit?	56
Për çfarë duhet të kujdesemi gjatë marrjes së gusulit në mënyrë që të veprojmë në përputhje të plotë me sunetin e Profetit (a.s)?	57
Tregim: Forca e ujit	57
Tejemumi	61
Çfarë është tejemumi?	61
Kur merret tejemumi?	61
Si merret tejemumi?	61
Cilat janë farzet e tejemumit?	62
Tregim: Shpella Çoraktepe	62
Pyetjet	66

NAMAZI / 69

Tregim: Hera e parë që fala namazin	70
Ç'është namazi?	72
Pse falim namaz?	73
Përfitimet tona me kryerjen e namazit?	74
Kush e ka farz faljen e namazit?	76
Llojet e namazit	76
Farzet e namazit	80
Ezani	81
Ikameti	83
Si e falim namazin?	84
Si falim namaz?	90
Duatë dhe tesbihët që këndohen pas namazit	94
Vaxhibet e namazit	96
Sunetet e namazit	97
Etika e namazit	98
Mekruhet e namazit	98
Të falësh namaz i përqendruar	99
Çfarë e prishin namazin	101
Rëndësia e faljes së namazit me xhematë	102
Etika e xhamisë	103
Disa namaze që falen me xhematë	106
Namazi i të sëmurit	109
Namazi i udhëtarit	110
Namazi Kaza	110
Sehvi sexhdeja	112
Sexhdeja e Tilavetit	113
Kohët në të cilat është mekruh të falja e namazit	114
Tregim: Namazet e mia	115
Pejgamberi ynë e pëlqente shumë faljen e namazit	118
Xhamitë dhe mesxhidet	119
Pyetjet	122

RAMAZANI DHE AGJERIMI / 129

Tregim: Agjërimi i parë	130
Çfarë është agjërimi?	133
Për kë është farz agjërimi?	133
Cilat janë kushtet e pranimit të agjërimit?	133
Disa koncepte në lidhje me Ramazanin	134
Duke u kujdesur për agjërimin, edhe agjërimi na kujdeset për ne	136
Çfarë përfitojmë nga agjërimi?	137
Llojet e agjërimit	139
Agjërimi kaza.....	142
Agjërimi kefaretit	142
Shkaqet që e prishin agjërimin	143
Shkaqet që shkaktjnë njëherësh agjërimin keffaret dhe kaza	143
Shkaqet që imponjnë vetëm agjërimin kaza	144
Shkaqet që nuk e prishin agjërimin	145
Kur mund të ndërpritet agjërimi?	146
Fidja e agjërimit	147
Sadakaja e fitrit	147
Agjërimi i zotimit	147
Namazi i teravisë	148
Itikafi.....	148
Nata e Kadrit	149
Bajrami i Ramazanit	150
Jeta e Profetit tone në Muajin e Ramazanit	151
Vjershë: Ramazani	154
Pyetjet	155

ZEKATI / 157

Tregim: Provimi i falënderimit	158
Kush është pronari i vërtetë i pasurisë	160
Sadakaja dhe zekati	161
Çfarë është zekati?	163
Dobitë e zekatit	164
Tregim: Ka që jep edhe më shumë se ju!	168
Për kë është farz zekati?	170
Cilat janë parametrat e të qenit i pasur në pikëpamje të Islamit	170
Cilat nevoja konsiderohen themelore ose bazike?	170
Nisabi i mallrave për të cilat jepet zekati dhe sasia e zekatit	171
Zekati dhe nisabi i mallrave tregtar	171
Nisabi dhe zekati i kafshëve	172
Nisabi dhe zekati i prodhimeve bujqësore	173
Tregim: Kopshti i shkretuar	174
Kujt i jepet zekati?	176
Kujt nuk i jepet zekati?	177
Tregim: Të japim nga ato që duam	178
Çfarë duhet të kemi kujdes gjatë dhënies së zekatit?	179
Të jetosh me mundin e krahëve është më mirë se sa të lypësh	181


Bujaria dhe bamirësia e profetit Muhamed (a.s.)	182
Poezi: Gati për tetë paraqsat	184
Pyetjet	185

HAXHI / 187

Tregim: Burimi i ujit zemzem	188
Çfarë është haxhi?	190
Ç'përfitojmë ne nga haxhi?	191
Tregim: Karamelet	194
Kush e ka farz haxhin?	195
Poezi: Udhët e Qabesë	196
Qabja	197
Vendet që vizitohen gjatë adhurimit të haxhit	199
Poezi: Rrugët nga kemi kaluar	202
Vendet që vizitohen në qytetet e Mekes dhe Medines	203
Farzet e haxhit	206
Veprimet që kryhen gjatë adhurimit të haxhit	206
Si kryhet haxhi?	210
Umreja	212
Çfarë dhuratash sollët prej haxhit?	213
Haxhi i profetit tonë Muhamed (a.s.)	214
Poezi: Kërko e kërko, gjurmën të ta gjej	216
Pyetjet	217

KURBANI / 219

Tregim: Sprovimi i miqësisë	220
Çfarë është kurban?	222
Kur prehet kurban?	222
Çfarë përfitojmë duke prerë kurban?	223
Kush e ka të detyruar fetarisht që të presë kurban?	225
Kafshët që bëhen kurban	226
Si pritët kurban?	227
Për çfarë duhet të tregojmë kujdes gjatë prerjes së kurbanit?	228
Si ndahet mishi i kurbanit?	228
Çfarë bëhet me lëkurën e kurbanit?	228
Kurbanit i zotimit	229
Kurbanit me rastin e lindjes së fëmijës	229
Profeti ynë dhe kurbanit	230
Pyetjet	231
Përgjigjet e sakta të pyetjeve	233
Suret dhe duatë e namazit	237



ADHURIMI



QELLIMI I KRIJIMIT TONE

✿ *Përkufizimi i adburimit*

✿ *Qëllimi i adburimit*

✿ *Ç'fitojmë nga adburimi*



Gostia në Saraj

Na ishte njëherë një mbret shumë i pasur. Ai dëshiroi t' u tregonte njerëzve pasurinë dhe madhësinë e mbretërimit të tij. Për këtë arsye, ndërtoi një pallat të madh mbretëror, dhomat e të cilit i pajisi me orendi dhe stoli të shtrenjta. Dha urdhër të shtroheshin sofa me lloje të shumta dhe të ndryshme ushqimesh.

Më pas, i caktoi si detyrë një oborrtari prezantimin e mbretit para njerëzve dhe mënyrën e të sjellurit të tyre në saraj. Pas këtyre përgatitjeve filloi pritja.

Oborrtari i mbretit i shëtiti të ftuarit në çdo skaj të sarajit. I ftoi të hanin nga ushqimet që gjendeshin mbi sofa dhe u bëri atyre dhurata të ndryshme. Pastaj nisi t' u fliste rreth mbretit.

O njerëz! Mbreti ynë, pronari i këtij pallati mbretëror, dëshiroi që ju ta njihni atë dhe madhësinë e pushtetit të tij, duke ju treguar këtë pallat mbretëror dhe pasuritë e tij. Ai e shprehu më së miri dashurinë e tij ndaj jush duke ju shtruar këtë gosti.

Edhe ju duajeni dhe respektojeni atë! Ai u tregua bujar dhe i mëshirshëm ndaj jush, në mënyrë të veçantë me dhuratat e shpërndara. Tregoni respekt ndaj tij duke e falënderuar. Ju jeni duke e parë që vula e tij është mbi çdo thesar dhe objekt të këtij pallati mbretëror. Prandaj, edhe ju këmbëngulni ta njihni pronarin e këtyre bukurive dhe përpiquni të kuptoni forcën dhe mëshirën e tij të pamatë.

Kështu oborrtari, ua prezantoi të ftuarve, mbretin dhe pallatin mbretëror. Pas këtij prezantimi, të ftuarit u ndanë në dy grupe.

Grupi i parë e dëgjoi me shumë vëmendje oborrtarin dhe i pranoi si të drejta fjalët e tij. Ata shprehën mirënjohje për ftesën e bërë. U treguan të kujdesshëm ndaj rregullave të vendosura në saraj, duke u sjellë me shumë edukatë gjatë gosisë dhe e falënderuan përzemërsisht mbretin për ftesën e bërë dhe për mikpritjen.



Mbreti mbeti shumë i kënaqur nga sjelljet e këtij grupi të ftuarish. Për këtë, ai i shpërbleu ata duke i dërguar në një pallat tjetër mbretëror, më të madh dhe më të bukur. Ata jetuan aty të lumtur deri në pafundësi.

Ndërsa grupi i dytë, u dha tërësisht vetëm pas ushqimeve dhe pijeve të ndryshme, duke mos dëgjuar aspak fjalët e oborrtarit. Ata e bënë veshin shurdh ndaj këshillave të tij. E tepruan si në ushqim, ashtu edhe në pije, duke mos marrë parasysh asnjë ndalesë. U dehën dhe filluan të shqetësonin edhe të ftuarit e tjerë. I nënvleftësuan edhe begatitë e sofrave, në vend që të falënderonin për gostinë. Ushtarët e mbretit, duke parë se ata e kaluan kufirin, i kapën dhe i futën në burg. Dhe kështu, ata e kaluan gjithë jetën në burg, deri në pafundësi.



PYETJET



- ❁ Në këtë tregim, mbreti simbolizon Allahun e Lartë. Po pallati mbretëror, çfarë simbolizon sipas jush?
- ❁ Çfarë shprehin sofrat, dhuratat dhe zbukurimet e ndryshme?
- ❁ Kë përfaqëson oborrtari i mbretit?
- ❁ Kush janë të ftuarit në gosti?
- ❁ Cilët janë grupi i parë i të ftuarve?
- ❁ Cilët janë grupi i dytë i të ftuarve?
- ❁ Ç'përfaqëson pallati i dytë mbretëror, tek i cili qëndruan deri në pafundësi grupi i parë i të ftuarve?
- ❁ Ç'përfaqëson vendi ku u dërgua grupi i dytë i të ftuarve, burgu?
- ❁ Pse u burgosën të ftuarit e grupit të dytë?
- ❁ Pse nuk e dëgjuan oborrtarin e mbretit të ftuarit e grupit të dytë?



Ç'ËSHTË ADHURIMI?

Adhurimi tregon besnikërinë dhe dashurinë ndaj Allahut, Krijuesit të çdo gjëje, gjithashtu zbatimin me përpikmëri të urdhrave dhe largimin nga çdo gjë që na ndalon Ai.

Adhurimi është shfaqja e besimit që ndodhet në zemrat tona me anë të sjelljeve dhe veprimeve. Falja e namazit, agjërimi i Ramazanit, leximi i Kuranit, bërja e duasë (lutjes) dhe përkujtimi i emrit të Allahut janë adhurime. Të mos gënjesh dhe të mos vjedhësh është adhurim. Të sillësh mirë ndaj prindërve dhe t'i bësh vizitë farefisit është adhurim. T'u bësh mirë njerëzve, t'i ndihmosh ata dhe t'u qëndrosh afër atyre që janë në vështirësi është adhurim. T'i përshëndesësh vëllezërit myslimanë me selam apo t'u dhurosh buzëqeshje atyre është adhurim. Pra, çdo gjë që bëhet për hir të Allahut është adhurim.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Duaja, është thelbi i adhurimit”

(Tirmidhi, Deavat 1)



Allahu (xh.sh.) thotë:

“Thuaj: “Padyshim namazi, adhurimi, jeta dhe vdekja ime janë vetëm për Krijuesin e gjithësisë që është Allahu i Lartë.”

(En'am, 162)



PSE ADHUROJMË?

Në çdo çast, Allahu na dhuron mirësi të panumërta. Ajri, uji, buka, frutat, perimet, kafshët... Të gjitha këto janë mirësi të Allahut të Lartmadhëruar, të krijuara për njerëzit.

Ne gëzohemi kur një njeri na bën qoftë edhe një të mirë të vogël. Ushqejmë respekt dhe dashuri për të. E falënderojmë përzemërsisht. Nëse ai na kërkon të bëjmë diçka, ne jemi të gatshëm t'ia plotësojmë dëshirën, apo jo? Atëherë, a nuk duhet falënderuar Allahu, i cili na krijoi nga asgjëja e na furnizon me begati të

panumërta, duke i kryer me dëshirë adhurimet tona ndaj Tij?

Po, ne duhet ta falënderojmë Allahun për mirësitë dhe begatitë që na dhuron, duke e adhuruar Atë. Nëpërmjet adhurimeve të ndryshme, ne shprehim besimin, dashurinë dhe lidhjen tonë të ngushtë me Të. Kështu ne fitojmë dashurinë e Allahut. Duke fituar dashurinë e Allahut, Ai do të na dhurojë edhe më shumë begati në ahiret, duke na vendosur përjetësisht në xhenetin e Tij.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’jua shtoj edhe më shumë begatitë e Mia.”

(Ibrahim 7)

Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Shikoni ata që kushtet e jetesës i kanë më të këqija sesa ju. Mos i shihni ata që janë mbi ju. Në mënyrë që të jeni mirënjohës ndaj mirësive të Allahut.”


(Muslim, Zuhd 9)

Këpuca

Një fëmijë nuk kishte këpucë dhe për këtë ishte mërzitur shumë. Duke ecur rrugës, vuri re një të gjymtuar. E falënderoi Zotin duke thënë me vete: - Falënderimet të takojnë vetëm Ty, o Zot! Vërtet unë nuk kam këpucë, por kam këmbë. Këpuca mund të sigurohet, por ama këmba jo.

Vlera e mirësive që na ka dhuruar Allahu, dihet vetëm atëherë, kur ne arrijmë ta falënderojmë me gjithë zemër Atë.





Falënderoj Allahun (xh.sh.)

Isra kishte ditë që ishte e sëmurë. Gjendja shëndetësore e saj po përmirësohej, por e ëma nuk e linte të ngrihej nga shtrati, derisa të shërohej plotësisht. Ajo kishte nevojë të pushonte, ta merrte veten dhe t'i kushtonte kujdes të ushqyerit.

Shtrati i Isrës ndodhej pranë dritares. Ajo e kalonte ditën duke parë kalimtarët, duke lexuar libra dhe duke biseduar me prindërit, por megjithatë mërzitej herë pas here. Nuk kishte dëshirë të hante, ndërsa ilaçet nuk dëshironte t'i shihte me sy.

Atë ditë, në shtëpinë e Isrës erdhi për vizitë mësuesja e saj. Kjo për të ishte një surprizë shumë e bukur. Isra u gëzua pa masë.

Mësuesja e përqafoi, u ul pranë saj dhe e pyeti në lidhje me shëndetin.

Isra i tha se ishte mërzitur shumë duke qëndruar në shtrat. Asaj nuk i pëlqenin ilaçet dhe dëshironte të shërohej sa më shpejt.

Mësuesja e përkëdheli dhe e këshilloi të bënte më shumë durim. Isra mendoi për një çast dhe shprehu pakënaqësinë e saj duke pyetur:

- Mësuese, pse vallë Allahu e ka krijuar sëmundjen?

Mësuesja, duke buzëqeshur, iu përgjigj:

- Që t'i dihet vlera shëndetit, të mësohet durimi dhe mirënjohja ndaj Tij.

Isra sërish nuk e kuptoi dhe e pyeti:

- Çfarë do të thotë kjo?

Mësuesja iu përgjigj:

- Shiko, e dashur Isra! Çdo gjë në jetë shërben për ta na mësuar diçka. Sëmundja na mëson vlerën e shëndetit, uria vlerën e begatave, me të cilat ushqehemi përditë, ndërsa etja vlerën e ujit. Nëse nuk i përjeton këto, atëherë nuk ua di vlerën të mirave të përditshme.

Isra e kuptoi urtësinë e fjalëve të mësueses dhe u shpreh:

- Po, keni të drejtë mësuese! Unë e kuptova rëndësinë e shëndetit vetëm pasi u sëmura!

Mësuesja, me dashamirësi, tha:

- Të lumtë, Isra! Kur ne nuk e kuptojmë vlerën që ka një gjë, atëherë nuk mund ta falënderojmë Dhuruesin e saj, Zotin. Tani e tutje besoj se ti do ta falënderosh më shumë Allahun, i Cili të ka krijuar me shëndet të plotë.

Isra i tha mësueses:

- Po, kjo është shumë e vërtetë! Këtë nuk do ta harroj asnjëherë!

Pasi u mendua pak, i erdhí në mendje një pyetje:

- Mësuese! Meqenëse është kështu, a nuk duhet ta falënderojnë të pasurit më shumë Allahun?

Mësuesja iu përgjigj:

- Pa mendo! Sikur një njeri të ishte i verbër dhe të kishte shumë para, a nuk do t'i shpenzonte ato që t'i kthehej shikimi për të parë bukuritë e kësaj bote? Po të ishte i shurdhër, a nuk do të bënte të njëjtën gjë që të mund të dëgjonte?

- Padyshim!



- Atëherë çdokush që ka sy për të shikuar, veshë për të dëgjuar dhe këmbë për të ecur, është i pasur. Por, më i pasur është ai që gëzon shëndet të plotë të mendjes...

- Atëherë, unë jam shumë e pasur! - tha Isra.

Mësuesja e gëzuar iu përgjigj:

- Po, ti je shumë e pasur. Prandaj duhet ta falënderosh sa më shumë Allahun.

Isra e lumtur u shpreh:

- Mësuese, tani e tutje unë nuk do të ankojem, por do të bëhem një fëmijë mirënjohës ndaj Allahut (xh.sh.), për çdo gjë.

Mësuesja ia shtrëngoi dorën e vogël Isrës, e përkëdheli dhe e uthi me dashuri. Ajo u largua duke i thënë:

- Të shkuara, e dashur Isra! Lus Allahun që të të japë shërim sa më shpejt!

Ç'PËRFITOJMË NGA ADHURIMET?

Adhurimet na afrojnë me Allahun

Qëllimi i krijimit tonë është të njohim Allahun dhe ta adhurojmë Atë. Me adhurimet që bëjmë, shprehim robërinë tonë ndaj Allahut dhe ndjehemi më afër Tij. Ne kërkojmë ndihmë prej Tij dhe strehohemi në mëshirën e Tij, pa pasur nevojën e asnjë ndërmjetësi. Përpjekja për të fituar dashurinë hyjnore na bën të ndjehemi të lumtur.

Adhurimet zbukurojnë moralin tonë

Adhurimi na largon nga gabimet, na bën më të moralshëm dhe më të dobishëm për shoqërinë. Ai pastron zemrën nga ndjenjat dhe mendimet e këqija dhe na zbukuron moralin.

Adhurimet kalisin besimin

Ruajtja dhe forcimi i besimit mundësohet vetëm me anë të adhurimeve. Në qoftë se adhurimet i kryejmë me përpikmëri, besimi ynë forcohet edhe më shumë.

Adhurimi është i dobishëm si për këtë botë, ashtu edhe për botën tjetër. Myslimani që e ka përjetuar qoftë edhe një herë shijen e adhurimit, nuk mund ta lërë pas dore asnjëherë atë. Si përherë edhe tani peygamberi ynë, Muhamedi (a.s.), përbën shembullin tonë më të madh. Ai ishte shumë i përpiktë në kryerjen e obligimeve ndaj Allahut, e dashuronte adhurimin dhe e kryente në mënyrë të përsosur. Ai i këshillonte sahabët që të tregoheshin të kujdesshëm ndaj disiplinës së adhurimit.

Allah (xh.sh.) thotë:

“Unë i krijova xhindët dhe njerëzit vetëm të më adhurojnë Mua”

(Dharijat 56)

Një ditë, një njeri shkoi tek Profeti dhe i tha:

- O i dërguari i Allahut, më trego se cilat vepra më largojnë nga xhehenemi duke më dërguar në xhenet!

Pejgamberi iu përgjigj:

- Ta adhurosh Allahun duke mos i shoqëruar askënd dhe asgjë Atij, të falësh namazin, të japësh zekatin dhe të ruash lidhjet farefisnore.”

(Buhari, Edeb 10)

Një ditë Profeti Muhamed (a.s.), e zuri për dore

Muadh bin Xhebelin dhe i tha:

- Unë të dua shumë për hir të Zotit.

Atëherë Muadhi i tha Pejgamberit:

- O i Dërguar i Allahut! Edhe unë të dua Ty!

Në vazhdim Pejgamberi i tha:

- Muadh, dëshiroj ta thuash me çdo kusht këtë dua pas çdo namazi:

اللَّهُمَّ اعْنِي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ

“Zoti im! Më ndihmo që të të përkujtoj, të të falënderoj për mirësitë e Tua ndaj meje dhe të të adhuroj me përkushtim!”.

(Ebu Davud, Vitr 26)

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

A janë të sakta apo të gabuara fjalitë e mëposhtme:

- ❁ Adhurimi është të shprehurit e dashurisë dhe respektit ndaj Allahut të Lartë, Krijuesit të gjithçkaje, si dhe të përmbushurit e detyrës së robërisë ndaj Tij. E SAKTË E GABUAR
- ❁ Qëllimi për të cilin jemi krijuar është të rritemi dhe të zotërojmë një profesion. E SAKTË E GABUAR
- ❁ T'i ndihmohesh njerëzit, t'u japësh selam atyre dhe t'i buzëqeshësh vëllait mysliman nuk është adhurim. E SAKTË E GABUAR
- ❁ Adhurimet jo vetëm që pastrojnë trupin tonë, por edhe zbukurojnë edukatën tonë. E SAKTË E GABUAR
- ❁ Duke kryer adhurimet ndaj Allahut, ne e falënderojmë Atë për mirësitë që na dhuron. E SAKTË E GABUAR

Të testojmë veten

1. Cilat nga veprimet e mëposhtme nuk janë adhurime?

- a) Të falësh namazin
- b) Të mos gënjesh
- c) Të heqësh nga rruga objekte dhe sende që i pengojnë njerëzit.
- d) Të flasësh pas krahëve.

2.

I. Punë e mirë

II. Gjynah

III. Adhurim

Cila nga pikat e mësipërme përdoret për ato gjëra që Allahu i dëshiron dhe i pëlqen më shumë?

- a) I-II
- b) I-III
- c) I-II-III
- d) II-III

3. Çfarë nuk përfitojmë nga kryerja e adhurimeve?

- a) Trupi dhe shpirti ynë pastrohen dhe hijeshohen
- b) Bëhemi njerëz me edukatë dhe të dobishëm për shoqërinë.
- c) Fitojmë dashurinë e Allahut.
- d) Bëhemi të famshëm.

4.

- I. Për të fituar kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut.
- II. Sepse ky është urdhri i Allahut.
- III. Për të shpëtuar nga dënimi i xhehenemit dhe për të qenë një nga njerëzit e lumtur të xhenetit.

Nga fjalitë e mësipërme zgjidhni ato që përbëjnë një përgjigje të plotë të pyetjes: Pse e adhurojmë Allahun?

- a) I-II
- b) I-III
- c) I-II-III
- d) II-III

Vendosni fjalët brenda kllapave, në hapësirat boshe të fjalive të mëposhtme.

(sjelljet tona, Allahut, të falënderoj, adhurim, adhurimi im)

- ❁ Thuaj: Padyshim namazi im,, jeta dhe vdekja ime janë për Allahun”
- ❁ Të mos gënjesht dhe të mos vjedhësh është
- ❁ Adhurimi është manifestimi i besimit tonë me
- ❁ Çdo gjë që bëhet për hir të është adhurim.
- ❁ Zoti im! Më ndihmo që të të përkujtoj, të për mirësitë e Tua ndaj meje dhe të të adhuroj me përkushtim.



OBLIGIMET TONA FETARE



- ❁ *Përgjegjësitë tona*
- ❁ *Normat juridike të fesë*
- ❁ *Kushtet e islamit*



RRUGËT PËR NË XHENET

Një ditë, Muadhi (r.a.), e pyeti Pejgamberin (a.s.):

- O i Dërguar i Allahut! A mund të më tregosh një punë që do të më shpjerë në xhenet dhe do të më largojë nga xhehenemi?

Pejgamberi ynë iu drejtua:

- Ti kërkon një gjë shumë të vështirë! Por kjo është shumë e lehtë për atë që e ndihmon Allahu. Shpreh përlësi (robëri) ndaj Allahut, pa i shoqëruar askënd Atij. Fal namazin me përpikmëri. Jep zekatin. Agjëro muajin e Ramazanit. Shko në haxh, nëse mundësitë që zotëron janë të mjaftueshme.

Më pas vazhdoi:

- Po tani, a dëshiron të t'i tregoj portat e mirësisë? Agjërimi është mburojë ndaj xhehenemit dhe gjynaheve. Sadakaja (lëmosha) shuan gjynahet, ashtu siç shuan uji zjarrin, namazi i natës gjithashtu.

Më pas i Dërguari i Allahut lexoi këto ajete:

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ta (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.” (Sureja Sexhde, 16-17)

Më pas tha:

- A të të tregoj për pikënisjen e punëve, shtyllën kryesore dhe më të madhërishtmen e të gjitha veprave?

Muadhi iu përgjigj:

- Sigurisht, o i Dërguari i Allahut!

Pejgamberi vazhdoi:

- Pikënisja e çdo pune është Islami, shtylla kryesore e të gjitha veprave është namazi, ndërsa më e madhërishtja e tyre është xihadi (përpjekje në rrugë të Allahut).



Më pas vazhdoi:

- A të të tregoj se cila është arteria kryesore e tyre?

Muadhi ia priti:

- Po, më trego, o i Dërguari i Allahut!

Pejgamberi (a.s.), kapi gjuhën dhe tha:

- Ruaje këtë!

Muadhi pyeti:

- O i Dërguari i Allahut! Edhe për ato që flasim, do të japim llogari?

- O Muadh! Janë pikërisht fjalët ato që i shpien më së shumti njerëzit drejt xhehenemit, - i tha Muhamedi (a.s.). (Tirmidhi, Iman, 8)



PËRGJEGJËSITË ME TË CILAT NA NGARKON FEJA

Allahu na ka dhuruar shumë mirësi, prej të cilave më e rëndësishmja është mendja. Në sajë të mendjes, ne arrijmë të dallojmë të drejtën nga e gabuara dhe të mirën nga e keqja. Prandaj, mendja dhe të menduarit janë tiparet themelore që e dallojnë njeriun nga krijesat e tjera.

Nga mendja buron edhe përgjegjësia, sepse Allahu, Dhuruesi i të gjitha këtyre mirësive, nuk na ka krijuar më kot, pa asnjë qëllim. Ai na ka urdhëruar kryerjen e veprave të dobishme dhe të mira, ndërsa të dëmshmet dhe të këqijta na i ka ndaluar. Na ka ngarkuar me disa përgjegjësi, kryerja e të cilave siguron lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër, ahiret. Ja pra, veprat, për të cilat jemi përgjegjës t'i kryejmë dhe ato prej të cilave duhet të largohemi, në gjuhën e fesë sonë quhen "përgjegjësi fetare".

Kur fillon periudha e pubertetit?

Periudha e pubertetit ndryshon sipas konstruktit trupor të fëmijëve dhe kushteve klimaterike. Kjo periudhë tek djemtë varion nga 12 deri në 15 vjeç, ndërsa tek vajzat nga 9 deri në 15 vjeçe. Fëmija, djalë ose vajzë, që arrin në moshën 15 vjeçare edhe pse nuk i shihet asnjë shenjë e pubertetit, konsiderohet i hyrë në këtë fazë zhvillimi, që do të thotë se ai është përgjegjës për zbatimin e urdhrave dhe ndalesave që na mëson feja jonë.

Kush konsiderohet i ngarkuar me përgjegjësi?

I ngarkuar me përgjegjësi fetare (mukel-lef) është ai njeri që gëzon shëndet të plotë mendor dhe që ka hyrë në fazën e pubertetit, pra ai që është përgjegjës për urdhëresat dhe ndalesat fetare. Ata që nuk gëzojnë shëndet mendor dhe fëmijët që nuk kanë arritur moshën e pubertetit, nuk janë përgjegjës në aspektin fetar.

NORMAT JURIDIKE FETARE

Çfarë janë normat juridike fetare?

Feja islame i përcakton në mënyra të ndryshme sjelljet dhe veprimet e njeriut. Normat juridike fetare nëpërmjet të cilave ne përcaktojmë sjelljet dhe veprimet tona quhen “efalu’l- mukel-lefin”.

Cilat janë emërtimet me të cilat shprehen normat juridike fetare?

Feja i grupon në tetë klasa veprat dhe sjelljet e njeriut:

PUNET E MUKELEFIT

- | | |
|-------------|-------|
| 1. Farz | ☺☺☺☺ |
| 2. Vaxhib | ☺☺☺ |
| 3. Sunet | ☺☺ |
| 4. Mustehab | ☺ |
| 5. Mubah | ☹ |
| 6. Mekruh | ☹☹ |
| 7. Haram | ☹☹☹☹ |
| 8. Mufsid | ☹☹☹☹☹ |



Farzi ☺☺☺☺

Farz quhen të gjitha ato adhurime, zbatimi i të cilave, sipas fesë islame, është i detyrueshëm, si p.sh.: falja e namazit, agjërimi dhe zekati.

Kush i kryen farzet, fiton shumë sevape, ndërsa kush nuk i zbaton ato pa pasur arsye, bën një gjynah të madh. Kush nuk i beson njërit prej farzeve dhe e mohon si një urdhër të fesë, konsiderohet i dalur nga feja islame.

Farzi është dy llojesh:

a) Farz Ajn: Është ai farz, që duhet të përmbushet nga çdo mysliman, që ka hyrë në fazën e përgjegjësisë fetare. Falja e pesë kohëve të namazit dhe agjërimi i muajit të Ramazanit, janë disa nga farzet ajn.

b) Farz Kifaje: Është ai farz që, kur përmbushet nga disa myslimanë, i shkarkon të tjerët nga përgjegjësia ndaj tij. Por, nëse asnjë mysliman nuk e përmbush atë, atëherë të gjithë myslimanët janë përgjegjës dhe gjynahqarë për moszbatimin e tij. Fjala vjen, kur një mysliman vdes dhe një grup besimtarësh ia fal xhenazen, atëherë, nga ky detyrim shkarkohen edhe myslimanët e tjerë.

Vaxhib 😊😊😊

Vaxhib quhen të gjitha ato adhurime, zbatimi i të cilave, sipas fesë islame, është i detyrueshëm, por argumenti fetar tek i cili mbështeten nuk është i prerë si në rastin e farzit. Ndër vaxhibet mund të përmendim: falja e namazit të Bajramit, dhënia e sadakasë në muajin e Ramazanit dhe therja e kurbanit.

Ai që zbaton me përpikmëri vaxhibet, fiton sevape, ashtu si në rastin e farzit, ndërsa ai që nuk i kryen ato, ngarkohet me gjynahe. Dallimi mes farzit dhe vaxhibit është se personi që mohon farzin del nga feja, ndërsa ai që mohon vaxhibin nuk del nga feja, por është gjynahbërës.



Suneti 😊😊

Sunet janë veprimet, përveç farzeve dhe vaxhibeve, që ka kryer Pejgamberi ynë dhe na ka këshilluar t'i kryejmë.

Suneti është dy llojesh:

a) Suneti muekkede

Përfshin ato veprime që Pejgamberi ynë i ka praktikuar rregullisht dhe rrallëherë i ka lënë pa kryer. P.sh: suneti i sabahut, i drekës, i akshamit dhe teravija.

b) Suneti gajri muekkede

Përfshin ato veprime që Pejgamberi ynë, herë i ka bërë e herë i ka lënë pa bërë. P.sh.: suneti i ikindisë dhe suneti i parë i jacisë.

Kush i kryen sunetet, fiton sevape dhe përfiton ndërmjetësimin e Pejgamberit (shefaat) në botën tjetër, ndërsa kush i lë ato, thjesht nuk përfiton asnjë sevap.



Mustehab 😊

Mustehab quhen adhurimet të cilat janë të pëlqyeshme dhe që burojnë nga tërësia e rregullave islame.

Ato quhen edhe "nafilë" ose "mendub". P.sh. të falësh namazin e duhasë (paradites), të agjërosësh të hënave dhe të enjteve, të japësh sadaka dhe të shkëmbesh dhurata.

Kush i bën gjërat mustehab, fiton sevape, ndërsa kush nuk i kryen ato, nuk bën gjynah.



Mubah ☹️

Mubah janë sjellje apo veprime të lira, që janë lënë në dëshirën e njeriut. Ne nuk fitojmë sevape, kur bëjmë një veprim që është mubah dhe nuk fitojmë gjynah, kur nuk e kryejmë atë. P.sh.: ngrënia, pirja, ecja, gjumi etj.



Mekruh ☹️☹️

Mekruh quhen veprat dhe punët të cilat janë të papëlqyeshme, sipas fesë islame.

Ka dy lloje mekruh:

a) Mekruh që është afër haramit janë veprimet dhe punët, të cilat janë të ndaluara në fenë islame, por që nuk mbështeten në një argument të prerë, si në rastin e haramit.

Kush bën mekruh të tillë, si pirjen e duhanit, mosfaljen e namazit të Bajramit, mosfaljen në kohë namazin e ikindisë dhe shtyrjen e

tij deri afër kohës së perëndimit të diellit, pa pasur ndonjë arsye, quhet gjynahbërës.

b) Mekruhet që janë afër hallallit janë punët ose veprimet, të cilat nuk janë të pëlqyeshme në fenë tonë.

Kush bën një veprim të tillë, nuk është gjynahbërës, por bën një punë jo të hijshme. P.sh. pastrimi i hundës me dorë të djathtë.



Haram ☹️☹️☹️

Haram quhen punët dhe veprimet të cilat janë rreptësisht të ndaluara në fenë tonë. P.sh.: vrasja e një njeriu, vjedhja, përdorimi i pijeve alkoolike, imoraliteti (zina), kumari, ngrënia e mishit të derrat, mosrespektimi i prindërve, përgojimi dhe thashethemet etj.

Kush bën një punë haram, thyen urdhrin e Allahut duke bërë kështu një gjynah shumë të madh. Ata që u largohen harameve, fitojnë dashurinë e Allahut, si dhe shumë sevape. Ai që e mohon, qoftë edhe një vepër haram, duke e konsideruar atë si hallall, del nga feja islame.

Mufsid 🚫

Mufsid quhen veprimet dhe punët që prishin adhurimin e filluar. P.sh.: të folurit e prish namazin dhe

ngrënia ose pirja me vetëdije e prish agjërimin. Adhurimi i prishur duhet të kryhet përsëri nga e para.

KUSHTET E ISLAMIT

Detyrat me të cilat ngarkohemi nga përkatësia jonë islame, janë disa. Ndër më kryesoret janë “Kushtet e Islamit”.

Këto kushte janë pesë:

1. Shehadeti. *Esh'hedu en la ilahe il-lall-llah ve esh'hedu en-ne Muhammeden abduhu ve resuluhu.* Që do të thotë: Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i Dërguari i Tij.

2. Falja e namazit.

3. Agjërimi i muajit të Ramazanit.

4. Dhënia e zekatit.

5. Shkuarja në haxh.

Kushti i parë, shehadeti, është baza e besimit në fenë islame, ndërsa të tjerat janë adhurimet themelore që ky besim përmban.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Shtyllat e Islamit janë pesë: Besimi se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i Dërguari i Tij, falja e namazit, agjërimi i muajit të Ramazanit, dhënia e zekatit dhe shkuarja në haxh.”

(Buhari, Iman 1)



Kushtet e Islamit

Islami ka pesë kushte
Ti dish bile një lumturi është
Kush u bindet këtyre
Rruga për në xhennet i hapet

I pari nga kushtet
Është fjala e dëshmisë
Përveç Allahut të madh dhe të
vetëm
S'ka tjetër zot padyshim
Pejgamberi i fundit i Tij
Është Muhamedi i Lartë.


Kushti i dytë është namazi
Sa adhurim i bukur që është ai
Gjysëm ore në ditë
I nxë pesë kohë shërbim...

Kushti i tretë është Ramazani
Në agjërim është nijeti
Pa ngrënë dhe pa pirë
Kalon koha me gëzim

Kushti i katërt është zekati
Nëse Allahu ka dhënë pasuri
Ndaje për dyzet atë
Dhe njëren dhuroje ti!...

Të shkosh një herë në haxh
Nëse bëhet e mundur
Kushti i pestë i Islamit
Vizita në Qabe.

Gokhan EVLIJA OGLU



BURRI NGA NEXHDI

Talha bin Ubejdullah tregon:

Njëherë erdhi tek Profeti ynë një burrë nga Nexhdi me paraqitje jo të rregullt, zërin e të cilit e dëgjonim nga larg, por që nuk e kuptonim. Iu afrua të Dërguarit të Allahut dhe në atë çast pyeti se ç'ishte Islami. Më pas Pejgamberi ynë i tha:

- "Falja e pesë kohëve të namazit në ditë."

- A ka ndonjë namaz tjetër që më duhet ta fal? - pyeti burri:

- Jo, por, nëse fal nafile, ajo është gjë e mirë, - u përgjigj i Dërguari i Allahut. Duke mos e ndërprerë fjalën vazhdoi:

- Gjithashtu është edhe agjërimi i muajit të Ramazanit.

- A ka ndonjë agjërim tjetër? - pyeti burri përsëri.

- Jo nuk ka, por, nëse agjëron nafile, ajo është gjë e mirë, - u përgjigj i Dërguari i Allahut.

Ravi Talha tregon se Pejgamberi (a.s.), i tha burrit që të jepte zekat dhe burri përsëri pyeti:

- A ka ndonjë sadaka tjetër që më duhet ta jap?

- Jo nuk ka, por, nëse jep nafile, ajo është gjë e mirë.


Këtë herë burri u largua nga Profeti duke thënë:

- Nuk do të bëj as më pak as më shumë nga këto që më the.

Pas kësaj, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha:

- Nëse do t'i qëndrojë, do të shpëtojë.

(Buhari, Iman 34, Savm 1, Shehadat 26, Hijel 3; Muslim, Iman 8, 9.)



PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

Shënjoni kutinë “e saktë” ose “e gabuar” në varësi të diturive që keni marrë në këtë kapitull.

- ❁ Allahu i Madhëruar ka urdhëruar gjërat të cilat janë të dobishme dhe të mira për ne dhe ka ndaluar gjërat e dëmshme dhe të këqija. E SAKTË E GABUAR
- ❁ Edhe fëmijët që janë me të meta mendore dhe që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, janë të obliguar nga ana fetare. E SAKTË E GABUAR
- ❁ Kush i kryen farzet, fiton sevape, ndërsa kush nuk i kryen, pa pasur ndonjë arsye, bën gjynah. E SAKTË E GABUAR
- ❁ Kush nuk beson njërin prej farzeve apo nuk e pranon atë si urdhër të fesë, konsiderohet i dalë nga feja islame. E SAKTË E GABUAR
- ❁ T'i kundërshtosh prindërit është gjynah. E SAKTË E GABUAR

TË TESTOJMË VETEN

1. Cila nga pikat e mëposhtme është farzi ajn?
 - a) Këndimi i ezanit
 - b) Agjërimi i Ramazanit
 - c) Thirrja e ikametit
 - d) Bërja e tesbihëve
2. Cila nga pikat e mëposhtme është farzi kifaje?
 - a) Falja e namazit
 - b) Shkuarja në haxh
 - c) Dhënia e zekatit
 - d) Falja e namazit të xhenazes
3. Cila nga pikat e mëposhtme është Suneti gajri muekkede?
 - a) Suneti i namazit të ikindisë
 - b) Suneti i namazit të akshamit
 - c) Namazi i vitrit
 - d) Suneti i namazit të sabahut
4. Cila nga pikat e mëposhtme nuk është haram?
 - a) Gënjeshtria
 - b) Hajdutëria
 - c) Sporti
 - d) Kumari

5. Cila nga pikat e mëposhtme nuk është mekruh tahrime?
- a) Të pastruarit e hundës me dorën e djathtë
 - b) Mosfalja e namazit të Bajramit
 - c) Falja e namazit të ikindisë pak para se të perëndojë dielli
 - d) Pirja e duhanit

FJALËT BRENDË KLLAPAVE VENDOSINI NË VENDET E DUHURA

(farz, mekruh, haram, vaxhib, i obliguar (mukel-lef), mubah, mustehab, farz kifaje, sunet muekede, farz ajn)

- ❁ Ai që ka arritur moshën e pjekurisë dhe që është përgjegjës për urdhrat dhe ndalimet e fesë sonë quhet
- ❁ Adhurimet e urdhëruara në mënyrë të prerë për t'u bërë quhen.....
- ❁ Farzet që duhet t'i kryejë çdo mysliman quhen
- ❁ Farzet që mjafton të kryhen nga disa myslimanë quhen
- ❁ Adhurimet e urdhëruara për t'u bërë, por që nuk janë të mbështetura në argumente të prerë, siç është farzi, quhen
- ❁ Sunetet që Pejgamberi ynë i ka bërë vazhdimisht dhe i ka braktisur në pak raste quhen
- ❁ Ssjelljet e mira dhe të pëlqyeshme që bëhen sipas rregullave të përgjithshme të fesë sonë quhen
- ❁ Sjjelljet apo veprimet që mund të bëhen apo mund edhe të mos bëhen quhen
- ❁ Sjjelljet apo veprimet që feja jonë i ndalon në mënyrë të prerë quhen
- ❁ Sjjelljet apo veprimet që feja jonë i quan të papëlqyeshme për t'u bërë quhen



SIMBOLI I QYTETËRIMIT ISLAM



PASTËRTIA



- ❁ *Feja islame dhe pastërtia*
- ❁ *Llojet e pastërtisë*
- ❁ *Marrëdhënia pastërti-adburim*
- ❁ *Rëndësia që i ka dhënë Pejgamberi (a.s.) pastërtisë*



GRUAJA QE PASTRONTE SHTEPINE E ALLAHUT

Na ishte një herë një grua e moshuar që quhej Ummu'l-Mihxhen, e cila banonte në njërën nga lagjet e Medines. Një ditë kjo nënë e dashur, me plot ndjenja dhe mendime të pastra, mendoi:


- Meqënëse Allahu i Lartmadhëruar e pastroi zemrën time nga mosbesimi edhe unë do ta mbaj pastër shtëpinë e Tij. Kështu, ajo vendosi që çdo ditë të pastronte mesxhidin, vendin ku faleshin besimtarët dhe nga ku Pejgamberi (a.s.), mbante ligjëratën.

Ishte e varfër, por zemrën e kishte të pasur. Sa herë që pastronte mesxhidin, ndiente sikur pastronte edhe zemrën e saj, në të cilën gufonte një gëzim dhe lumturi e papërshkrueshme.

Me kalimin e kohës, Ummu'l-Mihxhen u sëmur. Ajo nuk arrinte të falej në xhami së bashku me Pejgamberin (a.s.), pasi dergjej në shtrat. Me shpirt ishte në mesin e atyre njerëzve të mirë që faleshin me Pejgamberin (a.s.). Dëshironte që të shërohej dhe të vazhdonte përsëri punën, por shëndeti i saj nuk po përmirësohej. Në veshë i kumbonte zëri qetësues i Pejgamberit (a.s.), tek u drejtohej njerëzve me zërin e tij të ëmbël profetik, ndërsa në shpirt i vlonte dëshira për ta njomur edhe njëherë ballin me sexhde.

Një ditë Pejgamberi pyeti për të. Fqinjët e saj i thanë:

- Eshtë e sëmurë, o i Dërguari i Allahut.



Me ta marrë vesh këtë lajm, Pejgamberi (a.s.), shkoi në shtëpinë e saj. Disa njerëz kishin shkuar tek ajo përpara dhe e kishin lajmëruar se Pejgamberi (a.s.), ishte duke ardhur për ta vizituar.

Kur Ummu'l-Mihxhen e dëgjoi këtë, nuk dinte se ç'të bënte nga emocionet. Zemra e saj e vetmuar nga sëmundja, filloi të dridhej me shpejtësi. Në ballë iu panë bulëza djerse. Nuk kaloi shumë dhe u dëgjua një zë i ëmbël.

Es-selamu alejkum!

Ishte Pejgamberi (a.s.)

Pastaj një zë i dobët që shprehte faëndërimin.

- Ve alejkum salam, o i Dërguari i Allahut!

Vizita ishte e shkurtër, por kishte vlera shumë të mëdha. Pejgamberi i Allahut ishte babai i jetimëve dhe i të dobtëve. Ai i vizitonte njerëzit e pastër, si në aspektin shpirtëror ashtu edhe në atë material. "Allahu është i pastër dhe i do të pastrit" (Tirmidhi, Edeb, 41). Ai i donte shumë myslimanët, që i kush-tonin kujdes pastërtisë së trupit, shpirtit dhe vendit ku banonin.

Pejgamberi (a.s.) vazhdimisht i pyeste

fqinjtë rreth gjendjes shëndetësore të Ummu'l-Mihxhenit. Më në fund, u tha fqinjve:

- Nëse Ummu'l-Mihxheni ndërron jetë, mos e varrosni pa më njoftuar!

Një mbrëmje, Ummu'l-Mihxheni, ia dorëzoi shpirtin e saj qelibar, plot dashuri për Allahun dhe për më të Dashurin e Tij, melekut të vdekjes, Azrailit.

Fqinjtë e saj, pa humbur kohë, e lanë dhe e qefinosën. U drejtuan për në shtëpinë e të Dërguarit të



Allahut. Mirëpo koha kishte ecur, jacia ishte falur dhe Pejgamberi po flinte.

Ata menduan se nuk do të ishte me vend që të shqetësohej i Dërguari i Allahut, sepse në gjumë mund t'i vinte shpallje. Vendosën që mos ta shqetësojnë.

Kështu, Ummu'l-Mihxhen, u dërgua në banesën e saj të fundit. Iu fal namazi i xhenazes dhe u varros. Të pranishmit bënë dua që Allahut ta mëshironte.

Kur i Dërguari i Allahut pyeti në mëngjes për të, ata i thanë:

- E kanë varrosur, o i Dërguari i Allahut. Fqinjët e saj erdhën tek ju për t'ju njoftuar pasi

kishin përfunduar përgatitjet e xhenazes, por ju ndërkohë po flinit. Nuk e pamë të arsyeshme t'ju shqetësonim.

Pejgamberi (a.s.) urdhëroi:

- Ejani së bashku me mua!

Ata ecën drejt varrezave. Komshinjtë i treguan vendin e varrit, ku prehej Ummu'l-Mihxhen. Pejgamberi (a.s.) dhe shokët e tij, ia falën përsëri namazin e xhenazes dhe u larguan duke iu lutur Allahut të Lartë që ta mëshironte.

AHMET LUTFI KAZANXHI

FEJA ISLAME DHE PASTËRTIA

Feja islame është feja e pastërtisë. Pastërtia është baza e adhurimeve tona. Pastërtia e trupit, e rrobave dhe kryesisht e moralit, tregon përkatësinë tonë islame. Jeta e shëndetshme kushtëzohet nga pastërtia. Për këtë arsye, feja islame i ka dhënë rëndësi të veçantë pastërtisë.

Një nga urdhëresat e para të Kuranit është "rrobat e tua pastroji" (el-Muddeththir, 4). Kjo tregon rëndësinë që ka pastërtia në fenë islame. Pejgamberi (a.s.), ka theksuar domosdoshmërinë e pastërtisë në fenë tonë, duke thënë se: "Pastërtia është gjysma e besimit" (Muslim, Taharet, 1).

Islami i ka dhënë rëndësi të veçantë edhe pastërtisë së mjedisit. Pejgamberi (a.s.), ka kër-

kuar ta mbajmë pastër ambientin. Ai i ka përgëzuar me xhenet njerëzit që mbajnë pastër vendet publike dhe që nuk e dëmtojnë këtë pastërti:

"Një njeri pa në mes të rrugës një degë peme dhe tha me vete:

- Beto hem në Allahun, se unë do ta heq nga ai vend atë degë peme që mund t'i pengojë myslimanët tek ecin. Ai e hoqi atë dhe për këtë arsye hyri në xhenet" (Buhari, Edhan 32, Medhalim 28)

Pastërtia sipas Islamit nuk është vetëm pastrimi fizik. Kur një mollë bie në tokë, ne e marrim dhe e shpëllajmë atë. Kështu ne bëjmë pastrimin fizik të saj. Por, nëse molla është e

vjedhur, sado ta lajmë atë, ajo mbetet e papastër, sepse ajo është haram, pra në planin fetar është e papastër.

Ashtu siç ndotin papastërtitë morale trupin, rrobat dhe ambientin tonë, ashtu edhe gjynahet, fjalët dhe sjelljet e këqija ndotin zemrën tonë. Ne duhet të pastrohemi nga këto papastërti shpirtërore, në mënyrë që të jetojmë të lumtur dhe të qetë. Pastrimi shpirtëror bëhet i mundur me anë të pendimit, e më pas kryerjes

së adhurimeve dhe sjelljeve të bukura. Allahu i Lartë në lidhje me këtë thotë:

“Padyshim që Allahu i do ata që pendohen dhe që pastrohen” (Bekara, 222)

Përfundimisht, ne duhet të mbajmë pastër trupin, rrobat, mjedisin që na rrethon dhe gjithashtu ta zbukurojmë moralin duke qëndruar larg gjynaheve, fjalëve dhe veprimeve të ndaluara.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Padyshim që Allahu i do ata që pendohen dhe që pastrohen.”

(Bekare 222)

PASTERTIA DHE MYSLIMANI

Pastërtia dhe e drejta
Janë thelbi i fesë sonë
Padyshim që fjala më e drejtë
Është ajo e Zotit tonë.

Çdo rob që pendohet
Pastrohet nga papastërtitë e zemrës
Nga sherri i shejtanit nuk ndikohet
Dyshim i fal ai jetës

Çdo besimtar që merr abdest
Gëzohet i emocionuar
Pasi pastron gjynahun e vet
çdo pikë duke pikuar

Me trupin dhe shpirtin e tij
Myslimani i pastër mbetet
Nuk ndahet nga e drejta
Përherë. respektohet

Kasim AK





LLOJET E PASTËRTISË

Pastërtia na mbron nga fëlliqësitë shpirtërore, morale, fizike dhe materiale.

Pastërtia është dy llojesh:

1. Pastërti materiale

Materialet që strehojnë mikrobe, si gjaku, jashtëqitja ose qelbi, konsiderohen të pista, sipas fesë islame. Pastrimi i trupit, i rrobave dhe i mjedisit quhet pastërti materiale. Gjatë pastrimit material duhet të kujdesemi për:

a. Pastërtisë së trupit: Trupi ynë ndotet nga djersitja dhe nga shkaqe të tjera të ndryshme. Gjithashtu shëndetin tonë e kërcënojnë edhe mikrobet që lindin dhe zhvillohen në trupin tonë. Rruga më e mirë për të pastruar trupin nga këto papastërti dhe mikrobe është larja e trupit me ujë të ngrohtë dhe me sapun. Prandaj, për të ruajtur shëndetin tonë, mirësinë më të madhe të dhuruar

nga Allahu, duhet të lahemi, të paktën një herë në javë. Është kusht pastrimi i trupit nga nexhaseti. Me nexhaset kuptojmë papastërtitë fizike që shkaktohen nga jashtëqitja, gjaku, qelbi etj.

b. Pastërtisë së duarve: Duart janë gjymtyrët që përdorim më shpesh gjatë ditës, prandaj ato ndoten më shumë. Papastërtia e duarve krijon vatra të përshtatshme për shumimin e mikrobeve. Këto mikrobe kalojnë në trupin tonë nëpërmjet ushqimeve, duke u bërë kështu burim sëmundjesh të ndryshme. Prandaj, ne duhet t'i lajmë duart para dhe pas ngrënies. Duart duhet t'i lajmë mirë e mirë me sapun, pas kryerjes së nevojave personale.

c. Pastërtisë së fytyrës: Organi i fytyrës ndikohet më së tepërmi nga pluhurat dhe papastërtitë. Larja e fytyrës heq lodhjen dhe dhembjet

e kokës. Ajo na jep energji, si dhe paraqitje të bukur dhe të shëndetshme. Për këtë arsye, duhet ta lajmë shpesh fytyrën gjatë ditës.



d. Pastërtisë së gojës: Grimcat e ushqimeve që hamë, mblidhen kryesisht tek dhëmbët. Pas ca kohësh, nëse nuk i lajmë dhëmbët rregullisht, këto mbetje fillojnë të prodhojnë bakterie të dëmshme. Kjo shkakton erë të keqe të gojës dhe prishjen e dhëmbëve. Prishja e dhëmbëve është një ndër shkaqet kryesore të sëmundjeve të ndryshme, si ato të stomakut, të zembrës, si dhe sëmurjen e bajameve. Për të parandaluar këtë, duhet ta mbajmë pastër gojën dhe të lajmë dhëmbët të paktën dy herë në ditë.



e. Pastërtisë së këmbëve: Të gjithë peshën e trupit e heqin këmbët. Këmbët djersiten nga këpucët. Larja e këmbëve, duke pasur kujdes pjesën ndërmjet gishtave, na bën më të shëndetshëm dhe më dinamikë. Prandaj duhet t'i lajmë mirë dhe shpesh këmbët. Duhet t'i fshijmë me një copë të thatë, në mënyrë që të mënjanojmë formimin e disa sëmundjeve të lëkurës. Gjithashtu, duhet t'i kushtojmë kujdes edhe pastërtisë së çorapeve dhe të këpucëve.



f. Pastërtisë së thonjve: Prerja e thonjve është pjesë e pastërtisë së duarve dhe këmbëve. Nuk duhet të harrojmë se thonjtë janë një vatër e mundshme mikrobesh. Ne mund ta kuptojmë më mirë rrezikun që paraqet papastërtia e thonjve, duke menduar për një çast veprimet që kryejmë me gishta, si për shembull kontakti i tyre me gojën, syrin, veshin etj.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Përdorimi i misvakut pastron gojën dhe e gëzon Allahun”

(Nesai, Taharet 4)



Unë mendoj se pastërtia e dhëmbëve është shumë e rëndësishme, por jo e mjaftueshme. Përpiqem të pastrohem edhe nga ndjenjat dhe sjelljet e këqija. Kur ia arrij kësaj, besoj me gjithë zemër se Zoti i Lartmadhëruar do të më dojë edhe më shumë.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Shkurtoji thonjtë! Pasi gjërat e dëmshme strehohen tek thonjtë e zgjatur”

(Dejlemi, Musnedu'l-firdeus, 4579)



g. Pastërtia në tualet: Pastërtia në tualet ka një rëndësi të veçantë për shëndetin dhe adhurimet tona.

Duke hyrë në tualet, thuhet kjo lutje:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْخُبْثِ وَالْخَبَائِثِ

“Zoti im! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga fëlliqësitë dhe papastërtitë e ndryshme!”

Ndërsa duke dalë prej tualetit thuhet kjo lutje:

غُفْرَانَكَ الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَدَّبَنِي وَعَافَانِي

“Zoti im, kërkoj faljen Tënde! Falënderimet i takojnë Allahut, i Cili më ruajti shëndetin duke larguar prej meje çdo gjë që më shqetësonte.”


h. Pastërtia e rrobave: Kur ndoten rrobat që na mbrojnë nga të nxehtët dhe nga të ftohtët, dëmtojnë trupin dhe ambientin tonë. Për të penguar dëmin e papastërtive dhe të mikrobeve, duhet që t’i ndërrojmë dhe t’i lajmë në kohë të caktuara.

i. Pastërtia e ushqimeve dhe pijeve: Mikrobet zakonisht hyjnë në trup nëpërmjet ushqimeve dhe pijeve të ndryshme. Për të mbrojtur shëndetin, duhet që para se të hamë, t’i lajmë frutat dhe perimet. Një kujdes të veçantë duhet t’u kushtojmë edhe pijeve të ndryshme të lejuara.

i. Pastërtia e ambientit: Pastërtia e ambientit realizohet duke mbajtur të pastër fillimisht shtëpinë, lagjen, rrugën, shkollën dhe më pas edhe vendin ku ne jetojmë. Mbajtja pastër e ambientit është shumë e rëndësishme për t’u mbrojtur nga sëmundjet, për pastërtinë e ujërave që pimë dhe për jetën e gjallesave jashtë nesh. Duke mbajtur të pastër ambientin tonë, nuk duhet t’i shqetësojmë dhe dëmtojmë të tjerët. Në një hadith, Muhamedi (a.s.), ka thënë: “Një person,

Për çfarë duhet të kujdesemi gjatë pastrimit në tualet?

1. Të kemi kujdes që rrobat të mos hasin në tokë dhe të mos ndoten.
2. Para se të hyjmë në tualet, bëjmë një dua të tillë: “Zoti im! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga fëlliqësitë dhe papastërtitë e ndryshme!”
3. Në tualet hyjmë me këmbë të majtë.
4. Nevojat personale i kryejmë duke qenë të ulur.
5. Gjatë pastrimit përdorim ujë të bollshëm dhe letrën e tualetit.
6. Gjatë pastrimit përdorim dorën e majtë.
7. Në tualet nuk duhet të hamë, të pimë dhe të flasim.
8. Nga tualeti duhet të dalim me këmbë të djathtë.
9. Në dalje bëjmë këtë dua: “Zoti im, kërkoj faljen Tënde! Falënderimet i takojnë Allahut, i Cili më ruajti shëndetin duke larguar prej meje çdo gjë që më shqetësonte.”
10. Pasi kryejmë nevojat personale, lajmë duart me ujë të bollshëm dhe me sapun.



duke ecur në rrugë, vuri re një degë me gjemba dhe e hoqi atë nga rruga. Me këtë veprim që bëri, ai fitoi kënaqësinë e Allahut dhe faljen e Tij.” (Muslim, Birr 127, Imare 164)

2. PASTERTIA E BRENDSHME

Pastërtia e brendshme lidhet me pastërtinë e zemrës, ndjenjave dhe mendimeve tona.

Pastërtia e brendshme ndahet në dy pjesë:

a. Pastërtia e zemrës: Shoqëritë që përbëhen nga njerëz me zemër të pastër dhe moral të mirë janë të qeta dhe të lumtura. Për të krijuar një shoqëri të tillë, edhe ne duhet ta pastrojmë zemrën tonë nga sjelljet, idetë dhe mendimet e këqija, si: egoizmi, gënjeshtria, dyfytërsia, të folurit pas krahëve. Duhet të qëndrojmë larg urrejtjes dhe mllefrit. Nuk duhet të kemi smirë. Në një ajet kuranor thuhet “Vërtet, kushdo që pastrohet, do të shpëtojë”. (Sure Shems, ajeti 9)

b. Pastrimi nga çdo gjë që konsiderohet e papastër fetarisht: Marrja e gusulit dhe abdestit në situata të nevojshme. Thënë ndryshe, shmangia e çdo lloj papastërtie, mungese abdesti ose gusuli, që na pengon të kryejmë adhurimet tona.

Pejgamberi ynë (a.s) ka thënë:

“Dijeni mirë që në trupin e njeriut gjendet një copë mishi. Nëse ajo është mirë, i gjithë trupi ndjehet mirë. Nëse ajo prishet edhe trupi prishet. Ja pra, kjo copë e vogël mishi është zemra.”

(Buhari, Iman 39)

PASTËRTIA DHE SHËNDETI

Të pastër vishuni, të rregullt shëtisni,
Të të respektojë secili.
Askush nuk e do papastërtinë.
A ka mirësi më të madhe sa shëndeti?

Mburrja, egoizmi, gënjeshtria dhe
mashtrimi
Zemra është e ndotur, besoji këtij.
Është i pastër kush i qëndron larg.
A ka mirësi më të madhe se shëndeti?

Mos shko në vendin ku sjell mikrobe,
Mos pështyj nëpër rrugë.
Jep dhimbje plaga.
A ka mirësi më të madhe se shëndeti?

Një trup i pastër, një ambient i pastër,
Kujdes, mos i lejo papastërtinë
Shëndetit, pasurisë dhe varfrisë.
A ka mirësi më të madhe se shëndeti?

Ahmet EFE



Cila është marrëdhënia ndërmjet pastërtisë dhe adhurimit?

Feja islame i afron njerëzit me Krijuesin e tyre, por gjithashtu ajo synon edhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore. Prandaj feja islame na urdhëron të bëjmë kujdes ndaj pastërtisë. Ajo na obligon që të parapërgatitemi ndaj kryerjes së disa adhurimeve, duke marrë abdest ose gusël.

Gjatë adhurimit ne dalim para Allahut. Para Tij duhet të dalim të pastër, duke i kushtuar shumë rëndësi pastërtisë së trupit, rrobave dhe vendit ku do të kryejmë adhurimet tona. Ne nuk dëshirojmë t'i afrohem askujt, kur jemi të papastër, kur trupi dhe rrobat mbajnë erë. Nuk mund t'i qëndrojmë afër një më të madhi në moshë apo një shoku në raste të tilla, por bëjmë banjë dhe veshim rroba të pastra. Gjatë adhurimeve të ndryshme duhet të kujdesemi edhe më shumë ndaj higjienës, sepse në ato momente jemi pranë Zotit.

Disa nga adhurimet, si namazi i xhumasë apo i bajramit, kryhen në grup. Në këto adhurime

ne dalim para Allahut, por gjithashtu jemi edhe pranë njerëzve të tjerë. Prandaj themi që pastërtia gjatë këtyre adhurimeve është edhe më e rëndësishme.

Adhurimet na bëjnë të fitojmë disiplinën e të genit të pastër në çdo drejtim. Duke i kushtuar kujdes pastërtisë, para dhe gjatë adhurimit, pastrojmë anën tonë të brendshme, por edhe atë të jashtme.

Gjithashtu, çdo adhurim është në funksion të pastrimit të zemrës. Ato e largojnë zemrën nga ndjenjat dhe mendimet e këqija. P.sh.: Zekati pastron zemrën nga veset e koprracisë dhe të zilisë, ndërsa agjërimi e pastron atë nga koprracia, egoizmi, brutaliteti dhe mendjemadhësia. Kështu, të gjitha adhurimet na pastrojnë nga gjynahet duke na larguar prej tyre përgjithmonë.

Një herë Pejgamberi (a.s.), pyeti shokët: "Si mendoni?! Nëse afër shtëpisë së njërit prej jush do të gjendej një lumë dhe ai do të lahej përditë në të, a do t'i mbetej ndonjë papastërti?"

Ata iu përgjigjën:

- Jo, atij nuk do t'i mbetej asnjë grimcë papastërtie në trup.

Pejgamberi ynë vijoi:

- Ja pra, edhe pesë kohët e namazit janë të ngjashëm me këtë lumë. Me pesë kohët e namazit Allahu i fshin, pastron të gjitha gjynahet."

(Buhari, Mevakit 6; Muslim, Mesaxhid 283)



PEJGAMBERI YNË I JEpte RËNDËSI PASTËRTISË

Pejgamberi (a.s.), i jepte shumë rëndësi pastërtisë. Ai vazhdimisht i lante duart para dhe pas ushqimit. Kur zgjohej nga gjumi, nuk hante dhe nuk pinte asgjë, pa larë më parë duart.

Puna e parë që bënte, kur ngrihej në namazin e natës dhe të sabahut, ishte larja e dhëmbëve me misvak. Edhe në momentin e fundit të jetës u kishte kërkuar njerëzve që e rrethonin, një misvak për të pastruar dhëmbët.

Pejgamberi (a.s.), aq sa i kushtonte kujdes pastërtisë së zemrës, po aq i kujdesshëm tregohej edhe ndaj pastërtisë së trupit dhe të rrobave. Kishte raste kur vishte edhe rroba të vjetra, por asnjëherë nuk dilte me rroba të grisura apo të ndotura. Ai i kushtonte më tepër kujdes anës së tij të jashtme, kur priste ndonjë mysafir.

Ai i mbulonte enët e ushqimeve për t'i ruajtur nga ndotja e ambientit. Urdhëronte mbajtjen pastër të rrugëve apo të vendeve të ndryshme, ku njerëzit uleshin për të pushuar.

Pejgamberi (a.s.), dëshironte që brenda mundësive, çdo mysliman të vishej mirë dhe t'i kushtonte rëndësi pamjes së tij. I tërhiqte vërejtjen në mënyrë të kujdesshme çdo personi të papastër duke i thënë: "Pse nuk i pastron rrobat?"

Njëherë, kishte parë një person me flokë të pakrehura dhe të ndotura dhe e kishte pyetur për arsyen e kësaj. Sipas Pejgamberit (a.s.), çdo mysliman duhet të jetë i rregullt.

Pejgamberi ynë i dashur i jepte shumë rëndësi pastërtisë. Ai vazhdimisht i lante duart para dhe pas ushqimit. Kur zgjohej nga gjumi, nuk hante dhe nuk pinte asgjë, pa larë më parë duart.



"Zoti im! Më bëj mua prej atyre që pendohen shumë dhe që kujdesen për pastërtinë e tyre."

اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَّابِينَ وَمِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ

"Zoti ynë! Na pastro neve nga gjynahet, sikurse pastrohet rroba e bardhë kur lahet."

رَبَّنَا نَقِّنَا مِنَ الذَّنُوبِ كَمَا يُنْقَى

الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ

PASTERTIA

Pastërtia vjen nga besimi, thotë Pejgamberi
Në kopshtin e lumturisë buzëqesh pastërtia ...
Si melekë bëhen ata që pastrohen
Si një krah nga xheneti për botën është pastërtia ...

Shpirti ndotet në tokë me pluhur
Edhe ana e jashtme edhe ajo e brendshme duhet të lahet
Bëhet krejt e pastër duke arritur në qetësi.
Një rrugë drejt qiellit me shtatë kate është pastërtia

Pastërtia e jashtme është të jesh si hëna.
Ajo e brendshmja është të mbushesh me hallall.
Askujt nuk i pëlqen ujitja me papastërti.
Është gjuha më e bukur për njeriun pastërtia.

Është urdhër i Allahut, mbaje pastër veshjen tënde
Ha pastër, pi pastër dhe mbaje trupin pastër
Të të themi edhe ty “Nuk mban reja papastërti”
Është një dorë që nuk të hedh në kosh pastërtia.

Është shumë gjynah të ndotesh dhe të qëndrosh i ndotur.
Kush është i ndotur vuan shumë.
Allahu i do ata që janë të pastër.
Është një gjendje që të zbardh faqen pastërtia...

M. Ali ESHMELI

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

Shënjoni kutinë “e saktë” ose “e gabuar” në varësi të mësimave që keni marrë në këtë kapitull.

- | | | |
|--|----------------------------------|-----------------------------------|
| Pastërtia është baza e adhurimeve tona. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Pastërtia arrihet vetëm nëpërmjet pastrimit fizik. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Për t'u pastruar nga gjynahet duhet të pendohemi dhe të mos i përsërisim më ato. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Në tualet hyjmë me këmbë të djathtë. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Kryerja e veprimeve të ndaluara nga Allahu e ndot zemrën. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |

Të testojmë vetveten

1. Cilë nga pohimet e mëposhtme nuk ka lidhje me hadithin “Pastërtia është gjysma e imanit”?

- Për të qenë besimtar mjafton të jemi të pastër.
- Të besosh, pra imani imponon pastërtinë.
- Trupi dhe mjedisi i një besimtari është përherë i pastër.
- Besimi i atyre që nuk i kushtojnë rëndësi pastërtisë është i dobët.

2. Cila nga alternativat e mëposhtme bën pjesë në etikën e tualetit?

- Në tualet hyhet me këmbë të majtë.
- Në pastërtinë e tualetit përdoret dora e djathtë.
- Gjatë kryerjes së nevojave personale mund të flitet.
- Pas kryerjes së nevojave personale nuk është kusht larja e duarve.

3. Çfarë është pastrimi shpirtëror?

- a) Pastrimi i vendeve ku do të falim namazin.
- b) Larja e pjatave të ushqimit.
- c) Heqja e mbeturinave nga vendet ku njerëzit mund të bëjnë pushim.
- d) Të qëndruarit larg nga gënjeshtra.

4. Cili nga veprimet e mëposhtme nuk na pastron shpirtërisht?

- a) Larja e trupit dhe e rrobave.
- b) Adhurimi.
- c) Pendimi nga gjynahet.
- d) Dhënia e zekatit dhe e sadakasë.

Vendosni fjalët brenda kllapave në hapësirat e mëposhtme

(pastrohen, gjysma, e pastër, hadeth, nexhaset)

- ✿ Pastërtia është e imanit.
- ✿ Sado që ta lajmë një mollë të vjedhur, ajo nuk konsiderohet, sepse nuk është hallall.
- ✿ Allahu i do shumë ata që pendohen dhe që
- ✿ Përpara se të kryejmë disa adhurime, duhet ta pastrojmë trupin patjetër nga gjaku, urina, qelbi që në gjuhën e fesë quhen
- ✿ Pastrimi që duhet realizuar nga papastërtitë që mund të hiqen vetëm duke marrë abdest apo gusël quhet pastrimi nga



Abdesti-GUSULI TEJEMUMI



TRI LLOJET E PASTRIMIT SIPAS ISLAMIT

❁ Abdestit

Marrja e abdestit

Rregullat e marrjes së abdestit

Urtësitë dhe dobitë e abdestit

❁ GUSULI

Marrja e gusulit

Rregullat e marrjes së gusulit

Urtësitë dhe dobitë e gusulit

❁ TEJEMUMI

Bërja e tejemumit

Rregullat e tejemumit



ABDESTI PASTRON GIYNAHET

Shite koha kur në Mekë Islami përhapej në fshehtësi. Amër bin Abese qe pjesëtari i njërit prej fiseve që jetonin në shkretëtirë. Ai qe kureshtar për fenë e re që po përhapej, prandaj shkoi në Mekë për të mësuar rreth saj. Kur mbërriti, kërkoi të takohej me Pejgamberin (a.s.). Një ditë u takua me të. Amri e pyeti Pejgamberin:

- Kush je ti dhe çfarë je?

Iu përgjigj:

- Unë jam Pejgamberi.

Amri pyeti:

- Kush të ka dërguar?

Pejgamberi vazhdoi:

- Mua më ka dërguar Allahu.

Amri sërish pyeti:

- Ç' detyra të ka dhënë Allahu të përmbushësh?

Pejgamberi iu përgjigj:

- Ndhimën dhe mirëkuptimin me farefisën, thyerjen e idhujve, besimin se Allahu është një i Vetëm dhe mosshoqërimin asgjë dhe askënd Atij.

Amër bin Abese pyeti:

- A ke fituar ndonjë njeri këndeje që të të ndihmojë?

Profeti iu përgjigj:

- Një burrë dhe një skllav.

Deri në atë moment kur po zhvillohej ky dialog, Islamin e kishin pranuar vetëm Ebu Bekri dhe Bilali.

Amri tha:

- Edhe unë dëshiroj të të qëndroj afër dhe të të ndihmoj.



Pejgamberi (a.s.), tha:

- Nuk mund ta bësh këtë. Ti e sheh gjendjen time dhe të Mekës. Kthehu dhe, kur të dëgjosh që unë e kam shpallur besimin tim haptazi, eja!

Amër bin Abese tha shehadetin dhe u bë mysliman. Qëndroi për një kohë tek Profeti dhe pas disa ditësh u kthye në vendin e tij. Ende s' ishte shpallur urdhri për faljen e pesë kohëve të namazit.

Nga kjo ditë kaluan vite dhe myslimanët emigruan nga Meka në Medinë. Me të marrë vesh këtë, Amri shkoi ta vizitonte Pejgamberin (a.s.). Kur u takua, e pyeti:

- O i Dërguari i Allahut! A më mbani mend?

Profeti tha:

- A nuk ishe ti, ai që ke folur me mua në Mekë?

Amri iu përgjigj:

- Po.

Atëherë vazhdoi:

- O i Dërguari i Allahut! Më trego gjërat e urdhëruara nga Allahu të cilat nuk i di.

Pejgamberi (a.s.), i tregoi për pesë kohët e namazit dhe mënyrën sesi duhet të faleshin ato. I tregoi se, përpara faljes së namazit, duhet marrë abdesti. Ia shpjegoi me këto fjalë Amrit abdestin:

- Atij njeriu, që përgatit ujin e abdestit dhe me të lan gojën, hundën, fytyrën, sipas rregullave, do t'i falen gjynahet e bëra me këto organe. Kur të lajë duart deri në bërryla, së bashku me ujin e abdestit do t'i rrjedhin edhe gjynahet e këtyre gjymtyrëve. Kur me dorë të lagur do të prekë një pjesë të flokëve (mes'h), do t'i bien nga flokët bashkë me ujin edhe gjynahet. E njëjta gjë ndodh, kur ai lan këmbët deri në nyje. Pasi ai fal namazin me zemër të bindur ndaj urdhrave të Tij, duke e lavdëruar Allahun, falënderuar dhe madhëruar Atë, siç e meriton Ai, nuk ka dyshim se do të pastrohet nga çdo gjynah që ka bërë.

(Muslim, Musafirin 294)



Abdesti

Çfarë është abdesti?

Abdest quhet larja dhe mes'hi me ujë i disa gjymtyrëve të caktuara sipas rregullave të Islamit.

Çfarë nuk mund të bëjmë pa abdest?

Pa abdest



- Nuk mund të falim namaz .
- Nuk mund të bëjmë tavaf rreth Qabes.
- Nuk mund të prekim Kuranin.

46

Si merret abdesti?

- 1 Bëjmë nijetin duke thënë: "E bëra nijet për hir të Allahut të marr abdest".
- 2 Fillojmë të marrim abdest duke thënë: "Eudhu bil-lahi mineshejtanirr-rraxhim. Bismil-lahirrrahmanirr-rahim".
- 3 Duart i lajmë deri në kyçe



- 4 Shpërlajmë gojën tri herë me dorën e djathtë.



- 5 Me dorën e djathtë shpërlajmë hundën tri herë, me të majtën e pastrojmë atë.



- 6 Lajmë fytyrën tri herë duke pasur kujdes që ujin mos ta përplasim për fytyrë.



- 7 Lajmë krahët tri herë deri në bërryla, duke filluar nga i djathti.



- 8 Pasi lagim dorën e djathtë sërish, prekim një herë kokën (i bëjmë mes'h asaj).



- 9 Me gishtin tregues lajmë veshët nga brenda, ndërsa me të madhin pjesën e jashtme të tyre. Me pjesën e jashtme të tre gishtave të tjerë (që janë të lagur) prekim qafën (i bëjmë mes'h asaj).



- 10 Lajmë këmbët tri herë, deri në kyçe, duke filluar me të djathtën. Këtu përfundon marrja e abdestit.

Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Atij, që merr abdest, ashtu siç duhet, më pas thotë: “Esh’hedu en la ilahe il-lall-llah ve esh’hedu en-ne Muhammeden abduhu ve resuluhu” (Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij), do t’i hapen të tetë portat e xhenetit dhe do të hyjë nga cila portë të dëshirojë.”

(Ebu Davud, Taharet 65; Tirmidhi, Taharet 41)

Burimi i ftohtë

Enesi kishte përfunduar me sukses vitin shkollor. Prindërit e tij mendonin se ai e meritonte një pushim të mirë veror, prandaj vendosën ta dërgonin në fshat, tek xhaxhai i tij. Kur mori vesh këtë lajm, Enesi u gëzua shumë. Xhaxhai erdhi për ta marrë, pas disa ditësh. Enesi pyeste kureshtar, për vendin ku do të shkonin. Por më shumë ishte kurioz për Imranin, djalin e xhaxhait. Kishte kohë pa e parë.

Përgatitjet për rrugë u bënë që në darkë. Enesi nuk kishte fjetur gjithë natën nga emocionet.

Në të gdhirë, u nis së bashku me xhaxhain e tij. Afërsisht, pas disa orësh udhëtim, mbërritën në fshat. Ai u përshtat shumë shpejt. Me Imranin e thelluan shoqërinë e tyre. Në për-

rua, së bashku bënë shtëpi prej balte. Hipnin në biçikleta dhe shëtisnin në zonat përreth.

Një mbrëmje, gjyshi Ali u foli me zë të ëmbël nipërve të tij, që po grindeshin mbi krevat, për një jastëk.

- Nëse nuk flini shpejt, nuk vini nesër me mua në bjeshkë. Unë do të nisem sapo të lindë dielli. Kush nuk zgjohet, mbetet në fshat.

Pas këtyre fjalëve, të dy ranë të flinin. Të nesërmen, gjyshi Ali, bashkë me dy nipërit u nisën. Fillimisht e tatëpjeta u ishte dukur e lehtë fëmijëve. Por sapo dielli kishte filluar të ngrohte, rruga kishte filluar të vështirësohej. Gjyshi Ali, nga njëra anë, përpiquej të vazhdon-te rrugën, nga ana tjetër u thoshte nipërve:

- Ecni bijtë e mi! Sa të kalojmë këtë kodër do të bëjmë pak pushim te burimi i ftohtë. Haj-



de edhe pak! Ky emër i kishte pëlqyer shumë Enesit, i cili pyeti:

- Gjyshi, ç'është burimi i ftohtë?

Gjyshi dhe Imrani qeshën.

- Biri im, burimi i ftohtë ndodhet pas asaj kodre. Ata që nisen për në bjeshkë kalojnë pranë tij dhe bëjnë pushim. I lajnë këmbët me ujë të ftohtë dhe burimi u heq gjithë lodhjen. Nëse kanë me vete shalqi apo pjepër, e vendosin në ujë të ftohtë. Pasi të ftohet e presin dhe e hanë.

- Ah sikur të kishim sjellë edhe ne ndonjë shalqi a pjepër! – tha Enesi.

Gjyshi Ali tregoi me shenjë nga gomari që vinte pas i lodhur.

- Në një rën anë të hejbes kemi ushqimet, ndërsa në tjetrën shalqirin dhe pjepirin. Kur ngjitemi drejt bjeshkës, asnjëherë nuk harrojmë të marrim me vete shalqi dhe pjepër.

Ideja e ngrënies të një shalqiri të freskët dhe pushimi pranë burimit i gëzoi fëmijët. Enesi u afrua te veshi i gomarit dhe i pëshpëriti diçka.

Gjyshi e pa dhe e pyeti

- Hë Enes, po flet me gomarin?

Enesi ia priti:

- I thashë se sipër ka gosti me shalqi. Shiko gjysh se si i pëshpëritoi hapat.

Më në fund u duk edhe burimi. Kur u afruan, fëmijët lanë gjyshin dhe vrapuan drejt burimit. U ulën mbi gurët e mëdhenj dhe i futën

këmbët e tyre në ujin e ftohtë. Sapo i futën, i hoqën menjëherë.

Enesi tha:

- Uji qënkë shumë i ftohtë! Jo më kot e ka marrë emrin që ka!

Burimi e kishte habitur Enesin.

Ai e pyeti gjyshin:

- Gjyshi, si ka mundësi që ky ujë i ftohtë të burojë në këtë të nxehtë mes këtyre gurëve? Si mund të barten tonelata ujë pa makineri?

Gjyshi qeshi dhe iu përgjigj ëmbël:

- Nuk ka ndonjë gjë të vështirë për Allahun, i Cili ka krijuar ujin dhe gjithësinë. Kur Ai dëshiron të bëhet diçka i thotë "Bëhu!" dhe ajo menjëherë bëhet. Nuk ka fund fuqia e Tij.

Në këtë kohë, gjyshi vuri shalqirin në ujin e ftohtë. Pasi u ftoh mirë, e hëngrën së bashku. Pas kësaj gostije, dy fëmijët u ngjitën për të mbledhur dardha në mal. Gjyshi ishte ulur në gurin e një cepi të burimit dhe po lante duart. Lau gojën dhe hundën nga tri herë. Lau tri herë fytyrën, krahun e djathtë dhe më pas të majtën. Me dorën e lagur i bëri mes' h kokës dhe me duar fshiu veshët dhe qafën. Në fund, ai lau këmbët. Enesi pyeti gjyshin:

- Gjyshi, pse po merr abdest ndër kohë që akoma nuk ka ardhur koha e namazit?

- E di, biri im! Namazin e drekës do ta fal në bjeshkë, por thashë të merrja që tani abdest. Të jesh përherë me abdest është adhurim. Të marrësh abdest është një gjë e lehtë për njeriun, por ama sevapet që fiton janë të shumta.





Që të dy përnjëherë pyetën:

- Ç' do të thotë kjo?

- Melekët ia shkruajnë si vepër të mirë besimtarit marrjen e abdestit dhe shmangien nga veprimet e këqija dhe të turpshme. Veçanërisht njeriu me abdest është më i mbrojtur nga shejtani. Sa adhurim i lehtë dhe me shumë fitime, apo jo nipërit e mi?!

Me të dëgjuar fjalët e gjyshit, fëmijët filluan menjëherë të marrin abdest.

Pasi mbaruan, gjyshi u tha:

- Tani fëmijë, mblidhni plaçkat. Kemi akoma edhe dy orë rrugë për të bërë.

HASAN TAHSIN KARAMAN

DOBITË E ABDESTIT

Abdesti na përgatit për adhurime

Më marrjen e abdestit ne përgatitemi për të kryer shumë adhurime, si faljen e namazit, leximin e Kuranit etj. Në saje të abdestit, ne dalim të pastër përpara Allahut duke u përpjekur të fitojmë kënaqësinë dhe dashurinë hyjnore.

Abdesti na pastron

Në jetën e përditshme organet që ndoten më shumë janë duart, krahët, goja, hunda, fytyra dhe këmbët. Duke marrë abdest, ne i lajmë ata disa herë në ditë, duke u mbrojtur nga shumë papastërti dhe mikrobe. Të qënurit vazhdimisht të pastër na bën të jemi më të shëndetshëm, më të kënaqur dhe më të qetë.

Pastrimi i gojës është shumë i rëndësishëm për shëndetin. Një nga vendet më të përshtatshme për formimin dhe zhvillimin e mikrobeve

është goja. Sa herë që marrim abdest, shpërlajmë gojën, duke u kujdesur për pastërtinë e saj gjatë gjithë ditës. Kështu, ne pengojmë gjallimin e mikrobeve në gojën tonë. Gjithashtu duke i kushtuar kujdes të madh higjienës së gojës, ne nuk shqetësojmë të tjerët me erën e pakëndshme të saj.

Abdesti ndihmon sistemin nervor dhe sistemin e qarkullimit të gjakut

Jemi të detyruar t'i kushtojmë një kujdes të veçantë sistemit nervor dhe atij të qarkullimit të gjakut për një jetë sa më të shëndetshme. Abdesti, pra larja e organeve, ndikon pozitivisht në funksionimin sa më të rregullt të këtyre dy sistemeve. Kështu trupi ynë bëhet më i shëndetshëm.

Abdesti zbukuron fytyrën

Marrja e abdestit ndihmon funksionimin e kapilareve të fytyrës dhe pengon gjithashtu rrudhjen e saj. Prandaj fytyrat e njerëzve që marrin abdest dhe falin namaz janë të shndritshme. Pejgamberi ynë ka thënë se ai do të na njohë në ditën e gjykimit nga rrezatimi i gjurmëve të abdestit në fytyrat tona.

Abdesti pastron zemrën nga të këqijat

Sa herë që marrim abdest, nuk harrojmë të kujtojmë Allahun. Kështu, abdesti na mbron nga gjynahet. Na pastron zemrën nga ndjenjat dhe mendimet e këqija.

Të qenit me abdest shpërblehet me sevapin e adhurimit

Kur jemi me abdest shmangemi nga çdo veprim i papëlqyer. Prandaj, Zoti me mëshirën e Tij të pakufishme, këtë gjendje e konsideron si adhurim dhe çdo moment të saj e shpërblen me shumë sevape. Si rrjedhojë, nëse vdesim me abdest shpërblehemi me sevapet e vdekjes gjatë adhurimit, duke fituar kështu sevapet e një shehidit (dëshmor islam). Kjo është një mirësi e madhe e Allahut ndaj nesh.

Abdesti i jep dritë fytyrës dhe qetësi zemrës sonë.

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“O ju që besoni! Kur të ngriheni në namaz lani fytyrat, duart deri në bërryla dhe këmbët.”

(Maide 6)

Cilat janë farzet e abdestit ?

Gjatë marrjes abdest



- 1. Larja e fytyrës:** Larja një herë e fytyrës që nga pjesa ku mbarojnë flokët e deri tek veshët dhe poshtë mjekrës.
- 2. Larja e krahëve:** Larja një herë e krahëve nga duart e deri tek byrrylat, duke i përfshirë këto të fundit.
- 3. Bërja mes'h e kokës:** Prekja e një të katërtës së kokës me dorë të lagur.
- 4. Larja e këmbëve:** Larja një herë e këmbëve deri tek kyçet.

Është farz





Sipas sunetit të Profetit çfarë duhet të kemi kujdes gjatë marrjes së abdestit?

Gjatë marrjes
abdest











- 😊 Kthimi drejt Kiblës nëse është i mundur.
- 😊 Bërja e nijetit dhe shqiptimi i Eudhu Besmelesë.
- 😊 Shpëlarja me ujë e gojës dhe e hundës.
- 😊 Pastrimi i dhëmbëve me furçë ose me misvak.
- 😊 Bërja mes'h e veshëve dhe e qafës.
- 😊 Larja tri herë e çdo organi gjatë abdestit.
- 😊 Larja e organeve duke filluar nga e djathta.
- 😊 Ndjekja e radhës që ka përcaktuar Pejgamberi (a.s.).

Është sunet



Çfarë e prish abdestin?

Gjatë marrjes
abdest

-  Kryerja e nevojave personale.
-  Nxjerrja e gazrave
-  Dalja e gjakut apo e qelbit nga ndonjë pjesë e trupit.
-  Të qeshurit në namaz aq sa të dëgjojë edhe ai që kemi pranë.
-  Të fjeturit duke u shtrirë ose duke u mbështetur diku.
-  Të rënit të fikët
-  Të vjellurit me gojë plot
-  Dehja

E prish
abdestin



DRITA E YMETIT TË MUHAMEDIT (A.S.)

Një ditë Pejgamberi (a.s.) tha:

Sa kisha dashur t'i shihja vëllezërit e mi! Më pas sahabët thanë:

A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut? Pejgamberi iu përgjigj:

Ju jeni miqtë e mi të ngushtë, vëllezërit e mi akoma nuk kanë ardhur në jetë. Sahabët e pyetën:

Si do t'i njihni në Ditën e Gjykimit ata që akoma nuk kanë ardhur në këtë jetë, o i Dërguari i Allahut? Pejgamberi (a.s.) pyeti:

Një njeri që ka një kalë të bardhë, a nuk e njeh kalin e tij në mesin e kuajve të zi, si mendoni? Sahabët iu përgjigjën:

Po, o i Dërguari i Allahut, e njeh.

Pejgamberi (a.s.) u shpreh:

Ja pra, vëllezërit e mi në Ditën e Gjykimit do të vijnë me fytyrë, duar dhe këmbë të shndritshme, sepse kanë marrë abdest. Unë do të shkoj para tyre tek Burimi i Keutherit. Do t'i njoh ata nga ndriçimi i gjymtyrëve të abdestit.

(Muslim, Taharet 39)

Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Drita dhe bardhësia e saj do të shkëlqejë ato gjymtyrë të besimtarit që i ka prekë uji i abdestit.”

(Muslim, Taharet 40)



GUSULI



Çfarë është gusuli?

Larja e të gjithë pjesëve të trupit pa mbetur asnjë vend i thatë.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“O besimtarë! Nëse jeni të papastër (si pasojë e ejakulimit), pastrohuni (duke u larë krejtësisht)!”

(Maide 6)



Çfarë nuk mund të bëjmë kur na mungon gusuli?

54

Pa marrë gusul



- Nuk mund të falim namaz.
- Nuk mund të bëjmë tavaf Qaben.
- Nuk mund të prekim Kurandin.
- Nuk mund të lexojmë Kuran.
- Nuk mund të hyjmë në xhami.

Cilat janë farzet e gusulit?

Gjatë marrjes së gusulit



1. Larja e gojës
2. Larja e hundës
3. Larja e tërë trupit, duke mos lënë asnjë pjesë të tij të paprekur nga uji.

Është farz



Kur duhet të marrim gusul?

- ✓ Kur jemi xhunub, të papastër (si pasojë e ejakulimit).
- ✓ Pas ciklit menstrual.
- ✓ Pas periudhës së lehonisë.

Është farz të marrim gusul



Si merret gusuli?

Nëse është e nevojshme, pastrojmë trupin nga çdo lloj papastërtie.

Shpëljajmë tri herë gojën me ujë dhe duke bërë gargara e pastrojmë mirë atë.

Lajmë mirë duart.

Një herë në javë ditën e xhuma çdo musliman duhet të lahet.

Lajmë tri herë hundën.

Bëjmë njetin për të marrë gusul duke thënë: "E bëra njet për hir të Allahut për të marrë gusul"

(Tirmidhi, Salat, 381)

Marrim abdest sikurse abdesti i namazit.

Para se të fillojmë me gusulin bëjmë Eudhu Besmele.

Si merret gusuli?

Larja e tërë trupit, duke mos lënë asnjë pjesë të tij të paprekur nga uji.

DOBITË E GUSULIT

Gusuli na pastron shpirtërisht

Sipas fesë sonë, gjendjet që na imponojnë marrjen e gusulit konsiderohen në aspektin shpirtëror të papastra (hadeth). Pa marrë gusul nuk mund t'i kryejmë disa nga adhurimet tona sepse jemi të papastër. Duke marrë gusul ne parapërgatitemi për namaz, pastrohemi shpirtërisht dhe qetësohemi psikologjikisht.

Gusuli na ndihmon të fitojmë pëlqimin e Allahut

Para së gjithash, marrja e gusulit, për ne, është një urdhër hyjnor. Me plotësimin e këtij urdhëri kryejmë një nga detyrat tona të përkushtimit ndaj Tij, duke fituar kështu pëlqimin dhe dashurinë e Allahut. Kështu, shpirti ynë gjenë qetësi në zbatimin e urdhërave të Allahut dhe gjithashtu pastrohet nga çdo lloj papastërtie.

Gusuli gjallëron trupin

Trupi ynë komunikon me botën e jashtme me anë të lëkurës. Prandaj papastërtitë dhe pluhurat së pari, bien në kontakt me lëkurën. Yndyra dhe

djersa e trupit hidhen jashtë nëpërmjet bezeve të djersës dhe të yndyrës. Këto lëndë helmuese që hidhen jashtë nëpërmjet djersitjes, ngjiten në trup dhe me kalimin e kohës bllokojnë porët e lëkurës. Në këtë mënyrë, lëkura nuk mund të ndihmojë funksionin e frymëmarrjes së mushkërive. Gusuli hap porët e bllokuara të trupit. Trupi pastrohet dhe frymëmarrja lehtësohet ndjeshëm. Kështu ne ndjejmë lehtësimin e trupit dhe gjallërimin e tij. Së fundi themi se gusuli është pastrimi fizik që na mban larg fëlliqësirave të trupit.

Gusuli na ruan shëndetin fizik dhe atë shpirtëror

Gjatë gusulit, kontakti i trupit me ujin, shkarkon ngarkesat elektrike dhe përmirëson qarkullimin e gjakut. Qetëson sistemin nervor dhe ul dozën e stresit.

Gusuli është një pastrim i brendshëm, që mbron shëndetin tonë shpirtëror dhe i jashtëm, që mbron shëndetin tonë fizik. Pra, ai është një ilaç i domosdoshëm për shëndetin tonë shpirtëror dhe fizik.

Çfarë nuk është e pëlqyeshme të bëhet gjatë marrjes së gusulit?

Gjatë marrjes së gusulit



- 🙄 Përdorimi pa kriter i ujit.
- 🙄 Kthimi drejt Kiblës duke pasur vendet e turpshme të zbuluara.
- 🙄 Të folurit pa nevojë.

Është mekruh



Sipas sunetit të Profetit çfarë duhet të kemi kujdes gjatë marrjes së gusulit?

Gjatë marrjes së gusulit



- 😊 Bërja e nijetit.
- 😊 Leximi i Eudhu besmelesë.
- 😊 Larja e duarve dhe pjesëve të turpshme.
- 😊 Marrja e abdestit

Eshtë sunet



FORÇA E UJIT

Akili rrinte duke i lëvizur sa në një anë, në anën tjetër, ullinj të vendosur në pjatën e tryezës së shtruar për mëngjes. Kohët e fundit e kishte mbërthyer një mërzi dhe shqetësim. Këtë vit që kishte kaluar në klasën e tetë ndiente në vetvete ndryshime fizike dhe shpirtërore. Për një moment trupi i ishte zgjatur, zëri i ishte trashuar bile në fytyrë aty-këtu kishin filluar të dukeshin edhe shenja mjekre. Ai bën përgatitje nën ndikimin e një zëri fëmije që i vinte nga brenda nganjëherë. Nuk i dukeshin të përshtatshme për moshën e tij ato që bënte me ndjenjën e përgjegjësisë që sillte rritja në moshë. Mosdija se sa do të zgjaste një situatë e tillë lëkundjet që jetonte në moshën e pjekurisë e hiqnin atë nganjëherë edhe nga kjo botë. Ai u zgjua për një moment me zërin e babait:


Akil, përsëri humbe biri im! Mbaro ushqimin e mëngjesit, nëse sillesh përsëri edhe pak do të mbetesh vonë për shkollë. Pasi erdhi në vete i dha përgjigje babait:

Mos u merakos baba, e arrij. Babai i cili i

kish-te vënë re shqetësimet e të birit dhe që e kishte planifikuar të bashkohej me shqetësimet e tij duke u ulur për të biseduar në një kohë të përshtatshme me të, i tha:

Nëna dhe motra janë mysafir sonte tek te zja që është bërë me fëmijë. Ne sonte, babë e bir, edhe bëjmë një gosti edhe bisedojmë. Sonte kam shumë gjëra të rëndësishme për të të thënë.

Akili, i cili në moment mori çantën dhe fluturoi përjashta, nga njëra anë rrinte e mendonte se çdo të bisedonte sonte në mbrëmje babai dhe nga ana tjetër, shpejtonte hapat që të arrinte pa humbur kohë në orën e mësimt



të gjeografisë me mësues z. Irfanin që të mos merrte ndonjë qortim prej tij.

Pasi hyri në klasë dhe u përshëndet me shokët e klasës gjeti një vend për tu ulur aty nga fundi i bankave. Deri sa erdhi mësuesi ata folën gjithë së bashku për ndeshjet e mbrëmshme, ç' gola ishin bërë dhe si ishin realizuar, për gjyqtarin e ndeshjes që kishte mbajtur anën, për penalltitë e pa dhëna e sa e sa gjëra të tjera të pavlefshme. Sapo zotëri Irfani u duk tek dera menjëherë u ndërpre edhe zhurma. Klasa u mbërthye në një qetësi që as miza nuk dëgjohej. Mësues Irfani ishte një mësues me syze, me shëndet të plotë, por ajo që ishte më e rëndësishmja, ishte një mësues i ditur dhe me disiplinë që me vështrimet e tij dallonte menjëherë nxënësin që bënte gabim. Ai nuk thyente zemrën e askujt por kurrë nuk lejonte të kalonte ora kot. Ai gjente një mundësi që ti bënte për vete edhe nxënësit e dënuar. Ai ishte një mësues i ëmbël dhe i egër në kuptimin e plotë të fjalës.

Pikërisht në një moment kur Metini kishte siguruar një pozicion për të fjetur duke rregulluar me shokun e tij përpara, u zgjua me reagimin e mësuesit.

Metin, biri im! Pse ke qëndruar mbrapa? Ç'punë ke mbrapa ndërkohë që ka vende bosh përpara. Dhe duke thënë kështu ia prishi të gjitha planet. Metini duke iu shmangur shiut kishte rënë në breshër. U ul pa dëshirë në radhën e parë. Mësues Irfani filloi të shpjegonte mësimin me zërin e tij të fortë.

Në rregull djem dhe vajza! Sot do t'u flas për forcën e ujit. Është pikërisht historia apo ndodhia e ujit të pastër, të qetë që e marrim nga burimi kur e mbushin në broke. Fillimisht duhet të dihet se pa të nuk mund të mendohet

jeta. Njeriu pa ushqim mund të durojë edhe me javë të tëra por pa ujë vetëm tre ditë. Allahu i Lartë na ka njoftuar se të gjitha gjallesat i ka krijuar nga uji. Sistemet e ajrosjes në botë që ne i quajmë atmosferë, përbëhen nga ndikimi i prurjeve në oqeanë. Pikat e ujit që kthehen në avull nën ndikimin e diellit përbëjnë retë. Retë nganjëherë bëjnë me mijëra kilometra rrugë dhe bëhen shi për malet dhe pyjet. Ata bëhen jetë për bimët dhe të gjitha gjallesat që i ushqejnë. Të gjitha qeniet në një farë mënyre janë nën ndikimin e ujit. Një nga nxënësit e suksesshëm të klasës, Akili, ngriti dorën dhe kërkoi fjalën:

Mësues, edhe tema e formimit të njeriut që e kemi zhvilluar në orën e biologjisë vërteton këta që thoni ju. Gjallesat përbëhen nga uji dhe me anë të bërthamave hedhin hapat e parë të tyre në jetë. Desha thjeshtë të tërheq vëmendje për këtë ngjashmëri, tha Akili.

Faleminderit Akil, siç e theksove edhe vetë shkencat natyrore nuk përplasen me njëra-tjetrën. Allahu që ka krijuar gjithësinë me rregullat e vendosura, e ka vënë në jetë hapësirën e botës dhe të ambientit tonë që prej miliona viteve pa pësuar asnjë kontradiktë.

Duke shpjeguar forcën e ujit treguam vetëm anët e bukura të tij. Uji ka edhe anë të këqija. Të tregojmë pak edhe për ta. Jepni atëherë, mendohuni pak. Këtë anë thuajeni ju, tha mësues Irfani. Për një çast u ngritën gishtat në klasë.

Presionet e ujit, përmbytjet...

Fatkeqësia e Tsunamit, mësues...

Erozionet që formojnë lumenjtë.

Furtunat në dete, mësues...

Ndërkohë që përgjigjet po rreshtoheshin



në këtë mënyrë mësuesi Irfani me një zë të fuqishëm rregulloi ambientin e krijuar në klasë.

Që të gjithë dhatë përgjigje të sakta, miqtë e mi. Në fund të mësimit të gjithë morën diçka nga forca e ujit dhe tani kemi ardhur në pikën më të rëndësishme të temës. Kur i hedhim një sy formave të ndryshme gjeografike maleve, kodrave, fushave vëmë re ndikimet e ujit në to. Përpjekja që nuk ka të reshtur, mundimi i vazhdueshëm që zgjat me mijëra vite shmanget malet që përbëjnë gurët e fortë dhe zbret deri në dete. Vendet që mbart uji në pikat e derdhura në det të lumenjve sjellin në pah fusha dhe lëndina të pafundme. Edhe ju merrni mësime nga fuqia e ujit, bëni përpjekje vazhdimisht se sado probleme të mëdha të keni, shkrihen para jush dhe mbarojnë.

Metini nuk e kishte menduar asnjëherë se mësimi i gjeografisë do të bëhej kaq i rrjedhshëm. Në mëngjes kur kishte përgatitur çantën, kishte vendosur edhe librin e gjeografisë dhe

kishte menduar: “Aty nga fundi i klasës sikur të gjej një vend dhe të fle”. Të dhënat statistikore që e kishin munduar për të mësuar hartat e ngatërrueshme, pyetje të tilla si cilat prodhime rriten dhe ku rriten etj e kishin ftohur shumë Metinin nga mësimi i gjeografisë. Por mësimi i sotëm mjaftoi që ta ndryshonte tek ai këtë. Kur shihte me vëmendje, arriti të dallonte se në ujën që rrjedh në fusha, në male ka mesazhe të fshehta që na ndriçojnë dhe na motivojnë.

Akili nga njëra anë mendonte mësimin, por nga ana tjetër mendonte se çdo t’i thoshte babai në darkë. Koha në shkollë si përherë kaloi shumë shpejt.

Kur arriti në shtëpi, vinte era e një peshku të pjekur. Babë e bir i hëngrën me shumë kënaqësi peshqit në darkë. Babai duke e ditur se Akili i pëlqente shumë, kishte marrë nga pasticheria edhe tullumba të freskët. Pasi mblodhën tryezën së bashku morën çajin dhe kaluan në kuzhinë. Akili e kishte mendjen vazhdimisht tek



biseda që kishin bërë në mëngjes në lidhje me temat e rëndësishme. Babai e ndjente gjendjen dhe priste sa të krijohej situatë e përshtatshme. Piu pak nga çaji dhe ngadalë ngadalë hyri në temë:

Shiko, Akil, njerëzit linden, rriten sapo kalon fëmijëria dhe rinia më pas plaken dhe vdesin. Ti tani je 15 vjeç. Je në një periudhë që po i jep lamtumirë fëmijërisë dhe po fillon moshën e pjekurisë. Zhvillimin e trupit dhe ndryshimin në ndjenja bashkë me ty, e duam edhe ne. Sado ta falenderojmë Allahun, përsëri është pak. Ne kemi dy fëmijë të shëndetshëm.

Biri im! Nuk ke nevojë të frikësohesh. Pasi të kalojë një periudhë kohe, do të forcohen erërat e ndryshimit në trupin dhe shpirtin tënd, do të vësh re se edhe periudha e rinisë do të kalojë po aq e lumtur dhe e këndshme sa ajo e fëmijërisë. Në këtë kohë gjatë natës kur të

shohësh ëndrra të ndryshme dhe ta ndjesh se je lagur, duhet të marrësh abdesin e gusulit. Periudha e pjekurisë tashmë është periudhë e mbartjes së përgjegjësisë. Kurse gusuli që është edhe pastrimi i plotë i trupit është kushti i parë i adhurimeve. Përveç banjave javore kur nevojitet, është farz edhe abdesi i trupit. Pasi të pastrosh mirë me ujë të bollshëm gojën dhe hundën, duhet të lalesh komplet si trup dhe kjo është edhe mënyra e marrjes së abdesit të gusulit. Nëna dhe unë jemi njerëzit më të afërt për ty që mund të bisedosh për problemet e periudhës kalimtare të rinisë. Mos harro se me ty dhe sjelljet e tua ne jemi krenar dhe kështu babai e përfundoi bisedën e tij. Akili që e dëgjoji me shumë vëmendje bisedën e babait, tha:

Zoti të dhëntë rehati dhe kaloi në dhomën e vet. Fjalët që tha i ati e drejtuan atë nga dera e banjës. Në fillim mori një abdes namazi. Më pas lau hundën dhe gojën dhe më vonë u fut nën dush dhe u la plotësisht. Më pas veshi rrobën e tij të banjës dhe kaloi në dhomë. Duke tharë flokët përpara pasqyrës për një çast mendoi edhe orën e mësimin të gjeografisë. Në orën e mësimin ishte folur për forcën e ujit. Por një pikë kishte mbetur e paplotësuar. Uji nuk i jepte formë vetëm anës së jashtme, por edhe asaj të brendshme. Akili e kishte kuptuar dhe jetuar këtë në abdesin e parë të gusulit që kishte marrë. Abdesi i trupit ishte një nga detyrat më të rëndësishme të roberisë që lante dhe shndriste jo vetëm trupin por edhe shpirtin. Akili pasi u shtri në shtrat, tha: “Tani e kuptova më mirë rëndësinë e ujit” dhe e zuri një gjumë i thellë me një shpirt të pastruar nga mungesa e qetësisë që ndjente kohët e fundit.

HASAN TAHSIN KARAMAN

TEJEMUMI

Çfarë është tejemumi?

Tejemumi është marrja e abdestit me anë të dheut apo gjërave prej dheu.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“... Nëse nuk gjeni ujë, atëherë gjeni dhé të pastër dhe fshini fytyrat e duart me të.”

(Maide 6)

Kur merret tejemumi?

Kur nuk mund të gjejmë ujë të pastër aq sa për të marrë abdest apo gusul

ose kur nuk mund ta përdorim ujin për arsye të sëmundjeve të ndryshme.

Në vend të abdestit dhe gusulit

Bëjmë tejemum

Si merret tejemumi?

- 1 Them i Eudhu Bismelenë.
- 2 Bëjmë njetin në lidhje me qëllimin e marrjes së tejemumit (për abdest ose gusul).
- 3 Vendosim duart në dhé të pastër dhe i bëjmë mes' h fytyrës.
- 4 Vendosim duart për herë të dytë në dhé të pastër dhe me pjesën e brendshme të duarve i bëjmë mes' h krahut të djathtë dhe më pas atij të majtë.



Cilat janë farzet e tejemumit?

Gjatë marrjes së tejemumit



1. Bërja e nijetit.
2. Të bërit mes' h fytyrës dhe krahëve me dhé të pastër.

Është farz



SHPELLA ÇORAKTEPE

Emre bashkë me babain u nis herët në mëngjes në shkollë. Fundjavën e parë të Qershorit do ta kalonte në kamp me grupin e klubit të gjurmimit Kur Emre erdhi në shkollë, autobusi kishte ardhur dhe përgatitjet kishin përfunduar. Pas pak autobusi u nis për në kamp. Kryetari i grupit dhe njëkohësisht mësuesi i turqishtes, zotëri Ismaili, mori mikrofonin në dorë dhe filloi t'i informonte nxënësit në lidhje me shëtitjen.

Miqtë e mi, së pari dua t'ju informoj juve se kjo shëtitje është përgatitur për t'ju argëtuar dhe t'ju informuar ju. Do të shohim vende që nuk i kemi parë, do të jemi larg zhurmës së qytetit, do të kalojmë çaste të gëzueshme. Autobusi do të na ndalë në kampin e Pyllit Çamllijajla. Do të ndërtojmë çadrat tona dhe do të luajmë. Në ditën e dytë të shëtitjes në një udhëtim prej dy orësh do të shkojmë në Çoraktepe ku do të analizojmë shpellat në të cilat zënë vend piktura të vjetra që i takojnë periudhave të hershme. Dëshiroj prej jush t'ju bindeni rregullave, të mos ndaheni asnjëherë nga grupi dhe të jeni të kujdesshëm në mbajtjen pastër të mjedisit. Nuk duhet të harrojmë se ambienti është amanet për ne. Përcjellja tek

brezat e ardhshëm pa e ndotur është një nga detyrat tona më të rëndësishme.

Pas një udhëtimi prej një ore e gjysmë arritën në vendin e kampit. Në fillim zgjodhën vendin ku do të hapeshin çadrat. Për një kohë të shkurtër përfundoi edhe puna e hapjes së çadrave me ndihmën e mësuesve. Materialet e kuzhinës dhe ato që mbarten lehtë u vendosën në një çadër. Kryetari i grupit, mësues Ismaili, i ra bylbylit dhe i mbledhi të gjithë të pranishmit.

Miqtë e mi, tani ora është 11. Në orën 13:00 do të mblidheni për të ngrënë drekën. Jeni të lirë me kusht që mos të largoheni shumë. Dua tre vetë ndihmës me dëshirë në përgatitjen e drekës.





Fëmijët me plot dëshirë krijuan grupe mes vete dhe filluan të luanin lojëra të bukura dhe tërheqëse. Loja nën shoqërinë e diellit të dhembshur të pranverës, zërit të zogjve dhe aromave të pemëve, ishin një dhunti e madhe që fëmijët nuk mund ta gjenin në qytet.

Fëmijët që hidheshin të lumtur në krye të çezmës për të larë fytyrat dhe duart më pas zunë vendet e tyre në tryezat e shtruara në çadër. Ajri i pastër i kishte bërë ata që të ishin të uritur si ujçërit. Ata fëmijë që në shtëpitë e tyre u bënë një mijë e një naze prindërve të tyre kur hanin, këtu i fshin dhe i përulanë pjatat.

Pas ngrënies së drekës u hodhën në barin jeshil për të falur namazin e drekës. Gjurmëtarët e vegjël me në krye mësuesin e tyre shëtitën pyllin deri në aksham. Duke u kthyer në kamp

nuk lanë pas dore edhe mbledhjen e druve për të nderur zjarrin. Para perëndimit hanë darkën e përgatitur. Pas namazit të akshamit fëmijët që ishin ulur në formën e një hallke pranë zjarrit që digjej filluan të nxirrnin bejta për shokët e tyre. Disa filluan të qeshnin me të madhe nga imitimet e bëra. Ata nuk e kuptuan aspak se si kaloi koha. Fëmijët e shtrirë nëpër shtretër nën shoqërinë gjinkallave nga lodhja e ditës menjëherë i zuri gjumi.

Pa dalë dita ata u ngritën me zërin e mësuesit të tyre Ismail. Ndërkohë që në shtëpitë e tyre nënat mezi i zgjonin duke iu lutur bile, ajri i pyllit u kishte mundësuar që të pushonin pakëz dhe të zgjoheshin menjëherë. Namazi që falën me abdestin e marrë me ujin e ftohtë akull të çezmës, u çelte sytë. Në drejtimin e mësuesve Osman dhe Ismail filloi sporti i mëngjesit. Ah sikur mëngjeset e ëmbla

që konsumohen këndshëm dhe që kalojnë në shtrat deri në drekë në qytete të mëdha, të kalonin të mbushura dhe me dëfrime sikur kalojnë edhe këtu! Sportistët që përfunduan sportin, u ulën në sofrën e mëngjesit të përgatitur në çadra. Fëmijët, të cilët e mbaruan me të shpejtë mëngjesin e tyre, po prisnin me padurim të shihnin shpellat Çoraktepe. Mësuesi Ismaili tha:

Djema! Udhëtimi ynë do të zgjasë afërsisht dy orë në këmbë. Mos harroni të merrni me vete ushqimet, ujin e pijshëm dhe kapelet për diell!

Emre dhe shokët e tij kaluan në alpinizëm drejt Çoraktesës në një radhë të vetme në një shteg të ngushtë. Gjysma e parë e udhëtimit kishte kaluar duke qeshur e luajtur, ndërsa pjesa tjetër kishte filluar t'i mërzhiste. Dielli nuk përkëdhelte më shpinat e fëmijëve sikurse mëngjesëve, të nxehtët e drekës ua thante gjuhën.

Me shumë vështirësi arritën në kodrën e duhur. Fëmijët të cilët nuk ishin mësuar në një udhëtim të gjatë nën diell ishin lodhur shumë. Kryetari i grupit, mësuesi Ismaili me një buzëqeshje përqeshëse pyeti:

Ç' kemi fëmijë? U lodhët? Hajde, mblidhni veten se tani fillon shëtitja në shpellë.

Shpella në të cilën hynë fëmijët të mbajtur dorë për dorë në një radhë të vetme mes dy thepinave, i habiti pa masë. Thuajse në një çast ajri i jashtëm kishte ndryshuar menjëherë. Ata e ndjenë veten sikur kishin hyrë në një frigorifer të madh. Mësuesi Omeri me llambën që kishte në dorë, ndriçonte shpellën dhe jepte informacion lidhur me të.

Miqtë e mi! Tani jemi përpara një flete

historike e ndërtuar me mijëra vite më parë e cila ka arritur të ruhet deri në ditët tona. Shumë detaje që në shikim të parë mund t'ju duken të pakuptimta, kanë kuptime dhe shpjegime shumë të rëndësishme. Pikturat që shohim këtu na tregojnë për mënyrën e jetesës së njerëzve të asaj kohe, mënyrën se si ushqeheshin, jetën sociale të tyre dhe çdo gjë tjetër.

Fëmijët që përfunduan kërkimet e tyre në shpellë nën drejtimin e mësuesit, shtruan ushqimet në barin jeshil dhe hëngrën drekën. Të ngopurit e tyre kishte sjellë edhe njëherë në vend harmoninë dhe gëzimin e mëparshëm. Ata u mblodhën menjëherë me zërin e mësuesit të tyre Omer:

Miqtë e mi! Siç e kishim programuar në ditën e dytë të kampit sot pamë shpellën Çoraktepe. Ora tani është tre. Të falim namazin e drekës këtu dhe na duhet të ecim drejt kampit. Melihi që kishte pirë gjithë ujin në bidon, kërkoi të merrte fjalën:

Mësues, mua nuk më ka mbetur aspak ujë. Edhe tek shokët nuk besoj se ka mbetur ndonjë shishe ujë. Këtu përreth nuk ka asnjë fshat afër që të mbushim ujë. Si do të marrim abdest për namaz? Mësuesi iu përgjigj:

Një pyetje shumë e bukur! Të lumtë Melih. Edhe unë pikërisht për këtë temë do të bëja një sqarim. Miqtë e mi, feja jonë e bukur Islami nuk i ka ngarkuar atyre që besojnë përgjegjësi më shumë se kanë mundësi për të mbartur. Pra, Islami nuk është feja e vështirësive, por e lehtësive. Aliu i cili ngriti gishtin doli përpara duke pyetur:

Atëherë nuk do të falim namaz, apo jo mësues? Dhe mësuesi iu përgjigj:

Jo Ali! Për një mysliman me përgjegjësi



nuk ka asnjë pretekst që ta pengojë atë të dalë para Allahut. Në raste kur nuk ka ujë dhe kur nuk ka mundësi të gjetjes së tij brenda kohës së namazit, mund të falim namaz duke bërë tejemum. Fillimisht bëjmë nijet për marrjen e abdestit të tejemumit. Më pas duke i përplasar duart në dhe të pastër, ashtu i bëjmë me duar fytyrës. Për herë të dytë u bëjmë mes' h krahëve. Ja kaq e thjeshtë është pra miqtë e mi.

Aliu pyeti përsëri:

Mirë pra mësues, a mund t'i bëjmë të gjitha adhurimet tona të bëra me abdest duke bërë tejemum? Dhe mësuesi u përgjigj:

Padyshim që mund t'i bëjmë, pasi me tejemum ne jemi sikur kemi marrë abdest.

Të rinjtë të emocionuar nga ato që kishin mësuar si të re, filluan të merrnin tejemum së

bashku me mësuesit e tyre. Pasi falën së bashku namazin, u nisën për rrugë. Kur u kthyen në kamp, zunë radhë të madhe në çezme për të pirë ujë.

Kampi nga i cili u ndanë në perëndim të diellit të dielën kishte qenë me shumë dobi për Emren dhe shokët e tij. Ata ishin njohur edhe me vende të reja por edhe kishin marrë njohuri të reja. Aq më tepër që edhe koha kishte kaluar duke qeshur e luajtur pa u mërzhitur sikurse në shkollë. Emre i hodhi një shikim të fundit nga dritarja e autobusit kodrës Çoraktepe që i kujtonte folenë e shqiponjës. Atë e zuri gjumi në krahun e shokut të vet Burhan duke bërë planet për kampin e viti të ardhshëm.

HASAN TAHSIN KARAMAN

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë

Vendosni shenjë të saktë ose atë të gabuar në fjalitë e mëposhtme:

- | | | |
|--|----------------------------------|-----------------------------------|
| Eshtë sunet larja tri herë e organeve gjatë marrjes së abdestit. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Mund të bëhet tavafi i Qabes edhe pa abdest. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Përdorimi pa kriter i ujit kur merr abdest është mekruh. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Të fjeturit të shtrirë apo të mbështetur në një vend nuk e prish abdestin. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Mund të bëjmë mes'h mbi fashon apo lekoplastin e vendosur mbi plagë. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |

Të testojmë veten tonë 1

- A është njëri nga farzet e abdestit?
 - Shpërlarja e gojës.
 - Shpërlarja e hundës.
 - Mes'hi i kokës
 - Mes'hi i veshëve
 - Larja e fytyrës
 - Larja e këmbëve bashkë me thembra
 - Larja e hundës
 - Bërja mes'h e një të katërtës së kokës.
- Cili nga veprimet e mëposhtme nuk është njëri nga farzet i abdestit?
 - Larja e duarve së bashku me kyçet.
 - Larja e këmbëve
 - Larja e fytyrës
 - Larja e gojës
- A është njëri nga sunetet e abdestit?
 - Dalja e gjakut nga trupi
 - Të qeshurit
 - Të fjeturit
 - Të rënit të fikët

5. 3. Cila nga pikat e mëposhtme e prish abdestin?

- a) Të gogësiturit
- b) Të qarit
- c) Të folurit
- d) Kryerja e nevojave personale.

Nga fjalët brenda kllapave vendosni të duhurat në vendet boshe. (1)

(misvak, nga tri herë, është sunet, është mekruh, është farz)

- ✿ Larja e organeve që do të lahen gjatë marrjes së abdestit është sunet.
- ✿ Larja me radhë e organeve gjatë marrjes së abdestit
- ✿ Larja e dhëmbëve me furçë ose me gjatë marrjes së abdestit është sunet.
- ✿ Spërkatja me ujë e rrobave gjatë marrjes së abdestit
- ✿ Larja një herë e këmbëve gjatë marrjes së abdestit

Të kontrollojmë njohuritë 2

- ✿ Larja e gojës dhe e hundës gjatë gusulit është farz. E SAKTË E GABUAR
- ✿ Nuk mund të prekim Kur'anin pa gusul. E SAKTË E GABUAR
- ✿ Mund të hyjmë në xhami pa gusul, por nuk mund të falim namaz. E SAKTË E GABUAR
- ✿ Nuk është kusht bërja e nijetit gjatë marrjes së tejemumit. E SAKTË E GABUAR
- ✿ Nëse personit që është me tejemum i hiqet pengesa e përdorimit të ujit tejemumi nuk priset. E SAKTË E GABUAR

Të testojmë veten 2

1. Cila nga pikat e mëposhtme është nga farzet e gusulit?
 - a) Larja e këmbëve
 - b) Shpëlarja e hundës
 - c) Të bërit mes'h i kokës
 - d) Të bërit mes'h veshëve
2. Kur duhet të marrim gusul?
 - a) Kur jemi xhunup
 - b) Kur nga trupi ynë rrjedh gjak ose qelb
 - c) Kur kryejmë nevojat personale.
 - d) Të vjellurit me gojën plot.
3. Cila nga pikat e mëposhtme është prej mekruheve të gusulit?
 - a) Përdorimi i ujit pa kriter
 - b) Të folurit pa nevojë
 - c) Kthimi drejt Kiblës duke pasur vendet e turpshme të zbuluara.
 - d) Të gjitha
4. Çfarë mund të bëhet pa pasur gusul?
 - a) Falja e namazit
 - b) Leximi i Kuranit
 - c) Të ngrënit
 - d) Të bërit tavaf rreth Qabes
5. Çfarë nuk e prish tejemumin?
 - a) Të qarit
 - b) Të kryerit e nevojave personale
 - c) Gjetja e ujit që mund të përdoret për të marrë abdest
 - d) Rrjedhja e gjakut nga hunda

VNga fjalët brenda kllapave vendosni të duhurat në vendet boshe. (2)

(është farz / tejemum / mekruh / e gojës, e hundës tonë / është sunet)

- ☼ Të larit gjatë gusulit është farz.
- ☼ Marrja e gusulit pas ciklit menstrual.....
- ☼ Larja e duarve dhe e vendeve të turpshme gjatë marrjes gusul është
- ☼ Gjatë marrjes së gusulit të kthyerit drejt Kibles me pjesët e turpshme të zbuluara është
- ☼ Në mungesë të ujit të pastër për të marrë abdest apo për të marrë gusël marrim



NAMAZI



MIRAXHI I BESIMTARIT / BAZA E FESE ISLAME

- ❁ Ç'është namazi?
- ❁ Përse falim namaz?
- ❁ Dobia e namazit
- ❁ Kush e ka farz faljen e namazit?
- ❁ Llojet e namazeve
- ❁ Ezani dhe ikameti
- ❁ Në ç'mënyrë falet namazi?
- ❁ Falja e pesë kohëve të namazit
- ❁ Duaja dhe tesbihët që këndohen pas namazit
- ❁ Farzet, vaxhipet, sunetet dhe mekrubet e namazit
- ❁ Përqëndrimi në namaz
- ❁ Gjërat që e prishin namazin
- ❁ Namazi me xhemat
- ❁ Namazi i xhumasë, xhenazes, bajramit dhe i teravisë
- ❁ Namazi i të sëmurit, i udhëtarit dhe namazi kaza
- ❁ Sexhdeja e harresës dhe sexhdeja e tilavetit
- ❁ Kohët kur është i papëlqyeshëm të falurit namaz
- ❁ Namazi i Pejgamberit (a.s.)




HERA E PARË QE FALA NAMAZIN

Sa ftohtë ishte sot në mëngjes. U ngrita nga shtrati i ngrohtë dhe ashtu këmbëzbathur sapo futa këmbët në shapkat e ftohta, që dukej sikur kishin përthithur ngricën e një nate të tërë, ndjeva të dridhura në trup.

Akoma s'kishte zbardhur drita. U mbësh-teta në dritare. Askush nuk ishte në minaren e plakur dhe të vogël të xhamisë së vjetër që ndodhej mes shtëpive, e cila ngrihej drejt qiellit tepër madhështore.. Më pas, në ballkonin e minares, u duk hija e dobët e muezinit të ri. U struka mirë nën rrobën time. Duke dëgjuar ezanin që dridhte shpirtin tim, i tkurrur nga të ftohtit, kujtoja të parin mëngjes kur isha zgjuar plot gjallëri që pesëmbëdhjetë vjet. Ah, para pesëmbëdhjetë vitesh!...

Nëna ime, njeriu që dua më shumë në këtë botë, para pesëmbëdhjetë vjetësh më pati zgjuar në namazin e parë të sabahut. Siç duket, ishte i njëjti dimër. Duke fjetur në shtratin e vogël në dhomën time, ngjitur me dhomën e saj, duke më krehur flokët me gishtërinjtë e hollë që më përkëdhelnin ballin si një puthje e ëmbël, më pati thënë:



- Hajde! Omeri im i vogël, ngrehu! Ngrehu biri im!

Unë hapa sytë dhe i thashë:

- Aman, nënë. Akoma është natë.

Pasi më puthi përsëri në

vetullën e majtë, aty ku më puthte përherë, më kapi kraahun dhe më ngritur nga shtrati, duke nxituar nga frika se mos kalonte koha.

E ndoqa duke mbathur pantoflat e mia të vogla dhe duke fërkuar sytë me duar. Në një çast, duke kaluar nga dhoma e errët hymë në dhomën e saj, aty ku gjendej shporeti që i ngjante një zezaku të ulur këmbëkryq që digjej duke flakëruar.

- Aaa... Edhe Pervini qenka zgjuar!...

Pervini po hiqte nga shporeti kovën e verdhë. Nuk ma merrte mendja se do të zgjohej. Nëna më pati thënë:

- Pervini ngrihet çdo mëngjes.

Unë u çudita për të edhe pse vetë nuk ngrihesha asnjëherë. Më hoqën rrobën, më shpërvjelën krahet dhe u përkula para legenit të abdestit. Nëna më tha:

- Lodhesh ashtu.

Më vendosi një stol të vogël dhe aty u ula.

Sapo mora abdest, shkova para sobës për t'u ngrohur. Kur u ktheva prapa pushë nënën që po shtronte sexhaden dhe duke vënë mbulesën, më thirri edhe mua.

- Eja...

Shkova. Unë më i vogli, në një sexhade me të, qëndrova pranë trupit të një nënës sime, të kujdesshme dhe të ëmbël.

Ndërkohë që ajo po merrte tekbinin filles-tar, siç veprojnë gratë, duke ngritur duart mbi shpatulla, unë në mënyrë të pavetëdijshe



imitoja atë.

Pasi mbaroi sunetin, me një buzëqeshje të ëmbël, më tha:

- Biri im! Grua je ti? Gratë fillojnë ashtu. Ti je burrë. Duart duhet t'i ngresh deri te veshët. Me duart e saj të ngrohta m'i ngriti duart e mia të vogla duke më thënë:

- Ja, kështu!

Më mësoi tekbinin fillestar për meshkujt.

Edhe unë, ashtu siç mora tekbinin, përfundova namazin.

Duke bërë dua pyeta:

- Si do të lutem nënë?

Luajti kokën. Përfundoi duanë. Ajo ishte në mendjen time.

- O Zoti im! Të falënderoj që më bërë mysliman...! Mbroje atdheun tonë nga armiqtë. Kërkoj prej Teje që t'u japësh shëndet dhe paqe të gjithë myslimanëve që vuajnë, heqin keq, janë të sëmurë, të pashpresë, apo të varfër... Bëj dua që të jesh një mysliman i mirë dhe të mos gënjuhesh nga mashtrimet e shejtanit.

Pas namazit, duke mbledhur sexhaden, nëna më pyeti nëse do të flija apo jo. Nuk e dija dhe nuk arrita t'i jepja përgjigje.

Më tha:

- Atëherë shko merre librin të dëgjoj mësimin.

- Në rregull.

Vrapova me të shpejtë, mora librin që

qëndronte i hapur mbi tavolinë dhe vrapova drejt nënës. Nuk bëra asnjë gabim.

Nëna gjatë netëve më thoshte:

- Para se të flesh lexoje mësimin tri herë, se të ndihmojnë engjëjt dhe ta mësojnë atë.

Ato engjëj ma kishin mësuar mësimin edhe sot.

Nëna më përkëdheli flokët me dhembshuri duke më thënë:

- Ka edhe shumë kohë për në shkollë.

Më mori në shtratin e saj.

S'kisha gjumë dhe shihja nënën. Në mes të errësirës, me shaminë jeshile që kishte në

kokë, mori Kuranin duke bërë një lëvizje sikur të imagjinonte diçka. E ulur në karrige të gjerë, në qoshe të dritares, filloi të lexonte Kuran me një zë të hollë. Po humbisja duke dëgjuar këtë zë që linte gjurmë poezie në shpirtin tim. Nën shaminë e madhe jeshile, duke parë fytyrën e saj të bukur dhe duke vështruar atë ritëm të lehtë të kokës që luante duke iu lutur Allahut, nënën e përngjasoja me një engjëll. Me këtë imagjinatë, duke menduar engjëjt që duhet të mblidheshin rreth nënës që lexonte Kuran, më dukej sikur ndieja prekjen e krahëve të tyre duke më përkëdhelur flokët me gishtat e hollë.

OMER SEJFETTIN

Ç'ËSHTË NAMAZI?

Çdo qenie e gjallë që jeton mbi sipërfaqen e tokës, e adhuron dhe e madhëron Zotin sipas mënyrës së vet. Namazi është adhurimi bazë i fesë islame që i përmbledh në vetvete të gjitha llojet e adhurimeve që i bëjnë krijesat Zotit të tyre të vetëm. Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), e ka quajtur atë "shtylla e Islamit" për shkak se është adhurimi më i rëndësishëm i fesë islame.

Namaz do të thotë të bësh dua, të bekosh. Ai është "miraxhi i besimtarit", takimi i besimtarit me Zotin e tij. Me anë të namazit dalim përpara Allahut pesë herë në ditë. Tregojmë me sinqeritet robërinë tonë dhe i kujtojmë se jemi nevojtarë të Tij.

Namazi është një shprehje falënderimi ndaj Allahut. Me anë të namazit falënderojmë Allahun për të gjitha mirësitë që na ka dhënë. Tregojmë dashurinë dhe respektin tonë ndaj Tij, pasi namazi është treguesi

më i lartë i respektit.

Namazi është lutja jonë ndaj Allahut, është ndihma që kërkojmë prej Tij dhe përlujta për faljen e gabimeve.

Shkurt, namazi është baza e fesë dhe drita e zemrës. Është damari kryesor i jetës shpirtërore. Është adhurimi më i bukur, i cili ashtu siç na pastron nga ana materiale na mban të fortë edhe nga ana shpirtërore.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

"Namazi është një dritë në zemrën e njeriut. Tashmë ai që kërkon prej jush të ndriçohet me të, të përpiqet të shtojë dritë në zemrën e tij"

(Tirmidhi, Deavat 85)



PSE FALIM NAMAZ?

Namazi është detyra jonë e nënshtrimit ndaj Allahut i cili na ka krijuar dhe na mban gjallë. Ne i falim namazet që të jemi sa më afër Krijuesit tonë të Lartmadhëruar dhe të shfaqim dashurinë tonë ndaj Tij.

Zoti ynë na ka dhënë mirësi të panumërta. Ne duhet ta falënderojmë Atë për këto mirësi, prandaj edhe falim namazet.

Falënderimi i çdo mirësie buron nga vetvetja. Me zekatin që u japim të varfërve falënderojmë Zotin për pasurinë. Duke agjëruar falënderojmë Allahun që na ka dhënë një trup të shëndetshëm dhe na ka ushqyer me mirësitë e Tij. Edhe me namazin që falim i dërgojmë falënderimet tona më të mira Zotit tonë të Lartë, Krijuesit tonë dhe kështu çojmë në vend një falënderim tjetër të anës fizike. Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s.) e ka

treguar këtë dimension të namazit duke thënë:

“Për të realizuar falënderimin e çdo pjese të organizmit nevojitet një sadaka. Si rrjedhojë çdo tesbih është një sadaka, çdo falënderim është një sadaka, çdo Dëshmi e Njesisë (Teuhidit) dhe çdo tekbir është një sadaka. Të këshillosh mirësinë është një sadaka. Të bësh kujdes nga të këqijat është një sadaka. Dy rekatë namaz që do të falë njeriu në kohën e paramëngjesit i plotëson të gjitha këto” (Muslim, Musafirin 84)

Edhe ne duhet t’i bindemi kësaj këshille të Profetit tonë të dashur dhe duhet t’i falim me rregull namazet tona. Duhet ta falënderojmë Atë për të gjitha mirësitë që na ka dhënë, duke filluar prej trupit tonë.



Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Fal namazin, të më përkujtosh mua”

(Taha, 14)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“O ju që besoni! Bini në ruku dhe në sexhde, Adhuroni Zotin tuaj, bëni mirësi që të shpëtoni”

(Haxhkh, 77)

PERFITIMET TONA ME KRYERJEN E NAMAZIT

Trupi, shpirti dhe jeta jonë shoqërore përfiton shumë gjëra me faljen e namazeve. Disa nga dobitë e namazit janë:

Namazi na mundëson që ta kujtojmë Allahun ashtu siç Ai e meriton

Allahu i Lartë na njofton se “shpirtrat tanë do ta arrijnë kulmin e qetësisë vetëm duke e përkujtuar Allahun”.

Përkujtimi i Zotit që e duam më shumë se çdo gjë dhe përkujtimi i emrit të Tij, na e qetëson shpirtin dhe zemrën e ngushtuar duke e dhënë asaj prehje.

Mënyra më e bukur për të kujtuar Allahun është falja e namazit. Çdo namaz që falim, na kujton Zotin tonë. Si rrjedhojë, namazi është një mirësi e madhe. Pejgamberi ynë i dashur shpejtonte për ta kryer sa më parë dhe më mirë namazin, sepse ai e dinte shumë mirë vlerën e kësaj mirësie. Qetësinë dhe lumturinë që përjetonte duke e kujtuar Zotin me faljen e namazeve, ai e ka shprehur duke thënë: “Falja e namazit më bën të lumtur”.

Namazi na bën të kujtojmë ditën e llogarisë dhe të ahiretit

Në këtë botë, ka shumë gjëra që i bëjnë njerëzit të harrojnë botën tjetër. Njerëzit që harrojnë ahiretin dhe nuk mendojnë se një ditë do të japin llogari për gjithçka, mund të bëjnë çdo të keqe për interesin e vet. Atëherë është i nevojshëm një paralajmërues që t’ua kujtojë atyre ahiretin.

Namazet që falim me vetëdije dhe me kujdes na kujtojnë pesë herë në ditë Allahun, ditën e gjykimit dhe ahiretin, duke na larguar nga punët e këqija. Kështu nuk dëmtojmë as pasurinë e njerëzve të tjerë, nuk ua lëndojmë zemrën dhe as nuk ua cënojmë të drejtat.

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“O ju që besoni! Kërkoni ndihmë prej Allahut me durim dhe namaz! Padyshim që Allahu është me ata që durojnë!”

(Bekare, 153)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Bëni kujdes! Shpirtrat gjejnë qetësi vetëm me përkujtimin e Allahut!”

(Ra’d, 28)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Fal namaz në dy anët e ditës dhe në orët e natës afër ditës!”

(Bekare, 153)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Padyshim që namazi e largon njeriun nga të këqijat dhe imoraliteti.”

(Ankebut, 45)

Namazi na pastron nga gjynahet

Namazi është momenti i takimit tonë me Zotin. Kur falim namaz e dimë që kemi dalë para Allahut. Kur duam të bëjmë një punë që është gjynah, heqim dorë duke menduar se do të falim namaz dhe do të dalim para Allahut. Kështu pastrojmë zemrën nga mendimet dhe ndjenjat e këqija dhe organe të tilla si dorën dhe gjuhën nga sjelljet e këqija.

Namazi na mundëson të jemi të edukuar

Namazi është një mundësi shumë e mirë për të qenë të vetëdijshëm për gjynahet dhe gabimet e bëra si dhe për t'u pënduar për to. Në sajë të namazit kërkojmë falje nga Zoti ynë. Ne dalim para Zotit pesë herë në ditë duke menduar se Ai është në dijeni të gjërave që bëjmë, prandaj dhe u kushtojmë kujdes sjelljeve dhe veprimeve tona. Kështu bëhemi njerëz të moralshëm.

Namazet e bëjnë ditën që jetojmë më të frytshme

Kur i falim namazet rregullisht, atëherë edhe ditën e planifikojmë sipas kohëve të namazeve. Akoma pa lindur dita, ngrihemi për të falur namazin e sabahut dhe kështu e fillojmë herët ditën. Ndërsa pjesa më e madhe e njerëzve janë në gjumë, ne kemi përfunduar një pjesë të punëve tona. Kështu, marrim pjesë nga lutja e Pejgamberit tonë të dashur:

“Zoti im! Begatoje kohën e agimit për bashkësinë time!”

Ne e kujtojmë Zotin dhe e prehim në pushim shpirtin tonë edhe në orët më të dendura me punë gjatë ditës, duke falur namazet e drekës dhe të ikindisë. Mes namazeve pushojmë, qetësohemi psikologjikisht dhe mbledhim energji për punët tona në vazhdim. Meqë punët i kemi kryer duke bërë pushime në mes, marrim më shumë përfundime pozitive prej tyre.

Me faljen e namazit të akshamit dhe të jacisë, ne bëjmë një llogari të ditës dhe më pas flemë të qetë duke menduar se i kemi plotësuar detyrimet si robër të Allahut.

Namazi na pajis me shprehinë e pastërtisë

Kur marrim abdest për të falur namazin, ne pastrojmë organet që ndoten më shumë në jetën tonë të përditshme. Ne i kushtojmë kujdes pastërtisë së trupit, të veshjes dhe të vendit ku do të falim namazin. Duke marrë abdest ne i pastrojmë dhe lajmë disa herë në ditë duart, fytyrën dhe këmbët. Këto na japin mundësi ta kthejmë pastërtinë në zakon.



Njëherë Pejgamberi ynë pyeti sahabët:

- Si mendoni? Nëse përpara derës së dikujt rrjedh një lum në të cilin ai lahet pesë herë në ditë, a do t'i mbesë në trup ndonjë papastërti?

Sahabët u përgjigjën:

Jo, asgjë.

- Ja pra, edhe pesë kohët e namazit kështu janë. Allahu, me pesë kohët e namazit, i fshin të gjitha gjynahet.

(Buhari, Mevakit 6; Muslim, Mesaxhid 283.)

KUSH E KA FARZ FALJEN E NAMAZIT?

Falja e pesë kohëve të namazit u bë farz në natën e Miraxhit. Falja e pesë kohëve të namazit është farz për çdo mysliman që është i shëndoshë mendërisht dhe ka hyrë në moshën e pubertetit.

Namazi është një urdhër i prerë i Allahut. Ata që nuk falen, edhe pse e dinë se falja është farz, vetëm sepse përtojnë të falen, bëjnë një gynah të madh.

Feja jonë kërkon që edhe fëmijët, të mësohen të falin namazet që në moshë të vogël. Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), ka këshilluar që fëmijës t'i mësohet namazi që në moshën 7 vjeçare. Ndërkohë i ka dhënë rëndësi faktit që në moshën dhjetë vjeçare ata të falen rregullisht.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Puna e parë për të cilën do të pyetet njeriu në ditën e gjyimit, është namazi. Nëse namazi është i rregullt, puna e tij është në rregull dhe ai njeri del me fitim. Nëse namazi nuk del i rregullt humbet dhe del me humbje.”

(Tirmidhi, Mevakit 188)



LLOJET E NAMAZIT

Namazet ndahen në tre grupe: farz, vaxhib dhe sunet.



A. NAMAZET FARZ

Namazet farz janë tre llojesh:

1. PESE KOHET E NAMAZIT

a) Namazi i sabahut: Ka katër rekate, dy sunet dhe dy farz.

Në fillim falet suneti, më pas farzi.

b) Namazi i drekës: Ka dhjetë rekate. Fillimisht falen katër rekate sunet. Pastaj katër rekate farz dhe në fund dy sunet.

c) Namazi i ikindisë: Ka tetë rekate. Në fillim falen katër rekate sunet, pastaj katër të tjera farz.



Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Padyshim që namazi është bërë farz me kohë të përcaktuara për besimtarët.”

(Nisa, 103)



d) Namazi i akshamit: ka pesë rekate. Në fillim falen tre rekate farz, pastaj dy të tjera sunet.

fund dy rekate sunet. Pas namazit të jacisë falet namazi i vitrit që ka tre rekate.

e) Namazi i jacisë: Ka dhjetë rekate. Në fillim falen katër rekate sunet, pastaj katër rekatet farz dhe në


Falja e këtij namazi për një mysliman është vaxhib.

Numri i rekateve për pesë kohët e namazit

	Suneti i parë	Farzi	Sunet	Suneti i fundit	Vitri	Totali
SABAHU	2	2	-	-	-	4
DREKA	4	4	-	2	-	10
IKINDIA	4	4	-	-	-	8
AKSHAMI	-	3	2	-	-	5
JACIA	4	4	-	2	3	10+3
						40

2. NAMAZI I XHUMASE: Falet ditën e xhuma në kohën e drekës dhe në vend të namazit të drekës.


3. NAMAZI I XHENAZES: Ky namaz përbëhet nga lutjet dhe përgjërimet për myslimanin e vdekur. Në këtë namaz nuk ka ruku dhe sexhde. Është farz kifaje.



B. NAMAZET VAXHIB

1) Namazet e Bajramit: Namazet e Bajramit kanë dy rekate dhe falen me xhematë.

2) Namazi i vitrit: Ka tre rekate, falet pas namazit të jacisë. Falja kaza e namazit të vitrit që nuk falet në kohë, është vaxhib.



C. NAMAZET SUNET:

Namazet sunet janë namazet që ka falur Pejgamberi ynë, përveç atyre farz dhe vaxhib.

Nga marrëdhënia namaz farz-namaz sunet ato ndahen në dy grupe:

1. Ato të cilat kanë lidhje me namazet farz: Këto janë namazet sunet që falen para dhe pas namazit farz.

a) Sunetet e pesë kohëve namaz janë namazet sunet që falen para dhe pas farzeve të pesë kohëve namaz. (P.sh. suneti i namazit të sabahut)

b) Sunetet e namazit të xhumasë janë namazet sunet që falen para dhe pas namazit farz të xhumasë. (suneti i parë dhe i fundit i namazit të xhumasë)

2. Ato të cilat nuk kanë lidhje me namazet farz: Këto janë namazet sunet që falen në mënyrë të pavarur nga farzet, në dallim nga namazet sunet që lidhen me çfarëdo lloj namazi farz. Disa nga këto namaze sunet që i ka falur Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), janë:


a) Namazi i teravisë: Është një namaz sunet 20 rekate që falet pas namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit gjatë muajit të Ramazanit.

b) Namazi i natës (tehexhudit) është një namaz sunet prej 2 deri në 12 rekatësh që falet në kohën ndërmjet namazit të jacisë dhe namazit të sabahut.

c) Namazi i paradites (duhasë) është një namaz sunet prej 2 deri në 12 rekatësh që falet në kohën që fillon një orë pas lindjes së diellit dhe vazhdon deri në ngritjen e tij në kupën e qiellit.

d) Namazi evvabin është një namaz sunet prej 2 deri në 12 rekatësh që falet pas namazit të akshamit.

e) Namazi në shenjë përshëndetjeje për xhaminë (tahijetu'l-mesxhid) është një namaz sunet prej 2 deri në 12 rekatësh që falet në shenjë përshëndetjeje kur hyjmë në një xhami të re të pavizituar më parë.



“MË NDIHMO MUA DUKE FALUR SHUMË NAMAZ!”

Rabia Ibni Kab, e njohur me emrin Ebu Firas i shërbente vazhdimisht Pejgamberit (a.s.). Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.) ishte shumë i kënaqur nga shërbimet e saj. Kjo sahabe na tregon një kujtim të saj:

Një natë kisha përgatitur ujin për abdest për Pejgamberin. Ai më tha:

- Kërko ç'të duash prej meje nga të mirat e kësaj bote.

Ndërsa unë iu përgjigja:

- O Pejgamberi i Allahut! Më lër të mendohem dhe do ta them se ç'kërkoj prej teje!

Kjo sahabe mendoi me vete: Malli i kësaj bote është i përkohshëm. Të ardhura kam sa të më mjaftojnë. Atëherë më mirë të kërkoj diçka nga bota tjetër, sepse pozita e Profetit tek Allahu është më e lartë.

Më pas shkoi tek Pejgamberi, që e pyeti:

- Çfarë vendose, Rebia?

Unë iu përgjigja:

- O i dërguari i Allahut, dëshiroj të jem në xhe-net me ty. Kërkoj ndërmjetësimin tënd dhe inshallah Allahu do të më shpëtojë nga xhehenemi.

Pejgamberi pyeti:

- A nuk dëshiron diçka tjetër?

Iu përgjigja:

- Kjo është dëshira dhe kërkesa ime e vetme.

Pejgamberi më tha:

- Atëherë më ndihmo edhe mua me faljen sa më shumë të namazeve dhe duke rënë sa më shumë në sexhde.

(Muslim, Salat 226)

FARZET E NAMAZIT

Namazi ka 12 farze, gjashtë prej të cilave duhen përmbushur para se të falim namaz, ndërsa gjashtë të tjerat gjatë namazit. Nëse nuk e përfundon njërin prej tyre atëherë namazi bëhet i pavlefshëm.

Ato janë:

a. Farzet që duhen përmbushur përpara namazit

Këto farze që na përgatisin si fizikisht, ashtu edhe psikologjikisht për faljen e namazeve quhen edhe “kushtet (shart) e namazit”.

1. Pastrimi nga hadethi, ose nga papastërtitë, që i shpjegojmë në kapitujt e mëparshëm të këtij libri, na obligojnë marrjen e abdestit ose të guslit. Pastrimi nga kjo lloj papastërtie arrihet duke marrë abdest, gusël ose tejmemum në rast se nuk kemi ujë për t’u pastruar.

2. Pastrimi nga nexhaseti. Gjendja e papastërtisë që shihet me sy quhet “nexhaset”. Në këtë rast papastërtie duhet kryer pastrimi i trupit, rrobave dhe vendit ku do të falemi.

3. Setru'l-avret. Mbulimi i vendeve të turpshme. Meshkujt duhet të mbulojnë pjesën e trupit nga kërthiza deri nën kapakun e gjurit, ndërsa gratë duhet të mbulojnë kokën, flokët dhe trupin e tyre më përjashtim të duarve, fytyrës dhe këmbëve deri në kyçe.

4. Koha. Çdo namaz farz dhe namaz vaxhib falet në një kohë të caktuar. Namazi që falet para se të hyjë koha e përcaktuar për të është i pavlefshëm. Gjithashtu është gjynah i madh të mos e falim namazin në kohën e vet pa pasur arsye.

5. Drejtimi nga Kibla. Përpara se të fillojmë të falim namaz ne duhet të kthehemi në drejtimin e Qabesë. Namazi i personit që i shmanget drejtimit të Qabesë gjatë faljes së namazit, duke ndërruar drejtimin e kiblesë, prishet.

6. Nijeti. Vënja e qëllimit për namazin që duam të falim. Në nijetin e namazeve që falen me xhemat shtojmë se “jemi lidhur në namaz pas imamit”.

Vetëm në qoftë se i plotësojmë këto 6 kushte që numëruam, ne mund të falim namaz.



Një ditë Ibn Mesudi e pyeti Pejgamberin:
- O i dërguari i Allahut! Cila është puna me kryerjen e të cilës fitohet më shumë pëlqimi i Allahut?

Ai m’u përgjigj:

- Namazi i falur në kohën e vet.

Pyeta përsëri:

- Po pastaj, cila punë vjen?

Ai u përgjigj:

- T’i bësh mirë prindërve tuaj.


Përsëri pyeta:

- Po pastaj, cila punë vjen?

Përsëri u përgjigj:

- Xhiahadi në rrugën e Allahut.

(Buhari, Mevakit 5)



Në çastin që e kthejmë trupin drejt Kiblës përpara se të fillojmë faljen e namazit, zemrën duhet ta drejtojmë nga Allahu, sepse Ai është Kibla e shpirtit

(Mevlana)



b. Farzet e namazit

Kështu quhen veprimet, kryerja e të cilave gjatë namazit është e detyrueshme. Ato quhen ndryshe edhe “shtyllat e namazit”.

1. Tekbiri i hapjes quhet tekbiri fillestar, pra thënia “Allahu ekber” në momentin kur fillojmë namazin.

2. Qëndrimi në këmbë (kijam) Quhet qëndrimi në këmbë gjatë faljes së namazit.

3. Kiraet quhet leximi, të paktën, i tre ajeteve të shkurttra, kur jemi në këmbë.

4. Ruku quhet përkulja në namaz, pasi kemi lexuar ajetet e Kuranit, duke i vendosur pëllëmbët e duarve mbi kupat e gjunjve.



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Çasti kur robi është më afër Zotit të tij është momenti kur ai bie në sexhde”

(Muslim, Salat 215)



5. Sexhde quhet përkulja mbi tokë duke vendosur në të hundën, ballin, duart dhe këmbët.

6. Ulja e fundit është ulja në rekatën e fundit të namazit për aq kohë sa do të na mjaftonte të lexohej lutja “et-Tehijatu lilihi...”

EZANI

Çfarë është ezani? Kush është muezini?

Ezani është thirrja që u bëhet myslimanëve për t'i lajmëruar se ka filluar koha e namazit. Personi që e këndon ezanin quhet “muezini”.

Kur thirret ezani dhe si këndohet ai?

Ezani thirret nga minareja pasi të ketë hyrë koha e namazit. Ai këndohet me zë të lartë. Nëpërmjet ezanit myslimanët thirren pesë herë në ditë të shkojnë në xhami për të falur namazin.

Çfarë duhet të bëjmë kur dëgjojmë ezanin duke u thirrur?

Kur dëgjojmë ezanin, ne duhet të ndërpresim bisedën dhe ta dëgjojmë atë në heshtje. Përsërisim fjalët që këndon muezini. Në momentin që përfundon këndimi i ezanit, ne lexojmë duanë që na ka mësuar profeti ynë, Muhamedi (a.s.)



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Sikur ta dinin njerëzit se sa vepra të virtytshme janë thirrja e ezanit dhe falja e namazit në rreshtin e parë në xhami, do të hidhnin short mes tyre se kush do të thërriste ezanin dhe kush do të falej në rreshtin e parë, në qoftë se nuk kishin për ta zgjidhur ndryshe këtë.”

(Buhari, Edhan 9; Muslim, Salat 129)



Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Kur të dëgjoni ezanin, përsëritini me vete edhe ju fjalitë e tija.”

(Buhari, Edhan 7)



Fjalët e ezanit dhe kuptimi i tyre

اللَّهُ أَكْبَرُ	Allahu ekber (4)	Allahu është më i madhi!
أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ	Eshhedu en la ilahe il-lall-llah (2)	Dëshmoj se s'ka zot tjetër pos Allahut!
أَشْهَدُ أَنْ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ	Eshhedu enne Muhammeden rasulull-llah (2)	Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut!
حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ	Hajje ale-s selah (2)	Ejani në namaz!
حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ	Hajje ale'l felah (2)	Ejani në shpëtim!
اللَّهُ أَكْبَرُ	Allahu ekber (2)	Allahu është më i madhi!
لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ	La ilahe il-lall-llah (1)	S'ka zot tjetër pos Allahut!



Këto fjali thuhet në çdo ezan që këndohet për çdo kohë të namazit, vetëm se, kur këndohet ezani në namazin e sabahut në të shtohet në këndim fjalia “es-selatu hajrun minen-nevm”, që në shqip do të thotë “më mirë të falet namazi sesa të flihet gjumë”, dy herë, pas fjalisë “Hajje ale’s-salat” që në shqip përkthehet “Ejani në namaz”.

Ç’na kujton ezani?

Ezani na njofton se ka hyrë koha e namazit. Duke qenë se falja e namazit është veçori dalluese e myslimanëve, në një vend ku thirret ezani do të thotë se aty jetojnë myslimanë.

I kënduar pesë herë në ditë, ezani na kujton bazat e besimit në një Zot të vetëm. Ai skalit në mendjen dhe zemrën tonë besimin në ekzistencën e Allahut, një i vetëm, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Zotit. Ai na kujton faktin se qëllimi i krijimit tonë është vetëm adhurimi i Allahut, me anë të së cilit edhe ne do të shpëtojmë në botën tjetër.

Profeti ynë (a.s.) thotë:

Myslimani që bën këtë dua, pasi ta ketë dëgjuar ezanin të thirret, e meriton ndërmjetësimin tim ditën e kiametit:

اللَّهُمَّ رَبِّ هَذِهِ الدَّعْوَةُ التَّامَّةُ
وَالصَّلَاةُ الْقَائِمَةُ آتِ سَيِّدَنَا مُحَمَّدٍ الْوَسِيلَةَ
وَالْفَضِيلَةَ وَالدرَجَةَ الرَّفِيعَةَ
وَأَبْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَهُ
إِنَّكَ لَا تُخْلِفُ الْمِيعَادَ

O Allah, Zot i kësaj ftese pa mangësi dhe i këtij namazi që do të falet! Jepi Muhamedit mundësinë e ndërmjetësimit, gradën e lartë, virtytet dhe vendosë atë në “postin e lavdëruar” (makamu’l-mahmud) të cilin ia ke premtuar, sepse Ti je Ai që nuk e then premtimin.

(Buhari, Ezan 8)

IKAMETI

Çfarë është ikameti?

Ikameti është procesi dhe teksti që këndohet përpara se të fillojë falja e namazeve farz.

Kush e thërret ikametin dhe si këndohet ai?

Kur falet namazi me xhematë muezini e këndon më zë të lartë ikametin. Mashkulli që e fal namazin vetëm, e këndon ikametin me aq zë sa të dëgjojë vetveten. Gratë nuk thërresin ikamet.

Fjalitë e ikametit janë të njëjta me ato të ezanit. Vetëm se, në ikamet pas fjalisë “Hajje alel felah” thuhet dy herë fjalia “Kad kametis-salah” që do të thotë “për pak dhe do të fillojë të falet namazi”. Një dallim tjetër ndërmjet ezanit dhe ikametit është mënyra sesi këndohen ato. Ezani këndohet ngadalë dhe duke bërë pushime të shkurtra ndërmjet fjalive, ndërsa ikameti këndohet shpejt dhe duke mos bërë pauzë ndërmjet fjalive.

Fjalët e ikametit:

- Allahu ekber (4)
- Eshhedu en-la ilahe il-lall-llah (2)
- Eshhedu en-ne Muhammeden Rasulull-llah (2)
- Hajje ale’s-selah (2)
- Hajje ale’l-felah (2)
- Kadkameti’s-saleh (2)
- Allahu ekber (2)
- La ilahe il-lall-llah (1)

SI E FALIM NAMAZIN?

Në fillim marrim abdest. Vishemi në atë mënyrë që të mbulojmë me rroba pjesët që janë kusht të jenë të mbuluar në namaz. Qëndrojmë mbi një sexhade apo një

vend të pastër dhe drejtohem nga kibla. Pastaj bëjmë nijetin për namazin që do të falim, p.sh.: “Bëra nijet të fal namazin sunet të sabahut, për hir të Zotit!”.

Rekati i parë

1 (Burrat)

Ngrejnë duart me pëllëmbë të shtrirë deri tek bulëzat e veshëve në mënyrë që me gishtat e mëdhenj t’i prekin ato dhe bëjnë tekbinin fillestar duke thënë “Allahu ekber”.



1 (Gratë)

Ngrejnë duart me pëllëmbë të shtrirë në mënyrë që majat e gishtave të mbërrijnë deri në nivelin e supeve dhe bëjnë tekbinin fillestar duke thënë: “Allahu ekber!”



Llokmani i dha këtë këshillë të birit:

- Biri im! Fale namazin, urdhëro për të mirë, largoji të tjerët nga të këqijat, bëj durim për ata që të ndodhin, pasi këto janë punë që duhet të bëhen me vendosmëri.”

(Lukman, 17)



2 (Burrat)

Vënë dorën e djathtë mbi të majtën duke rrethuar kyçin e të majtës me gishtin e madh dhe gishtin e vogël të së djathtës. Duart e lidhura në këtë mënyrë ulen poshtë këerthizës.

Fillimisht duke qëndruar në këmbë, thuhet duaja “Subhaneke All-llahumme...”, më pas “Eudhu... besmele...”-ja, “Fatiha”-ja dhe një nga suret e Kuranit.



2 (Gratë)

Vënë dorën e djathtë mbi të majtën dhe në këtë formë i vendosin mbi kraharor.

Fillimisht duke qëndruar në këmbë, thuhet duaja “Subhaneke Allahume...”, më pas “Eudhu... besmele...”-ja, “Fatiha”-ja dhe një nga suret e Kuranit.



3 (Burrat)

Duke u përkulur, thuhet “Allahu ekber!” Përkulemi në atë mënyrë që shpinën ta mbajmë të shtrirë drejt, vendosim duart mbi kupat e gjunjëve me gishtat e të cilave i mbërthejmë fort ata. Në ruku thuhet tri herë “Subhane rab-bijel adhim”.



3 (Gratë)

Duke u përkulur, thuhet “Allahu ekber!” Përkulemi në atë mënyrë që shpinën ta mbajmë të shtrirë, por në krahasim me meshkujt, gratë e mbajnë shpinën shumë më të harkuar dhe vendosin duart lehtë mbi gjunjë. Në ruku thuhet tri herë “Subhane rab-bijel adhim”.



4 (Burrat)

Duke thënë "Semiallahu limen hamideh", drejtojnë trupin në pozicionin e kijamit me duart e lëshuara anash. Qëndrojnë për një moment në këmbë dhe thonë "Rabbena ve lekel hamd"

4 (Gratë)

Duke thënë "Semiallahu limen hamideh", drejtojnë trupin në pozicionin e kijamit me duart e lëshuara anash. Qëndrojnë për një moment në këmbë dhe thonë "Rabbena ve lekel hamd"

5 (Burrat)

Duke thënë "Allahu ekber!" bien në sexhde. Në sexhde hunda dhe balli duhet ta takojnë tokën në mënyrë që ta ndjejnë atë. Krahët i largojnë nga trupi dhe bërrylat nuk i mbështesim në tokë. Këmbët i vendosin vertikalisht, mbi gishtat e kthyer nga Kibla. Në sexhde thuhet tri herë "Subhane rabijel ala"

5 (Gratë)

Duke thënë "Allahu ekber!" bien në sexhde. Në sexhde hunda dhe balli duhet ta takojnë tokën në mënyrë që ta ndjejnë atë. Në sexhde krahët i ngjeshin me trupin. Bërrylat i vendosin në tokë. Këmbët i vendosin vertikalisht, mbi gishtat e kthyer nga Kibla. Në sexhde thuhet tri herë "Subhane rabijel ala"



6 (Burrat)

Më pas, duke thënë "Allahu ekber" drejtohen nga sexhdeja dhe qëndrojnë ndenjor mbi gjunjë. Këmbën e majtë e shtrijnë dhe ulemi mbi të, ndërsa këmbën e djathtë e mbajnë vertikalisht me gishtërinjtë të kthyer nga kibla. Duart i vendosim mbi kofshë.

6 (Gratë)

Më pas, duke thënë "Allahu ekber" drejtohen nga sexhdeja dhe qëndrojnë ndenjor mbi gjunjë. Të dy këmbët i shtrijnë dhe i nxjerrin djathtas. Ulen mbi sexhade.

7 (Burrat)

Bien përsëri në sexhde duke thënë: “Allahu ekber!”, ku përsëritet tri herë “Subhane rabbijel ala!”

7 (Gratë)

Bien përsëri në sexhde duke thënë: “Allahu ekber!”, ku përsëritet tri herë “Subhane rabbijel ala!”

8 (Burrat)

Ngrihen në këmbë për rekatën e dytë duke thënë “Allahu ekber!”

8 (Gratë)

Ngrihen në këmbë për rekatën e dytë duke thënë “Allahu ekber!”

Rekati II

9 (Burrat)

I lidhin duart nën kërthizë. Thonë vetëm “Besmele”-në, “Fatiha”-në dhe një sure.

9 (Gratë)

I vendosin duart mbi kraharor duke vendosur dorën e djathtë mbi dorën e majtë. Thonë vetëm “Besmele”-në, “Fatiha”-në dhe një sure.

10 (Burrat)

Përkulen në ruku duke thënë “Allahu ekber!” Në ruku thonë tri herë “Subhane rabbijel adhim!”

10 (Gratë)

Përkulen në ruku duke thënë “Allahu ekber!” Në ruku thonë tri herë “Subhane rabbijel adhim!”

11 (Burrat)

Duke thënë “Semiallahu limen hamideh”, drejtojnë trupin në pozicionin e kijamit me duart e lëshuara anash. Qëndrojnë për një moment në këmbë dhe thonë “Rabbena ve lekel hamd”.

11 (Gratë)

Duke thënë “Semiallahu limen hamideh”, drejtojnë trupin në pozicionin e kijamit me duart e lëshuara anash. Qëndrojnë për një moment në këmbë dhe thonë “Rabbena ve lekel hamd”.

12 (Burrat)

Bien në sexhde duke thënë “Allahu ekber!”. Në sexhde thuhet tri herë “Subhane rebbijel a’la!”.

13 (Burrat)

Më pas duke thënë “Allahu ekber” ngrihen nga sexhdeja dhe qëndrojnë ndenjur mbi gjunjë.

14 (Burrat)

Duke thënë “Allahu ekber!” bien në sexhde, ku thuhet tri herë “Subhane rabbijel a’la!”

15 (Burrat)

Më pas duke thënë “Allahu ekber” ngrihen nga sexhdeja dhe qëndrojnë ndenjur mbi gjunjë. Këtë herë duke qëndruar ndenjur, këndojnë me vete dua të “Ettehijatu lil-lahi...!”, “All-llahumme sal-li ala Muhammedin...!”, “Allahumme barik ala Muhammedin!”, “Rabbena atin afi dunja!” dhe “Rabbenagfirli..!”

12 (Gratë)

Bien në sexhde duke thënë “Allahu ekber!”. Në sexhde thuhet tri herë “Subhane rebbijel a’la!”.

13 (Gratë)

Më pas duke thënë “Allahu ekber” ngrihen nga sexhdeja dhe qëndrojnë ndenjur mbi gjunjë.

14 (Gratë)

Duke thënë “Allahu ekber!” bien në sexhde, ku thuhet tri herë “Subhane rabbijel a’la!”

15 (Gratë)

Më pas duke thënë “Allahu ekber” ngrihen nga sexhdeja dhe qëndrojnë ndenjur mbi gjunjë. Këtë herë duke qëndruar ndenjur, këndojnë me vete dua të “Ettehijatu lil-lahi...!”, “All-llahumme sal-li ala Muhammedin...!”, “Allahumme barik ala Muhammedin!”, “Rabbena atina fid-dunja!” dhe “Rabbenagfirli..!”



16 (Burrat)

Pasi t'i lexojnë duatë, kthejnë kokën në të djathtë duke thënë "Es-selamu alejkum ve rahmetull-llah!" dhe më pas në krahun e majtë duke thënë "Es-selamu alejkum ve rahmetull-llah!". Kështu kemi falur dy rekate namaz.



16 (Gratë)

Pasi t'i lexojnë duatë, kthejnë kokën në të djathtë duke thënë "Es-selamu alejkum ve rahmetull-llah!" dhe më pas në krahun e majtë duke thënë "Es-selamu alejkum ve rahmetull-llah!". Kështu kemi falur dy rekate namaz.



Kur e pyetën Hatemi Esmanë, njërin nga miqtë e ngushtë të Allahut, se si e falte namazin, ai iu përgjigj:

Kur afrohet koha e namazit, marr abdest, shkoj në vendin ku do të falem, ulem aty dhe përqendrohem, më pas ngrihem për t'u falur. Vendosem në atë mënyrë që Qabja të jetë mes dy vetullave të mia, rruga e drejtë nën këmbë, xheneti në të djathtë dhe xhehenemi në të majtë. Azraili në majë të kokës në çdo çast mund të ma marrë shpirtin. E pranoj sikur ky namaz të ishte i fundit dhe e fal atë mes ndjenjës së frikës dhe të shpresës. Me kujdes marr tekbinin fillestar dhe duke menduar kuptimin e ajeteve, lexoj Kuranin. Me mirënjohje dhe mirësjellje ulem në ruku, me qetësi ulem në sexhde, me mirësi fal namazin. Më pas, mbaj ankthin e pranimit apo jo të tij. Së fundi, kërkoj prej Allahut shpëtim.



SI FALIM NAMAZ?

NAMAZI I SABAHT	Rekati i parë	Rekati i dytë		
SUNETI I NAMAZIT TË SABAHT (2)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam		
FARZI I NAMAZIT TE SABAHT (2)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam		

NAMAZI I DREKËS	Rekati i parë	Rekati i dytë	Rekat i tretë	Rekat i katërt
SUNETI I NAMAZIT TË DREKËS	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam



FARZI I NAMAZIT TË DREKËS (4)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam
SYENTI I FUNDIT I NAMAZIT TË DREKËS (2)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam		

NAMAZI I IKINDISË	Rekati i parë	Rekati i dytë	Rekat i tretë	Rekat i katërt
SUNETI I NAMAZIT TË IKINDISË (4)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik	*Subhaneke * Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam
FARZI I NAMAZIT TË IKINDISË (4)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam

NAMAZI I AKSHAMIT	Rekati i parë	Rekati i dytë	Rekat i tretë	
FARZI I NAMAZIT TË AKSHAMIT	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam	
SUNETI I NAMAZIT TË AKSHAMIT (2)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam		

NAMAZI I JACISE	Rekati i parë	Rekati i dytë	Rekat i tretë	Rekat i katërt
SUNETI I PARË I NAMAZIT TË JACISË (4)	*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde	* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam



<p>FARZI I NAMAZIT TE JACISE (4)</p>	<p>*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde</p>	<p>* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat</p>	<p>* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde</p>	<p>* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam</p>
<p>SUNETI I FUNDIT I NAMAZIT TE JACISE (2)</p>	<p>*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde</p>	<p>* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam</p>		

<p>NAMAZI I VITRIT</p>	<p>Rekati i parë</p>	<p>Rekati i dytë</p>	<p>Rekat i tretë</p>	
<p>NAMAZI I VITRIT (3)</p>	<p>*Tekbiri fillestar *Subhaneke *Eudhu Besmele *Fatiha *Besmele *Një sure *Ruku *Sexhde</p>	<p>* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Ruku * Sexhde * Tahijat</p>	<p>* Eudhu Besmele * Fatiha * Besmele * Një sure * Tekbiri * Duaja e kunutit * Ruku * Sexhde * Tahijat * Sal-li barik * Rabbena * Selam</p>	

DUATË DHE TESBIHET QË KËNDOHEN PAS NAMAZIT

Në çdo namaz, pas dhënies së selamit thuhet:

اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمِنْكَ السَّلَامُ تَبَارَكْتَ
يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

“All-llahumme ente-selamu ve minkes-selamu tebarekte ja dhel xhelali vel ikram.” Më pas themi:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ وَلَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ
وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ

“Subhanall-llahi vel hamdulil-lahi ve la ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber ve la havle ve la kuvvete il-la bil-lahil alijjil adhim”

Pas besmelesë këndojmë ajeti kursinë.

Pasi të themi 33 herë **سُبْحَانَ اللَّهِ** Subhanall-llah, 33 herë **الْحَمْدُ لِلَّهِ** Elhamdulil-lah, 33 herë **اللَّهُ أَكْبَرُ** Allahu ekber shtojmë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ الْمَلِكُ وَلَهُ
الْحَمْدُ وَهُوَ عَلِيُّ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ
سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَلِيِّ الْأَعْلَى الْوَهَّابِ

“La ilahe il-lallahu vahdehu la sherijkeleh le-hul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kul-li shej’in kadir. Subhane rabbijel alij-jil ea’lel vehhab”, pastaj ngremë duart lart dhe bëjmë duatë. Pas duasë prekim lehtë fytyrën me duar dhe kështu e kemi përfunduar adhurimin tonë.

Këtu mund të bëjmë edhe duanë e mëposhtme, të cilën Pejgamberi ynë Muhammedi (a.s) e

ka lexuar pas namazeve dhe i ka këshilluar edhe myslimanët që ta lexojnë atë:

Zoti im! Vetëm Ty të falënderoj. Ti je Ai që zotëron ç’ka në tokë, në qiell dhe mes tyre.

“Falënderimet të qofshin Ty. Ti je e drejta dhe e vërteta. Çdo gjë që Ti ke vendosur të bëhet është e drejtë dhe e vërtetë. Fjala Jote është e drejtë dhe e vërtetë, ashtu siç është edhe vdekja dhe takimi me Ty e vërtetë. Xheneti ekziston vërtet. Xhehenemi ekziston vërtet. Dita e gjykimit vërtet që do të vijë. Pejgamberët me të vërtetë i ke dërguar Ti për njerëzit. Muhamedi (a.s.) është profeti i fundit.

Zoti im! Vetën time ta dhashë vetëm Ty duke pranuar urdhrat dhe ndalesat e Tua. Vetëm Ty të besova. Vetëm tek Ti besova. Vetëm tek Ti e ktheva fytyrën dhe shpirtin tim.



Zoti im! M'i prano namazet dhe duatë e mia. Ti je Ai që dëgjon dhe sheh gjithçka.

Zoti im! M'i fal gjynahet e mia, ato që kam bërë pa vetëdije, gabimet që kam bërë duke i tejkuar kufijtë, të gjitha fajet që i di më mirë se unë!

Zoti im! M'i fal gjynahet që i kam bërë gabimisht apo me vetëdije!

Zoti im! Më ndihmo që të të kujtoj Ty, të të falënderoj për mirësitë e Tua dhe të të adhuroj Ty!

Zoti im! Më ruaj që të mos bie në ato gabime që bien ndesh me fenë time e cila është edhe pikënisja e të gjitha punëve të mia! Mundëso që të më shkojnë mbarë punët në këtë botë që jetojmë! Më ndihmo që të fitoj ahiretin! Më jep mundësi që të bëj më shumë të mira gjatë jetës!

Zoti im! Më ruaj nga çdo gjë që do të prishë bashkimin e myslimanëve, nga mospërshtatja e të brendshmes me të jashtmen, dyfytërsia dhe nga çdo gjë tjetër e keqe!

Zoti im! Më trego rrugën e drejtë! Ma ruaj të pastër moralin dhe shpirtin tim. Më zbukuro moralin, më mbaj larg haremeve!

Zoti im! Të mbështetem Ty për të më mbrojtur nga morali i keq, nga kryerja e punëve të këqija, nga kalimi në besimet e gabuara!

Zoti im! Të mbështetem Ty për të më mbrojtur nga varfëria, poshtërimi, nga marrja nëpër këmbë e të tjerëve dhe nga të tjerët!

O Zoti im që na ke krijuar dhe edukuar! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër! Na ruaj nga vuajtja e xhehenemit!

O Zoti ynë që na ke krijuar dhe na edukon! Më fal mua, nënën dhe babanë dhe të gjithë njerëzit në ditën kur do të japim llogari!

Amin!



Një ditë Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), takoi Muadh bin Xhebelin dhe i tha: O Muadh! Unë me të vërtetë të dua ty!

Muadhi iu përgjigj: O Pejgamberi i Zotit! Edhe unë të dua ty!

Pejgamberi ynë vazhdoi: Muadh, të këshilloj që pas çdo namazi të këndosh këtë dua:

اللَّهُمَّ اَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ

“Zoti im! Më ndihmo mua të të kujtoj Ty, të të falënderoj për mirësitë e Tua, dhe të të adhuroj me përkushtim!”

(Ebu Davud, Vitir 26)



VAXHIBET E NAMAZIT ☺☺☺

Vaxhibe quhen veprimet që kryhen gjatë faljes së namazit dhe që e bëjnë më të plotë atë. Kur nuk kryhet pa dashje ose e vonojmë një vaxhib të namazit, atëherë duhet të bëjmë sexhden e harresës (sehvi sexhde).

Vaxhibet e namazit janë:

- ☺ Leximi i sures “Fatihā” në namaz.
- ☺ Leximi i një sureje apo disa ajeteve të një sureje përveç sures “Fatihā”.
- ☺ Leximi i “Fatihasë” para sures tjetër.
- ☺ Të prekim tokën me hundë dhe me ballë kur jemi në sexhde.
- ☺ Ulja në tehijat në rekatin e dytë të namazeve me tre dhe katër rekate.
- ☺ Kryerja e çdo shtylle (rukn) të namazit në vendin dhe kohën e duhur (tadili erkan). E thënë ndryshe, kryerja ngadalë e pa u nxituar e lëvizjeve gjatë rënies dhe ngritjes nga rukuja dhe sexhdeja. P.sh.: personi që kur drejtohet nga rukuja nuk qëndron në këmbë aq kohë sa të thuhet “Rabbena ve lekel hamd!”, por bie menjëherë në sexhde nuk e ka respektuar këtë vaxhib të namazit, pra tadili erkanin.
- ☺ Leximi i lutjes “Tehijat” në uljen e parë dhe të fundit.
- ☺ Marrja e tekbitit të kunutit dhe e leximit të duasë së kunutit në namazin e vitrit.
- ☺ Dhënia selam në të djathtë dhe në të majtë në fund të namazit.
- ☺ Bërja e sehvi sexhdes, kur gabojmë pa dashje në namaz, në disa raste të përcaktuara sipas jurisprudencës islame (fikhut).
- ☺ Leximi me zë i imamit në namazet e sabahut, akshamit dhe jacisë.
- ☺ Leximi pa zë i imamit në namazet e drekës dhe të ikindisë.

FALE NAMAZIN PËRSËRI

Një ditë Pejgamberi hyri në mesxhid dhe u ul në një qoshe të tij. Sahabët u ulën përreth tij. Në atë çast erdhi një person dhe filloi të falte namazin. Burri nuk e dinte se Pejgamberi ynë po e ndiqte me sy tek falej. Pasi përfundoi namazin, erdhi te Pejgamberi dhe i dha selam. Pejgamberi ia ktheu selamin dhe i tha:

- Kthehu dhe falu përsëri, sepse nuk e ke falur namazin siç duhet.

Burri u kthye dhe e fali përsëri si më parë. Më pas, i shkoi pranë Profetit i cili i tha:

- Kthehu dhe falu përsëri, sepse nuk e ke falur namazin siç duhet.

Kjo gjë u përsërit tri herë dhe në fund fare personi tha:

- Beto hem në Allahun që të ka dërguar, o Muhamed, se nuk di të falem ndryshe, por vetëm në këtë mënyrë që u fala. Më mëso se si është e sakta!

Pejgamberi e mësoi duke i thënë:

- Merr tek bir kur të drejtosh në namaz. Më pas lexo ajetet që i ke për më lehtë. Më pas ulu në ruku. Qëndro në ruku derisa çdo gjymtyrë e jotja të marrë formën e saj. Thuaj tri herë “Subhane rabbijel adhim”, drejtohu nga rukuja dhe

qëndro në këmbë me trupin drejt. Më pas bjer në sexhde. Qëndro në sexhde derisa çdo gjymtyrë e jotja të marrë formën e saj. Thuaj tri herë “Subhane rabbijel a’la!” në sexhde. Pastaj drejtohu nga sexhdeja dhe qëndro ndenjtur derisa çdo gjymtyrë e jotja të drejtohet. Vepron në këtë mënyrë në të gjitha rekatet e namazeve.

(Buhari, Ezan 95)

SUNETET E NAMAZIT 😊😊

- 😊 Këndimi i ezanit për pesë kohët e namazit, ezani i namazit të xhumasë dhe ikameti.
- 😊 Leximi në heshtje i “Subhaneke” pas marrjes së tek birit fillestar.
- 😊 Leximi i “Eudhu Besmele”-së në rekatën e parë, para se të lexojmë suren “Fatiha”- dhe leximi vetëm i “Besmele”-së në rekatet e tjera.
- 😊 Thënia “Amin” pa zë kur përfundojmë leximin e sures “Fatiha”.
- 😊 Këndimi tri herë i tesbihëve në ruku dhe në sexhde.
- 😊 Këndimi në ruku i tesbihi me fjalët “Subhane rabbijel adhim” dhe në sexhde i tesbihut “Subhane rabbijel a’la”.
- 😊 Këndimi i tek biritëve ndërmjet veprimeve si kijami, rukuja dhe sexhdeja.
- 😊 Thënia “Semiall-llahu limen hamideh” ndërsa drejtojmë trupin nga rukuja dhe “Rabbena lekel hamd” pasi ta kemi drejtuar atë.
- 😊 Këndimi i duave “All-llahumme sal-li ala Muhammed..., All-llahumme barik ala Muhammedin” dhe “Rabbena atina..., Rabbenagfirli...” në uljen e fundit.



ETIKA E NAMAZIT

Respektimi i etikës së namazit na ndihmon të falim një namaz me zemër të qetë dhe të përkushtuar. Disa nga veprimet e etikës (adab) së namazit janë:

- ☺ Vështrimi i vendit të sexhdes kur jemi në këmbë, i gishtave të këmbëve në ruku, i gjunjve në sexhde dhe i shpatullave kur japim selam.
- ☺ Këndimi më shumë se tri herë i tesbihëve në ruku dhe sexhde.
- ☺ Mbjajtja ndër mend se në namaz jemi para Allahut.

Pyetën një dijetar mysliman: "Si e arrin besimtari qetësinë në namaz?"

Ai dha këtë përgjigje:

- 1- Duke u ushqyer me hallall.
- 2- Duke qenë i kujdesshëm në përgatitjet e namazit dhe gjatë marrjes së abdestit.
- 3- Duke menduar që jemi para Allahut që nga marrja e tekbitit fillestar dhe deri në përfundimin e namazit.
- 4- Mos ta harrojmë asnjëherë Allahun edhe jashtë namazeve duke qenë të vetëdijshëm se Ai na sheh në çdo çast.

MEKRUHET E NAMAZIT ☹️☹️

Nuk duhet të harrojmë se gjatë namazit jemi para Allahut dhe duhet të falemi siç na ka mësuar Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.). Duhet t'u kushtojmë kujdes vaxhibeve dhe suneteve si plotësim të farzeve. Moskryerja e vaxhibeve dhe suneteve të namazit quhet mekruh, që do të thotë veprim i papëlqyeshëm.

Disa nga mekruhet e namazit janë:

- ☹️ Lëvizjet e panevojshme të trupit dhe luajtja me rrobat kur jemi të lidhur në namaz.
- ☹️ Falja e namazit ndërsa të mendojnë nevojat fiziologjike.
- ☹️ Të falesh pas rreshtit të xhematit në të cilin ka
- ☹️ Mosvendosja e ndonjë objekti përpara nëse mendon se mund të kalojë dikush përpara teje.
- ☹️ Mosthënia e tesbihëve që këndohen në ruku dhe në sexhde apo këndimi i tyre më pak se tri herë.
- ☹️ Suret që këndohen pas Fatihasë, këndohen sipas radhitjes që kanë në Kuran. P.sh. kur duam që në një namaz me dy rekatë të këndojmë suret Kevther dhe Ihlas, atëherë në rekatën e parë duhet të lexojmë suren Kevther, ndërsa në të dytin suren Ihlas. Moszbatimi i kësaj rradhe të sureve është mekruh.
- ☹️ Falja e namazit përpara pikturës apo fotografisë të cilat kanë qenie të gjalla; njeri apo kafshë.

KUSH ERDHI NË NAMAZ?

Një ditë Ramazani halife Harun Reshidi i tha Behlul Danasë:


- Shko në xhami të falësh namazin e akshamit dhe fto për yftar të gjithë ata që janë duke u falur.

Hyri koha e namazit të akshamit. U thirr ezani. Në xhami kishte disa rreshta xhemati. Pas faljes së namazit, Behlul Dana doli nga xhamia i shoqëruar me pesë vetë. Halifeja u habit.

- Vetëm kaq?! Unë i ftova që të vinin për yftar të gjithë ata që ishin duke falur namazin e akshamit, ndërsa ju më keni sjellë vetëm pesë vetë.

Behlul Dana tha:

- I nderuari mbreti im! Ju më thatë që të ftoja për yftar ata që falin namaz dhe jo ata që vijnë në xhami. Pas namazit qëndrova tek dera e xhamisë dhe e pyeta secilin që doli nga xhamia se cilën sure këndoi imami në namaz. Shumica e xhematit nuk e kujtoi se cilën sure kishte kënduar imami. Vetëm këta persona që ju solla, e mbanin mend. Kishte shumë njerëz në xhami, por ata që e falën namazin me vëmendje dhe sinqeritet ishin vetëm këta që ua solla.



TE FALESH NAMAZ I PËRQENDRUAR

Ne i përkushtohemi plotësisht punës që bëjmë me dëshirë në mënyrë që ta realizojmë atë me sukses. Nganjëherë aq shumë përqendrohemi mbi të sa që nuk kuptojmë se çfarë ndodh rreth nesh. Përqendrimi (hushu) në namaz do të thotë që besimtari ta ndjejë me zemër që gjendet përpara Allahu dhe të mos i tërheqë vëmendjen asgjë përreth.

Ne nuk dëshirojmë të ndahemi nga personi që e duam. Shpeshherë na duket se koha kalon shpejt, megjithëse kalojmë orë të tëra duke biseduar, madje shprehim keqardhjen tonë duke thënë "Sa shpejt që kaloi koha!".

Është gabim të merremi me gjëra të tjera ndërkohë që bashkëbisedojmë me të tjerët, apo jo? E njëjta gjë vlen edhe kur jemi në namaz. Pra, është gabim të merremi me gjëra të tjera kur jemi përpara Allahut!

Namazet tona nuk duhen kthyer në kohën që planifikohet zgjidhja e problemeve të punës, të shkollës, të familjes dhe të shokëve. Zemrat tona duhen kthyer drejt Allahut që nga momenti kur drejtohem nga Kibla. Respekti ynë ndaj namazit që falim, rritet më shumë kur kuptojmë domethënien e ajeteve që lexojmë dhe përjetojmë ndjesinë se jemi përpara Allahut.

Nuk duhet të merremi me gjëra të tjera në momentet kur jemi vetëm me Zotin, që na sheh kudo që të gjendemi, bëjmë dua dhe lexojmë ajetet e Tij. Si do t'i përgjigjemi Zotit kur të na pyesë: "Robi im! Unë isha me ty. Po ti, me kë ishe?"

Çdo namaz që falim duhet ta konsiderojmë si çastin kur dy shokë takohen me njëri-tjetrin, ose kur robi takohet me Zotin. Namazin nuk duhet ta vlerësojmë si një barrë që na rëndon. Ne jemi të përqendruar në namaz (hushu) atëherë kur namazin e konsiderojmë si koha në të cilën shfaqim dashurinë tonë ndaj Zotit dhe ndiejmë se jemi vetëm për vetëm me Të.

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

"Me të vërtetë kanë shpëtuar besimtarët që janë të vetëdijshëm në namazet e tyre."

(Mu'minun 1-2)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

"Kërkoni ndihmë prej Allahut me durim dhe namaz. Padyshim që këto dy elemente (durimi dhe namazi) janë pjesë të detyrës që çdokujt i duket e vështirë dhe e rëndë përveç atyre që u dridhet zemra nga respekti ndaj Allahut, që u besojnë në mënyrë të prerë Zotit të tyre dhe se do të kthehen tek Ai dhe që e kanë pranuar një gjë të tillë".

(Bekare 153)

Kur fillojmë namazin, mendojmë madhësitinë e Allahut dhe dalim përpara Tij duke thënë "Allahu ekber". Qëndrojmë me respekt përpara Tij. Ne mendojmë se Allahu është duke folur me ne teksa lexojmë apo dëgjojmë suret. Përkulemi në ruku duke kujtuar madhësitinë e Zotit. Përsëri, pasi drejtohem me respekt me gjithë trupin dhe qënien tonë, biem në sexhde dhe vendosim ballin në tokë. Duke menduar se momentet që rrimë në sexhde janë çastet që gjendemi më afër Zotit, themi: "Zoti im i lartë, Ty të madhëroj me tesbih". Ne mendojmë se qëllimi i krijimit

është robëria ndaj Zotit, për hir të të Cilit ne jemi të gatshëm të sakrifikojmë çdo gjë, prandaj edhe e madhërojmë Atë. Rekatet e namazit i falim duke përjetuar ndjenja të njëjta. Qëndrojmë kokulur në uljen e fundit të namazit dhe lexojmë lutjet "et-Tehijjatu...", "Allahumme sali..., Allahumme barik..." dhe "Rabbena atina...". Japim selam në të djathtë dhe në të majtë, duke përshëndetur kështu njerëzit dhe engjëjt, të pushtuar nga gëzimi që të fal përmbushja e një adhurimi që të afron me Krijuesin tonë, siç është namazi.

ÇFARE E PRISH NAMAZIN? 💣

- Prishja e abdestit gjatë faljes së namazit.
- Shmangia nga drejtimi i kiblës në namaz.
- Moskryerja e njërit prej farzeve të namazit.
- Kryerja e disa veprimeve që nuk kanë lidhje me namazin, në mënyrë aq të vazhdueshme, sa që të na humbasë përqendrimi.
- Ngrënia dhe pirja në namaz.
- Të folurit dhe përshëndetjet gjatë namazit .
- Leximi i gabuar i ajeteve të Kuranit duke ia prishur kuptimin atyre.
- Qarja me zë ose rënkimi që shkaktohen nga shqetësimet e kësaj bote (qarja për shkak të dashurisë dhe frikës ndaj Allahut nuk e prish namazin)
- Lindja e diellit kur jemi duke falur namazin e sabahut.
- Qeshja pa zë (qeshja me zë prish edhe abdestin)

Nuk dëshirova t'ua prishja lojën!

Ishte koha e namazit të drekës apo të ikindisë, kur pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), mori me vete mbi supe nipërit e tij, Hasanin dhe Hysenin, dhe u nis për në xhami. Pasi mbërriti, iu drejtua mihrabit duke i ulur në tokë ato. Filloi namazin me tekbirin fillestar. Edhe sahabët u rreshtuan në namaz pas tij. Pejgamberi e zgjati sexhden e namazit më shumë se herët e tjera. Në këtë kohë njëri prej nipave zuri lojë mbi shpinën e tij. Pas faljes së namazit sahabët e pyetën:

- O Pejgamberi i Allahut! Kur zgjatët qëndrimin tuaj në sexhde, pandehëm se mos pësuat gjë, apo se mos ju erdhi shpallja.

Pejgamberi (a.s.) u përgjigj:

- As njëra, as tjetra. Kur isha në sexhde, nipi im hipi mbi shpinën time. Qëndrova ashtu derisa zbriti ai. Dëshiroja që mos t'ia prishja lojën.”

(Nesai, Tatbik 82)



RËNDËSIA E FALJES SË NAMAZIT ME XHEMAT

Kush quhet imam? Po xhematë?

Imam quhet ai person që i prin një ose disa besimtarëve në faljen e namazit. Xhematë quhen myslimanët që rreshtohen në namaz pas imanit.

Pse xhamia është quajtur “shtëpia e Allahut”?

Xhamitë dhe mesxhidët janë ndërtesa ku myslimanët grumbullohen për të falur së bashku namazet. Këto ndërtesa quhen ndryshe edhe “shtëpitë e Zotit”, sepse aty adhurohet Allahu, falet namazi dhe i bëhet sexhde vetëm Krijuesit të Gjithësisë.

Përse duhet falur namazi me xhematë?

Pejgamberi ynë i ka falur vazhdimisht namazet me xhematë dhe ia ka këshilluar këtë myslimanëve. Ai na ka treguar se namazi që falet me xhematë është 27 herë më i vlefshëm se namazi që falet vetëm. Ai ka shprehur pakënaqësinë e tij ndaj braktisjes së namazit me xhematë pa pasur një arsye serioze. Ai e ka konsideruar faljen vazhdimisht me xhematë si tipar dallues të një myslimani të devotshëm.

Gjithashtu, Pejgamberi ynë i dashur i ka përgëzuar myslimanët që marrin abdest dhe shkojnë në xhami, me faljen e gjynaheve dhe fitimin e sevapeve për çdo hap të hedhur.



Pejgamberi ynë (a.s) ka thënë:

“Namazi i falur me xhematë është 27 herë më me vlerë sesa namazi që falet vetëm.”

(Buhari, Ezan 30)



Ç’përfitojmë ne nga falja e namazit me xhematë?

Falja e namazeve në grup zgjon në mesin e myslimanëve frymën e dashurisë dhe të solidaritetit. Myslimanët që i falin namazet me xhematë njihen me problemet e njëri-tjetrit dhe përpiqen të gjithë së bashku t’u japin zgjidhje atyre.

Në xhami ne mësojmë urdhëresat dhe ndalesat e Allahut nëpërmjet ligjëratave fetare (vazë), hutbeve dhe bashkëbisedimeve të ndryshme; thellojmë njohuritë që kemi në lidhje me jetën dhe moralin e Pejgamberit tonë.



Pejgamberi ynë (a.s) ka thënë:

“Njerëzit që do të fitojnë më tepër sevap nga falja e namazit janë ata që përshkojnë në këmbë distanca më të gjata për të shkuar në xhami. Sevapet e atij që fal namazin me xhematë janë më të shumtë sesa sevapet që fiton myslimani që falet vetëm.

(Buhari, Ezan 31)



Pejgamberi ynë (a.s) ka thënë:

“Nëse dikush merr abdest në shtëpinë e tij dhe niset të shkojë në xhami për të falur namazin, çdo hap që hedh me një këmbë i shlyen një gjynah, ndërsa çdo hap që hedh me këmbën tjetër ia lartëson gradën shpirtërore.”

(Muslim, Mesaxhid 282)



Kur mblihdemi për t'u falur së bashku në xhami, ne përjetojmë gëzimin dhe qetësinë e kryerjes së adhurimit. Engjëjt na rrethojnë dhe mirësitë e Allahut derdhen mbi ne. Zoti ynë i do më shumë adhurimet që bëhen në bashkësi, për hir të së cilave, Ai na fal të metat tona në namaz.

Si duhet bërë rreshtimi në namazin me xhematë?

Kur namazi falet me xhematë, burrat duhen të qëndrojnë në rreshtat e parë, fëmijët në ato të mesit dhe gratë në fund.

Nëse në rreshtin e parë pas imamit ndodhet vetëm një person, ai qëndron në krahun e djathtë të imamit.

Rreshtat e xhematit duhet të jenë të rregullt dhe në to nuk duhet të ketë asnjë vend bosh. Nuk përfrohet të formohet një rresht tjetër, kur ai përpara tij është i paplotësuar.

Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Drejtojini rreshtat! Bashkujini sa më drejt shpatullat! Plotësojini hapësirat ndërmjet jush! Silluni butë me vëllezërit besimtarë që ju tërheqin nga krahu për të plotësuar rreshtin. Mos lini hapësira nga ku mund të hyjë shejtani. Allahu i përmirëson zemrat e myslimanëve që në namaz rrinë ngjeshur, pranë njëri-tjetrit, dhe nuk i begaton ata që bëjnë të kundërtën.”

(Ebu Davud, Salat 93)

Pejgamberi na kujton se drejtimi i rreshtave është një ndër elementet plotësues të namazit. Ai përshkonte rreshtat nga cepi në cep dhe duke i drejtuar u thoshte kështu sahabeve: “Mos rri në mënyrë të çrregullt, njëri para, tjetri prapa, se atëherë edhe zemrat tuaja bëhen të huaja për njëra-tjetrën.

(Ebu Davud, Salat 93)

EDUKATA E XHAMISË

Duhet t'u kushtojmë kujdes pikave të mëposhtme që kanë lidhje me edukatën e xhamisë:

- Në xhami duhet të hyjmë me abdest dhe me këmbë të djathtë.
- Nga xhamia duhet të dalim me këmbë të majtë.
- Në tapetin e xhamisë nuk duhet të shkelim me këmbë dhe çorape të ndotura.
- Para se të shkojmë në xhami nuk duhet të hamë diçka që shkakton shqetësim tek xhemati, si: qepë, hudhra etj.
- Duhet të shmangim sjelljet dhe veprimet që konsiderohen mungesë respekti për xhaminë, si: të ulemi duke i zgjatur këmbët, të thërrasim dhe bërtasim me zë të lartë, të flasim gjëra të panevojshme dhe të kota etj.
- Të dëgjojmë me vëmendje dhe respekt ajetet e Kuranit që lexohen apo ligjëratën fetare që mbahet në xhami.
- Kur vijmë me vonesë në xhami nuk duhet ta shqetësojmë xhematin për të dalë në rreshtat e parë, por të ulemi në vendin e lirë që gjejmë.



Cili është gjykimi fetar rreth faljes së namazeve me xhematë?

Falja me xhematë e namazit të xhumasë është farz, ndërsa falja e kohëve të tjera është "sUNETI MUEKEDË". Mosfalja e namazeve me xhematë pa pasur ndonjë arsye bie në kundërshtim me praktikën e jetës së Profetit tonë, Muhamed (a.s.).

Si falet namazi me xhematë?

Kur namazi falet me xhematë imami bën njetin për të falur namazin dhe për t'u prirë atyre që janë pas tij në namaz. Xhemati pas imamit bën njet për namazin që është bërë gati të falë dhe për imamin pas të cilit është duke e falur atë.

Për të qenë më i qartë namazi me xhematë, po tregojmë se si falet farzi i namazit të drekës me imam:

1) Fillimisht bëjmë njetin duke thënë: "Bëra njet për hir të Zotit që të fal farzin e namazit të drekës dhe iu lidha pas imamit".

2) Sapo imami të marrë me zë të lartë tekbinin fillestar, "Allahu ekber!", edhe ne e themi atë me vete pa zë dhe lidhemi pas imamit. Edhe tekbinët e tjerë që thotë imami ne i themi me zë të ulët, aq sa të dëgjojmë vetveten.

3) Pas marrjes së tekbinut fillestar, i lidhim duart nën këthizë duke kënduar "Subhaneken" dhe pastaj nuk lexojmë asgjë. Edhe në rekatet e tjera nuk lexojmë gjë kur jemi në këmbë. Në namazet ku imami këndon me zë, pas Fatihasë, thuhet me zë të ulët "Amin".

4) Biem në ruku dhe themi tri herë "Subhane rabbijel adhim". Drejtohem nga rukuja, kur imami thotë: "Semiallahu limen hamide", dhe kur jemi drejt në këmbë, themi: "Rabbena ve lekel hamd".

5) Në sexhde themi tri herë "Subhane rabbijel a'la".

6) Në ulje këndojmë lutjet: "Tehijjatu", "Allahumme sal-li", "Allahumme Barik", "Rabbena atina", dhe "Rabbena gfril!" dhe japim selam së bashku me imamin.

Gjatë faljes me xhematë ne ndjekim imamin dhe nuk kryejmë asnjë veprim të namazit përpara se ai të veprojë.

Si lidhemi në namaz pas imamit kur e kapim xhematin me vonesë?

Kur vonohemi në namazin me xhematë dhe e zëmë atë të filluar, i falim rekatet që nuk i falëm me imam, në fund fare, pasi imami të japë selamin. Rehati që zëmë përpara se imami të ngrihet nga rukuja numërohet si rekat i falur me xhematë, prandaj atë rekat nuk e llogarisim në rekatet që do të falim pasi imami të japë selamin.

Në qoftë se e arrijmë namazin me xhematë në rekatën e dytë, atëherë kur të qëndrojmë në uljen e fundit lexojmë me vete vetëm duanë "et-Tehijatu" dhe presim që imami të japë selam. Pasi imami jep selamin, ngrihemi në këmbë dhe e plotësojmë rekatën e parë që nuk e kemi falur me imam.

Rekati i parë

- *Subhaneke
- *Eudhu, Besmele
- *Fatiha
- *Sure shtesë
- *Ruku
- *Sexhde
- *Ulja e fundit
(Tahijat, sal-li barik, Rabbena, Rabenagfirli)
- *Selam



Në qoftë se e arrijmë namazin me xhematë në rekatën e tretë, ngrihemi në këmbë, pasi imami jep selam dhe dy rekatet që nuk i kemi falur me imam, i plotësojmë siç tregohet në tabelat e mëposhtme:



Rekati i parë	Rekati i dytë
*Subhaneke	*Subhaneke
*Besmele	*Eudhu, Besmele
*Fatiha	*Fatiha
*Sure shtesë	*Sure shtesë
*Ruku	*Ruku
*Sexhde	*Sexhde
	*Ulja e fundit (Tahijat, sal-li barik, Rabbena, Rabenagfirli)
	*Selam

Në qoftë se e arrijmë namazin me xhematë në rekatën e katërt, ngrihemi në këmbë, pasi imami jep selam dhe tri rekatet që nuk i kemi falur me imam i plotësojmë siç tregohet në tabelat e mëposhtme:

Rekati i parë	Rekati i dytë	Rekati i tretë
*Subhaneke	*Besmele	*Subhaneke
*Besmele	*Fatiha	*Eudhu, Besmele
*Fatiha	*Sure shtesë	*Fatiha
*Sure shtesë	*Ruku	*Sure shtesë
*Ruku	*Sexhde	*Ruku
*Sexhde		*Sexhde
*Ulja e parë		*Ulja e fundit (Tahijat, sal-li barik, Rabbena, Rabenagfirli)
*Tahijat		*Selam

Kur arrijmë në rekatën e tretë në namazin e akshamit, ngrihemi në këmbë, pasi imami jep selam dhe dy rekatet e tjerë që nuk i kemi mbërritur, i plotësojmë në këtë mënyrë:



Kur arrijmë në rekatën e fundit të një namazi, pasi imami të ketë kryer rukunë e rekatit të fundit, atëherë ngrihemi në këmbë pasi imami jep selam dhe i falim të gjithë rekatet e tjera nga fillimi.

Rekati i parë	Rekati i dytë
*Subhaneke	*Subhaneke
*Besmele	*Eudhu, Besmele
*Fatiha	*Fatiha
*Një sure shtesë	*Sure shtesë
*Ruku	*Ruku
*Sexhde	*Sexhde
*Ulja e parë	*Ulja e fundit (Tahijat, sal-li barik, Rabbena, Rabenagfirli)
*Tahijat	*Selam



DISA NAMAZE QË FALEN ME XHEMATE

A. NAMAZI I XHUMASE

Dita e xhuma është festa e javës për myslimanët. Ata takohen me njëri-tjetrin në xhami këtë ditë dhe kështu njihen me problemet e njëri-tjetrit. Ata përpiqen të gjithë së bashku t'u japin zgjidhje atyre.

Sa rekate ka namazi i xhumasë dhe si falet?

Feja islame e urdhëron myslimanin që kur të hyjë koha e namazit të xhumasë të lërë punën dhe të shkojë në xhami për të falur namazin e xhumasë.

Për të falur namazin e xhumasë është kusht që në xhami të mblidhen të paktën katër persona, nga të cilët njëri bëhet imam, ndërsa të tjerët përbëjnë xhematin.

Namazi i xhumasë ka dhjetë rekate dhe falet në vend të namazit të drekës së ditës së premte. Ata myslimanë që nuk mund ta falin namazin e xhumasë duke pasur arsye, duhet të falin namazin e drekës së ditës së premte.

Kush e ka farz faljen e namazit të xhumasë?

Namazi i xhumasë është farz vetëm për meshkujt që e kanë kaluar moshën e pubertetit.

Kush nuk e ka farz faljen e namazit të xhumasë?

Namazi i xhumasë nuk është farz për gratë, fëmijët, të sëmurët, ata që janë të detyruar të kujdesen për të sëmurët, për udhëtarët, për ata që nuk janë të lirë, për të verbrit, sakatët dhe personat me të meta fizike. Në qoftë se një person që i përket njëres prej këtyre grupeve e fal namazin e xhumasë ditën e premte, namazi që fal është i vlefshëm dhe nuk ka nevojë që të falë namazin e drekës së ditës së premte.

Cilat janë kushtet që duhet të përmbushen për të falur namazin e xhumasë?

1. Namazi i xhumasë duhet të falet në kohën e namazit të drekës.
2. Duhet të jetë një person që do të lexojë hutben.
3. Vendi ku falet namazi i xhumasë duhet të jetë i hapur për këdo.
4. Përveç imamit duhet të jenë të pranishëm si xhematë të paktën tre vetë.

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“O ju që besoni! Ditën e xhuma kur të thirreni në namaz me ezan vraponi të përkujtuni Zotin tuaj. Shkoni në namaz. Lëreni pazarin. Nëse e dini, kjo është më e dobishme për ju.”

(Xhuma 9)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Kur të plotësohet namazi, shpërndahuni, kërkonit rrishtun tuaj nga dhuntitë e Allahut, kujtojeni Allahun shumë që të arrini në shpëtim.”

(Xhuma 10)

Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

“Çdonjëri prej pesë namazeve të ditës shlyen mëkatet që janë kryer prej momentit që është falur namazi paraardhës dhe deri në momentin që falet ai, ndërsa namazi i xhumasë fal mëkatet që janë kryer që prej namazit të xhumasë të falur përpara tij dhe deri sa falet ai, me kusht që mëkatet e bëra të mos jenë gjynahe të mëdha.”

(Muslim, Taharet 14)

Si falet namazi i xhumasë?

- Para farzit të xhumasë falen katër rekate sunet.
- Ky namaz falet njësoj si katër rekatet sunet të namazit të drekës.
- Pas namazit sunet ligjëruesi (hatibi) ngjit shkallët e minberit dhe pasi hip disa shkallë, ulet.
- Muezini këndon ezanin brenda në xhami.
- Pasi këndohet ezani, ligjëruesi ngrihet në këmbë dhe lexon hutben. Myslimanët në xhami e dëgjojnë pa fjalë këtë hutbe, leximi dhe dëgjimi i së cilës është farz.
- Pas hutbes, kur muezini këndon ikametin ngrihemi në këmbë dhe lidhemi pas imamit. Falim dy rekate farz të xhumasë.
- Pasi kemi falur dy rekate farz të xhumasë, falim edhe katër sunetet e fundit të xhumasë, të cilat falen njësoj si suneti i drekës.
- Myslimani që dëshiron, mund të falë edhe gjashtë rekate të tjera.

B. NAMAZI I BAJRAMIT

Myslimanët kanë dy festa të mëdha në vit. Njëra është Bajrami i Ramazanit, ndërsa tjetra Bajrami i Kurbanit. Në këto bajrame falim namazin e Bajramit, që është dy rekate, në shenjë falënderimi ndaj Allahut.

Për cilët është vaxhib falja e namazit të Bajramit?

Falja e namazit të Bajramit është vaxhib për ata myslimanë që e kanë farz faljen e namazit të xhumasë.

Kur falet namazi i Bajramit?

Namazi i Bajramit falet 40-45 minuta pas lindjes së diellit të mëngjesit të ditës së Bajramit. Kjo kohë nuk është e prerë. Në disa vende koha e pritjes pas lindjes së diellit për të falur namazin e Bajramit është më e shkurtër.

Si falet namazi i Bajramit?

Namazet e Bajramit falen me xhematë. Nuk thirret as ezani dhe as ikameti. Bëjmë nijetin dhe lidhemi në namaz. Më pas namazin e falim në këtë mënyrë:

Rekati i parë: Fillojmë namazin me tekbirin fillestar. Më pas këndojmë "Subhaneke". Marrim tri herë tekbir sikurse tekbiri fillestar bashkë me imamin duke i çuar duart deri te veshët. Në dy tekbirët e parë nuk i lidhim duart, ndërsa në të tretin i lidhim. Dëgjojmë imamin që këndon Fatihanë dhe një sure shtesë. Me rukunë dhe sexhdet përfundojmë namazin.

Rekati i dytë: Pasi dëgjojmë Fatihanë dhe suren përsëri marrim tre tekbire së bashku me imamin duke i ngritur duart deri tek veshët dhe në secilin rast duart i lëshojmë anash. Në tekbirin e katërt nuk i ngrejmë duart, por përkulemi në ruku. Me rukunë, sexhden dhe uljen përfundojmë edhe namazin.



Kur lexohet hutbeja e namazit të Bajramit?

Hutbet e Bajramit lexohen pas namazit. Leximi i këtyre hutbeve është sunet, traditë e Pejgamberit tonë.

Në këto hutbe, ligjëruesit japin këshilla në lidhje me rëndësinë dhe domethënien e ditës së Bajramit. Pasi të mbarojnë hutbet dhe duatë, myslimanët urojnë njëri-tjetrit për Bajramin. Ata që nuk kanë folur me njëri-tjetrit, pajtohen në këtë ditë.

Cilat janë fjalët e tekbitit teshrik dhe kuptimi i tyre?

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ
اللَّهُ أَكْبَرُ وَاللَّهُ أَحْمَدُ

“Allahu ekber, Allahu ekber, La ilahe il-lallah, huvallahu ekber, Allahu ekber ve lil-lahil hamd”

Kuptimi është: “Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi. Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut. Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi. Falënderimet i takojnë vetëm Atij”.

Ç’është tekbiti teshrik? Kur thuhet?

Tekbiret që këndohen pas namazeve farz në ditët e Kurban Bajramit quhen “Tekbiti teshrik”. Këto tekbitë këndohen pas çdo namazi farz duke filluar me namazin e sabahut të ditës së Arefesë për të përfunduar në namazin e ikindisë të ditës së katërt të Bajramit. Këndimi i këtyre tekbitëve është vaxhib. Këto tekbitë këndohen edhe kur falim namaz me xhematë, edhe kur falemi vetëm.

C. NAMAZI I XHENAZES.

Namazi i xhenazes është një lutje që bëhet për vëllain tonë mysliman që ka vdekur. Ky namaz, që zakonisht falet me xhematë, mund të falet edhe vetëm.

Cili është gjykimi juridik fetar për këtë namaz?

Falja e namazit të xhenazes është farzi kifaje. Kur falja e këtij namazi kryhet nga një grup myslimanësh, personat që e falin atë fitojnë sevape, ndërsa personat që nuk janë të pranishëm, nuk janë përgjegjës për mosfalje të namazit të xhenazes. Nëse askush nuk ia fal xhenazen myslimanit të vdekur, të gjithë myslimanët e asaj zone janë përgjegjës për moskryerjen e një farzi dhe janë gjynahqarë.

Si falet namazi i xhenazes?

Namazi i xhenazes nuk ka ruku, as sexhde. Ai falet duke bërë nijet dhe me marrjen e katër tekbitëve.

Qëndrojmë para xhenazes së vendosur në vendin e caktuar dhe bëjmë nijet duke thënë “Po fal namaz për hir të Allahut, po bëj dua për të vdekurin dhe iu lidha imanit”. Marrim tekbitin fillestar dhe ngrejmë duart deri te veshët. Pastaj i lidhim ato nën kërthizë. Them i lutjen “Subhaneke All-llahume”. Marrim tekbitin e dytë, por këtë herë pa i ngritur duart deri tek veshët. Them duatë “All-llahumme sal-li...All-llahumme barik...”. Marrim tekbitin e tretë, pa i ngritur duart deri tek veshët dhe lexojmë duanë e xhenazes, nëse e dimë përmendësh atë. Në qoftë se nuk e dimë duanë e xhenazes, atëherë lexojmë suren Fatiha. Pas tekbitit të katërt japim selam në të djathtë dhe në të majtë dhe kështu përfundon edhe falja e namazit të xhenazes.

Pas faljes së xhenazes u japim ngushëllimet tona familjarëve dhe të afërmeve të të vdekurit. Ne u gjendem pranë në ditën e tyre më të vështirë dhe u japim mbështetjen tonë. Ne ndajmë me ta dhimbjen dhe hidhërimin e tyre.

Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

Kush qëndron në xhenaze deri sa të falet xhenazja fiton sevapin e një këratit. Në qoftë se qëndron edhe deri sa të varroset, fiton sevapet e dy kërateve. Pyetën: “Sa është një kërat?” Pejgamberi iu përgjigj: “Sa dy male të mëdha!”.

(Buhari, Xhenaiz 59)

D. NAMAZI I TERAVISE

Namazi i teravisë përbëhet nga 20 rekatë dhe falet gjatë muajit të Ramazanit. Falja e këtij namazi është suneti muekede si për meshkujt, ashtu edhe për gratë. Edhe ata të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të agjërojnë, e kanë sunet të falin teravinë.

A mund ta falim vetëm namazin e teravisë?

Pejgamberi ynë e ka falur këtë namaz herë vetëm dhe herë me xhematë. Ai i ka kushtuar rëndësi këtij namazi. Më pas, në kohën e Omerit (r.a.), namazi i teravisë është falur vazhdimisht me xhematë dhe kështu ka ardhur si traditë deri në ditët tona.

Kështu që namazin mund ta falim si vetëm në shtëpi, ashtu edhe me xhematë. Por, natyrisht, sevabi i faljes në bashkësi është më i madh.

Kur dhe si e falim namazin e Teravisë?

Namazi i teravisë falet pas namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit. Është shumë sevap të falet i plotë me 20 rekate. Këto rekate mund të falen dy nga dy ose katër nga katër. Kur e falim me nga katër rekatë, atëherë ato i falim si rekatet sunet të para të ikindisë ose të jacisë. Pra në uljen e parë pas rekatit të dytë

themi “Ettehijatu...” dhe “All-llahumme sal-li... All-llahumme barik...” dhe kur ngrihemi në rekatën e tretë “Subhaneke”.



Pejgamberi (a.s.) ynë thotë:

“Kush e fal teravinë duke besuar në vlerat e muajit të Ramazanit dhe duke e pritur sevabin prej Allahut, atij i falen të gjitha gjynahet.”

(Muslim, Taharet 14)



NAMAZI I TE SEMURIT

Si e falim namazin kur sëmuremi?

Feja jonë e bukur, Islami ka paraparë shumë lehtësime në mënyrë që të mos mbetemi pa i kryer adhurimet tona. Kur jemi të sëmurë aq sa të mos kemi mundësi të qëndrojmë në këmbë, ne mund të falemi ulur. Nëse as këtë nuk mundemi ta bëjmë dot, falemi shtrirë duke bërë me shenja. Me shenja nënkuptojmë përkuljen e kokës lehtë për rukunë dhe sexhden.

Ç'mund të bëjmë nëse s'mund ta falim namazin, qoftë edhe shtrirë dhe me shenja?

Nëse nuk kemi mundësi të falemi as me shenja, namazet i lëmë për më vonë dhe kur të shërohemi i falim kaza.

NAMAZI I UDHETARIT

Kur quhemi udhëtarë?

Quhemi udhëtarë kur shkojmë në një qytet apo vend që ndodhet 90 km larg nga vendi ku banojmë për të qëndruar aty më pak se 15 ditë.



Kur fillon dhe kur mbaron udhëtimi?

Udhëtimi fillon kur dalim nga vendbanimi ynë dhe përfundon me kthimin tonë në të.

Si i falim namazet kur jemi udhëtarë?

Duke qenë se gjatë udhëtimit përballemi me vështirësi dhe situata të rënda, feja jonë i ka lehtësuar rregullat me të cilat kryhen adhurimet. Namazet farz

me katër rekate shkurtohen në dy (dreka, ikindia, jacia). Namazet farz që kanë dy dhe tre rekate (sabahut dhe akshami) falen pa i shkurtuar. Nëse koha nuk është e përshtatshme, atëherë mund të mos i falim sunetet. Por nëse i falim namazet sunet, ato nuk i shkurtojmë, siç bëjmë me namazet farz.

Si e falim namazin me xhematë, kur jemi udhëtarë?

Kur jemi udhëtarë dhe falemi të lidhur pas një imami që nuk është udhëtar namazet farz nuk i shkurtojmë, por i falim të plotë.

Si i fal namazet farz udhëtari që falet pas një imami që nuk është udhëtar?

Nëse imami është udhëtar, ai jep selam pas dy rekatëve të parë të namazeve farz. Nëse në xhematin që falet pas tij ka njerëz që nuk janë udhëtarë, ata e falin namazin të plotë duke plotësuar më vete edhe dy rekatët e tjerë.

NAMAZI KAZA

Ç'do të thotë namazi kaza?

Falja e namazit në kohën e vet quhet "eda", ndërsa kur namazi nuk falet në kohën e vet, por më vonë ai quhet "namaz kaza".

Cili është vendimi juridik fetar në lidhje me shtyrjen e faljes së namazit, derisa të bëhet kaza?

Ashtu sikurse është farz falja e namazeve në kohën e vet, ashtu është farz edhe falja e tyre kaza, kur nuk

kemi mundësi t'i falim në kohën e tyre. Lënia kaza e namazeve pa patur ndonjë shkak është një gjynah i madh.

Si falen kaza namazet?

Namazi i sabahut që nuk falet në kohën e tij të përcaktuar mund të bëhet kaza së bashku me sunetin në të njëjtën ditë deri sa dielli të ngjitet në zenit. Suneti i sabahut i një dite më parë nuk falet kaza. Kur falen kaza namazet falen vetëm rekatët farz dhe jo ato sunet.

Si e bëjmë nijetin në namazet kaza?

Kur bëjmë nijetin për namazet kaza p.sh. për sabahun, e bëjmë kështu:

- Bëra nijet për të falur farzin e sabahut që nuk arrita ta falja sot.

Nëse nuk arrijmë të kujtojmë se namazet e cilës ditë kanë mbetur kaza atëherë nijetin e bëjmë kështu:

- Bëra nijet për faljen e farzit të sabahut të fundit që nuk arrita ta fal.

Në cilat kohë mund të falen namazet kaza?

Namazi kaza mund të falet në çdo kohë përveç tre kohëve në të cilat falja e namazit është mekruh, të cilat janë kur lind dielli, kur është në kupë të qiellit dhe duke perënduar.

SHEJTANI MUNDOHET TË NA LARGOJË NGA NAMAZI

Namazi është një adhurim i madh. Padyshim që shejtani nuk rri duarbosh, por përpiket të na largojë nga ky adhurim duke na nxjerrë lloje të ndryshme pretekstesh. Kur vjen koha për namaz dhe dëshirojmë të falemi shejtani na vjen pranë duke na thënë:

- Ka akoma kohë. Tani ti po punon. Shiko punën tënde. E fal më vonë. Ti je i lodhur, fli edhe pak... dhe kështu përpiket të na largojë nga ky adhurim. Kështu ai bën që të vonohemi dhe koha e namazit të kalojë.

Nganjëherë me anë të njerëzve përpiket të na pengojë dhe të na largojë nga namazi. Edhe kur jemi me njerëz ai na thotë:

- Ka kohë. Të mbarojë edhe kjo temë. Fol edhe pak apo e fal më vonë pasi të ikë shoku yt, dhe kështu mundohet të na largojë nga namazi. Në situata të tilla duhet thënë

- Koha po kalon duhet të fal namazin, dhe nëse falemi atëherë kemi mundur shejtanin.

Një nga rrugët që ka aplikuar shejtani për të na mashtruar është edhe përshepitimi i namazit.

- Fale sa më shpejt namazin se ke shumë punë”

Duke na i kujtuar të gjitha punët në momentin e namazit dëshiron të sillemi shumë shpejt sikur të mos kishim aspak kohë. Në këtë mënyrë ai na pengon t'i bindemi urdhërit të namazit dhe të plotësojmë rukutë dhe sexhdet. Ndërsa në fakt kur mendojmë për namazin aq shumë kohë të lirë ke...

Shejtani për të na larguar nga anamazi klikon aq shumë gjëra në mendjen tonë. Disa prej tyre janë: shkon pranë të varfërve dhe të pastrehëve, u thotë që ta lënë namazin duke u thënë:

- Namazi nuk është për ju!.. Namazi është për ata që Allahu u ka dhënë shëndet dhe pasuri të madhe. Shkon te të sëmurët dhe u thotë:

- Lëre namazin pasi Allahu thotë se ka sjellë lehtësi për ata që janë të sëmurë. Kur të bëhesh mirë fal sa të duash. Kështu, ai mundëson ta lënë namazin. Çdo njeri përpiket t'i shmanget namazit duke gjetur çdo lloj preteksti për shpëtim nga kjo detyrë.

Rruga më e mirë për të shpëtuar nga këto kthetra është falja vazhdimisht e namazit sapo t'i vijë koha.



SEHVI SEXHDEJA

Ç'është sehvi sexhdeja?

Sehvi sexhde do të thotë sexhdeja e harresës apo e ngatërrimit të veprimeve në namaz.

Nëse gjatë namazit, në rast harrese, bëjmë një veprim që nuk e prishë namazin, por nuk përputhet me mënyrën e saktë të tij, atëherë ne duhet të bëjmë sehvi sexhde. Duke bërë sehvi sexhde ne plotësojmë të gjitha mangësitë që mund të kryejmë pa dashje gjatë namazit.

Në cilat raste duhet të bëjmë sehvi sexhde?

1. Kur vonojmë kryerjen e njërit prej farzeve brenda namazit, atëherë duhet të bëjmë sehvi sexhden. (Kur nuk e bëjmë të paktën një farz p.sh. harrojmë të përkulemi në ruku, por biem menjëherë në sexhde atëherë namazi prishet.)

2. Kur vonojmë apo harrojmë të kryejmë njërin prej vaxhibeve të namazit, atëherë duhet të bëjmë sehvi sexhden.

Disa raste që na detyrojnë të bëjmë sehvi sexhden

☞ Në një namaz me katër rekate nuk qëndrohet në ulje pas sexhdes së dytë të rekatit të tretë. Nëse ndodh që besimtari në namaz ulet në "Tehijatu", atëherë ai duhet të bëjë sehvi sexhde, sepse ai në këtë rast ka vonuar kijamin e rekatit të katërt.



☞ Kur lexojmë suren shtesë para Fatihasë, atëherë duhet të bëjmë sehvi sexhde. Pasi leximi i sures Fatiha para një sureje shtesë në namaz është vaxhib.

☞ Nëse përkulemi në ruku duke harruar të lexojmë suren shtesë pas Fatihasë, nuk drejtohem nga rukuja që ta lexojmë suren shtesë. Vazhdojmë namazin me rukunë dhe sexhden. Në fund të namazit bëjmë sehvi sexhde. Kjo sehvi sexhde bëhet sepse leximi i një sureje shtesë pas Fatihasë është vaxhib.

☞ Kur jemi duke falur Vitrin nëse përkulemi në ruku duke harruar të lexojmë "duanë e Kunutit", atëherë nuk ngrihem për të marrë tekbinin e kunutit dhe as nuk e lexojmë duanë e kunutit, por vazhdojmë namazin me rukunë dhe sexhden. Në fund të namazit bëjmë sehvi sexhde. Kjo sehvi sexhde bëhet sepse leximi i duasë së Kunutit është vaxhib.

☞ Në qoftë se, në namazet me tre apo katër rekate, ngrihem në këmbë duke harruar që të ulemi pas sexhdes së rekatit të dytë, atëherë nuk kthehem prapa dhe të ulemi në Tehijat, por vazhdojmë namazin me rekatit e tretë. Në fund të namazit bëjmë sehvi sexhde. Kjo sehvi sexhde bëhet sepse ulja e parë dhe këndimi i Tehijatit në atë ulje janë vaxhib.

Nëse bëjmë më tepër se një gabim gjatë namazit, atëherë sa sehvi sexhde duhen bërë?

Bërja një herë e sehvi sexhdes është e mjaftueshme për të kompensuar disa gabime të bëra.

Kur dhe si bëhet sehvi sexhdeja?

Në uljen e fundit pasi të kemi kënduar Tehijatu japim selam në të djathtë, pastaj themi "Allahu ekber" dhe bëjmë dy herë sexhde. Pas këtyre sexhdeve qëndrojmë përsëri të ulur dhe japim selam.

SEXHDEJA E TILAVETIT

Ç'është sexhdeja e Tilavetit?

Në Kuran gjenden disa ajete, për të cilat bëhet sexhde në rast se i lexojmë apo i dëgjojmë ato. Pikërisht sexhdeja që bëjmë kur lexojmë apo dëgjojmë këto ajete quhet "sexhdeja e Tilavetit".

Sa ajete të sexhdes ka në Kuran?

Në Kuran ka 14 ajete të sexhdes.

Cili është vendimi juridik fetar rreth kë saj sexhdeje?

Ai që e dëgjon apo e lexon ajetin e sexhdes e ka vaxhib të bëjë sexhden tilavetin. Edhe ai mysliman që e lexon apo e dëgjon kuptimin nga gjuha arabe në një gjuhë tjetër jo arabe të këtyre ajeteve e ka vaxhib të bëjë sexhde tilavetin.

Si e bëjmë sexhden e Tilavetit kur jemi në namaz?

Kur ajetin e sexhdes e lexojmë gjatë namazit atëherë:

1. Nëse pas ajetit të tilavetit nuk do të vazhdojmë më leximin ose nuk do të lexojmë më shumë se tre ajete, atëherë përkulemi në ruku dhe bëjmë sexhden. Me anë të kësaj sexhdeje të namazit ne çojmë në vend edhe sexhden e duhur.

2. Nëse pas ajetit të tilavetit do të vazhdojmë leximin me më tepër se tre ajete, atëherë themi "Allahu ekber!" dhe biem drejt e në sexhde. Pasi të themi tri herë "Subhane rabbijel a'la!" në sexhde, marrim përsëri tekbir, ngrihem në këmbë dhe vazhdojmë të lexojmë pjesën pas ajetit të sexhdes.

Si e bëjmë sexhden e Tilavetit kur ajetin nuk e lexojmë gjatë namazit?

Kur njërën prej ajeteve të sexhdes e lexojmë jashtë namazit, atëherë marrim abdest nëse nuk kemi, kthehemi drejt kiblës, themi "Allahu ekber!" pa i ngritur duart tek veshët dhe biem në sexhde. Pasi të themi tri herë "Subhane rabbijel a'la!" në sexhde ngrihem nga sexhdeja duke thënë përsëri "Allahu ekber!" Ndërsa ngrihem themi "Gufraneke Rabbena ve ilejkel mesir!"



KOHET NE TE CILAT ESHTË MEKRUH FALJA E NAMAZIT

A ka ndonjë kohë në të cilën është mekruh falja e namazit?

Namazi është mekruh të falet në tre kohë. Në këto kohë nuk falet asnjë lloj namazi çfarëdo qoftë ai (farz, vaxhib, sunet, nafîle, xhenaze apo kaza). Nuk bëhet as sexhdeja e tilavetit. Këto tre kohë janë:

1. **Gjatë lindjes së diellit:** Kjo kohë fillon me lindjen e diellit dhe zgjat 45 minuta pas lindjes së tij. (Në qoftë se lindja e diellit na zë duke falur namazin e sabahut, ai namaz zhvleftësohet dhe duhet falur më vonë.)
2. **Kur dielli është në kupën e tij:** Është një kohë rreth 45 minuta para namazit të drekës.
3. **Gjatë perëndimit të diellit:** Është një kohë afërsisht 45 minuta para perëndimit të diellit. (Në këtë kohë mund të falet vetëm namazi i ikindisë së asaj dite.)

A ka kohë në të cilat është mekruh vetëm falja e namazeve nafîle?

Ka dy periudha kohore në të cilat mund të falen namazet farz, vaxhib, xhenazja dhe të bëhen kaza ato që nuk janë falur. Në këto kohë mund të bëhet edhe sexhdeja e tilavetit. Por, në këto dy kohë është mekruh falja e namazit nafîle. Ato dy kohë janë:

1. **Koha e namazit të sabahut:** Që nga momenti i agimit (imsakut) e deri sa të lindë dielli, falja e çdo lloj namazi nafîle përveç sunetit të sabahut është mekruh.
2. **Koha pas farzit të ikindisë:** Është mekruh falja e namazit nafîle pas faljes së farzit të namazit të ikindisë.



NAMAZET E MIA

Më tingëlluan në veshë fjalët e gjyshes së tij.

- Biri im, a lihet namazi në këtë kohë?


Gjyshja ishte rreth të shtatëdhjetave, por në momentin që thirrej ezani fluturonte nga vendi, merrte abdest dhe falte namazin. Ndërsa vetë ai nuk mundte ta kontrollonte veten. Se ç'ndodhte, por gjithnjë namazi i mbette në minutat e fundit. Kështu nxitimthi përfundonte namazin. U ngrit nga vendi për të menduar këtë dhe papritmas sytë i rrëshqitën te ora. Kishte edhe 15 minuta të thirrej ezani i jacisë.

- Përsëri e vonova namazin - tha me vete duke tundur kokën sa një anë në tjetrën. Mori abdest në përshpejtim dhe akoma pa u tharë mirë kaloi në dhomën e tij. I detyruar e fali nnamazin me shpejtësi. Dhe duke bërë tesbihatet nuk mundi të rrinte pa kujtuar fjalët e gjyshes së tij.

- Sikur të më shihnte në ç'gjendje jam përsëri do më bërtiste me të ëmbël.

Ai e donte shumë gjyshen... Sa bukur e falte namazin ajo grua e bekuar, aq bukur saqë atë e ndiqte me një admirim, si të shihnte një ylber. Ajo falej në namaz me një përulje aq të madhe sa që ndryshonte bota e saj shpirtërore. Sapo e kujtoi atë thujse ndryshoi. Atë ditë ishte lodhur shumë deri në darkë. Mbi supë mbarte një lodhje të madhe. Në momentin e duasë u ul në sexhde. Ai e pëlqente që pas namazit të bënte një meditim të tillë. Për një moment sikur iu mbyllën sytë:

- Sa shumë qënkam lodhur! - tha me vete dhe ashtu humbi në botën e tij.



Kishte shpërthyer kiameti. Kishte një turmë të madhe njerëzish. Kudo kishte njerëz. Dikush i ngrirë rrinte dhe shihnte ambientin, dikush sillej sa majtas djathtas, dikush tjetër ulur në gjunjë dhe kokën e kishte mes duarve.

I dukej sikur zemra po i dilte nga vendi. Thujse po përpiquej të shpëtonte nga kafazi dhe dridhej i tëri. Në jetë kishte dëgjuar shumë gjëra për ahiretin, për marrjen në pyetje dhe peshoren dhe tashmë ishin bërë pjesë e përndarë. Por se kishte menduar asnjëherë se do të ndiente një frikë kaq të tmerrshme.

Llogaria dhe pyetjet i vazhdonin.

Në këtë kohë u lexua edhe emri i tij. Shikoi me çudi djathtas dhe majtas.

- Më thirrët emrin tim? pyeste me vete duke u dridhur.

Grumbulli i njerëzve sikur ishte ndarë në gjysëm dhe para tij ishte hapur një rrugë.

Dy persona e morën për duarsh. Ishte e qartë se ishin nëpunës të kësaj dite. Eci i habitur mes njerëzve. Melekët u larguan në të dyjat anët. Koka e tij ishte përpara.

E gjithë jeta i kalonte para syve si në një film.

- Falënderimet i qofshin Atij - tha me vete dhe vazhdoi.

- I hapa sytë botës dhe pashë vetëm njerëz që shërbenin.

Babai merrte pjesë në shumë biseda fetare dhe pasurinë e harxhonte në rrugë të Zotit.

Nëna përcillte mysafirë dhe sa mblidhte njëren tryezë shtronte tjetren.

Unë përherë në këtë rrugë kam qënë, gjithmonë në shërbim të njerëzve. Atyre u kam shpjeguar Allahun. Kam falur namazet. Kam agjëruar. Çdo farz e kam kryer dhe jam larguar nga harami.

Duke lotuar thoshte:

- E dua Zotin tim. Të paktën kështu mendoj.

Por nga ana tjetër mendonte

- Ç'të bëja, është pak, nuk mund ta fitoja xhenetin.

Mbështetja e vetme ishte mëshira e Allahut. Llogaria zgjati shumë. Dridhej i tëri. Ishte djersitur.

Sytë prisnin rezultatin e peshores. Më në fund do të jepej rezultati.

Engjëjt e ngarkuar me detyrë, në dorë kishin letër dhe dolën para parisë së njerëzve. Fillimisht u lexua emri Tashmë këmbët nuk e mbanin më. Thuajse do t'i binte të fikët. Nga emocioni kishte mbyllur veshët dhe nuk dëgjonte asgjë.


Nga turma e njerëzve u dëgjua një zë.

Vallë i dëgjonte gabim?

Emri ishte në listën e xhehenemit.

Ra në gjunjë. Nga çudia kishte mbetur i ngrirë.

- Jo, s'mund të jetë kështu! Vraponte sa djabatas majtas.



- Si ka mundësi të jem në xhehenem? Kam genë gjithmonë me njerëz që vetëm shërbenin. Kam punuar perherë me ta. Gjithmonë kam shpjeguar Zotin.

Sytë ishin mbushur me lot sa dhe trupin po ia lagnin.

Dy engjëjt në detyrë e mbajtën për krahë dhe po e çonin drejt zjarrit të xhehenemit.

Po ulërinte

- A nuk kishte shpëtim? A nuk do dalë dikush të më ndihmojë?

Nga buzët e tij dilnin vetëm lutje.

- Ku janë shërbimet e mia?... Agjërimet e mia?... Kuranet që kam lexuar?... Namazet e mia?... Askush nuk do të më shpëtojë sot?

Lutej duke bërëtitur.

Engjëjt e xhehenemit vazhdonin ta merrnin zvarrë. Ishin afruar shumë zjarrit. Kthehu kokën prapa. Ishin mundimet e fundit, ndërkohë i erdhi në mëndje fjala e Pejgamberit (as) që thoshte:

- Ashtu sikurse një lumë që e pastron njeriun pesë herë në ditë, edhe namazet e pastrojnë atë nga gjynahet.

Dhe mendoj:

- As namazet e mia nuk do më shpëtojnë dot?

Namaaazet e mia... Namazet e mia... Namazet e miaaaa...

Engjëjt në detyrë nuk pushuan. Vazhduan të ecnin dhe arritën deri te hyrja e xhehenemit. Nxehtësia po i digjte fytyrën. U kthye për herë të fundit dhe

pa mbrapa. Tashmë edhe sytë i ishin tharë. Shpresat i kishin mbaruar. Uli kokën dhe u kërrus.

Gishtat që kishin kapur krahët u liruan. Një nga melekët e shtyu. Për një çast e pau veten në ajër. Po binte drejt flakëve. Sapo kishte rënë dy metra dhe një dorë e kapi. Ngriti kokën dhe pau sipër.

Një i moshuar me mjekër të bardhë e kishte shpëtuar. E tërhoqi sipër. Duke shkundur pluhurat nga sipër e pau në fytyrë të moshuarin.

- Po ju kush jeni? - e pyeti.

I moshuari buzëqeshi dhe iu përgjigj:

- Unë jam namazet e tua.

- Pse u vonuat? Për pak po bija. Në momentin e fundit më keni shpëtuar.

Me buzëqeshje i tha:

- Edhe ti përherë në momentin e fundit më arrije mua, a të kujtohet?

Ngriti kokën nga vendi ku kishte rënë në sexhde. Pa se ishte mbuluar në djersë.

Dëgjoji zërin që vinte nga jashtë.

Po këndohej ezani i jaxisë.

U ngrit me të shpejtë nga vendi. Shkoi të merrte abdest për namazin e jaxisë.

(ABDULLAH DEMIR)



PEJGAMBERI YNË E PËLQENTE SHUMË FALJEN E NAMAZIT

Pejgamberi ynë e quante namazin “Drita e syve të mi”. Ishte shprehja më e bukur e dashurisë dhe lidhjes së tij me Allahun. Ai tregonte kujdes që namazet t’i falte në kohën e duhur. Pëlqente shumë që namazin ta falte sapo të hynte koha. Nuk e pëlqente ta vononte. Ai thoshte:

“Në fillim të namazit është pëlqimi i Allahut, ndërsa në fund është falja e Tij”

(Tirmidhi, salat, 13)

Kështu, ai theksonte se Allahu mbetet i kënaqur me robërit e vet që e falin namazin në momentin e parë që hyn koha e tij, por dhe pohonte se Ai do t’i falte me mëshirën e Tij ata besimtarë që bëjnë gabimin e shtyrjes së namazit deri në kohën e fundit të tij duke treguar kështu nënvlerësim të rëndësisë së kohës së namazit.

Pejgamberi ynë, kur hynte koha e namazit, linte çdo gjë dhe i drejtohej Allahut.

Nëna e besimtarëve, Aishja e rrëfen me këto fjalë rëndësinë që i kushtonte Profeti (a.s.) kohës së namazit:

- I dërguari i Allahut, fliste me ne dhe ne me të. Por, kur vinte koha e namazit, ai sikur nuk na njihje më dhe vetëm i drejtohej Allahut.”

(Fezail ahmal, 303)

Përveç farzeve ai falte edhe nafile sa herë që gjente rastin. Për çfarëdo lloj shkaku që e gëzonte menjëherë falte namazin e falënderimit. Kur mërzitej për diçka menjëherë vraponte drejt namazit.

Një herë kishte falur namaz aq sa i ishin enjtur këmbët. Kur Aishja e pyeti:

- O i dërguari i Allahut! Kur të gjitha gjynahet ju janë falur, atëherë pse e mundoni veten kaq shumë?

Ai u përgjigj:

- A të mos jem një rob mirënjohës ndaj Zotit?

Pejgamberi ynë nuk e ka lënë namazin edhe në çastet kur sëmundja e tij ishte rënduar shumë. Megjithatë sëmundja i ishte rënduar dhe ishte dobësuar ai përsëri, me ndihmën e dy personave, doli nga shtëpia, shkoi në xhami dhe u fal me xhemat. Edhe në momentet fundit të jetës së tij ai nuk harroi të këshillonte umetin e tij duke thënë:

- Kini kujdes dhe mos e lini namazin! Kini kujdes dhe mos e lini namazin! Kini frikë Allahun nga mbiqyrja e të drejtës së skllëvërve, grave dhe fëmijëve tuaj!

(Ebu Davud, Edeb, 123-124)

Allahu (xh.sh.) ka thënë:

“Urdhëro familjen të falin namaz. Edhe ti vazhdoje me durim! Ne nuk duam gjë prej teje. Pasi ai që ta jep atë është Allahu.

(Taha 132)

Pejgamberi ynë (a.s.) i dashur thotë:

“Kur të lidhesh për të falur namazin, falu sikur të ishte namazi i fundit! Mos e thuaj atë fjalë për të cilën nesër do të pendohesh!”

(Ibni Maxhe, Zuhd, 15)

Pejgamberi ynë, që ia kushtoi jetën e tij predikimit të Islamit dhe edukimit të sahabëve me etikën hyjnore, dëshironte që çdo kush të falte në mënyrën më të mirë të mundshme namazin, që është burim qetësie. Abdullah bin Revaha do të shkonte në luftën e Mut'es dhe ngaqë e dinte që do ta merrte malli për profetin i shkoi pranë për tu përshëndetur me të me ç'rast edhe e pyeti:

- O i Dërguari i Allahut! Më këshillo mua diçka që ta mësoj përmendësh dhe mos ta harroj.

- Ti nesër do të shkosh në një vend që nuk e falënderojnë Allahun. Bëj sa më shumë sexhde atje dhe fal sa më shumë namaze."

(Vakiti, II, 758)



XHAMITË DHE MESXHIDET

Ç'është xhamia dhe mesxhidi?

Mesxhidet, që në gjuhën shqipe do të thonë "vendi ku bëhet sexhdeja", janë vende të shenjta të bëra për adhurim ndaj Allahut. Në traditën e vjetër mesxhide janë quajtur ato vende ku faleshin shumë pak njerëz. Xhami" quhen ato objekte të kultit ku mund të falen shumë njerëz. Në vendet e tjera myslimane këto dy fjalë përdoren në vend të njëra - tjetrës. Të dyja sëbashku xhamia dhe mesxhidi quhen në gjuhën arabe edhe "mabed" që do të thotë faltore ku adhurohet Allahu.

Në fenë islame nuk është kusht një vend i veçantë për të falur namaz, për të bërë dua ose për të adhuruar Zotin. Adhurimin ne mund ta bëjmë në çdo vend të pastër. Megjithatë nuk duhet të harrojmë se janë xhamitë dhe minaret e tyre që zgjaten drejt qiellit që na tregojnë se në atë vendbanim jetojnë myslimanë.

Veçanërisht kryerja e adhurimit në xhami bashkarisht është më e dobishme dhe më me vlerë se adhurimi i bërë vetëm. Xhamitë janë vende të shenjta ku myslimanët mblidhen dhe njihen mes tyre pesë herë në ditë dhe veçanërisht çdo të xhuma.

Cila është faltorja e parë e ngritur për adhurimin ndaj Allahut?

Kurani na mëson se vendi i parë i ndërtuar për adhurim të Allahut është Qabja. Në librat e historisë islame transmetohen njohuritë se ai që e ndërtoi i pari Qaben qe profeti Adem (a.s.). Ibrahim me të birin Ismailin e rindërtuan Qaben mbi të njëjtat themele. Xhamia e dytë në rruzullin tokësor është Mesxhidu'l-Aksa në Jeruzalem, të cilën e ndërtoi profeti Sulejman (a.s.).



A ka ndërtuar Pejgamberi ynë xhami?

Pejgamberi ynë, me vite të tëra në Mekë, ka adhuroar Allahun dhe ka falur namaz në Qabe. Në kohën kur jobesimtarët u shkaktonin edhe më shumë shtypje dhe mundime myslimanëve, profeti vazhdonte të falej me xhemat në banesën e quajtur “Darul Erkam”, prej ku edhe u mësonte të interesuarve mësimet e besimit islam. Në atë kohë kishte edhe njerëz si Ebu Bekri që shtëpitë e tyre i kthyen në mesxhide për t’u falur namazi.

Kur Pejgamberi emigronte drejt Medines ai urdhëroi që në vendin e quajtur “Kuba” të ndërtohej një mesxhid. Menjëherë filloi ndërtimi i një mesxhidi të vogël me çati të papërfunduar. Puna e parë që u bë kur erdhën në Medinë ishte ndërtimi i një mesxhidi që u bë i njour si ‘Mesxhidu’n-nebevi’ (xhamia e profetit) mbi një tokë të lirë që u ble me vlerën që kishte. Pejgamberi ka punuar vetë në ndërtimin e këtij mesxhidi dhe ka mbajtur gurë mbi shpatulla. Xhamia e profetit (Mesxhidu’n-nebevi) që gjendet sot në Medinë është varianti i zgjeruar i kësaj faltoreje.

Pse kanë rëndësi xhamitë dhe mesxhidet?

Fakti që një vendbanimi gjendet të paktën një mesxhid apo një xhami tregon se aty jetojnë myslimanë. Mesxhidet dhe xhamitë janë vendet e dedikuara për të adhuroar Allahun. Besimtarët që frekuentojnë xhamitë gjejnë në to qetësi dhe

e adhurojnë të sigurtë Allahun. Ata mësojnë dhe lidhen me njëri-tjetrin. Askush nuk mund t’i marrë në pronësi këto vende. Ky është një gjynah shumë i madh. Ata që bëjnë një gjë të tillë dhe që pengojnë adhurimin e Allahut në vende të tilla janë më të dhunshmit e njerëzve. Mesxhidet janë simboli i njësisë së Zotit (tevhid) dhe degë të Qabesë mbi tokë. Prandaj myslimanët në çdo vend ku kanë shkuar kanë ndërtuar xhami të madhësive të ndryshme sipas nevojave të vendit dhe të kohës.

A shërbejnë xhamitë vetëm për të falur namaz?

Xhamitë nuk janë vetëm vende ku falen namazet. Gjatë gjithë historisë islame xhamitë kanë përbërë bërthamën e qytetërimeve islame. Pejgamberi ynë në kohën e tij pati hapur afër Mesxhidi Nebevi një shkollë të quajtur “suffe”, e cila më pas u bë edhe një qendër fetare kulturore. Mësuesi i parë i suffe-s qe profeti ynë Muhamedi (a.s.). Ajo u shndërrua në një qendër ku myslimanët mblidheshin, falnin namaz dhe lexonin Kuran, dëgjonin bisedat e Profetit, bisedonin për problemet e tyre dhe u gjenin zgjidhje, ku priteshin përfaqësues të huaj dhe nga ku drejtohej shteti. Përreth xhamive të mëdha të ndërtuara në shekujt në vijim nga myslimanët, u krijuan dhe u formuan edhe insitucione të ndryshme si medresetë, menecat ku ushqeheshin falas të varfërit dhe të pastrehët, spitalet, bibliotekat, hamamet etj. që u jepnin përgjigje nevojave bazë të shoqërisë. Xhamitë u bënë qendra të shkencës, kulturës dhe të qytetërimit; vende ku mundësohej mirëkuptimi dhe arsimimi i njerëzve.

Cilët janë personat me detyrë në xhami?

Imami: Fjala imam, që në shqip ka kuptimin “udhëheqës dhe kryetar shteti”, është personi që i prin xhematit në faljen e namazit dhe e udhëzon atë në lidhje me çështje të ndryshme të fesë. Imamët nuk mjaftohen vetëm duke i prirë xhematit në faljen e namazit, por njëkohësisht i orientojnë njerëzit me dijen dhe moralin e tyre, sepse ata janë përgjegjës të edukimit shpirtëror të shoqërisë myslimane.

Muezini: Kështu quhet ai person që thërret ezanin kur vjen koha e namazit dhe që merret me punët e tjera përbrenda xhamisë. Kur nuk është i pranishëm imami, muezini e zëvendëson atë duke i prirë xhematit në faljen e namazit. Punon bashkë me imamin për edukimin shpirtëror të shoqërisë myslimane.

Vaiz: Kështu quhet ai person që këshillon xhematin para ose pas namazit në ditët e xhuma dhe të Bajramit, gjatë muajit Ramazan apo në ditë të caktuara të javës. Në bisedat që bëjnë nga kursitë vaizët mbajnë tema të ndryshme dhe bashkëbisedojnë me shoqërinë myslimane duke i mësuar asaj njohuri të ndryshme fetare. Ata i ndriçojnë myslimanët në aspektin fetar. Roli i vaizëve në edukimin e shoqërisë myslimane është i madh.

Kajjum: Zakonisht ndodhen në xhami të mëdha. Janë përgjegjës të xhamive që merren me pastrimin dhe rregullimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të xhamisë.

Cilat janë pjesët kryesore të një xhamie?

Mihrabi: quhet vendi ku imami fal namazin ndërsa i prinë xhematit në namaz.

Minber: quhet vendi nga ku lexohet hutbeja në ditët e xhuma dhe në Bajram. Kur kthehemi drejt Kibles minberi ndodhet në të djathtë të mihrabit. Ajo ka shkallare në të cilat ngjitet imami që mban hutben.

Kursi: quhet vendi nga ku imami i xhamisë apo vaizi i ligjëron xhematit dhe u jep vazë atyre

Mahfili i Muezinit: quhet vendi ku muezini falet dhe thërret ezanin. Jo në çdo xhami gjendet mahfili i muezinit. Zakonisht mahfile të tilla gjenden në xhamitë e mëdha.



Mihrab



Minber



Kursi



Mahfili i Muezinit

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë 1







Vendosni shenjat e sakta dhe të gabuara aty ku duhet në fjalitë e mëposhtme.

- | | | |
|---|----------------------------------|-----------------------------------|
| Pesë kohët e namazit janë bërë farz në natën e Miraxhit. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Namazi i sabahut është 8 rekate, 4 sunet dhe 4 farz. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Namazi i drekës është 10 rekate, 2 sunet, 4 farz dhe sy senete të tjerë. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Namazi i jacisë është 10 rekate, 4 sunet, 4 farz, 3 sunet. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Falja e namazit të vitrit është farz. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Falja e namazit të Bajramit është vaxhib. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Pastrimi i trupit, veshjes dhe i vendeve ku do të falet namazi nga papastërtitë që shihen me sy quhet "pastrim prej hadeth-it". | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Namazi i vitrit falet pas namazit të akshamit. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Në namazet që falen me xhematë bëhet nijet i veçantë për t'u lidhur pas imamit. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Marrja e tekbirit në fillim të namazit duke thënë "Allahu ekber" quhet "tekbiri fillestar". | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |

Të kontrollojmë njohuritë 2






Vendosni shenjat e sakta dhe të gabuara aty ku duhet në fjalitë e mëposhtme.

- | | | |
|---|----------------------------------|-----------------------------------|
| Thirrja që u bëhet myslimanëve për t'i njoftuar për kohën e namazit quhet "Ikamet". | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Duatë e kunutit i themi në rekatën e tretë të namazit të drekës. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Bërja nijet për namaz është sunet. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
| Marrja e tekbirit fillestar është farz. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |

- | | | |
|---|----------------------------------|-----------------------------------|
|  Leximi i “Subhaneke” pas tekbirit fillestar është farz. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Bërja e sexhdes është sunet. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Bërja e sehvi sexhdes në namaz kur gabojmë është vaxhib. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Falja e namazit kur na mendojnë nevojat fiziologjike është haram. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Ngrënia apo pirja e diçkaje në namaz është mekruh. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Shmangia e krahërorit nga drejtimi i Kibles gjatë faljes së namazit, prish namazin. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |

Të kontrollojmë njohuritë 3

Vendosni shenjat gabim dhe saktë në vendet ku duhet në fjalitë e mëposhtme.

- | | | |
|---|----------------------------------|-----------------------------------|
|  Hutbeja duhet lexuar përpara namazit të xhumasë. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Kemi dy bajrame fetare në vit, njëri është Bajrami i Ramazanit, ndërsa tjetri është Bajrami i Kurbanit. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Tekbirët që thuhën pas farzit të namazit në ditët e Kurban Bajramit, quhen “Tekbiri i teshrikut”. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Kur jemi udhëtar farzet me tre rekate shkurtohen dhe falen me dy. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |
|  Kur dielli është duke lindur, kur është në kulmin e tij dhe kur perëndon nuk falet asnjë namaz. | <input type="checkbox"/> E SAKTË | <input type="checkbox"/> E GABUAR |

Të testojmë veten 1

1.
 - I. Namazi mundëson përkujtimin sa më mirë të Allahut.
 - II. Namazi na kujton ahiretin dhe ditën e llogarisë.
 - III. Duke falur namaz bëjmë edhe sportin e trupit.
 - IV. Namazi na pastron nga gjynahet.

Cilat nga pikat e mësipërme janë pjesë e dobive që na jep namazi?

 - a) I-II-III
 - b) I-II-IV
 - c) II-III-IV
 - d) I-III-IV
2. Në cilën natë janë bërë farz pesë kohët e namazit?
 - a) Natën e Miraxhit
 - b) Natën e Kadrit
 - c) Natën e Mevlidit
 - d) Natën e Ragaibit
3. Cila nga pikat e mëposhtme nuk është e nevojshme që namazi të jetë farz?
 - a) Të qenit i mençur
 - b) Të qenit punëtor
 - c) Të arrish në moshën e pjekurisë
 - d) Të qenit mysliman
4. Cilat nga namazet e mëposhtme është vaxhib?
 - a) Namazi i drekës
 - b) Namazi i vitrit
 - c) Namazi i akshamit
 - d) Namazi i xhumasë
5. Cili nga namazet e mëposhtme është sunet?
 - a) Namazi i Bajramit
 - b) Namazi i vitrit
 - c) Namazi i teravisë
 - d) Namazi i xhenazes
6. Cili nga namazet e mëposhtme është farz?
 - a) Namazi i Bajramit
 - b) Namazi i xhenazes
 - c) Namazi i vitrit
 - d) Namazi i tehexhudit
7. Cila nga pikat e mëposhtme është namazi në të cilin farzi falet në fillim?
 - a) Dreka
 - b) Sabahu
 - c) Akshami
 - d) Jacia
8. Cilat nga pikat e mëposhtme nuk është nga farzet jashtë namazit?
 - a) Setr-i avert
 - b) Vakit
 - c) Nijet
 - d) Kijam
9. Cila nga pikat e mëposhtme nuk është nga farzet brenda namazit?
 - a) Kijam
 - b) Koha
 - c) Kirat
 - d) Ruku

10. Si quhet thirrja që bëhet për të njoftuar myslimanët për kohën e namazit?
- a) Ezani
 - b) Ikameti
 - c) Salat
 - d) Tekbir
11. Cili nga namazet sunet të mëposhtëm nuk është 4 rekate?
- a) Suneti i parë i namazit të drekës
 - b) Suneti i namazit të ikindisë
 - c) Suneti i namazit të akshamit
 - d) Suneti i parë i namazit të jacisë
12. Cili nga namazet sunet të mëposhtëm nuk është 2 rekate?
- a) Suneti i parë i namazit të drekës
 - b) Suneti i fundit i namazit të drekës
 - c) Suneti i namazit të akshamit
 - d) Suneti i fundit i namazit të jacisë
13. Cili nga namazet farz të mëposhtëm nuk është 4 rekate?
- a) Farzi i namazit të drekës
 - b) Farzi i namazit të ikindisë
 - c) Farzi i namazit të akshamit
 - d) Farzi i namazit të jacisë
14. Cila nga pikat e mëposhtme është prej vaxhibeve të namazit?
- a) Leximi i Subhaneke
 - b) Të thuash Subhane rabbije'l a'la
 - c) Leximi i Fatihasë
 - d) Të thuash Semiall-llahu limen hamideh

Të testojmë veten 2

1. Cila nga duatë e mëposhtme nuk lexohet në uljen e fundit në namaz?
- a) Tahijat
 - b) Rabbena
 - c) Sal-li barik
 - d) Duaja e kunutit
2. Cili nga pikat e mëposhtme nuk është një nga mekruhët e namazit?
- a) Luajtja pa vend me trupin dhe veshjet gjatë faljes së namazit.
 - b) Thënia më tepër se tri herë e tesbihëve në ruku dhe sexhde.
 - c) Falja e namazit kur jemi ngushtë me abdest të vogël apo të madh.
 - d) Falja e namazit para fytyrës së njeriut.

3. Cilin nga namazet e mëposhtme është kusht falja me xhematë?
- Namazin e xhumasë
 - Namazin e drekës
 - Namazin e ikindisë
 - Namazin e akshamit
4. Si quhet falja më vonë e namazeve që nuk mund të falen në kohën e duhur?
- Namazi i paradrekës
 - Namazi kaza
 - Namazi i të sëmurit
 - Namazi tahijatu'l mesxhid
5. Në cilën muaj falet namazi i teravisë?
- Rexhep
 - Shaban
 - Ramazan
 - Muharrem
6. Në cilin nga namazet e mëposhtme nuk bëhet ruku dhe sexhde?
- Namazi i xhenazes
 - Namazi i teravisë
 - Namazin e xhumasë
 - Namazi i Bajramit
7. Ku dhe në ç'vend është kibra e myslimanëve?
- Qabja në Mekë
 - Xhamia e Medines
 - Mesxhidi Aksa Kudus
 - Ravza medine
8. Kur thirret ikameti?
- Para farzit të namazit
 - Para namazit të Bajramit
 - Para namazit të xhenazes
 - Para namazit të vitrit
9. Cila nga pikat e mëposhtme nuk e prish namazin?
- Të folurit
 - Shpirja
 - Ngrënia dhe pirja e diçkaje
 - Të qeshurit sa ta dëgjojë vetë.
10. Cila nga pikat e mëposhtme tregon përbërjen e rekateve të namazit të drekës?
- 10 rekat - 2 sunet i parë, 4 Farz, 4 sunet i fundit
 - 10 rekat - 4 sunet i parë, 4 Farz, 2 sunet i fundit
 - 10 rekat - 4 sunet i parë, 2 Farz, 4 sunet i fundit
 - 8 rekat - 4 sunet i parë, 4 Farz

Të testojmë veten 3

1. Farzi është me 2 rekate. Para farzit lexohet hutbeja. Falet me xhematë, nuk falet vetëm. Është farz vetëm për burrat.
Cilit namaz i përkasin veçoritë e mësipërme?
 - a) Namazit të Bajramit
 - b) Namazit të sabahut
 - c) Namazit të xhenazes
 - d) Namazit të xhumasë
2. **Cila nga pikat e mëposhtme e prish edhe namazin edhe abdestin?**
 - a) Shmangia e trupit prej kibles në namaz.
 - b) Ngrënia e diçkaje në namaz.
 - c) Të folurit në namaz.
 - d) Të qeshurit me zë në namaz sa të dëgjohet nga tjetri.
3. **Cilat janë vendet e detyrueshme për t'u mbuluar në namaz?**
 - a) Nga supet deri tek këmbët
 - b) Nga mesi deri tek gjunjët
 - c) Nga mesi deri tek këmbët
 - d) Nga supet deri tek gjunjët
4. **Cilat janë vendet e detyrueshme për t'u mbuluar tek gratë?**
 - a) Çdo vend përveç fytyrës, shuplakave dhe këmbëve.
 - b) Çdo vend përveç kokës
 - c) Nga supet deri tek këmbët
 - d) Nga supet deri tek gjunjët
5. **Në cilin namaz thuhet duatë e kunutit?**
 - a) Namazi i xhumasë
 - b) Namazi i teravisë
 - c) Namazi i vitrit
 - d) Namazi i xhenazes
6. **Ç'është falja e namazit të xhumasë?**
 - a) Vaxhib
 - b) Farz ajn
 - c) Farz kifaje
 - d) Sunet
7. **Sa rekate është namazi i Teravisë?**
 - a) 18 b) 10 c) 20 d) 13
8. **Cila nga pikat e mëposhtme nuk është e saktë për namazin e Bajramit?**
 - a) Falet me xhematë dhe nuk bëhet kaza.
 - b) Falet dy herë në vit.
 - c) Është një namaz pa ruku dhe pa sexhde.
 - d) Lexohet hutbeja.
9. **Si quhet vendi ku lexohet hutbeja në namazet e Xhumasë dhe të Bajramit?**
 - a) Minber
 - b) Mihrab
 - c) Sherefe
 - d) Kursi
10. **Sa duhet të jetë largësia e udhëtimit në mënyrë që namazet farz me katër rekate të shkurtohen në dy rekate?**
 - a) 9 km
 - b) 90 km
 - c) 190 km
 - d) 900 km

Nga fjalët brenda kllapave vendosni të duhurat në vendet boshe (1)

(Kiraet, tehexhud, sexhde, drejtimi nga kibla, setru'l-avret)

- ❁ Namazi nafile që falet natën quhet namazi
- ❁ Mbulimi i vendeve të duhura në namaz quhet
- ❁ Kthimi drejt Qabes kur fillojmë faljen e namazit quhet
- ❁ Leximi i të paktën i tre ajeteve kuranore kur jemi në këmbë në namaz quhet
- ❁ Mbështetja në tokë pas rukusë i ballit, hundës, duarve, këmbëve dhe gjunjëve quhet

Nga fjalët brenda kllapave vendosni të duhurat në vendet boshe (2)

(teshrik, të djathtë, tilavet, gjynah, hutbeja, e harresës, shenja, kifaje)

- ❁ Në xhami duhet të hyjmë me abdest dhe me këmbë
- ❁ Para namazit të xhumasë duhet të lexohet
- ❁ Tekbirët që thuhën pas farzit të namazit në ditët e Bajramit të Kurbanit quhem tekbirë
- ❁ Falja e namazit të xhenazes është farz-i
- ❁ Të sëmurët që nuk kanë mundësi as të ulen mund të falin namaz me duke u përkulur apo përmbys.
- ❁ Lënia pa kriter dhe shkak i namazeve në kaza është një i madh
- ❁ Kur lëmë në harresë njërën prej vaxhibeve të namazit duhet të bëjmë sexhden
- ❁ Sexhdeja që bëhet kur lexojmë ajetet e sexhdes në Kuran quhet “sexhdeja e”



RAMAZANI dhe AGJERIMI



KLIMA E MËSHIRËS DHE E ADHURIMIT

- ✿ *Vlera e Ramazanit*
- ✿ *Koncepte të Ramazanit dhe të agjërimit*
- ✿ *Ç'përfitojmë nga agjërimi*
- ✿ *Llojet e agjërimit*
- ✿ *Agjërimi kaza dhe kefaret*
- ✿ *Çfarë e prish agjërimitin dhe çfarë jo*
- ✿ *Arsyet që lejojnë të mos agjërojmë*
- ✿ *Agjërimi i zotimit*
- ✿ *Fidja dhe fitri*
- ✿ *Teravi, Itikaf, Nata e Kadrit dhe Bajrami*
- ✿ *Jeta e Profetit në Ramazan*



AGJËRIMI I PARË

Iliri me babain e tij ishin lodhur dhe djersitur shumë. Ata kishin sjellë pakot e yftarit në shtëpi. Pasi lanë gjërat në kuzhinë, babai u ul në kolltuk, kurse Iliri në divan. E kishin përfunduar pazarin pasdreke, megjithëse kishin dalë shumë herët nga shtëpia. Në tezgjahët e ndriçuar me drita, gjeje çfarë të dëshiroje. Lloje të ndryshme peshqish që lëviznin të gjallë, lloje të ndryshme ullinjsh, djathrash, pastërmash dhe suxhukësh që të çelnin oreksin... Iliri u interesua më shumë për çokollatat. Ai bleu disa prej tyre për t'i ngrënë mbas yftarit.

Nëna i kishte filluar përgatitjet disa ditë para se të vinte muaji i shenjtë i Ramazanit. Ajo kishte pastruar shtëpinë, kishte bërë ëmbëlsira, komposto, kulaç ... Tashmë çdo gjë ishte gati.

Iliri kishte hyrë në të dhjetat. Të nesërmen do të mbante agjërimin e parë të jetës së tij. Në Ramazanët e tjerë kishte mbajtur agjërimet e pjesëmjetshme. Ky ishte agjërimi i të vegjëlve, i cili fillonte në syfyr e vazhdonte deri në drekë. Pas vaktit të drekës vazhdonte sërish, për të përfunduar në yftarin e të mëdhenjve. Por tani Iliri ishte rritur dhe dëshironte të agjëronte si të rriturit.

Babai i tha:

- Biri im, sonte fillon falja e namazit të teravisë. Nëse dëshiron, mund të vish me mua. Shkojmë bashkë, por duhet t'i përfundosh detyrat deri në darkë.

Iliri u përgjigj:

- Në rregull baba, detyrat do të përpiqem t'i përfundoj sa më shpejt.

Pasi hëngrën darkë, Iliri me babain u nisën për në xhami. Kur vuri në kokë fesin e bardhë të namazit që nëna ia dhuroi, e ndjeu veten më të rritur. Para namazit dëgjuan vazë. Pastaj u këndua ezani, filluan të falen. Ai e fali me shumë kënaqësi namazin e gjatë të teravisë. I këndoi me zë të lartë e me shpirt salavatet ndërmjet selameve. Pastaj u kthye me babanë në shtëpi. Ilirit i kishte ardhur ora e gjumit. Duke shkuar në shtrat i tha nënës:

- Nëna ime e shtrenjtë, mos harroni të më zgjoni për syfyr! Nëse nuk zgjohem, më lag me ujë në fytyrë.



Nëna i foli:

- Fli, pa merak, moj zemër, të zgjoj unë ty!

Me të vënë kokën në jastëk, Ilirin e zuri gjumi menjëherë. Në mëngjes, nëna me duart e saj të buta e përkëdheli dhe i tha:

- Zgjoju, burrë i madh, po kalon koha e syfyrit!

Freskia e ujit me të cilin shpëlau faqet ia largoi përgjumjen. U ul në sofrën që kishte përgatitur e ëma. Ajo kishte bërë byrekun që Ilirit i pëlqente më shumë. Kishte menduar t'ia bënte surprizë. Ai iu hodh nënës në qafë nga gëzimi dhe i tha:

- Këtë tepsi, unë mund ta ha të tërën, moj nënoke! Faleminderit!

Ai hëngri aq sa u ngop dhe mendoi se do ta kalonte lehtë agjërimin e asaj dite.

Babai ia priti:

- O djalë, mos harro të pish ujë! Pas pak do të këndoje ezani i sabahut!

Iliri piu disa gota ujë për ta përballuar etjen gjatë ditës. Pastaj lau dhëmbët, bëri nijetin dhe dëgjoji babain tek lexonte Kuran në sallon. Së bashku falën namazin e sabahut, pastaj shkuan të vazhdonin gjumin e lënë përgjysmë.

Kur u zgjua, Iliri shkoi në kuzhinë për të pirë pak ujë. Sapo e takoi gotën në buzë, iu kujtua agjërimi. Shikoi orën. Po shkonte drejt dhjetës. Iliri filloi të mendonte. Si do të duronte pa pirë ujë deri në yftar? Fillimisht mendoi të hiqte dorë nga të agjëruarit. Ndërsa një zë i brendshëm i thoshte se nuk duhej të hiqte dorë nga fjala e dhënë Allahut. Ai tashmë ishte i rritur. E vendosi që sado i vështirë të ishte agjërimi, do ta mbante atë për hir të Allahut, sepse të zgjohesh në mëngjes dhe të bësh syfyrin, do të thotë t'i japësh fjalën Zotit për agjërim në vazhdimin e asaj dite.

Ai duhej të gjente diçka me të cilën mund të shtynte kohën. Filloi të luante me lojërat e tij. Mirëpo etja, që i kishte sjellë edhe tharjen e buzëve, e detyronte të hidhte shikimin drejt brokes që gjendej mbi tavolinë. Në drekë etjes iu shtua edhe uria.

Në buzëmbremje, Iliri iu afrua nënës që ishte duke përgatitur yftarin. U ul i heshtur në tryezën e yftarit. Nëna, pasi vërejti të birin me vëmendje, i tha:

- Çfarë ke biri im? Mos të ka lodhur agjërimi?

- Edhe ujin e zogut në kafaz e kam zili, nënoke! Edhe purrinjtë, që nuk i fus në gojë, tani do t'i haja me dëshirë! Nuk do të kishe nevojë të më lutje për të ngrënë.

Nëna i tha ngadalë:

- Shiko, o djali im i bukur, sa shumë të mësoi agjërimi i një dite. Të mësoi të kuptosh gjendjen e të varfërve, vlerën e një kafshate buke dhe të një gllënjke uji, dhe ç'është më kryesorja, të mësoi bujarinë e të madhit Zot, i cili na e mbush sofrën tonë me të gjitha të mirat...Eja më ndihmo të shtrojmë sofrën! Ta përgatisim pa ardhur babai.

Tani Iliri i bartte me kujdesin më të madh pjatat e ushqimit të cilat deri dje i ishin dukur krejt të kota, si të çonte ndonjë thesar drejt tavolinës.

Të gjithë pjesëtarët e familjes u ulën në sofër para yftarit dhe filluan të pritnin ezanin.

Babai, duke qeshur, tha:


- Të lumtë Ilir! Agjërimin e parë e mbajte me sukses. Unë po e blej agjërimin tënd, - vazhdoi ai dhe ia mbushi xhepin me paratë që Iliri mund t'i shpenzonte gjatë javës.

Akoma pa mbaruar agjërimi, Iliri mori shpërblimin për të. Ai i kishte pasur krejt afër begatitë dhe bereqetet e Zotit, por kishte duruar për kënaqësin e Tij.

Momenti i shumëpritur erdhi. Në minaret e xhamive u ndezën dritat dhe filloi të këndohej ezani. Iliri i lumtur i dha fund agjërimit i pari. Ai përjetoi kënaqësinë që të dhuron besnikëria e fjalës së dhënë Allahut (xh.sh.).

Hasan Tahsin KARAMAN





Kurani ka filluar të zbresë në muajin e Ramazanit

Ramazani është muaji i ditëve të agjëritit dhe i nerëve të teravive.

Në muajin e Ramazanit adhurimet dhe mirësitë tona shpërblehen më me shumë sevape.

Nata e Kadrit që është më e vlefshme se një mijë muaj ndodhet në muajin e Ramazanit.

Ramazani është mbreti i dymbëdhjetë muajve.

Ramazani është muaji i shtimit të begatëve.

Ramazani është muaji i durimit. Shpërblimi i durimit është xheneti.

Ramazani është muaji i solidaritetit.

Fillimi i Ramazanit është mëshirë, vazhdim falje, ndërsa fundi shpëtëm dhe mbrojtje nga xhehenemi.

ÇFARË ËSHTË AGJËRIMI?

✍ Agjërimi është largimi nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet seksuale, brenda intervalit kohor që fillon me imsakun dhe mbaron me akshamin.



Allahu (xh.sh.) në Kuran thotë:

“O ju që besuat! Iu është bërë obligim agjërimi ashtu siç u qe bërë paraardhësve tuaj, në mënyrë që të përmbaheni”

Bekare 183

Për kë është farz agjërimi?

Çdo mysliman

që është i shëndoshë psikikisht dhe ka hyrë në moshën e pubertetit

e ka farz agjërimin



në muajin e Ramazanit.

✍ Fëmijët nuk e kanë obligim agjërimin, por këshillohet të agjërojnë brenda mundësive të tyre.



Cilat janë kushtet e pranimit të agjërimit?

Kushtet e pranimit të agjërimit janë

- * bërja e nijetit,
- * qëndrimi nga syfyri deri në aksham larg çdo veprimi që e prish agjërimin.

Disa koncepte që lidhen me Ramazanin:

Kur dhe si duhet bërë nijeti për agjërim?



Nijeti për të agjëruar mund të bëhet në darkë ose në syfyr, duke thënë: "E bëra nijet të agjëroj në këtë ditë të Ramazanit për hir të Allahut (xh.sh.).!"



Çfarë duhet bërë, nëse në darkë harrojmë bërjen e nijetit për agjërim?



Në qoftë se nuk kemi kryer ndonjë veprim që prish agjërimin, ne mund ta bëjmë nijetin deri 45 min. para se të hyjë mesdita.



A është i nevojshëm formulimi i nijetit me fjalë?



Bërja e nijetit me zemër, për agjëruenin është e mjaftueshme. Zgimi në syfyr, vendimi i marrë për të agjëruar dhe mendimi se, nesër do të jesh agjërueshëm konsiderohen nijet në vetvete. Por formulimi i nijetit me fjalë është edhe më i mirë.



Çfarë është imsaku?



Imsaku është koha që shënon fundin e natës dhe hyrjen e agimit. Në të njëjtën kohë, ai shënon edhe hyrjen e kohës së namazit të sabahut.



Çfarë është syfyri?



Syfyr konsiderohet koha para imsakut. Gjithashtu edhe ushqimi që hahet në këtë kohë quhet syfyr.



☸ Koha e syfyrit është koha e pranimit të duave. Vakti i syfyrit është gjithashtu, ushqimi që na jep forcë për të rezistuar. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kujdesuni për vaktin e syfyrit, sepse në sofrën e syfyrit ka bollëk dhe bereqet.”

Koha e syfyrit është koha e agimit. Është koha kur nga qiejt zbret mëshira e Zotit.




Çfarë është yftari?

Syfyri është koha kur besimtarët falen, adhurojnë Allahun me namaz dhe dhikër.

Ata që zgjohen në syfyr, sikur thonë:

“Zoti im! Të falënderoj, sepse më ke bërë nga njohësit dhe të dashurit e Tu. Për të shfaqur lidhjen që kam me Ty, prisha gjumin dhe u zgjova. Nesër vetëm për Ty do të agjëroj. Shprehe pëlqimin tënd ndaj meje, o Zot!”



Yftari shënon përfundimin e agjërimit dhe hyrjen e namazit të akshamit. Koha e yftarit shënon momentin më të këndshëm të agjëruesit, që ka qëndruar larg të ngrënit dhe të pirit.



☸ Në yftar, ne përjetojmë kënaqësinë e plotësimin me sukses të një dite agjërimi. Por, kënaqësinë e vërtetë të agjërimit do ta përjetojmë në botën tjetër, Ahiret.

Pejgamberi ynë (a.s.), thotë:

“Për agjëruesin ka dy momente të këndshme: Njëri prej tyre është momenti i yftarit, kurse tjetri është ballafaqimi me Zotin nëpërmjet sevapit të agjërimit.”

(Buhari, Savm, 9)

☸ Për agjëruesit është veprim shumë i pëlqyeshëm shtrimi i yftareve.

Pejgamberi ynë (a.s.) thotë:

“Kush i shtron yftar një agjëruesi, fiton sevape sa vetë agjëruesi, duke mos iu pakësuar asnjë sevap këtij të fundit.”

(Tirmidhi, Savm, 82)

☸ Koha e yftarit dhe e syfyrit është shumë e përshtatshme për pranimin e duave. Allahu (xh.sh.), i pranon duatë e singerta që bëhen në kohën e yftarit. Këto kohë duhen shfrytëzuar për të bërë sa më shumë dua.

Pejgamberi ynë (a.s.), thotë:

“Tre personave nuk u refuzohet duaja: Agjëruesit që bën dua në kohën e yftarit, drejtuesit të drejtë dhe atij që i është bërë padrejtësi.”

Tirmidhi, Deavat, 128

Duaja e yftarit:

Para yftarit është sunet të bëhet kjo dua:




اللَّهُمَّ لَكَ صُمْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ وَصَوْمَ الْغَدِ
مِنْ شَهْرِ رَمَضَانَ نَوَيْتُ فَاعْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ

“All-llahumme leke sumtu ve bika amentu ve alejke tevekkeltu ve ala rizkike eftartu ve savme'l-gadi min shehri ramadane nevejtu fagfir li ma kaddemtu ve ma ahhartu.”


“Zoti im, për ty agjërova, Ty të besova, tek Ti u mbështeta, me atë që më dhurove Ti, po bëj yftar. E bëra nijet të agjëroj ditën e nesërme. Zoti im, m'i fal gjuhahet e mia që i përkasin së kaluarës dhe ato që i përkasin së ardhmes.”

DUKE U KUJDESUR PËR AGJËRIMIN, EDHE AGJËRIMI KUJDESET PËR NE

Si duhet të agjërojmë?



Zgjohe mi natën vonë, hamë ushqimin e syfrit dhe pastaj bëjmë nijetin. Fillimi i imsakut shënon edhe fillimin e agjërit.



Nga imsaku e deri në aksham ne duhet të qëndrojmë larg ngrënies e pirjes si dhe larg çdo veprimi që e prish agjërimin.

Ne i japim fund agjërit duke çelur yftarin në kohën e perëndimit të diellit. Falënderojmë Allahun për begatitë e dhuruara.

Kështu ne kemi realizuar agjërimin e një dite.

Si na ruan agjërimi neve?

Agjërimi nuk përbëhet vetëm nga largimi prej çdo lloj ushqimi ose pijeje. Ai në tërësinë e tij përmban qëndrimin larg zënkave, gënjeshtreve, përgojimeve, fjalëve të rënda që thyejnë zemrat e njerëzve si dhe larg çdo vepre të ligë. Profeti (a.s.), jo më kot thotë: “Agjërimi është mburojë ndaj mëkateve dhe zjarrit të xhehenemit.” Nëse gjatë agjërit nuk largohemi nga haramet, sikurse largohemi nga ushqimet dhe pijet, atëherë agjërimi nuk ka asnjë vlerë tek Allahu (xh.sh.).

Profeti (a.s.), thotë:

“Allahu (xh.sh.), nuk vlerëson braktisjen e ushqimit dhe të pijeve, por atë të gënjeshtreve dhe të mashtrimeve.”

(Buhari, Savm, 8)

ÇFARË PËRFITOJMË NGA AGJËRIMI?

DUKE AGJËRUAR,



- * Fitojmë pëlqimin dhe dashurinë e Allahut.
- * Kujtohemi për të mirat që Allahu (xh.sh.), na dhuron dhe e falënderojmë Atë.
- * Mësojmë të jemi të durueshëm.
- * Mbrohemi nga zjarri i xhehenemit, duke qëndruar larg të këqijave dhe gjynaheve.
- * E kuptojmë më mirë varfërinë dhe urinë duke i përjetuar ato.
- * Mbrojmë shëndetin tonë.

Gjatë agjërimit ne i braktisim ushqimet dhe pijet e ndryshme, vetëm për hir të Allahut. Ne nuk duhet ta prishim agjërimit në vende ku mendojmë se nuk na sheh kush, sepse Zoti (xh.sh.), sheh kudo. Me këtë, ne fitojmë pëlqimin dhe dashurinë e Allahut.

Në një hadith kudsî Allahu (xh.sh.)
thotë:

“Robi im agjërues ka braktisur të ngrënë dhe të pirët për të fituar dashurinë Time. Vetëm unë do të jem shpërblyesi i agjërimit të tij.”

(Buhari, Saum, 4)



Shpesh ne nënvlerësojmë begatitë që na dhuron Allahu (xh.sh.). Vetëm atëherë kur na mungojnë, kujtohemi për rëndësinë e tyre. Gjatë agjërimit, ne qëndrojmë larg ushqimeve dhe pijeve të ndryshme dhe kjo na shton vetëdijen mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e tyre. Kështu që kujtohemi për të mirat që na jep Allahu në përditshmëri dhe e falënderojmë me gjithë zemër Atë.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Më përmendni Mua, që unë t’ju përmend ju. Më falënderoni e mos më mohoni.

(Bekare, 152)

Ne në jetë do të përballemi me vështirësi të ndryshme. Që të mund t’i përballojmë ato, duhet të bëjmë durim. Durimi është çelësi kryesor i suksesit. Gjatë agjërimit mësojmë të durojmë urinë dhe etjen, pra, kështu ne mësojmë të durojmë.

Profeti (a.s.) thotë:

“Agjërimi është gjysma e imanit.”

(Ibn Maxhe, Sijam, 44)



Gënjeshtra, përgojimi, debatet e kota, shkelja e të drejtave të njerëzve, thyerja e zemrës, janë mëkate që shpien në xhehenem. Ne mund të ruhemi nga këto mëkate, duke kontrolluar egon tonë. Në muajin e madhërueshëm të Ramazanit ne hyjmë në një atmosferë edukimi shpirtëror. Qëndrojmë larg veprave të këqija dhe mëkateve dhe, me këtë stil jetese, ruhemi nga zjarri i xhehenemit.

Profeti ynë i dashur thotë:

“Agjërimi është mburojë ndaj gjynaheve. Agjëruesi të mos thotë fjalë të liga dhe të mos zihet me kënd. Po qe se e fyejnë, le të përgjigjet: Unë sot kam agjëruar.”

(Buhari, Savm, 9)



Asnjë njeri nuk mund ta kuptojë si dhe sa duhet gjendjen e të varfërit, pa e provuar sadopak në jetën e tij. Ata që kanë një dorë në gjalpë e tjetrën në mjaltë, nuk do të mund të përjetojnë asnjë vështirësi të fukarait. Gjatë agjërit, ne mësojmë se çfarë është varfëria dhe uria. Në këtë muaj zhvillohen ndjenjat e dhembshurisë dhe mëshirës. Ne i zgjasim dorën e ndihmës dhe të bashkëpunimit njëri-tjetrit duke ndarë çdo gjë që kemi në zotërim.

Profeti ynë i dashur thotë:

“Shikoni ata që bëjnë një jetë në kushte më të vështira se ju dhe mos shihni ata që kushtet e jetesës i kanë më të larta se ju. Kështu do t'i kuptoni më mirë begatitë që ju dhuron Allahu (xh.sh.) dhe nuk do t'i përçmoni ato.”


(Muslim, Zuhd, 9)


Stomaku, së bashku me organet e tjera, punon vazhdimisht, mëngjes e mbrëmje gjatë gjithë vitit. Ata që kanë probleme të ndryshme, e sidomos me stomakun, kurohen nëpërmjet dietave të ndryshme. Edhe agjërimi është një lloj diete. Në muajin e Ramazanit stomaku, së bashku me sistemin e tretjes, bëjnë relativisht pushim. Pra, nëpërmjet agjërit mbajmë në formë edhe shëndetin tonë.

Profeti ynë i dashur thotë:

“Agjëroni që të keni shëndet.”
(Taberani, Mu'xhemu'l-evsat, VIII, 174)







LLOJET E AGJERIMEVE

Agjërimet ndahen në katër grupe: 1 FARZ, 2 VAXHIB, 3 SUNET, 4 MEKRUH

Agjërimet farze ☺☺☺☺

- * Agjërimi i Ramazanit.
- * Agjërimi kaza i Ramazanit.
- * Agjërimi i kefaretit të Ramazanit.

Agjërimet Vaxhib ☺☺☺

- * Agjërimi i zotimit.
- * Agjërimi kaza i agjërimit nafle.

Agjërimet Sunet 😊😊

Pejgamberi ynë i dashur agjëronte, jo vetëm në muajin e Ramazanit. Këto agjërime përtej Ramazanit janë:

- * Agjërimi i ditës së nëntë dhe të dhjetë të muajit Muharrem.
- * Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval, pas muajit Ramazan.
- * Agjërimi i ditëve të hëna e të enjte.
- * Agjërimi i ditëve 13, 14, 15 të muajve, sipas kalendarit hënor.
- * Agjërimi i një dite po dhe i një dite jo. Sigurisht, kjo vlen për të gjithë muajt, përveç Ramazanit, dhe quhet agjërimi i Davudit (a.s.).



Agjërimet Mekruh ☹️☹️


Agjërimet që, për arsye të ndryshme konsiderohen mekruh, janë dy llojesh:

1. Agjërimet tahrimen mekruh ☹️☹️☹️

- * Agjërimi i ditës së parë të Bajramit të Ramazanit.
- * Agjërimi i të gjitha ditëve të Kurban Bajramit.

2. Agjërimet tenzihen mekruh ☹️☹️

- * Agjërimi vetëm i ditës së ashures (dita e dhjetë e muajit Muharrem).
- * Agjërimi vetëm i ditës së premtë ose vetëm i së shtunës.

 Ai që dëshiron të agjërojë në ditë e ashures dhe në ditë e premtë ose të shtunë, duhet të agjërojë gjithashtu edhe një ditë para ose pas tyre.

AGJËRIMI KAZA

Çfarë është agjërimi kaza?

✍ Agjërim kaza quhet zëvendësimi i agjërit të prishur gabimisht ose i mosagjërit për shkaqe objektive.

Kur mund të kryhet agjërimi kaza?

Agjërimi kaza mund të kryhet pas muajit të Ramazanit, përveç ditëve në të cilat agjërimi është tahrimen mekruh.



AGJËRIMI KEFARET

Çfarë është agjërimi kefaret?

✍ Ai që e prish agjërimin e tij me qëllim, pa ndonjë arsye objektive, duhet të agjërojë dy muaj pa ndërprerje pas Ramazanit. Ky agjërim, që është një masë ndëshkimore, quhet agjërim kefaret.

Sa ditësh është agjërimi kefaret?

Agjërimi kefaret zgjat dy muaj, sipas kalendarit hënor. Ky afat është afërsisht 60 ditë. Këtij numri të ditëve i shtohet edhe një ditë agjërimi që ne kemi prishur.



SHKAQET QË E PRISHIN AGJËRIMIN

Shkaqet që prishin agjërimin do t'i studiojmë në dy grupe:

Shkaqet që shkaktjnë njëherësh agjërimin kefaret dhe kaza. 🍷🍷

Të mos agjërosh në muajin e Ramazanit pa pasur justifikim ose ta prishësh agjërimin e nisur pa ndonjë arsye, konsiderohet gjynah. Ne duhet të kërkojmë falje nga Allahu (xh.sh.), për prishjen me qëllim të agjërimit të nisur. Si masë ndëshkimore duhen agjëruar dy muaj pa ndërprerje dhe gjithashtu edhe ajo ditë agjërimi si kaza.

- 🍷🍷 Ngrënia dhe pirja pa ndonjë arsye,
- 🍷🍷 Kryerja e marrëdhënieve seksuale.



Imponojnë agjërimin kefaret dhe atë kaza.





Shkaqet që imponojnë vetëm agjërimin kaza

Agjërimi mund të priset gabimisht ose nga ndonjë arsye objektive. Në këto kushte, ne duhet ta zëvendësojmë atë ditë agjërimi.

Disa nga shkaqet që imponojnë agjërimin kaza janë:

- Të vazhdojmë të hamë ose të pimë, duke pandehur se agjërimin e kemi prishur, ngaqë kemi ngrënë ose pirë diçka në harresë.*
- Ngrënia ose pirja e materialeve, të cilat nuk shërbejnë për t'u ushqyer. (si letra, ose dheu etj.)
- Ngrënia ose pirja, pasi të ketë hyrë koha e imsakut, duke menduar se ajo kohë nuk ka hyrë ende.
- Çelja e yftarit para kohe, duke menduar se ka hyrë akshami.
- Përtpjja e ndonjë grimce ushqimi në madhësinë e një kokërr qiçre.
- Hyrja e ujit në fyt gjatë shpëlarjes së gojës ose të hundës.
- Përtpjja pa dashje e ndonjë floku bore, ndonjë kokërr breshëri ose pikë shiu.
- Hedhja e ndonjë pike ilaçi në hundë ose në vesh.
- Prishja e agjërimit me dhunë apo imponim.
- Prishja e një dite agjërimi jashtë Ramazanit, me ose pa dashje.

Duhet të agjërojmë kaza.

*Agjërimi nuk priset nga ngrënia ose pirja në rast harrese. Por në momentin që kujtohem, duhet ta ndërpresim në çast ngrënien dhe pirjen. Nëse kujtohem për agjërimin tonë dhe, megjithkëtë vazhdojmë të hamë ose të pimë, atëherë agjërimi priset.

SHKAQET QË NUK E PRISHIN AGJËRIMIN

- ✘ Ngrënia ose pirja në rast harrese *
- ✘ Gëllitja e një grimce ushqimi të mbetur ndër dhëmbë, në qoftë se ajo është më e vogël sesa një kokërr qiqre.
- ✘ Kapërdirja e pështymës.
- ✘ Kapërdirja së bashku me pështymën e lagështirës së ujit të mbetur në gojë pas larjes së dhëmbëve.
- ✘ Kalimi pa dashje i pluhurit ose tymit nga hunda ose goja.
- ✘ Hyrja e ujit në vesh.
- ✘ Gjendja e xhunubllëkut, kur ejakulimi ka ndodhur në gjumë.
- ✘ Bërja banjë.
- ✘ Hedhja e ilaçit në sy.
- ✘ Nuhatja e luleve të ndryshme, si trëndafili etj, dhe gjithashtu nuhatja e esencave të ndryshme.
- ✘ Heqja e dhëmbit. **,
- ✘ Vjellja pa e provokuar atë vetë.
- ✘ Kapërdirja e të vjellit që të ka mbushur gojën.
- ✘ Shijimi i ushqimit, por pa e kaluar atë. ***,
- ✘ Përdorimi i furçës pa kolinoz.
- ✘ Dhurimi i gjakut.



Nuk e prish agjërimin



* Ai, që në mënyrë të pavetëdijshme, duke harruar se është agjërueshëm, ha ose pi diçka dhe pastaj kujtohet, duhet menjëherë t'i ndërpresë ato. Shpëlan gojën dhe vazhdon agjërimin. Nëse ai vazhdon të hajë ose të pijë, edhe pasi kujtohet për agjërimin e tij, atëherë agjërimi priset dhe duhet bërë kaza.

** Ilaçi spruc, që përdoret gjatë heqjes së dhëmbit, nuk e prish agjërimin, ndërsa gjilpëra me morfinë e prish atë. ☹️

*** Të provosh shijen e ushqimit, pa e ngrënë atë, është mekruh. ☹️☹️

Pejgamberi ynë (a.s.) i dashur thotë:

“Ai, që në mënyrë të pavetëdijshme, ha ose pi diçka, ta vazhdojë agjërimin e tij. Sepse Allahu (xh.sh.) ka dashur ta qerasë atë me ushqim dhe pije.”

(Buhari, Savm, 26)



KUR MUND TË NDËRPRITET AGJËRIMI?

Feja Islame është feja e lehtësimit. Allahu nuk i ngarkon robërit e Tij me përgjegjësi që i tejkalojnë mundësitë e tyre. Ky arsyetim vlen edhe për agjërimin. Të mos agjërosh muajin e Ramazanit, pa pasur ndonjë arsye objektive, është gynah. Por, nëse ka arsye, atëherë agjërimi mund të mos mbahet, ose të ndërpritet dhe,

pas Ramazanit, në mundësinë e parë më të mirë, duhet të zëvendësohet. Sipas fesë islame, arsyet objektive për të mos agjëruar ose për ta ndërprerë agjërimin e nisur janë:

1	Udhëtimi	<p>📖 Ai besimtar që udhëton, duke përshkuar një distancë të paktën prej 90 km dhe do të qëndrojë në destinacion më pak se 15 ditë, mund të mos agjërojë, por, nëse agjëron, kjo është më mirë.</p>
2	Sëmundja	<p>📖 Nëse një besimtar frikësohet se agjërimi ia përkeqëson sëmundjen ose ia shtyn afatin e kurimit, atëherë ai mund të mos agjërojë. Për arsyet e mësipërme mund ta ndërpresë edhe agjërimin e nisur.</p> <p>✍️ Që agjërimi përkeqëson gjendjen e të sëmurit, duhet konfirmimi i një mjeku besimtar. Nëse kjo mundësi nuk ekziston, atëherë agjëruesi duhet ta ndejë thellë brenda vetes përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore gjatë agjërimit.</p>
3	Pleqëria	<p>📖 Besimtarët që kanë hyrë në fazën e sëmundjes pa shërim të pleqërisë, nëse nuk mund të agjërojnë, janë të liruar nga ky obligim i prerë fetar.</p> <p>✍️ Besimtarët e thyer në moshë, në pamundësi të agjërimin në kohë ose kaza, duhet të japin për çdo ditë agjërimi fidje.</p>
4	Shtatzania ose fëmija për gjirit	<p>📖 Nëse një besimtare është shtatzënë ose ka fëmijën akoma në fazën e gjirit dhe frikësohet nga dëmi që mund t'i sjellë agjërimi, mund të mos agjërojë.</p>
5	Cikli menstrual dhe perioda e lehonës	<p>📖 Kur një agjëruese hyn në ciklin menstrual ose pas lindjes, në periudhën e lehonisë, duhet ta ndërpresë agjërimin.</p>
6	Lufta	<p>📖 Një ushtar në luftë, që i frikësohet rënies së aftësive të tij ushtarake nga agjërimi, mund ta prishë atë.</p>
7	Në rast rreziku dhe vështirësie	<p>📖 Besimtari që kërcënohet se do të plagoset apo do të vritet në rast se agjëron, mund ta ndërpresë agjërimin e nisur.</p>
8	Uria dhe etja e tejskajshme	<p>📖 Ai besimtar që frikësohet nga dëmi psikik ose fizik që mund t'i shkaktojë agjërimi, mund ta prishë atë.</p>

FIDJA E AGJËRIMIT



✍️ Ata që nga pleqëria ose nga një sëmundje e pashërueshme nuk agjërojnë, nuk e zëvendësojnë atë. Ata janë të detyruar t'u japin të varfërve dhe nevojtarëve një sasi të caktuar parash ose ushqimi për çdo ditë agjërimi. Ky obligim material, në terminologjinë Islame quhet fidje.

📖 Shuma e fidjes është e barabartë me shumën e fitër bajramit. Fidja e një dite agjërimi është sa vlera monetare e një vakti, me të cilin mund të ngopet një i varfër. Vlera monetare e fidjes mund të ndryshojë në përshtatje me mundësitë ekonomike që ka fidjedhëni.

SADAKAJA E FITRIT



✍️ Sadakaja e fitrit është ajo lëmoshë që jep çdo mysliman i pasur për vete dhe për çdo individ të familjes së tij, për të cilin ai është përgjegjës. Kjo sadaka quhet fitër. Dhënia e saj në muajin e Ramazanit është vaxhib.

✍️ Shuma më e vogël e fitrit është ushqimi i një dite për një person ose vlera monetare e kësaj sasive ushqimi. Kjo shumë nuk ka kufi të sipërm. Ata që japin më shumë, fitojnë më shumë sevape.

✍️ Fitri duhet të jepet para se të falet namazi i Bajramit të Ramazanit. Kështu, ne gëzojmë të varfërit dhe nevojtarët, duke u mundësuar edhe atyre të sigurojnë nevojat me rastin e festës së Bajramit.

✍️ Sadakaja e fitrit është lëmosha apo sadakaja e trupit dhe shëndetit që ne gëzojmë. Është shprehje falënderimi dhe mirënjohjeje ndaj Krijuesit për mirësitë e dhuruara gjatë muajit të Ramazanit dhe që ia mbërritëm sërish festës së Bajramit.

AGJËRIMI I ZOTIMIT



✍️ Agjërim i zotimit është agjërimi vetëm për hir të Zotit.

Ky agjërim është dy llojesh:

1. Agjërimi me kusht

- Nëse vendosim të agjërojmë për arsye të ndryshme. Për shembull betohemi : "Nëse gjendja shëndetësore e nënës sime përmirësohet, unë do të agjëroj tre ditë" atëherë jemi të detyruar t'i përmbahemi këtij zotimi.

2. Agjërimi pa ndonjë kusht

- Ne duhet të agjërojmë, nëse vendosim ta bëjmë një gjë të tillë duke thënë: "Unë dua të agjëroj një ditë vetëm për hir të Zotit". Nëse kemi përcaktuar edhe ditën, atëherë agjërimi duhet kryer pikërisht në ditën e përcaktuar.

NAMAZI I TERAVISË ☺☺

- ☸ Teravija është një namaz njëzet rekatësh që falet vetëm në muajin e Ramazanit. Ky namaz është sunet muekede, si për burrat, ashtu edhe për gratë.
- ☸ Namazin e teravisë mund ta falim në xhami me xhematë, por edhe vetëm në shtëpi. Falja me xhematë ka më shumë sevape.
- ☸ Falja e teravisë është sunet edhe për ata që nuk kanë agjëruar për arsye objektive.

ITIKAFI ☺☺

- ✂ Qëndrimi në xhami ose në mesxhid për një periudhë të caktuar kohe, me qëllim adhurimi, quhet itikaf.
- ☸ Profeti ynë i dashur ka bërë itikaf dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, deri në fundin e jetës së tij. Për këtë arsye, itikafi në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit është sunet.
- ☸ Para se të hyjmë në itikaf, veshim rroba të pastra dhe lyhemi me erë të mirë. Gjatë itikafit lexojmë Kuran, hadithe dhe libra të ndryshëm fetarë. Përmendim Allahun duke bërë dhikër, falim namaze nafile ose kaza; bëjmë vazhdimisht dua; qëndrojmë larg bisedave të kota; bëjmë kujdes ndaj veprimeve. Duke menduar se jemi para Zotit.

Teravija e parë

Ishte buzëmbremje Ramazani. Kishin mbetur edhe shtatë ditë nga përfundimi i muajit. Deri atë ditë Pejgamberi, pasi falte namazin e jacisë, drejtohej për në shtëpinë e tij. Atë natë, pas jacisë, fali namazin e teravisë, i cili zgjati deri në përfundimin e një të tretës së natës.

Të nesërmen u përhap lajmi se Pejgamberi kishte falur namazin e teravisë. Mirëpo një natë më pas, Profeti nuk e fali namazin e teravisë. Ndërsa natën tjetër sërish u fal. Namazi zgjati deri në gjysmën e natës. Të nesërmen nuk u fal.

Së fundi, tre ditë para se të përfundonte muaji i Ramazanit, e fali namazin e teravisë, namaz ky që zgjati deri në agim. Mirëpo nga frika se mos ky namaz po kuptohej si një ndër namazet farz, një ditë më pas nuk u fal. Ai i këshilloi të pranishmit të shkonin në shtëpi dhe ta falin namazin.

Falja e namazit të teravisë në xhami ka filluar të praktikohet në kohën e halifit Omer (r.a.).





NATA E KADRIT C

C Ashtu siç është veçuar Ramazani në vlerësim ndaj muajve të tjerë, ashtu edhe nata e Kadrit është veçuar po në vlera ndaj netëve të tjera. Allahu (xh.sh.), në lidhje me këtë natë, thotë: “Ne e zbritëm Kuranin në natën e Kadrit. Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj. Në këtë natë engjëjt së bashku me Xhebrailin, me urdhrin e Zotit zbresin radhë-radhë për çdo punë. Atë natë, deri në të zbardhur ka vetëm qetësi”.

C Nata e Kadrit është nata e shenjtë në të cilën zbret mëshira dhe mirësia e Zotit, falen mëkatet dhe pranohen lutjet e besimtarëve.

C Profeti Muhamed (a.s.), e shtonte adhurimin në ditët e fundit të Ramazanit, sepse nata e Kadrit ndodhet në njërën nga këto ditë të bekuara.

C Gjithashtu edhe ne duhet ta vlerësojmë shumë dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit. Në mënyrë të veçantë natën e njëzet e shtatë të tij. Duhet të punojmë të ritojmë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.), në këtë natë që vlen sa 83 vjet. Këtë natë të lindjes së diellit të Islamit, pra, të zbritjes së ajeteve të para të Kuranit, duhet ta vlerësojmë:

- ✂ Duke dëgjuar ligjërata të ndryshme në xhami,
- ✂ Duke lexuar Kuran,
- ✂ Duke falur namaz,
- ✂ Duke bërë dua,
- ✂ Duke rënë salavatë mbi Profetin,
- ✂ Duke i kërkuar Zotit falje për gabimet që kemi bërë..



Profeti ynë i dashur thotë:

“Të gjitha mëkatet do t’i falen atij besimtari që e vlerëson natën e Kadrit duke besuar në madhësitinë e saj dhe gjithashtu duke e pritur shpërblimin vetëm nga Allahu (xh.sh.).”

(Buhari, Iman, 25)



Aishja (r.a.), një ditë e pyeti Profetin (a.s.):

“O i dërguari i Allahut (xh.sh.), çfarë duaje duhet të bëj unë, nëse do ta dija se kur është nata e Kadrit?”

Profeti (a.s.) i përgjigjet:

“Zoti im! Ti je shumë falës, e do faljen, më fal mua!”

(Tirmidhi, Deavat, 84)



Duaja që këndohet në Natën e Kadrit

اللَّهُمَّ إِنَّكَ عَفُوٌّ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي

All-llahumme inneke afuvvun
tuhibbu'l-afve fa'fu anni

“Zoti im! Ti je shumë falës,
e do faljen, më fal mua!”



BAJRAMI I RAMAZANIT

Sheja jonë Islame e ka bërë farz agjërimin. Ditën e parë të Shehalit e ka shpallur festë për myslimanët. Në fundin e Ramazanit ndiejmë trishtimin e lamtumirës së mirësisë së Ramazanit dhe gëzimin e festës së Bajramit. Në ditën e fundit bëjmë bilancin e të gjitha veprave që kemi bërë gjatë Ramazanit, por edhe fillojmë të bëjmë përgatitjet për Bajramin. Në mëngjes veshim rrobat e reja të Bajramit dhe nisemi drejt xhamisë. Ditën e Bajramit e fillojmë me faljen e namazit të Bajramit që është edhe shprehje e një falënderimi të thellë dhe të sinqertë ndaj të madhit Zot.

Bajrami nuk është ditë pushimi që kalohet në vetmi, por një ditë që festohet së bashku me myslimanët e tjerë. Në fillim përshëndetemi me

prindërit prej të cilëve nuk harrojmë të kërkojmë edhe lutjen e mbarësisë. Pastaj vizitojmë miqtë dhe të afërmit. U urojmë me dashamirësi festën e Bajramit të gjithë njerëzve që takojmë. I ngrohim me fjalë të ëmbla jetimët dhe ata që kanë mbetur pa asnjë mbështetje, kurse të sëmurëve u urojmë shërim sa më të shpejtë dhe shëndet të plotë. Pajtohemi me njerëzit prej të cilëve jemi fyer, duke mos u vënë shumë rëndësi shkaqeve. Në Bajram forcohen lidhjet me miqtë dhe të afërmit, zhvillohen ndjenjat e mëshirës, butësisë dhe mirënjohjes, u çelet dritarja e zemrës të gjithë të varfërve, jetimëve dhe nevojtarëve.

JETA E PROFETIT TONË NË MUAJIN E RAMAZANIT

Sihariqi i Ramazanit

Profeti Muhamed e priste me shumë mall muajin e shenjtë të Ramazanit. Gëzohej kur vinin tre muajt e mëdhenj dhe bënte dua me gjithë zemër:

“Zoti im, begatoje muajin Rexheb e Shaban dhe bëj të mundur ta mbërrijmë me shëndet të plotë muajin e Ramazanit.”

Ai e shtonte agjërimin në muajt Rexheb dhe Shaban, kurse për muajin e madhëruar të Ramazanit thoshte:

“Në Ramazan hapen plotësisht dyert e xhenetit, mbyllen krejtësisht dyert e xhehenemit dhe dobësohen shejtanët.”

“Xheneti ka tetë dyer. Emri i njërës prej tyre është Rejjan, nga e cila do të hyjnë vetëm agjëruesit. Kjo derë do të mbyllet kur të hyjë agjëruesi i fundit. Atyre që hyjnë nga kjo derë, do t’u shërbehet një pije, e cila do t’ua shuajë etjen.”



Syfyri i Pejgamberit

Pejgamberi e vlerësonte së tepërmi vaktin e syfyrit. “Kini kujdes zgjimin në syfir, sepse ushqimi i syfyrit është i begatshëm!” - thoshte ai. Një ditë profeti ftoi për syfir Irbaz Ibn Sarijen, të cilit iu drejtua: “Urdhëro në ushqimin e rëndësishëm!” Një herë tjetër, ai u shpreh kështu, duke dashur të vinte theksin

mbi rëndësinë e zgjimit për të ngrënë syfyrin: “Ushqimi i syfyrit është i bereqetshëm. Mos e lini pas dore! Qoftë edhe me një gllënjë ujë bëni syfir. Allahu (xh.sh.), së bashku me melekët e Tij, lëshon mëshirën e tyre mbi ata që bëjnë syfir.”

Yftari i Profetit

Allahu lumturohet nga përkushtimi i besimtarit në rrugën e Tij, nga respekti dhe dashuria që ushqen ai për Të. Yftari është koha më e mirë, në të cilën shfaqet lidhja me Zotin dhe respekti ndaj Tij. Për këtë arsye, Profeti i kushtonte shumë rëndësi yftarit. Me të hyrë koha e yftarit, ai gëzohej si fëmijë, sepse e dinte që yftari gëzonte edhe Krijuesin e tij dhe besonte se yftari do të sillte begati. Një ditë ai tha: “Bashkësisë sime nuk do t’i mungojë

begatia dhe bollëku, përderisa ata të nxitojnë të çelin yftar sa më parë.

(Buhari, Savm, 45)

Ai këshillonte bërjen e duasë para yftarit, sepse plotësimi i saj ishte i sigurtë. Ai vetë bënte këtë dua: “Zoti im! Agjërova për hatrin Tënd. Po e çel yftarin që Ti më dhuron.” Pastaj çelte yftarin me hurma, kur i kishte, nëse i mungonin e çelte me ujë.



Bujaria e Profetit Muhamed

Në muajin e Ramazanit Profeti bëhej edhe më bujar. Ai bëhej edhe më bujar se erërat që frynin në tre muajt e madhërueshëm. Çdo gjë që i binte në dorë, e shpërndante. Nëse i kërkohej diçka që

e kishte, e jepte menjëherë; nëse nuk e kishte, e siguronte nëpërmjet të tjerëve. Kur e pyetën se cila është sadakaja më e pranueshme, ai tha: “Sadakaja që jepet në Ramazan.”



Adhurimi i Profetit në muajin e Ramazanit

Profeti i shtonte adhurimet nafile në muajin e Ramazanit. Ndër këto adhurime, më kryesori ishte namazi i teravisë.

Ai lexonte më shumë Kuran se herët e tjera, gjatë këtij muaji të adhurimit, të duave dhe dhikrit. Çdo natë të këtij muaji Profetin e vizitonte Xhebraili dhe së bashku ata të dy lexonin Kuran. Me përjashtim të Ramazanit të vitit të fundit të jetës së profetit Muhamed (a.s.), në të cilin Kuranin e lexuan dy herë nga fillimi deri në fund, në Ramazanet e viteve të tjera ata e lexuan Kuranin vetëm një herë.

Në ditët e fundit të Ramazanit, Profeti i shtonte edhe më shumë adhurimet dhe ibadetet. Mundësia që nata e Kadrit të ishte në 10 ditët e fundit të Ramazanit, e sidomos gjatë netëve të 25, 27 apo 29, e nxiste Profetin të qëndronte gjithë natën duke bërë ibadet me dëshirën që kjo natë të mos kalonte pa lënë gjurmë. Ai tha: “Kush fal namaz në natën e Kadrit duke besuar tek mirësia e saj dhe duke pritur shpërblimin vetëm nga Allahu (xh. sh.), do t’i falen të gjitha mëkatet.”

Në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Profeti hynte në itikaf. Ai falte namaz, bënte dua, dhikër dhe ibadetet të tjera. Të gjitha këto jepnin këtë mesazh: “Zoti im, erdha në portën Tëndë! Unë nuk lëviz prej këtu në qoftë se Ti nuk e pranon pendimin tim”.

M. Jashar Kandemir

Agjërimi dhe Kurani do të jenë ndërmjetësues për tek Zoti

Profeti ynë na tërheq vëmendjen mbi rëndësinë e leximit të Kuranit duke thënë:

“Agjërimi dhe leximi i Kuranit në muajin e Ramazanit do të jetë ndërmjetësues tek Zoti. Agjërimi do të thotë: “Zoti im! Robin tënd e largova nga ushqimi dhe nevojat fizike gjatë gjithë ditës. Pranoje ndërmjetësimin tim për robin tënd.”

Kurse Kurani do të thotë: “Unë robin tënd e lashë pa vënë gjumë në sy gjatë gjithë natës. Pranoje ndërmjetësimin tim për të.”

Ahmed b. Hanbel, Musned, VI, 188

Ramazani

Universi mbushë me nur
Për besimtarët provim,
Për çdo mumin (besimtarë)
Ramazani një muaj për agjërim

Preket shumë nefsi
Gjallërohesh shpirtërisht,
Njëri nga farzet (obligimet) e Islamit
Është Agjërimi i Ramazanit

Ramazani për myslimanët
Është muaji i Kuranit,
Është muaji i falënderimit,
I faljes dhe i udhëzimit

Në çdo qoshe e kënd
Veç lumturi e gaz,
Agjërimi për çdo mysliman
Është padyshim një farz.

Besimi është lumturi,
Islami është shpëtim,
Çdo çast në agjërim
Është vetëm adhurim.

Agjërimi të shpie drejt Zotit
Të bën t'i falesh shpirtin Atij,
O Zoti ynë i madh, neve
Na bën të arrijmë këtë mrekulli!

Enver TUNXHALI

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

A janë fjalitë e mëposhtme të sakta apo jo?

1. Agjërimi është një adhurim i rëndësishëm, i cili na ruan nga veprimet e këqija në këtë botë si dhe nga xhehenemi në botën tjetër. Gjithashtu ai është ndërmjetësues për faljen e gjynaheve tona. E SAKTË E GABUAR
2. Prishja e agjërimin, pa pasur ndonjë arsye objektive, detyron agjërimin kaza dhe kefaret. E SAKTË E GABUAR
3. Fidja është shuma monetare ose sasia në ushqim që japin besimtarët e thyer në moshë, që nuk mund të agjërojnë dhe të sëmuret që nuk shpresojnë në përmirësimin e gjendjes së tyre shëndetësore. E SAKTË E GABUAR
4. Agjërimi që ne kemi vendosur të mbajmë për hir të Zotit quhet kefaret. E SAKTË E GABUAR
5. Qëndrimin në xhami për një periudhë të caktuar, për të bërë ibadet, quhet yftar. E SAKTË E GABUAR
6. Libri ynë, Kurani, ka filluar të zbresë në muajin e Miraxhit. E SAKTË E GABUAR
7. Agjërimi prishet në rast se hahet ose pihet, qoftë edhe në harresë. E SAKTË E GABUAR
8. Me fjalët "Agjërimi është mburojë" Profeti (a.s.), thekson faktin se agjërimi na mbron nga veprat e këqija dhe nga gjynahet. E SAKTË E GABUAR

Të testojmë veten

1. Nga fjalitë e mëposhtme, cila prej tyre s'ka asnjë lidhje me Ramazanin?
 - a) Shkuarja në haxh.
 - b) Agjërimi
 - c) Fillimi i zbritjes së Kuranit.
 - d) Nata e Kadrit.
2. Cila nuk shënon përfitimet tona nga muaji i Ramazanit?
 - a) Me agjërim fitojmë dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut.
 - b) Duke agjëruar ndihmojmë të varfërit.
 - c) Agjërimi na mban larg punëve të këqija dhe mëkateve, si dhe larg dënimit të xhehenemit.
 - d) Agjërimi na mëson durimin.

3. Cili nga agjërimet e mëposhtme është vaxhib?
a) Agjërimi nafile b) Agjërimi i Muharremit
c) Agjërimi i zotimit d) Agjërimi i Ramazanit.
4. Si quhet koha ndërmjet mbarimit të natës dhe fillimit të sabahut?
a) Imsak b) Syfyr c) Yftar d) Itikaf
5. Cila nga këto veprime nuk e prish agjërimin?
a) Të hash diçka që nuk përdoret si material ushqimor.
b) Të kapërdish flok bore, kokërr breshëri apo pikë shiu.
c) Të kapërdish pështymën.
d) Kalimi i ujit të abdestit në fyt.
6. Cila nga arsyet e renditura më poshtë imponon agjërimin kaza?
a) Hyrja e ujit në vesh gjatë bërjes banjë.
b) Hyrja e pluhurit apo tymit në gojë pa dëshirën tënde.
c) Kërcënimi dhe detyrimi i prishjes së agjërimit.
d) Vjellja e agjëruarit në mënyrë të padëshiruar.
7. Cila është arsyeja kryesore e agjërimin të myslimanëve gjatë muajit të Ramazanit?
a) Kontrolli i egos.
b) Shëndeti.
c) Krijimi i raporteve sa më të mira me mjedisin ku jetojnë.
d) Zbatimi i urdhrin të Allahut.
8. Cila nga veprimet e mëposhtme nuk e prish agjërimin?
a) Çelja e yfarit pa hyrë akshami, duke pandehur hyrjen e tij.
b) Bërja banjë ose dush për t'u freskuar.
c) Përtpja e një thërrimeje në madhësinë e një qiqre të mbetur ndërmjet dhëmbëve.
d) Të kapërdish pa dashje ndonjë flok bore, kokërr breshëri apo pikë shiu.
9. Cilët nga këto shkaqe nuk konsiderohen objektive për prishjen e agjërimin?
a) Ardhja e mysafirëve në shtëpi.
b) Kërcënimi me vdekje ose plagosje.
c) Lufta me armikun.
d) Udhëtimi.

Plotësoni vendet bosh me fjalët që janë në kllapa:

1. **(Kadrit, mëshirë, falje, gjashtëdhjet e një, falje, kaza, zotim, shëndet, Rejjan)**
Ramazani është muaji, fillimi i të cilit është....., mesi i të cilit është..... dhe fundi i të cilit është mbrojtje nga zjarri i xhehenemit.
2. Agjëroni që të keni
3. Agjërimi kefaret zgjat zakonisht.....ditë
4. Personi, i cili ha ose pi diçka në rast harrese dhe pastaj mendon se iu prish agjërimi, duhet më vonë të mbajë agjërimin
5. Zotimi për të agjëruar një ditë për hir të Allahut quhet agjërimi i
6. Pejgamberi (a.s.) në natën e bënte këtë dua: Zoti im! Ti je shumë falës, e dëshiron faljen, mua!
7. Xheneti ka tetë dyer. Njëra prej tyre quhet Nga ajo derë do të hyjnë vetëm agjëruarit. Kjo derë do të mbyllet me hyrjen e agjëruarit të fundit. Dhe ata që hyjnë brenda do të qerasen me një pije shumë të mirë; Ata që do ta pinë, nuk do të ndiejnë etje kurrë.



ZEKATI



URA MES TE VARFERVE DHE TE PASURVE

- * Pronari i vërtetë i pasurisë është Allahu
- * Sadakaja dhe zekati
- * Përkufizimi i zekatit
- * Ç'përfitojmë nga zekati?
- * Nisabi i domosdoshëm për zekat dhe sasia e këtij të fundit.
- * Kujt i jepet zekati?
- * Kujt nuk i jepet zekati?
- * Çfarë duhet të kemi kujdes kur japim zekatin?
- * Bamirësia e Profetit tonë



PROVIMI I FALËNDERIMIT

Profeti Muhamed (a.s.) herë pas here shpjegonte ndonjë histori që kishte ndodhur në të kaluarën.

Njëra nga këto histori është edhe kjo...

Njëherë në mesin e hebrenjve jetonin tre persona. Njëri ishte lebros, tjetri qeros dhe tjetri i verbër. Allahu (xh.sh.) dëshiroi t'i vinte në provë, prandaj u dërgoi një engjell në formën e njeriut.

Engjëlli fillimisht shkoi tek njeriu lebros dhe e pyeti:

“Çfarë dëshiron më shumë se çdo gjë?”

Ai u përgjigj:

“Dëshiroj të kem një lëkurë të shëndetshme me ngjyrë të bukur dhe të shpëtoj nga kjo sëmundje që i largon njerëzit nga unë.”

Engjëlli ia fërkoj me dorë lëkurën të sëmurit. Menjëherë njollat që gjendeshin mbi të u zhdukën. Lëkura mori pamje krejt tjetër.

Engjëlli sërish e pyeti atë:

“Çfarë dëshiron tjetër të kesh në zotërim?”

Ai u përgjigj:

“Dëshiroj të kem një deve.”

Atëherë engjëlli i dhuroi një deve të mbarsur dhe i tha: Zoti të dhuroftë begati edhe më shumë!

Pastaj u nda nga ai.


Më vonë engjëlli shkoi tek qerosi dhe e pyeti:

“Çfarë dëshiron më shumë se çdo gjë?”

“Dëshiroj flokë të bukur dhe të shërohem nga kjo sëmundje për shkak të së cilës njerëzit më rrinë larg.”

Engjëlli ia fërkoj kokën dhe menjëherë sëmundja u zhduk. Burri ndryshoi krejtësisht. Tani ai kishte flokë të bukur dhe të dendur.

Engjëlli e pyeti sërish:



“Çfarë dëshiron më shumë të kesh në zotërim?”

Burri iu përgjigj:

“Dëshiroj të kem gjedhë.”

Pasi i dhuroi një lopë të mbarsur, engjëlli u përshëndet edhe me të duke i uruar mirësi e begati.

Pastaj erdhi tek i verbri. I bëri të njëjtat pyetje si dy të parëve. I tha:

“Çfarë dëshiron më shumë se çdo gjë?”

Ai u përgjigj:

“Dëshiroj kthimin e syve që të mund të shoh njerëzit.”

Engjëlli e pyeti sërish:

“Çfarë dëshiron tjetër të kesh më shumë?”

Ai u përgjigj:

“Dëshiroj të kem dele.”

Në çast engjëlli i dhuroi një dele të mbarsur. Me kalimin e kohës pasuria e këtyre njerëzve u shtua shumë. Njëri kishte një kope me deve, tjetri një kope me gjedhë, kurse i treti me dele.

Vite më vonë, engjëlli u shfaq përsëri, por kësaj here në formën e një njeriu lebroso.

Engjëlli i tha atij që kishte qenë lebroso:

“Unë jam një njeri i varfër. Nuk kam se me çfarë të vazhdoj udhëtimin tim. Mund të mbërrij atje për ku jam nisur vetëm me ndihmën e Zotit dhe përkrahjen tënde. Pashë Atë që të dhuroi këtë bukuri të lëkurës dhe këtë pasuri, ma fal një deve.

Ai u përgjigj:

“Nuk mundem. Kjo pasuri është e imja dhe e atyre që kanë nevojë më shumë sesa ti.”

Engjëlli ia ktheu:

“Unë sikur të njoh ty. A je ti ai i varfri prej të cilit njerëzit largoheshin për shkak të sëmundjes dhe Zoti të shëroi e të pasuroi?”

Burri e mohoi këtë të vërtetë dhe i tha:

“Po flet si tepër më duket. Këtë pasuri e kam trashëguar nga të parët e mi.”

Engjëlli i kujtoi:

“Nëse po gënjen, atëherë Allahu të ktheftë në gjendjen e mëparshme!”

Engjëlli vazhdoi rrugën. Mori formën e një qerosi. Takoi personin e dytë. I bëri të njëjtat pyetje si të parit, por qerosi ktheu të njëjtat përgjigje si lebroso.

Engjëlli së fundi i kujtoi:

“Nëse po gënjen, atëherë Allahu të ktheftë në gjendjen e mëparshme!”

Pasi mori formën e një njeriu të verbër, takoi personin e tretë. Engjëlli i tha:

“Unë jam një njeri i varfër. Nuk kam të holla për të vazhduar udhëtimin tim. Mund të arrij atje për ku jam nisur vetëm me ndihmën e Zotit dhe përkrahjen tënde. Pashë dashurinë e atij që të fali shikimin, ma fal një dele nga kopeja jote.

Burri në sytë e të cilit dukej besimi i fortë, i tha:

“Edhe unë isha i verbër si ti e Allahu m’i hapi sytë. Isha i varfër e Allahu më pasuroi. Merr sa të duash dhe lër çfarë të duash. Të betohem në të madhin Zot, se nuk të ndaloj të marrësh asgjë!”

Engjëlli i tha:

“Këto pasuri qofshin të gjitha tuat! Allahu qoftë i kënaqur prej teje!”

Ai i tregoi për sprovën me të cilën të tre njerëzit u ndeshën dhe për përgjigjet që dhanë. “Dy shokët e tu e humbën provimin, prandaj merituan dënimin e Zotit (xh.sh.)”, - tha dhe në çast u zhduk në horizont.

KUSH ESHTË PRONARI I VERTETË I PASURISË?

Islami i nxit njerëzit të punojnë dhe me fitimet e tyre hallall, të pasurohen. Por nuk duhet harruar se Ai që na i dhuron këto të mira është Allahu (xh. sh.), zotëruesi i vërtetë i pasurive tona. Ai na e lë amanet pasurinë për një periudhë të caktuar kohe dhe na provon nëse do ta harxhojmë ashtu siç dëshiron Ai. Nëse ne e shpenzojmë pasurinë që na është dhuruar ashtu siç dëshiron Allahu, duke ua shpërndarë njerëzve në nevojë, atëherë fitojmë provimin së bashku me kënaqësinë e Dhuruesit.

Allahu (xh.sh.) thotë:

Thuaj: "O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përul atë që do, e lartëson atë që do. Çdo e mirë është në dorën Tënde. Vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!"

(Al-i Imran 26)



SADAKAJA DHE ZEKATI

Në fenë tonë infak quhet shpenzimi i pasurisë për të fituar kënaqësinë e Allahut. Lloji më i mirë i infakut është sadakaja dhe zekati.

Ndihma monetare që një mysliman jep me dëshirën e tij quhet sadaka. Me fjalën sadaka kuptojmë ndihmën materiale që i dhurohet të varfërve ose nevojtarëve. Por, sadakaja nuk përbëhet vetëm nga dhurimi i vlerave materialo-financiare. Profeti (a.s.) thotë se çdo vepër e mirë është sadaka. Ai ka dhënë shumë shembuj të sadakasë prej të cilave mund të veçojmë:

- ◆ Të ndihmosh materialisht të varfrin është sadaka.
- ◆ Të ndihmosh borxhliun duke ia shtyrë afatin e pagesës është sadaka.
- ◆ Të këshillosh njerëzit për mirë e t'i ndalosh nga e keqja është sadaka.
- ◆ Të heqësh nga rruga ndonjë pengesë për kalimtarët është sadaka.
- ◆ T'i përshkruash dikujt ndonjë adresë ose rrugë është sadaka.
- ◆ Të ndihmosh dikë në ngarkimin e mjetit është sadaka.
- ◆ Të pajtosh dy njerëz është sadaka.
- ◆ "Të përkujtosh Zotin duke thënë Allahu ekber, Elhamdulilah, Lailahe il-lallah etj., është sadaka.
- ◆ Buzëqeshja është sadaka.
- ◆ Fjala e ëmbël është sadaka.



- ◆ Të marrësh dituri e ta shpërndash atë është sadaka.
- ◆ Çdo hap i hedhur për të shkuar në xhami ose mesxhid është sadaka.
- ◆ Mbjellja e pemëve është sadaka.
- ◆ Kontributet e një burri për të lumturuar familjen e tij është sadaka.
- ◆ Çfarëdo gjëje që një grua bën për të mirën e burrit dhe fëmijëve të saj është sadaka.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“O ju që keni besuar, para se të vijë një ditë kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësi, jepni nga ajo me çka Ne ju furnizuem ju. Pabesimtarët janë mizorë.”

(Bekare 254)

- Kryerja e një të mire ose ndihma që fëmija i ofron prindërve, vëllezërve dhe motrave të tij është sadaka.

Shkutimisht;

Çdo mirësi që bën një mysliman është sadaka. (Buhari, Edeb, 33).

Siç vërehet, në fenë tonë kuptimi i sadakasë është shumë i gjerë. Që një mysliman të mund të japë sadaka nuk është kusht që ai të jetë i pasur. Çdo mysliman mund të japë sadaka brenda mundësisë së tij nëpërmjet veprave të mira. Por infaku përfshin edhe një drejtim tjetër që është tërësisht i lidhur me anën ekonomike. Allahu e ka bërë farz për çdo mysliman të pasur që t'u jap pjesë nga pasuria e tij njerëzve në nevojë. Ky obligim i prerë, me natyrë krejtësisht ekonomike, që përbën edhe njërin nga shtyllat e Islamit, quhet zekat.

Një ditë Profeti (a.s.) tha:

“Për çdo mysliman dhënia e sadakasë është detyrim.”

Shokët e tij e pyetën:

“Po nëse ai nuk ka asgjë për të dhënë si sadaka?”

Ai u përgjigj:

“Atëherë le të punojë e të bëhet i vlefshëm për vete e për të tjerët; kështu mund të japë sadaka.”

“Po nëse s'mund të punojë ose nuk gjen dot punë?”

“Atëherë të ndihmojë njerëzit e mbetur në vështirësi.”


“Po nëse as këtë s'mund ta bëjë?”

“Atëherë le të këshillojë njerëzit për të bërë vepra të mira.”

“Nëse as këtë s'mund ta bëjë?”

“Atëherë, le të qëndrojë larg së keqes. Kjo për të është sadaka.”

(Buhari, Zekat 30)





ÇFARE ESHTË ZEKATI?

✍ **Zekati** është një pjesë e pasurisë së myslimanit që duhet të dorëzohet në përputhje me rregullat islame.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Kryeni faljen (namazin) dhe jepeni zekatin, e çfarëdo të mire që e përgatitni për veten tuaj; atë e gjeni te Allahu. S’ka dyshim Allahu përcjell çdo veprim tuajin.”

(Bekare 110)

Zekati është pastërti

Njëri nga kuptimet e fjalës “zekat” është pastërti. Dhënia e pasurisë njerëzve në nevojë është pastrim material dhe shpirtëror. Ai e pastron njeriun nga papastërtitë e koprracisë, gjynaheve dhe lakmisë për pasuri.

“Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe sheh.”

(Tevbe 103)


DOBITE E ZEKATIT

ZEKATI



- * Është shprehje falënderimi ndaj Allahut për pasurinë e dhuruar.
- * Kultivon ndjenjën e dhembshurisë, mëshirës dhe mirësisë.
- * Pastron pasurinë tonë.
- * Na ruan nga kopracia dhe egoizmi.
- * Zhvillon ndjenjën e dashurisë dhe solidaritetit ndërmjet njerëzve.
- * Shton pasurinë dhe bereqetin.
- * Ruan pasurinë tonë nga fatkeqësitë e ndryshme.

“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron. Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.”



Ne duhet të falënderojmë Allahun për pasurinë e dhuruar. Shpenzimi i saj siç dëshiron Ai është falënderimi më i mirë që bëhet. Ne e adhurojmë dhe e falënderojmë Allahun duke i dhënë një të katërtën e pasurisë njerëzve në nevojë. Nuk duhet të presim asnjë falënderim nga njerëzit për zekatin. Zekati ndihmon në shprehjen e falënderimit ndaj Zotit për pasurinë që na dhuron.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimet) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë vështirë. Po Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh.”

(Insan 8-11)

Të pasurit që kanë kushte më të mira jetese, mund të mos e dinë dhe kuptojnë gjendjen e të varfërve. Për të përcaktuar të varfrit që e meritojnë me të vërtetë zekatin, të pasurit interesohen nga afër për gjendjen e tyre. Kështu, të varfrit përfitojnë nga ndihma e të pasurve. Së fundi mund të themi se zekati kultivon ndjenjën e dhembshurisë, të mëshirës dhe të mirësisë.

Profeti a.s. thotë:

“Nëse dëshiron zbutjen e zemrës, ushqe të varfrit dhe përkëdhel kokën (ngrohe zemrën) e jetimit.”

(Ahmed b. Hanbel, II, 263)

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të varfrit. Pra, në pasurinë e të pasurit ka pjesë edhe i varfri. Nëse ne nuk i japim të varfërve pjesën që u takon nga pasuria jonë, atëherë ne bëhemi grabitës të pasurisë së tyre. Kjo do të thotë që pasuria jonë përzihet me haramin. Pasuria jonë e përzier me haramin është e papastër. Duke dhënë zekat ne parandalojmë përzierjen e pasurisë sonë me haramin. Prandaj themi se zekati pastron pasurinë tonë.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin), lëmshë që t’i pastros me të dhe t’u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht luto për ta, se lutja jote është qetësim për ta. Allahu dëgjon dhe sheh.”

(Teube 103)



Zekati dhe sadakaja ekuilibrojnë dashurinë tonë ndaj pasurisë. Ato pengojnë përdorimin e gabuar të saj. Na mësojnë se nuk është gjithçka të kesh para. Zekati bëhet shkak të përjetojmë lumturinë e ndarjes me të tjerët të gjërave që kemi. Zekati na ruan nga koprancia dhe egoizmi. Nëpërmjet tij ne mendojmë edhe për të tjerët duke sakrifikuar për to edhe pasurinë, gjënë më të dashur.

Profeti ynë i dashur thotë:

“Është i mbrojtur nga koprancia ai që jep zekatin, ai që shpreh bujari ndaj mysafirëve dhe ai që ndihmon njerëzit fatkeqë”

(Taberani, Mu'xhemu'l-Kebir, IV, 256)

Zekati është ura nëpërmjet së cilës pasuria e të pasurve arrin tek të varfrit. Rrit komunikimin, dashurinë e solidaritetin dhe zhduk xhelozitë, ndërmjet tyre. Të pasurit tregojnë dhembshuri dhe mëshirë ndaj të varfërve, kurse të varfrit shprehin respekt dhe mirënjohje ndaj tyre. Në shoqëri zhvillohen vlerat e solidaritetit, ndihmës së ndërsjellë dhe mirëkuptimit. Kështu zekati plotëson nevojat e të varfërve dhe pengon lindjen e problemeve të ndryshme shqetësuese në shoqëri.

Profeti ynë i dashur thotë:

“Zekati është ura e Islamit.”

(Hejthemi, Mexhmauz-zevaid. 1, 480)

Zekati dhe sadakaja ruajnë pasurinë nga rreziqet dhe fatkeqësitë. Këtë të vërtetë e hasim edhe tek fjala e urtë popullore: “Vetëm pak lëmoshë do të mjaftonte për të mbajtur larg rreziqet”, sepse të ngrohësh shpirtin e një të varfri dhe të marrësh duanë e tij, do të thotë të largosh të gjitha fatkeqësitë dhe rreziqet. Mbi atë që jep zekat zbret mëshira dhe mbrojtja e Allahut (xh.sh.).

Profeti ynë i dashur thotë:

“Ruajini pasuritë tuaja me zekatë”


(Bejhaki, Shuabu'l-iman, V, 184)

Zekati shton dhe begaton pasurinë tonë. Allahu në lidhje me këtë në Kuran thotë: “Ndërsa atë që e jepni si dhuratë me mendjen që ajo mund t’ju shtojë (pasurinë duke pritur t’ju kthehet një dhuratë më e mirë) nga pasuria e njerëzve të tjerë, - nuk ka shtesë tek Allahu, kurse ajo që e jepni si zekat duke kërkuar Fytyrën e Allahut. Këta janë ata që do të kenë rritje shumëfish”. (Rrum, 39). Në themelin e kësaj rritjeje është lumturia që zekati dhe sadakaja u dhurojnë të varfërve dhe duatë e melekëve. Duatë e melekëve, nevojtarëve dhe të varfërve janë një burim i brendshëm qetësie për të pasurit që japin zekatin.

Profeti ynë i dashur thotë:

“Çdo mëngjes zbresin dy melekë. Njëri prej tyre bën dua: “Zoti im! Shtojë pasurinë e atyre myslimanëve që e harxhojnë atë në rrugën Tënde”. Kurse meleku tjetër thotë: “Zoti im! Zhduke pasurinë e atyre myslimanëve që janë koprracë.”

(Muslim, Zekat, 57)



KA QË JEP EDHE MË SHUMË SE JU!

Në kohën e hilafetit të Ebu Bekrit, në Medine, në një periudhë të caktuar kohe, mbizotëroi skamja. Njerëzit nuk gjenin asnjë kokërr grurë për të bërë bukë. Duke parë gjendjen e popullit, tregtarët e Medines i kishin derdhur të gjitha paratë e tyre për të blerë grurë. Hazreti Osmani kishte dërguar një karvan me deve në Sham për tregti dhe me të solli 100 deve të ngarkuara me grurë. Gruri që pruri Osmani plotësonte deri diku nevojat e popullit, sepse popullsia e Medinës ishte e vogël në atë kohë.

Disa tregtarë shkuan tek Osmani dhe kërkuan prej tij blerjen e grurit. Ata jepnin katër dërhëm për një masë të caktuar gruri. Por Osmanit iu duk pak vlerësimi që tregtarët i bënë grurit. Ai tha: “Ka që jep edhe më shumë se ju”.

Ai nuk dëshiroi t’ia shiste grurin askujt. Ndërkohë tregtarët e rritën çmimin e blerjes së grurit, por sërish Osmani i tha atyre: “Ka që jep edhe më shumë se ju”. Ato ishin gati të jepnin edhe shtatë dërhëm për një masë të caktuar gruri. Ky ishte edhe çmimi më i shtrenjtë i mundshëm i grurit. Kurse nga goja

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Të cilët japin kur janë sh lirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.”

(Al-i İmran 134)

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.”

(Bekare 261)

e Osmanit dilte vetëm shprehja: “Ka që jep edhe më shumë se ju”. Disa tregtarë kishin filluar të mendonin se Osmani po shfrytëzonte rastin për të përfutuar materialisht edhe më shumë. Nuk mendonin se Osmanit i kishte hije ky veprim, ndërkohë që populli po vuante nga uria.



Së fundi ata vendosën të shkonin tek halifja për t'ia shpjeguar situatën. Ato do të kërkonin nga halifja t'i jepte zgjidhje këtij problemi.

Dolën para halifes dhe ia shpjeguan çështjen. Ebu Bekri i dëgjoi deri në fund dhe u tha:

“Kjo punë më duket shumë e çuditshme! Më duket se ju nuk i paskeni kuptuar mirë fjalët e Osmanit! Ai është dhëndri dhe shoku i Profetit në xhenet. Nuk është prej atyre që përfiton në kurriz të të tjerëve. Nëse ka vepruar siç më thatë, me siguri do të ketë një urtësi. Ejani të shkojmë dhe ta sqarojmë këtë temë direkt me të!”

Të gjithë së bashku shkuan tek Osmani. Ebu Bekri e pyeti Osmanin:


- “Pse nuk ia ke shitur grurin tregtarëve në çmimin e kërkuar?”

Osmani iu përgjigj Ebu Bekrit me një zgjuarsi shumë të hollë:

“O Mëkëmbësi i Profetit! Këta tregtarë duan ta blejnë një masë gruri me shtatë dërhem. Pra, këta japin shtatë për një. Por unë dëshiroj që këtë grurë t'ia shes Atij që më jep shtatëqind për një. A nuk premtom Allahu shpërblimin e një vepre të mirë deri në shtatëqind fish? Duke pasur mundësi tregtimi me një leverdi kaq të madhe, pse duhet t'ia shes mallin tim këtyre tregtarëve?”

Pas kësaj përgjigjeje tregtarët filluan të mendonin. Ato e kuptuan se sa gabim e kishin pasur, kur kishin menduar keq për Osmanin.

Osmani ia shpërndau të gjithë grurin si sadaka popullit të tij. Me këtë i ktheu buzëqeshjen të varfërvë dhe jetimëve. Kështu skamja në qytet u lehtësua, në saje të Osmanit dhe vizionit të tij.



Për kë është farz zekati?

Çdo mysliman që

- * gëzon një shëndet të mirë mendor
- * ka mbërritur moshën e pjekurisë.
- * sipas Islamit konsiderohet i pasur. (Ai që zotëron pasuri në nivelin e nisabit.)

e ka farz dhënien e zekatit
😊😊😊😊

një herë në vit.

Cilat janë parametrat e të qenit i pasur në pikëpamje të Islamit.

Sipas fesë Islame, i pasur konsiderohet ai që zotëron pasuri në nivelin e nisabit duke përjashtuar nevojat e tij themelore dhe borxhet.

Nisabi është kufiri i poshtëm i pasurisë. Ai që me pasurinë e tij arrin këtë kufi është i obliguar të presë kurban dhe të japë sadaka-i fitër. Zekati bëhet farz kur pasuria e një myslimani arrin vlerën e nisabit dhe qëndron në gjendje gjatë një viti hënor.

Cilat nevoja konsiderohen themelore ose bazike?


Nevoja themelore konsiderohen:


- ➔ Shtëpia.
- ➔ Sendet shtëpiake.
- ➔ Rrobat
- ➔ Mjetet e ngarkesës.
- ➔ Librat.
- ➔ Mjetet e nevojshme për profesionin.
- ➔ Shpenzimet e jetesës së një viti të familjes.

Me kusht që të mos përdoren për tregti.



Nisabi i mallrave për të cilat jepet zekati dhe sasia e zekatit

 Dhënia e zekatit është farz për atë që në pikëpamje islame konsiderohet i pasur dhe që zotëron pasuri në sasinë e nisabit për një vit.

 Sasia e nisabit llogaritet përtej nevojave themelore dhe borxheve.

 Nisabi dhe sasia e zekatit ndryshon në varësi të pasurisë.

Zekati dhe nisabi i mallrave tregtar

Lloji i mallit	Sasia e nisabit	Sasia e zekatit që duhet dhanë:
Ar	80,18 gram	<p>Një e dyzeta (2,5 përqind) % 2,5</p>
Argjend	561 gram	
Pasuri tregtie	80,18 gram në vlerën e arit	
Para kesh	80,18 gram në vlerën e arit	



Nisabi dhe zekati i kafshëve

Sasia e zekatit që jepet për kafshët lidhet me llojin dhe numrin e kafshëve:

- * **Desh dhe cjpë:** Zekati për 40-120 desh ose cjpë është 1 cjac ose 1 dash.
- * **Gjedhë:** Zekati për 30-39 gjedhë (duke përfshirë edhe 39-ën) është 1 viç.

- * **Deve:** Zekati i 5-9 deveve (duke përfshirë edhe 9) është një dash ose një cjac.

Njohuritë e tjera në lidhje me zekatin e kafshëve të mësipërme, kur ato janë në sasi të tjera mund t'i merrni në ilmi Hale të ndryshme.





Nisabi dhe zekati i prodhimeve bujqësore

- ❖ Nisabi i prodhimeve bujqësore është 610 kg.
- ❖ Zekati i prodhimeve që sigurohen nga një tokë që nuk ka shpenzime ujitjeje është 1 e 10-ta (10%).
- ❖ Zekati i prodhimeve që sigurohen nga një tokë me shpenzime të larta ujitjeje është 1 e 20-ta (5%).
- ✍ Zekati jepet për të gjitha prodhimet bujqësore, si: grurë, elb, mel, panxhar, pjepër, bostan, oriz, patëllxhan, ulli, mollë, portokall, qersh, pjeshkë, zarzavate të ndryshme, etj.
- ✍ Për prodhimet bujqësore nuk është kusht që ato të qëndrojnë një vit. Zekati i prodhimeve bujqësore jepet menjëherë pasi të mblidhet nga parcela.

“Fara e zbraz hambarin e bujkut, por kur vjen koha e të vjelave, mendo sa herë më tepër i rikthehet atij!

Sa hambarë të mbushur dëng përfiton ai në këmbim të një hambari me farë!

Po që se gruri nuk mbillet dhe nuk përdoret si duhet, por ruhet brenda në hambar, ai do të kthehet në ushqim për morrat, krimbat dhe minjtë.”

(Mevlana)

KOPSHTI I SHKRETUAR

Njëherë e një kohë një burrë bujar zotëronte një kopsht me rrush dhe hurma. Ai besonte dhe zbatonte me përpikmëri urdhrat e Allahut (xh.sh.). Në kohën e të vjelave ai jepte rregullisht zekatin. Me vdekjen e tij, trashëgimia e kopshtit i kaloi pasardhësve të tij, të cilët ishin shumë të dhënë mbas botës materiale. Kjo gjë ia shtonte atyre koprracinë në zemër.

Zekati që u shpërndante bujarisht babai i tyre të varfërve, ia shtonte pasurinë dhe begatinë kopshtit. Të gjithë përfitonin nga ai. Mirëpo me kalimin e kohës, kur pronarët e këtij kopshti u bënë fëmijët, situata filloi të ndryshonte. Atyre sasia e zekatit u dukej shumë e madhe. Kujtonin se zekati e pakëson pasurinë. Etja e madhe për pasuri i verboi aq shumë, sa nuk arrinin të kuptonin burimin e bereqetit dhe begatisë së kopshtit të tyre.

Ato filluan të nxirrnin pretekste për të mos dhënë zekat:

“Familja jonë është zgjeruar shumë. Kurse pasuria jonë është pamjaftueshme. Le të dalim nesër herët në mëngjes dhe të mbledhim të mbjellat tona. Të varfërve mos t’i japim më nga pasuria jonë!”

Ato kishin harruar se pronari i vërtetë i pasurisë ishte Allahu. Gjithashtu harruan pjesën e

të varfërve në pasurinë e tyre...

Kur po flinin, ia behu dënimi i Allahut. Në kopshtin e tyre, papritmas, u hap një zjarr i madh dhe të gjitha prodhimet e tyre u bënë shkumb e hi.

Në mëngjes u zgjuan të lumtur dhe të painformuar për çfarë kishte ndodhur në mbrëmjen e kaluar.

Tek ecnin, i pëshpëritnin njeri-tjetrit:

“Mos lejoni të vijmë sot të varfrit dhe fukarenjtë! Mos i lejoni të hyjnë në kopshtin tonë.”

Kur mbërritën në kopsht, nuk i besuan syve. Ata thanë:

“Mos kemi ngatërruar rrugën?! Ku jemi këtu?!”. Panë përreth mirë. Ky ishte vendi ku ata kishin pasur kopshtet e tyre, por ato nuk ishin më aty. Aty, çdo gjë ishte bërë shkumb e hi.

Më i zgjuari i tyre tha:

- Jo, jo! Nuk kemi ardhur gabim! Kjo është toka jonë. Ne kishim vendosur të mos i ndihmonim të varfrit, Allahu prandaj na dënoi kështu.

Në fytyrat e tyre lexohej një mërzi e madhe. Çfarë planesh kishin bërë në mbrëmje e çfarë i kishte gjetur në mëngjes! Filluan të bënin shamatë duke fajësuar njeri-tjetrin: “Mendimin e keq për të mos ndihmuar fukarenjtë e ke dhënë ti i pari.”

Më i zgjuari i vëllezërve tha:


- O vëllezërit e mi të dashur! Mos të fajësojmë njëri-tjetrin kot së koti, por të kërkojmë falje tek Allahu. Ndoshta Ai me mëshirën e tij na fal dhe na mëshiron!

Ata e kuptuan më në fund gabimin. Kuptuan gjithashtu se pronari i vërtetë i pasurisë është Allahu (xh.sh.) dhe se pasuria duhet përdorur ashtu siç dëshiron Ai. Harxhimi i pasurisë sipas urdhrave të Allahut e shton

dhe e begaton atë. Nëpërmjet saj fitohet edhe xheneti. Duke kërkuar falje nga Zoti, thanë:

- Sa turp për ne! Ne paskemi bërë një gabim të madh! Gjithçka erdhi vetëm nga të metat tona! Kurse Zoti është larg të metave e gabimeve! Atëherë t'i drejtohem Allahut plot shpresë. Edhe në qoftë se Allahu na e merr tokën për shkak të gabimeve tona, Ai na dhuron një më të mirë se ajo, nëse i drejtohem me lutje vetëm Atij. Ne kërkojmë me këmbëngulje mëshirën e Tij dhe vetëm Atij i drejtohem.

(ajetet që lidhen me temën janë: Surja Kalem, ajetet 17-33)



KUJT I JEPET ZEKATI?

Zekati mund t'i jepet:

☞ **Të varfërve:**

Konsiderohen ata individë që sipas Islamit nuk janë të pasur. Pra, njerëzit me pasuri nën nivelin e nisabit.

☞ **Të vobektëve:**

Konsiderohen ata individë të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë as nevojat e tyre themelore.

☞ **Borxhlinjve:**

Konsiderohen ata individë që po të shlyenin borxhin me pasurinë e tyre do të varfëroheshin krejtësisht. Këtyre u jepet zekati, kur sigurisht pasuria e tyre nuk e arrin nisabin.

☞ **Udhëtarëve:**

Konsiderohen ata individë që kanë mbetur pa lekë gjatë udhëtimit. Këtyre mund t'u jepet zekat sa për të mbërritur në shtëpinë e tyre. Udhëtarët e tillë, me pasuri të mjaftueshme për të plotësuar nevojat, është më mirë të marrin borxh.

☞ **Luftëtarëve në rrugën e Zotit:**

Konsiderohen ata individë që dëshirojnë të marrin pjesë në një luftë të drejtë, por nuk i kanë mundësitë ekonomike për ushqim, armë, etj. Këtyre mund t'u jepet zekati për të plotësuar këto nevoja. Në këtë grup përfshihen edhe ato që i janë përkushtuar tërësisht diturisë dhe luftën e tyre e bëjnë me pendë.

☞ Në Kuran përmenden edhe tre grupe të tjera që përfitojnë zekat. Ato janë skllëverit, të dobëtit në besim dhe mbledhësit e zekatit.

☞ Ne mund t'ia japim zekatin tërësisht një personi që bën pjesë në njërin nga grupet e mësipërme ose mund t'ia ndajmë disa njerëzve që përfshihen në grupe të ndryshme.

☞ Është më mirë që shpërndarja e zekatit të fillojë nga të afërmit.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por, nuk lyp).”

(Dharijat 19)

Allahu (xh.sh.) thotë:

Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e Allahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, Allahu është Bujar i Madh, i di qëllimet.

(Bekare 261)

KUJT NUK I JEPET ZEKATI?


Zekati nuk i jepet



- ⊗ Të pasurve.
- ⊗ Atyre që nuk janë myslimanë.
- ⊗ Atyre që e kemi për detyrë t'u shërbejmë gjithmonë (nënës, babasë, gjyshes, gjyshit, fëmijët dhe nipërve dhe mbesave).
- ⊗ Vendeve, si: shkollë, spital, rrugë, xhami, urë.

⊗ Bashkëshortët nuk mund t'i japin njëri-tjetrit zekatin.

☑ Zekati mund t'i jepet vëllait, motrës, xhaxhait, dajës, hallës, tezes, nipit si dhe mbesës.



TË JAPIM NGA ATO QË DUAM

Ebu Talhaja ishte njëri nga të pasurit e Medinës dhe njëri nga shokët më me prestigj të profetit Muhamed. Ai kishte shumë ara, vreshta, kopshte dhe kafshë. Kishte edhe një kopsht afër Mesxhidi Nebevisë që ishte edhe më i kushtueshmi. Ebu Talhaja e donte shumë këtë kopsht hurmash që kishte edhe një pus me ujë, mjaltë të ëmbël. Ai e fronte shpesh profetin së bashku me shokët e tij në këtë kopsht dhe e qeraste me kënaqësinë më të madhe. Në hijen e pemëve bëheshin biseda të ëmbla.

Një ditë profeti Muhamed (a.s.) po bisedonte me shokët në mesxhidin e tij. Gjatë bisedës, ai përmendi ajetin:

“Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë me besim (as kënaqësinë e lumtur në xhennet), derisa të mos e jepni më të dhembshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj. Çkado që jepni (për Zotin), Allahu atë e di.” (Ali Imran, 92)

Ebu Talhaja u ndikua shumë nga ajeti që Profeti lexoi dhe i emocionuar, tha:

“O i dërguari i Allahut! Ajo që është më e dashur për mua nga pasuria ime është kopshti përballë këtij mesxhidi. Që në këtë moment ia jap atë njerëzve në

nevojë. Le të përfitojnë të varfrit nga uji dhe nga frutat e tij.”

Pastaj Ubu Talha shkoi tek kopshti për ta bërë të vërtetë fjalën e tij. Kur mbërriti atje, vërejti bashkëshorten e tij, Ummu Sulejmi tek rrinte në hijen e një peme. Ai kërkoi prej saj ta braktiste kopshtin e tyre. Ajo e pyeti Ebu Talhanë:

“- O Ebu Talha! Përse duhet ta braktisim kopshtin tonë? A do të shkojmë diku tjetër?”

Ebu Talhaja iu përgjigj:

“- Jo, nuk do të shkojmë askund. Por ky kopsht nuk është më i yni, por i të varfërve të Medinës dhe pastaj ia shpjegoi ngjarjen që ndodhi në mesxhidin e Profetit.”

Ajo sërish e pyeti:

“- A e dhurove në emrin e të dyve ne, apo vetëm tëndin?”

Ai iu përgjigj:

“- Në emër të të dyve....”

Ummu Sulejme bëri për të një lutje duke thënë:

“Zoti qoftë i kënaqur me ty, o Talha! Sa herë që shihja të varfrit përreth nesh kam menduar të njëjtën gjë, por nuk kam pasur guxim ta thoja. Allahu e pranofitë këtë bamirësi prej nesh!



Halifi i njohur, Omer bin Abdulaziz blinte së tepërmi karamete dhe ia ndante vazhdimisht të varfërve.

Një ditë shokët e tij të dashur e pyetën:

“- Pse në vend të karameteve, nuk u jep para të varfërve?”

Ai u përgjigj:

“- Unë i pëlqej shumë karametet. Dëshiroj të dhuroj diçka nga ajo që dua.”



ÇFARË DUHET TË KEMI KUJDES GJATË DHËNIES SË ZEKATIT?


Kur japim zekatin duhet të sillemi me mëshirë.

Ne duhet ta japim zekatin dhe sadakanë me shumë dhembshuri e mëshirë dhe duke e vënë veten në vendin e të varfrit.



Gjatë dhënies së zekatit nuk duhet të harrojmë se jemi duke kryer një obligim fetar.

Kur jemi duke dhënë zekatin, nuk duhet ta heqim nga mendja faktin se jemi duke kryer një obligim fetar, pra jemi duke bërë ibadet. Ne duhet t'u jemi mirënjohës të varfërve, sepse ato mundësojnë kryerjen e këtij obligimi fetar si dhe fitimin e mirësive dhe kënaqësive shpirtërore që sjell kryerja e këtij adhurimi.



Gjatë dhënies së zekatit duhet të sillemi me edukatë.

Nuk duhet të harrojmë se ne japim zekatin për të fituar kënaqësinë e Allahut (xh.sh.). Ashtu sikurse kujdesemi për paketimin dhe politesën, kur i dhurojmë dikujt diçka ashtu duhet të kujdesemi edhe në dhënien e zekatit. Mos ta kursejmë buzëqeshjen dhe mirësjelljen ndaj atyre që i japim zekatë.

Nuk duhet të presim përfitime të tjera nga dhënia e zekatit, përveçse dashurisë Hyjnore. Kur të japim zekatin, nuk duhet ta lëndojmë atë që e merr, duke i thënë: "Kjo shumë është zekati im për ty". Sepse e rëndësishme është arritja e zekatit tek nevojtari, ndërsa informimi i tij për këtë nuk është i rëndësishëm.



"Mua më pëlqen dhurata e dhënë me buzëqeshje dhe e paketuar bukur."



Allahu (xh.sh.) thotë:

"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që ia jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk beson Allahun dhe botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar bmi të cilin ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. Allahu nuk udhëzon popullin pabesimtar."

(Bekare 264)

Ne duhet t'i kërkojmë mirë nevojtarët e vërtetë

Që zekati të jetë i vlefshëm duhet që përfituesi i tij të jetë vërtet nevojtar. E rëndësishme nuk është nxjerrja e lekut nga xhepi, por mbërritja e tij në vendin e vet, sepse shtylla themelore e zekatit është dhurimi i tij njerëzve vërtet në nevojë. Nëse zekati jepet pa i vënë rëndësi këtij fakti, atëherë zekati nuk pranohet dhe duhet ridhënë edhe një herë.

Në mënyrë të veçantë, duhen kërkuar ato njerëz që janë të varfër dhe që kanë turp ta thonë këtë. Këta janë pikërisht të varfrit, të cilëve obligohemi t'ua japim zekatin.

"Si mund t'i gjej të varfrit e vërtetë?"



Profeti ynë i dashur thotë:

"Nuk është i varfër ai që del derë më derë duke lypur ndonjë kafshatë bukë a ndonjë hurm. I varfër i vërtetë është vetëm ai që nuk zotëron të ardhurat e mjaftueshme për veten e tij dhe, edhe pse njihet si i tillë, nuk i dhurohet sadaka, megjithatë ai nuk i lyp gjë askujt."

(Buhari, Zekat 53)

TE JETOSH ME MUNDIA E KRAHEVE ESHTË ME MIRE SESA TE LYPESH.



Profeti ynë nuk e pëlqente lypjen. Ai u thoshte shokëve të tij: "Shumë më e mirë se të lypësh, është të dalësh me një litar, për të mbajtur disa racione dru, që të vetsigurosh jetesën, në mënyrë që Allahu të të ruajë nderin dhe të të mbajë larg përgjërimeve drejtuar të tjerëve."

(Buhari, Zekat, 53)



Profeti ynë (a.s.) thotë:

"Dora që jep, është më e mirë se dora që merr."

(Buhari, Zekat, 18)



Një ditë, tek profeti erdhi një njeri dhe kërkoi sadaka prej tij. Pejgamberi e pyeti:

- "A keni ndonjë gjë në shtëpi?"

Burri i tha:

- "Kam një mbulesë në gjysmën e së cilës shtrihem e me pjesën tjetër që mbetet mbulohem. Përveç kësaj kam edhe një gotë me të cilën pi ujë."

Pejgamberi e urdhëroi:

- "Çohu në këmbë, dhe më sill gjërat që përmend!"

Burri u çua, i mori ato dhe i pruri tek Profeti Muhamed (a.s.). Profeti i mori sendet në dorë dhe pyeti të pranishmit:

- "A dëshiron kush t'i blejë këto?"

Njëri nga të pranishmit tha:

- "Unë mund të jap për to një dirhem"

Profeti sërish pyeti:

- "A dëshiron kush të japë për këto sende më shumë se kaq?"

Pas pyetjes u dëgjua një zë:

- "Unë mund ta blej atë dy dirhem"

Profeti në çast ia shiti këto sende këtij të fundit. Pastaj dirhemët ia dha të zotit dhe i tha:

- "Me njërin nga këto dy dirhem bleji ushqim fëmijëve, kurse me tjetrin blej një litar për të mbartur disa racione drunjsh për të siguruar të ardhurat e jetesës."

Burri bëri siç i tha profeti dhe, kur erdhi pas pesëmbëdhjetë ditësh i tregoi atij për punën që kishte bërë dhe se kishte fituar dhjetë dirhem. Me disa prej tyre kishte blerë rroba e me disa prej tyre kishte blerë ushqime. Profeti, pasi e dëgjoi, i tha:

- "A është më mirë të jetosh me djersën e ballit, apo të dalësh me njollën e lysarit para Allahut në kijamet (xh.sh.)"

(Ebu Davud, Zekat, 26)



BUJARIA DHE BAMIRESIA E PROFETIT MUHAMED (A.S.)

Një nga karakteristikat më të mëdha të profetit tonë Muhamed (a.s.) ka qënë edhe bamirësia, zgjidhja e nevojave të njerëzve dhe përkujdesja ndaj të varfërve. Në qoftë se dikush kishte ndonjë vështirësi materiale, vraponte drejt Profetit për të qarë hallin që kishte. Profeti nga ana e tij përpiquej t'ia plotësonte dëshirat të gjithëve duke mos i kthyer asnjëherë njerëzit që i kërkonin ndihmë. Ai nuk e kishte zakon asnjëherë të thoshte: - "Nuk kam". U jepte edhe nga ato pak gjëra që kishte. Në rastet kur nuk kishte çfarë t'ua dhuronte, mendohej t'ua fitonte zemrat.

Profeti Muhamed (a.s.) qe njeriu më bujar. Ai nuk e nxirrte asnjëherë prej mendjes faktin që zotëruesi i vërtetë i të mirave materiale në këtë botë është Allahu (xh.sh.). Ai mendonte më


shumë për t'ua zgjidhur hallet nevojtarëve e të varfërve dhe për të ushqyer të uriturit, sesa për nevojat vetjake të përditshme.

Ndihmonte njerëzit që i kërkonin hua dhe ndodhte që të mos ua merrte atyre borxhet.

Si rezultat i bujarisë ai nuk harronte t'ua bën-te dhurata të ndryshme njerëzve që i donte. Ai i këshillonte përherë myslimanët që të këmbenin dhurata me njëri-tjetrin duke u thënë: "Bëjini njëri-tjetrit dhurata në mënyrë që të shtohet miqësia dhe dashuria mes jush". Vetë ai personalisht i gëzonte zemrat e shokëve dhe miqve të tij duke u bërë atyre dhurata të ndryshme. Dhuratat që i bëheshin i pranonte me kënaqësi, dhe përpiquej që t'ia kthente me dhurata më të vyera. Ka ngjarë që sendin që e blinte t'ia kthente pas shitësit si dhuratë. Një herë prej herësh ai bleu devenë e Xhabir bin Abdullahut që kishte probleme materiale dhe pastaj ia ktheu devenë sërish mbrapsht në formë dhurate.

Profeti ynë i dashur, Muhamedi (a.s.) i ftonte myslimanët që të tregoheshin bujarë dhe të përpiqeshin t'ua ndihmonin të tjerët që kishin probleme ekonomike. Me këto fjalë ai na mësonte se sa e pëlqen Allahu (xh.sh.) këtë sjellje tek njerëzit:

"Njeriu që plotëson nevojat e një myslimani nga bashkësia ime fiton kënaqësinë time. Ai me



të cilin unë mbetem i kënaqur e ka kënaqur njëkohësisht edhe Allahun (xh.sh.). Allahu e vendos në xhenet njeriun që ka arritur ta fitojë kënaqësinë e Tij.”

Profeti na jep lajmin e mirë se njerëzit bamiresh do të fitojnë lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërsa koprracët do të jenë të palumtur në të dy botët. Ai shprehej kështu duke na mësuar se bujaria e afron njeriun me radhë me Allahun, parajsën dhe njerëzit e tjerë:

“Njeriu bujar është i afërt me Allahun, afër me xhenetin dhe me njerëzit. Koprraci është i larguar nga Allahu, larg xhenetit e njerëzve dhe afër xhehenemit.”

Kjo që bujaria e profetit tonë të dashur, Muhamedit (a.s.) zemra e të cilit që e mbushur me dashuri, dhembshuri dhe ndihmë për njeriun. Ai parapëlqente të shkonte një jetë të thjeshtë edhe atëherë kur zotëronte mundësi materiale dhe financiare.



Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Vetëm njërin nga këta dy persona duhet t’i keni zili. Njeriun që e shpenzon dhe konsumon pasurinë që ia ka dhënë Allahu në rrugën e drejtë dhe njeriun që gjykon drejt saktë me dituritë që ia ka dhuruar Allahu dhe ua mëson ato që di edhe njerëzve të tjerë.”

(Buhari, Ilm 15)



Një ditë prej ditësh një nga gratë myslimane erdhi tek profeti Muhamed dhe i dhuroi atij një rrobë që ajo e kishte thurur me duart e saja. Profeti që e kishte të nevojshme një rrobë të tillë e mori me vete atë dhe shkoi në shtëpi. Pasi e veshi rrobën e re u kthye në xhami. Një nga shokët e tij e pëlqeu shumë atë veshje dhe duke guxuar ngaqë e dinte se profeti ynë që bujar i tha atij:

“O i dërguari i Allahut! Sa veshje e bukur që qenka kjo! A nuk ma kishe dhuruar mua?”

Megjithëse nuk kishte ndonjë veshje tjetër të tillë profeti ynë i dashur nuk ia ktheu mbrapsht dëshirën shokut të tij, por e hoqi rrobën dhe ia dhuroi atij.

Shokët e tjerë i thanë kështu personit që ia kërkoi rrobën profetit:

- Përse ia kërkove këtë rrobë profetit? Ti e di se profeti ka nevojë për të veshur një rrobë si ajo. A nuk e dije se ai nuk e kthen duarbosh njeriun që i kërkon diçka atij?

Ai u përgjigj me këto fjalë atyre:

- Unë nuk ia kërkova atë rrobë për ta veshur, por për ta bërë qefin për vete kur të vdes.

Dhe me të vërtetë, kur vdiq, atij sahabi ia veshën rrobën që ia kishte dhuruar profeti Muhamed (a.s.) në vend të qefinit.

(Buhari, Edeb, 39; Xhenaiz, 29)



GATI PER TE TETE PARAJSAT



Të të mëshirojnë ke nevojë dhe ti, o mik,
Në degë të trëndafilit bëhu vesë, jo gjemb.
Këdo që do ta shohësh krahëthyer
Bëhu melhem për plagën, pa e lënduar.

Ka duar që nuk kanë mbajtur shami të panjomur
Ka gjuhë që nuk u shpjegojnë ç'kanë hequr vallë!
Sa e sa njerëz të varfër dhe të ngratë
Ka kush i gëzon ata, prandaj ji fisnik!

Ji vetëdija për jetimin, fryma për bonjakun,
Shesho udhën tatëpijetës kur ngjit,
Me praninë tënde bëhu melhem
fytirës së përcëlluar nga diell'i skamësisë.

Jeta në këtë botë, pa zgjidhje mbushur plot,
Ndokush nuk ka as një grosh as torbë,
Tjetrit nuk ka një krah, ai tjetri as këmbë,
Bëhu i dhimbshëm o shpirt, bëhu njeri bujar!

Çdokush që gëlltit farmakun e kopracisë
Në fyt ka për t'i mbetur nga ah-u! i vegjëlisë,
Qytet dhe fshat shëtit, ngado që të shkosh e vish,
Të uriturit bëju ushqim, të eturit ujë!

O vëlla, të mirën që bëre hidhe në det
Edhe gur në iu duktë peshqëve syvëngër,
Të mjafton veç Zoti, të fshehtën ruan për çdo moment,
Bëhu fisnik, të tetat të presin ty xhenetet!

I varfër a i pasur, tek Zoti njëlloj janë,
Zili mos ki, mos nënçmo, të Zotit urdhëra janë
Ata që duan të ndihmojnë, Zoti do t'i gëzojë
Dhe ti o Sejri, hapja krahët dashurisë!

Muhammed Ali Eshmeli

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

Bashkoni me shigjetë fjalitë e mëposhtme.

- | | |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Ata që zotërojnë sasinë e nisabit. | <input type="checkbox"/> Ushqimi për dy vakte i një njeriu në gjendje ekonomike të mesme apo vlera në lekë e ushqimit. |
| <input type="checkbox"/> Dora që jep, | <input type="checkbox"/> Quhet “zekat” dhënia personave që na ka urdhëruar feja jonë. |
| <input type="checkbox"/> Një person, nipave të tij. | <input type="checkbox"/> Është më e mirë sesa dora që merr. |
| <input type="checkbox"/> Ndërsa japim zekatin. | <input type="checkbox"/> Me një fjalë tjetër ne japim si zekat 2.5 %. |
| <input type="checkbox"/> Institucioneve, siç janë: xhamia, shkolla, spitali | <input type="checkbox"/> 80.18 gram. |
| <input type="checkbox"/> Zekati, mundësitë ekonomike të të pasurve | <input type="checkbox"/> Nuk u jep zekat. |
| <input type="checkbox"/> Një mysliman i pasur, një pjesë të pasurisë së tij, | <input type="checkbox"/> Dhe për punë të tjera bamirësie, siç janë: rrugë, ura, kroje nuk u jepet zekat. |
| <input type="checkbox"/> Një të dyzetën e arit apo argjendit. | <input type="checkbox"/> Nuk duhet të harrojmë se jemi duke kryer një adhurim fetar. |
| <input type="checkbox"/> Sasia e nisabit për arin | <input type="checkbox"/> Shërben si një urë lidhëse me të varfrit. |
| <input type="checkbox"/> Kufiri minimal i sasisë së sadakasë së fitrit, | <input type="checkbox"/> Fetarisht numërohet i pasur. |






Le të testojmë vetveten


- Cilës prej kategorive të mëposhtme nuk i jepet zekati?
 - Atyre që mbeten në mes të rrugës
 - Të varfërve
 - Atyre që kanë borxhe
 - Prindërve
- Cila është karakteristika e përbashkët ndërmjet zekatit, sadakasë, kurbanit dhe sadakai fitrit?
 - Ndihma reciproke dhe mbështetja për njëri-tjetrin
 - Drejtësia dhe zbatimi i saj
 - Lumturia dhe të qenët punëtor
 - Durimi dhe begatia

3. Cila nga nevojat e mëposhtme nuk përbën nevojë themelore?
- a) Shtëpia
 - b) Makina
 - c) Mallrat tregtare
 - d) Mjetet e punës dhe të profesionit
4. Sa është numri i deleve dhe dhive që duhet të kemi për të dhënë zekatin e tyre?
- a) 40
 - b) 30
 - c) 20
 - d) 100
5. Si vlerësohet fetarisht akti i dhënies së sadakasë së fitrit?
- a) Farz
 - b) Vaxhib
 - c) Sunet
 - d) Mustehab
6. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i drejtë?
- a) Zekati pastron të metat e njeriut që është dhënë shumë pas pasurisë dhe tregohet koprrac.
 - b) Zekati bëhet shkas që pasuria jonë të jetë e begatë, e mbarë dhe të shtohet.
 - c) Zekati mundëson rritjen e dashurisë dhe të afërsisë tek njerëzit.
 - d) Zekati e bën të pasurin më të pasur dhe të varfrin më të varfër.
7. Cila nga gjërat e mëposhtme nuk përfshihet në dhënien e zekatit?
- a) paratë
 - b) delja
 - c) orenditë shtëpiake
 - d) gjedhi
8. Cila gjë nuk mund të thuhet në lidhje me zekatin?
- a) Zekati është farz për të pasurit.
 - b) Zekati jepet një herë në vit.
 - c) 1/40 e pasurisë jepet si zekat.
 - d) Ata që nuk janë mirë me shëndet nuk japin zekat.

Vendosni fjalët me të zeza brenda kllapave në hapësirat mes fjalëve.

(pasuritë, kokrrës, që dëshiron, që nuk lyp, pakësohet, pastron, zemra)

-  I varfri i vërtetë është personi që nuk ka aq para sa t'i mjaftojnë për nevojat e tij, që njihet si nevojtar, por nuk i jepet sadaka dhe nuk gjë prej gjëje prej të tjerëve.
-  Në e myslimanëve të pasur kanë të drejtën e tyre të varfrit që e dëshirojnë apo jo atë.
-  Gjendja e atyre që e shpenzojnë pasurinë në rrugën e Allahut i përngjan që jep shtatë kallinj, ku në secilin prej tyre gjenden 100 kokrra.
-  Po që se dëshiron të të zbutet, atëherë ushqeje të varfrin dhe përkëdhele kokën e jetimit.
-  Merre zekatin nga pasuria e të pasurve. Zekati i pasuritë e tyre dhe i purifikon ata prej gjynaheve.



HAXHI



UDHËTIMI PËR NË VENDET E SHENJTA

- ❁ *Përkufizimi i haxhit*
- ❁ *Ç'përfitojmë nga haxhi?*
- ❁ *Kush e ka farz të shkojë në haxh?*
- ❁ *Vendet që vizitohen me rastin e kryerjes së haxhit.*
- ❁ *Vendet që vizitojmë në Meke dhe Medine.*
- ❁ *Farzet e haxhit*
- ❁ *Detyrat gjatë adhurimit të haxhit*
- ❁ *Si bëhet haxhi?*
- ❁ *Umre*
- ❁ *Haxhi sipas praktikës së profetit Muhamed (a.s.).*



BURIMI I UJIT ZEMZEM

Allahu e urdhëroi profetin Ibrahim të çonte në Meke gruan e tij të quajtur Haxhere dhe djalin e tij të quajtur Ismail. Mekja, ato kohë gjendej rrugës së karvanëve tregtarë që shkonin nga Jemeni për në Siri. Në kohën që flasim, Mekja ishte një vend i pabanueshëm, aty nuk jetonte njeri. Nuk kishte asnjë burim uji për të shuar etjen. Ajo ishte një luginë e thatë dhe pa ujë. Profeti Ibrahim nxitoi ta çonte në vend urdhrin që kishte marrë nga Allahu. Ai mori me vete gruan e tij Haxheren dhe djalin e tyre Ismailin, i cili ende ishte foshnjë për gjiri. Të tre së bashku u nisën udhës për në Meke, ku mbërritën pas një udhëtimit të gjatë. Në Meke Ibrahim la Haxheren dhe Ismailin. Ata kishin me vete vetëm një pagure me ujë dhe ca ushqime për të ngrënë. Kur Ibrahim mori rrugën e kthimit për në Damask, Haxhereja iu vu pas duke e pyetur:

- O Ibrahim! Për ku je nisur të shkosh, ndërsa ne të dyve po na braktis në këtë luginë pa ujë?! Te kush po na dorëzon kështu?

Megjithëse ia drejtoi disa herë me radhë këto pyetje Ibrahimit, ajo nuk mori ndonjë përgjigje. Nga heshtja e tij, zonja Haxhere kuptoi se e gjithë kjo që po ndodhte kishte një tjetër shkak nga ç' mendonte ajo dhe këtë herë i drejtoi këtë pyetje:



- Më thuaj! Allahu të ka urdhëruar të na lësh në këtë vend vetëm?

Atëherë Ibrahim i u kthye nga e shoqja e tij, Haxhereja, dhe i tha:

- Po. Urdhrin e kam marrë nga Allahu.

Me të dëgjuar këtë përgjigje Haxhereja tha:

- Po qe se është kështu siç thua ti, atëherë udha e mbarë të qoftë, sepse neve na mjafton Allahu (xh.sh.). Ai do të na ruajë. Sa mik dhe mbrojtës i mirë është Ai për ne!

Pasi tha këto fjalë, Haxhereja u kthye tek djali i saj. Pasi ishte larguar ca prej tyre, Ibrahim hipi majë një kodre nga e cila mund të shihte luginën e Mekës. U kthye me fytyrë nga Qabja dhe duke ngritur duart, pëshpëriti këtë lutje:

- Zoti ynë! Unë e kam vendosur një pjesë të familjes sime pranë shtëpisë Tënde të shenjtë për të jetuar, në një luginë të thatë, ku as bari nuk mbin. Zoti ynë! Veprova në këtë mënyrë që ata të mund të falin namazet. Mbushi zemrat e njerëzve me dashuri ndaj tyre. Furnizoji ata me çdo lloj fruti. Ata do të dinë të të falënderojnë për shkak të këtyre begative. (Ibrahim, 37)

Pas njëfarë kohe, ushqimi dhe uji që kishte me vete Haxhereja mbaroi. Nga mungesa e ujit Haxheres iu prenë forcat dhe ajo ia ndërpreu foshnjës Ismail, qumështin e gjirit. Dielli digte dhe përvëlonte anakënd me gjithë forcën e tij përcëlluese dhe kjo bënte që Haxhereja dhe foshnja e saj të vuanin edhe më shumë nga etja. Meqë nuk po pinte dot qumësht foshnja Ismail filloi të qante nga etja dhe uria. Aq shumë qante foshnja Ismail, sa që Haxhereja mendoi se të birin do t'i ndodhte ndonjë gjë e keqe.

Zemra e saj nuk duronte më të shihte gjendjen në të cilën ndodhej Ismaili. Zuri të shkonte sa andej-këndej e merakosur. E la Ismailin aty ku ishte dhe vrapoi drejt kodrës Safa, që gjendej pranë tyre, me mendimin se mund të shihte ndonjë njeri që do t'i ndihmonte, por nuk pa asnjë njeri dhe nuk gjeti asnjë pikë ujë. E tronditur, Haxhereja shkoi drejt kodrës Merve. Disa herë ajo shkonte e vinte sa në një kodër, në tjetrën. Asaj iu prenë fuqitë nga vrapit që bëri mes dy kodrave dhe duke humbur shpresën se mund të gjente ndonjë njeri që do t'i ndihmonte u kthye e dërrmuar fizikisht dhe shpirtërisht pranë foshnjës së saj.

Kur u kthye tek foshnja e saj Ismaili, zonja Haxhere nuk po u besonte syve. Poshtë këmbëve të Ismailit buronte ujë. E gëzuar pa masë nga ajo që pa, Haxhereja falënderoi Allahun që ua kishte dërguar këtë ujë. Nga frika se mos burimi shteronte, ajo thirri me zë të lartë në gjuhën arabe: "Zem! Zem!", që do të thotë "Ndal! Ndal!" - dhe zuri ta rrethonte burimin me gurë dhe rërë. Piu ujë. Tani Haxhereja kishte ujë për të pirë, ndërsa Ismaili qumësht nga gjiri i nënës. Lutja e Ibrahimit që pranuar, ndërsa përpjekjet e Haxheres për të gjetur ujin në mënyrë që të shpëtonte birin e saj Ismailin, i pëlqyen Allahut (xh.sh.).

Një ditë prej ditësh një karvan udhëtarësh nga fisi Xhurhum po kthehej nga Damasku për në Jemen. Ata kaluan pranë vendit ku jetonin Haxhereja dhe biri i saj, Ismaili. Nga larg ata panë zogj që fluturonin lart në qiell. Ata u habitën kur panë zogj tek fluturonin në luginën e thatë të Mekës, sepse e dinin që shpendët në shkretëtirë mblidhen rreth burimeve të ujit për të shuar etjen. Prandaj vendosën të dërgojnë një person që të mësojë sesi qëndron puna. Kur mësuan rreth burimit të ujit të Zemzemit të gjithë së bashku shkuan pranë Haxheres dhe birit të saj Ismailit. Haxhereja u tregoi se kush ishin dhe se ç'kishte ngjarë me ta. Njerëzit e këtij karvani kuptuan që Ismaili ishte një fëmijë i bekuar. Ata kërkuan leje nga Haxhereja që edhe ata të vend-

oseshin për të jetuar pranë burimit të Zemzemit, leje të cilën ajo ua dha me kusht që të zotoheshin se të drejtat mbi burimin e ujit të Zemzemit do t'i mbeteshin vetëm asaj.

Njerëzit e fisit Xhurhum formuan një fshat të vogël përreth burimit të Zemzemit. Pa kaluar shumë kohë, lugina e thatë dhe e djerrë e Mekës, mori shpejt përmasat e një qyteti të shndërruar në stacionin e ndalimit të karvaneve tregtare, dhe nisi të quhej qyteti i Mekës.

Lutja e profetit Ibrahim u pranua dhe përpjekja e zonjës Haxhere u pëlqye nga Allahu (xh.sh.). Ata të dy dhe pasuesit e tyre u shpërblyen me ujin e bekuar të Zemzemit.



Profeti ynë i dashur (a.s.) na mëson:

"Uji i Zemzemit të bën derman në varësi të qëllimit me të cilin ti e pi atë. Po qe se e pi me qëllim që të gjeni shërim, Allahu ka për të të shëruar; po qe se e pi për të shuar urinë, Allahu ka për të të ngopur; po qe se e pi për të shuar etjen, Allahu ka për të ta hequr etjen. Zemzemi është pusi të cilin e hapi meleku Xhebrail dhe burimi nga i cili piu ujë për të parën herë profeti Ismail.

(Darekutni, III, 354)




Lutja që duhet të bëjmë kur duam të pimë ujë Zemzemi është:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا وَرِزْقًا
وَاسِعًا وَشِفَاءً مِنْ كُلِّ دَاءٍ

"Allahu im! Unë prej Teje kërkohj njohuri të vlefshme, begati të pamasë dhe shërim nga çdo lloj sëmundjeje."

(Darekutni, III, 354)





ÇFARE ESHTË HAXHI?

✍ **Haxhi**, është vizita që kryhet në Qabe dhe në vendet e shenjta përreth saj, me qëllim përmbushjen e një adhurimi fetar në intervalin e caktuar kohor.



Allahu thotë:

“Haxhin dhe Umren plotësojeni për hir të Allahut!”

Bekare 196



Një ditë prej ditësh e pyetën profetin tonë Muhamed:

- Cila është vepra më e mirë?
- Ai u përgjigj:
- Të besosh se Allahu është Zot dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij.
- Po pas saj cila vepër vjen? - e pyetën përsëri.
- Xhihadi në rrugën e Allahut - u përgjigj profeti Muhamed.
- Po pas saj? - e pyetën për të tretën herë.
- Haxhi i pranuar nga Allahu (xh.sh.), - u përgjigj ai.

(Buhari, Haxh 4)

Ç'PERFITOJME NE NGA HAXHI?

HAXHI



- * mundëson kontrollimin e fjalëve që themi dhe veprimeve që bëjmë.
- * forcon ndjenjën e vëllazërisë dhe zhvillon vetëdijen tonë se jemi një bashkësi e vetme fetare. na pastron nga fëlliqësitë e mëkateve.
- * sjell ndryshime në jetën tonë.





Haxhi është një rast i mirë për ne që të mund të largohemi nga sjelljet dhe zakonet e këqija duke e zbukuruar moralin dhe etikën tonë. Kur jemi të veshur me ihram këputja e një bime, veshja e rrobave të qepura, parfumosja me erë të mirë dhe zënkat me të tjerët përbëjnë raste që pasohen me ndëshkime fetare. Ne duhet të tregojmë kujdes më shumë se çdo herë tjetër ndaj urdhrave dhe ndalesave që na ka mësuar Allahu teksa kryejmë adhurimin e haxhit. Kjo na bën të aftë të kontrollojmë fjalët dhe veprimet tona.

Profeti ynë i dashur Muhamedi (a.s.) ka thënë:

“Myslimani që e kryen detyrën e haxhit pa thënë asnjë fjalë të keqe e fyese, si dhe pa punuar asnjë mëkat të madh, do të kthehet në shtëpinë e tij pa gjynahe, ashtu siç ka lindur i pastër nga nëna.”

(Buhari, Haxh, 4)

Ditët e haxhit në Meke, mbledhen miliona myslimanë nga të katër anët e botës, të cilët i kanë të ndryshme ngjyrën e lëkurës, gjuhët që flasin, rrobat dhe veshjet që mbajnë, shijet dhe preferencat e tyre. Në këto ditë kuptojmë më mirë se ne nuk jemi vetëm në këtë botë, por kemi vëllezër të shumtë të besimit islam që përpiqen të jetojnë në përputhje me mësimet e fesë. Në haxh kemi mundësinë të njihemi me disa prej tyre dhe të shkëmbejmë së bashku mendimet. Me ta ne ndajmë ujin dhe hurmat, gëzimin dhe brengat që kemi. Së bashku falim namazet, bëjmë tavafet, ndalojmë ca ditë në vakfe dhe qëllojmë me gurë armikun tonë të përbashkët, shejtanin. Ky unitet forcon ndjenjat e vëllazërisë dhe zhvillon vetëdijen tonë për të qenë pjesë e një bashkësie të madhe fetare.



Allahu thotë:

“Besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin.”

(Huxhurat 10)

Haxhi përbëhet në vetvete prej disa aktesh siç janë tavafi, saji, vakfe, prerja e kurbanit dhe gjuajtja me gurë e shejtanit. Këto akte na mundësojnë të fitojmë sevape dhe na pastrojnë nga fëlliqësitë e mëkateve.

Profeti ynë i dashur Muhamedi (a.s.) ka thënë:

“Pranimi i fesë Islame, kryerja e hixhretit dhe shkuarja në haxh fshijnë mëkatet që keni bërë më parë.”

(Muslim, Iman 192).

Haxhi është një adhurim fetar që zgjat afërsisht një muaj dhe që bën të mundur që ne të zhvillohemi shpirtërisht. Gjatë haxhit çdo gjë programohet sipas një adhurimi fetar. Tavafet që kryejmë, namazet që falim, leximet e Kuranit, përmendja sa më shumë e Allahut dhe lutjet tona na mundësojnë të hyjmë në një atmosferë intensive adhurimi. Në këtë atmosferë intensive çdo adhurim e ndryshon jetën tonë duke pasuruar mendimet, ndjenjat dhe përsiatjet tona. Adhurimi i haxhit na rrethon anekënd aq sa ne ndjehemi të përfshirë brenda një edukimi të veçantë. Nga ky aspekt, haxhi është një kamp edukimi dhe adhurimi. Ky është shkaku i ndryshimeve të hijshme që shohim tek njerëzit e kthyer nga haxhi.



Profeti ynë i dashur (a.s.) ka thënë:

“Shpërblimi i haxhit të pranuar është vetëm xheneti.”

(Buhari, Umre 1)



KARAMELET

Sabai i mëshoi trumbës. Pastaj me ujin që doli prej saj ai mori abdest. Nxori nga xhepi një shami, me të cilën fshiu ujin e abdestit që ende i rridhte nëpër duar dhe fytyrë. Hodhi xhaketen krahëve dhe rregulloi flokët që i ishin ngjitur nga djersët.

Hyri brenda shtëpisë dhe m'u drejtua me fjalët:

- Pra në lëndën e mësimit të fesë paske marrë notën "shkëlqyeshëm"!

- Shkëlqyeshëm me yll, - u përgjigja unë.

- Atëherë i meriton këto karamеле që t'i kam blerë, - më tha dhe nxori nga xhepi kaushin e mbushur me karamеле që bënte të dukej i fryrë xhepi i xhaketes.

Karamelet brenda kaushit ishin ngjyra-ngjyra. Të kuqe, të verdha, të bardha, të gjelbra..., por të gjitha ishin shumë të shijshme. Ashtu siç na kishte mësuar edhe mësuesi i fesë, Aliu, në shkollë. Në orën e mësimit mësuesi kishte hyrë në klasë dhe në dorë mbante një kuti me shumës me ngjyra të ndryshme. Ai e kishte vënë kutinë në mes të tavolinës.

- Le të mendojmë për një çast se kjo kutia këtu është Qabja, - u tha ai nxënësve dhe pastaj shtoi: - Kurse këta shumës me ngjyrë, që unë jam duke i vendosur përreth kutisë, e zëmë se janë myslimanët duke bërë tavafin. Ngjyra e secilit shumës është e ndryshme. Ai me ngjyrë të bardhë ka ardhur nga një shtet i Evropës, ai me ngjyrë kafe nga zezakët e Afrikës, kurse ky me ngjyrë rozë është lëkurëkuq

nga Amerika. Të verdhin numërojeni për kinez, ndërsa të kuqin nga kontinenti i Australisë. Të gjithë ata janë myslimanë dhe kanë të njëjtin besim. Kjo është edhe arsyeja përse ata janë mbledhur të gjithë së bashku përreth Qabes. Ata dëshirojnë t'i tregojnë të gjithë botës se myslimanët janë vëllezër ndërmjet tyre. Këtë na mëson edhe libri i Allahut, Kurani.

- A nuk përbën dallim mes tyre ngjyra e lëkurës që ata kanë?, - e pyeti Ibrahim.

Mësues Aliu nxori nga xhepi ca karamеле me ngjyra të ndryshme dhe ia zgjati atij duke i thënë:

- Pa na trego se ti mund ti hash të gjitha këto karamеле!

Ibrahimi nisi ti përtyp njëra pas tjetrës të gjitha karamelet.

- A kishte ndonjë karamеле të idhët apo djegëse? - e pyeti mësuesi Ibrahim.

- Jo, - u përgjigj ai.

- Pra, fakti ,që karamelet janë me ngjyra të ndryshme nuk ia ndryshon shijen e ëmbël që kanë. Kjo vlen edhe për këta njerëz. Nuk ka rëndësi se çfarë race i përkasin apo çfarë ngjyre kanë ata, sepse ata tani janë të gjithë myslimanë. Ata janë vëllezër feje në mes tyre.

(M. Yashar Kandemir)



Kush e ka farz haxhin? 😊😊😊😊

Allahu thotë:

“Allahu ua ka bërë të detyruar njerëzve që i kanë mundësitë financiare të shkojnë në haxh ...”

(Al-i Imran 97)


Çdo
mysliman


- * që është i shëndoshë psikikisht.
- * që ka hyrë në moshë të pubertetit.
- * që mund të udhëtojë.
- * që nuk është i sëmurë me sëmundje që e pengon të shkojë në haxh.
- * që ka mundësi ekonomike për vetë dhe familjen.
- * që udhëton në kushte sigurie.

e ka farz haxhin



një herë në
jetë.






UDHËT E QABESË

*Pjesë-pjesë udhës së Qabesë
Vrima-vrima zemra ime
Ajo që quajnë botë s'është veç një hije*

*Tek ti të mbërrij shpirti im Qabe
Me pluburin tënd fërkoj sy dbe ballë.*

*Ngarkuar ta kem barrën prej mikut tim,
Çdo gabim të më falni fqinjë të mi,
Nuk arrij të dalloj larg në është apo afër...*

*Tek ti të mbërrij shpirti im Qabe
Me pluburin tënd fërkoj sy dbe ballë...*



Qabja është qendra e rruzullit tokësor.
Zemra është qendra e njeriut.
Vetëm Allahut i takon zotërimi i Qabesë
dhe i zemrave tona.

QABJA

Ashtu sikurse tregohemi të kujdesshëm që ta mbajmë sa më pastër Qabenë, po aq të kujdesshëm duhet të tregohemi edhe ndaj pastërtisë së zemrës dhe të shpirtit tonë. Edhe ne duhet të pastrojmë çdo kënd të zemrës nga shprehjet dhe mendimet e gabuara dhe të këqija siç patën vepruar profetët Ibrahim dhe Ismail me Qabenë, të cilës i patën pastruar çdo skaj.

Qabeja është faltorja e parë e ndërtuar në rruzullin tokësor me qëllim adhurimin e Allahut brenda saj. Kjo faltore e ndërtuar për të parën herë nga profeti Adem, u përmbyt nga rrebeshi i madh i stuhisë shkatërruese me të cilën u dënua populli i profetit Nuh. Asaj iu shembën muret dhe i humbën themelet.

Më vonë profetët Ibrahim dhe Ismail e rindërtuan sërish Qabenë, e rrafshuar nga rrebeshi i stuhisë në kohën e profetit Nuh, mbi themelet e mëparshme të saj.

Ja si ngjau kjo histori:

Profeti Ibrahim shkante herë pas here në Meke, në vendin ku i kishte lënë gruan e tij Haxheren dhe të birin Ismailin, për t'i vizituar ata. Allahu e urdhëroi Ibrahimin që ta rindërtonte Qabenë, kur

ai gjendej në Meke për t'i bërë vizitë Haxheres dhe Ismailit. Pas këtij urdhri të Allahut, Ibrahim dhe djali i tij Ismaili iu përveshën menjëherë punës për ndërtimin nga e para të Qabesë. Ata i ngritën muret e Qabesë mbi themelet e vjetra të saj të mbetura që nga koha e profetit Adem. Ismaili transportonte gurë nga malet aty afër, ndërsa profeti Ibrahim merrej me ngritjen e mureve. Ndërsa punonin ata i përgjroheshin Allahut (xh.sh.), që u kishte bërë të mundur të ishin pjesëtarë të një shërbimi të tillë fetar të bekuar, me këto fjalë:

“O Zoti ynë! Pranoje këtë vepër që jemi duke bërë për hirin Tënd! Nuk ka dyshim që Ti dëgjon dhe di çdo gjë. Zoti ynë! Na bëj ne dhe pasardhësit tanë nga ata njerëz që të binden vetëm Ty! Na mëso mënyrën e adhurimit dhe pranoje lutjen tonë, sepse vetëm Ti je Ai që e pranon

pendesën e krijesave sa e sa herë dhe i mëshiron ato pa masë.”

“Zoti ynë! Dërgo një profet nga mesi i pasardhësve tanë, i cili do t’u lexojë atyre ajetet Tuaja dhe do t’u mësojë librin dhe urtësinë nëpërmjet të cilave ata do të pastrohen. Vetëm Ti je Ai që e bën çdo gjë ashtu siç i ka hije.” (Bekare, 127-129)

Muret qenë ngritur dhe ndërtimi i Qabesë ishte në përfundim e sipër. Në këtë moment ia behu engjëlli Xhebrail i cili u mësoi profetëve Ibrahim dhe Ismail se si ta kryejnë tavaf-in dhe aktet e tjera të haxhit. U komunikoi urdhrin hyjnor “ta mbajnë pastër Qabenë për njerëzit që do të vijnë aty për të bërë tavafin, për t’iu përkushtuar adhurimeve, për të rënë në sexhde dhe në ruku”. Tashmë Qabja e pastruar nga çdo lloj papastërtie, fizike apo morale, kishte hapur dyert e saja për çdo njeri që dëshironte kryerjen e adhurimeve në të. Allahu i lartësuar e urdhëroi Ibrahimin t’i thërriste njerëzit për të kryer haxhin:

“Shpallu njerëzve kryerjen e haxhit. Le ti përgjigjen kësaj thirrjeje duke kaluar udhë të gjata qofshin në këmbë, qofshin kaluar mbi kafshë” (Haxh, 26-27)

Ashtu sikurse nuk e çojmë ndërmend rrafshimin e Qabesë me tokën, po ashtu duhet të rrimë larg nga çdo veprim që lëndon zemrat dhe shpirtrat e njerëzve apo i thyen ato.


Bëhu shpirtmadh e mos e ndrydh zemrën, Sejrani!

I përjashtuar nga prebja hyjnore, mos u ndje, Sejrani!

Zemra është banesë e Zotit, mos e rrëno, Sejrani!

Shiko mundësinë si ta ndërtosh atë, mos ngurro, Sejrani!

Pas këtij urdhri hyjnor profeti Ibrahim u shpalli njerëzve publikisht se adhurimi i haxhit është farz. Ja pra, që nga ajo ditë myslimanët i përgjigjen kësaj ftese duke vërshuar drejt qytetit të Mekes për të përmbushur detyrën e haxhit. Duke shkuar në haxh, ata do të vazhdojnë t’i përgjigjen kësaj thirrjeje universale deri në ditën e Kiametit.



Vendet që vizitohen gjatë adhurimit të haxhit

Adhurimi i haxhit përfshin edhe vizitën e shumë vendeve fetare me plot simbole islame. Sa më mirë t'i njohim këto vende, aq më shumë mundësi kemi ta kuptojmë adhurimin të haxhit dhe ta kryejmë atë siç e meriton.



Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Namazi që falet brenda territorit të Mesxhidu'l-haramit është njëqind mijë herë më i bekuar sesa çdonjëri nga namazet që falet në një xhami tjetër”.

(Ibn Maxhe, Sunen, I, 450)



Mesxhidu'l-haram: Kështu quhet ndryshe xhamia e ngritur në një sipërfaqe shumë të gjerë përreth Qabesë. Kjo xhami quhet edhe Haremu' sh-sherif.



Qabja: Ndërtesa e parë e ngritur në rruzullin tokësor me qëllim adhurimin e Allahut. Qabenë e quajnë edhe Bejtullah që në shqip do të thotë “Shtëpia ku adhurohet Zoti”.

Feja, libri dhe profeti ynë janë një. Kibla jonë është Qabja. Ne jemi një bashkësi e vetme (ummet).

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Nuk ka dyshim se faltarja e parë e krijuar mbi rruzullin tokësor është Qabja që gjendet në Meke.”


(Al-i Imran 96)

Haxheru'l-esved: që në shqip do të thotë “guri i zi”. Ky gur është vendosur nga ana e profetit Ibrahim në skajin juglindor të Qabesë. Rituali i tavafit fillon pikërisht nga këndi i Haxheru'l-esvedit dhe gjatë çdo rrotullimi të plotë duhet ta përshëndesim atë në mënyrë simbolike.

Përshëndetja që ne i drejtojmë haxheru'l-esvedit është përkujtimi i fjalës së dhënë Allahut në botën e shpirttrave se ne do të mbetemi gjithmonë robërit e Tij.



Makamu'l-Ibrahim: Kështu quhet guri i madh për të cilin transmetohet se, profeti Ibrahim e ka përdorur në vend të skelës gjatë ndërtimit të Qabesë ose vendi mbi të cilin ai u njiit që t'u shpallte njerëzve obligimin e haxhit. Falja e namazit në këtë vend vlerësohet si një akt shumë i vyer.



Allahu (xh.sh.) thotë:

“Ne e shndërruam Qabënë në një vendtubimi për njerëzit. Vend i sigurtë për njerëzit dhe ku fitohen sevape dhe ata janë të sigurtë ata. Falini namazet në makamu'l-Ibrahim.”

(Bekare 125)


Për ne, profeti Ibrahim është një shembull i përsosur i dorëzimit ndaj urdhrave hyjnorë, i singëritetit në fe, i përpjekjeve të pareshtura në udhën e tebidit dhe i moralit të përkryer.

Arafat: Kjo është lugina e madhe në të cilën ditën e Arefe-së haxhinjtë të gjithë së bashku kryejnë ritualin e vakfe-s dhe nga ku i drejtohen me lutje Allahut. Kodra që ndodhet në mes të luginës së Arafatit quhet Xhebelu'rrrahme që në shqip do të thotë “mali i mëshirës”. Pikërisht në këtë kodër u takuan sërisht Profeti Adem dhe gruaja e tij Hava dhe aty i kërkuan së bashku Allahut, t'ua falte gabimin që kishin bërë në xhenet.

Profeti ynë i dashur (a.s.) ka thënë:

“Të shkosh në haxh do të thotë ta vizitosh Arafatin dhe të bësh një qëndrim aty.”

(Tirmidhi, Haxh, 57)



❁ **Muzdelife:** Ky vend ndodhet mes Arafatit dhe Minasë. Aty mbledhen haxhinjtë ditën e Bajramit të Kurbanit për të kryer ritualin e gjuajtjes së shejtanit me gurë.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Atëherë kur të vërshoni me furi drejt Muzdelifesë, pasi të jeni larguar nga vendndalimi (vakfe) në Arafat, përmendeni dhe përkujtojeni Allahun në mesharu’l-haram...”

(Bekare 198)



❁ **Mina:** është vendi ku prehen kurbanët në ditën e Bajramit të kurbanit dhe qëllohet shejtani me gurë. Pikërisht në Mina Profeti Ibrahim e pat shpënë të birin e tij, Ismailin, për ta bërë kurban.

Çdo gur i flakur në Mina është simboli i betejës sonë me shejtanin, betejë që do të vazhdojë një jetë të tërë.

❁ **Safa dhe Merve:** Janë dy kodra të vogla që ndohen 200 metra larg në juglindje të Qabesë. Këto dy kodra të ulta përfshihen brenda territorit të Mesxhidu’l-haramit dhe largësia ndërmjet tyre është 350 metër.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Nuk ka dyshim se, Safaja dhe Merveja janë nga simbolet e Allahut. Çdo person që dëshiron të kryejë haxhin apo umrenë nuk ka asnjë arsye që mos t’i vizitojë dhe bëjë tavaf në këto kodra...”

(Bekare 158)



Rrugët nga kemi kaluar

Selam keni - na i thoni
Rrugëve nga të kaloni,
Gjuhëve që përmendin Zotin
Selam keni - na i thoni.

Selam keni - na i thoni
Shkretëtirë e bekuar e Hixhazit,
Trëndafil, që nuk vyshket, të Zotit
dhe varganit me besimtarë...

Selam keni - na i thoni
atyre që mbajnë miqësi,
që s'bien në kurth mosbesimi
Malit të bekuar prej Nuri.

Selam keni - na i thoni
Dritës së Udhërrëfyesit tek rreshon
Safas dhe Merves
Muhamed Mustafasë.

Tek i përgjeroni Perëndisë
Lutje bëni dhe për ne,
Dhe të madhërishmes Qabe
Selam keni - na i thoni.

Allahut kush i drejtohet
Plot dritë zgjohet në agim
Familjes së Resulullahut
Selam keni - na i thoni.

Veshur keni petkun e ihramit
As dorën nuk ia zgjasni haramit
Sahabeve fisnike të resulullahut
Selam keni - na i thoni.

Mekeja dhe Medine
Dy thesare të pashoqe
Të dalluarave të Zotit
Selam keni - na i thoni.

Kokëzbuluar nën diell
Curin e zi për të puthur,
Lotit që pikon nga syri
Selam keni - na i thoni.

Myslimani që këndon tekbiere
Çdo kafshe për kurban,
Besimtarëve gjithë sa janë
Selam keni - na i thoni.

Eja, o Xhemal edhe ti,
Llafeve s'u është parë hajri,
Haxhilerëve një nga një
Selam keni - na i thoni.

Xhemal Oguz Oxhal

VENDET QE VIZITOHEN NE QYTETET E MEKES DHE MEDINES

A. VENDET QE VIZITOHEN NE MEKE

☉ **Shpella e Hirasë:** Kjo shpellë ndodhet pr - në Mekes në malin Nur. Në këtë shpellë profetit tonë i zbriti ajeti i parë i Kuranit: “Lexo!”.

☉ **Shpella e Thevrit:** Në këtë shpellë u str - hua profeti ynë Muhamed për tri ditë dhe tri netë gjatë rrugës së tij të emigrimit (hixhret) për në Medine.

✍ Mohuesit e besimit islam (mushrik) nga qyteti i Mekes erdhën deri tek hyrja e shpellës së Thevrit, por nuk mundën të shihnin profetin Muhamed dhe bashkudhëtarin e tij, Ebu Bekrin që ndodheshin brenda saj. Në hyrje të shpellës ata panë rrjetën e një merimange dhe folenë e pëllumbit. Idhujtarët e Mekës u kthyen pa hyrë brenda në shpellë duke menduar se asnjë njeri nuk do të mund të kishte hyrë në të pa e prishur rrjetën e merimangës dhe pa e trazuar folenë e pëllumbeshës.



B. VENDET QE VIZITOHEN NE MEDINE

Medineja është qyteti i bekuar në të cilën profeti ynë Muhamed emigroi dhe jetoi deri në fundin e jetës së tij. Aty erdhi dhe u vendos profeti Muhamed (a.s.) për nderin e të cilit ky qytet mori emrin e ri Medinetu'l-munevvere, që në shqip do të thotë “Qyteti i përndritshëm”.

✍ Ndërsa paganët e Mekes planifikonin si ta vrisnin profetin tonë Muhamed, populli i Medines kishte hapur zemrën dhe portat e qytetit për profetin dhe pasuesit e tij duke i pritur ata me refrenin e gëzimit dhe haresë: “Talea'l-bedru alejna”. Ata e kishin për nder t'i ndihmonin myslimanët e Mekes dhe profetin Muhamed, madje ishin të gatshëm të flijonin edhe pasuritë dhe jetën e tyre. Për këtë arsye Medineja u quajt “toka e emigrimit”, ndërsa njerëzit e bekuar që “e ndihmuan” profetin u quajtën “Ensar”.

Profeti ynë i dashur (a.s.) ka thënë:

“Unë do të ndërmjetësoj në botën tjetër për atë musliman që më viziton pas vdekjes”

(Taberani, Evsat, V/275, 4542)

✍ Ne lexojmë shumë salavat përmbi profetin tonë gjatë udhëtimit për në Medinë, dhe e shtojmë leximin e tyre në çastin që në horizont shfaqet Kupola e Blerë. Me zemër të brengosur dhe sy të përplotur përpiqemi të ndiejmë në shpirt mallin për profetin tonë. Ecim përgjatë

🌀 **Mesxhidu'n-nebevi:** Kjo është xhamia e parë që profeti Muhamed ndërtoi pasi u vendos në Medinën e Përndritshme. Ai mori pjesë personalisht në ndërtimin e kësaj xhamie duke mbajtur qerpiç mbi supet e tij të bekuar.

✍ Në këtë xhami profeti ynë Muhamed u priu shokëve të tij fisnikë për dhjetë vjet në faljen e namazeve. Shokët e Profetit (sahabe) u edukuan shpirtërisht në këtë xhami me anë të kuvendimeve të profetit Muhamed duke u shndërruar kështu në yjet që do ta orientojnë njerëzimin për në udhën e drejtë deri në ditën e kiametit.


🌀 **Kopshti i dliirë (Ravdatu'l-mutahhara):** Ky është vendi ku gjendet varri i profetit tonë Muhamed dhe ndodhet pikërisht nën kupolën e blertë të xhamisë profetike.

✍ Pranë varrit të profetit Muhamed gjenden edhe varri i Ebu Bekrit dhe ai i Umerit. Gjatë vizitës në varrin e profetit tonë Muhamed ne duhet të jemi të kujdesshëm në sjelljet tona thua se profeti është në jetë dhe ne po e vizitojmë atë.

Nga porta e xhamisë së profetit ne duhet të hyjmë të heshtur dhe të mbushur me ndjenjë respekti për të. Afrohemi tek *kopshti i dliirë* duke kënduar salavat për profetin Muhamed dhe duke e përshëndetur atë me selam. Pasi t'i kemi dhënë selam Ebu Bekrit dhe Umerit përfundojmë vizitën tonë.

🌀 **Parajsa e përherëshme (xhenetu'l-baki):** Kështu quhet varreza që ndodhet në anën lindore të xhamisë profetike. Këtu janë varrosur mijëra sahabe që patën fatin e lumtur ta shohin profetin Muhamed, që dëgjuan me veshët e tyre kuvendimet e tij dhe që

rrugëve të Medinës duke mbajtur të freskët në kujtesë shpirtin e ndihmës dhe të sakrificës që kishin ensarët. Të përshkuar nga këto ndjenja ne vizitojmë vendet ku jetuan profeti dhe shokët e tij.



Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Një namaz që falet në xhaminë time është më me vlerë se çdo namaz tjetër, me përjashtim të namazit që falet në Qabe.”

(Muslim, Haxh, 94.)



Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Ata që do të më vizitojnë pas vdekjes do të vlerësohen si të më kenë bërë vizitë kur unë kam qenë i gjallë.”

(Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VI, 48)



përballuan çdo lloj sakrifice për hir të fesë Islame. Gjithashtu këtu ndodhen edhe varret e disa prej figurave madhore nga gjeneza e profetit Muhamed, e grave dhe e bijave të tij. Profeti ynë e vizitonte shpesh varrezën Baki dhe lutej për myslimanët e varrosur aty.

Disa vende të tjera që mund të vizitohen në qytetin e Medinës janë edhe këto:




Xhamia Kuba që profeti e ndërtoi gjatë emigrimit të tij nga Meka për në Medine.



Varrezat e dëshmorëve të Uhudit ku gjenden varret e shokëve të profetit (sahabe) që ranë dëshmorë gjatë betejës së Uhudit.



Shtatë Xhamitë, e ndërtuara në vendet ku ndodheshin shatorret kryesore të luftës së Hendekut në të cilat myslimanët i falnin namazet grupe-grupe gjatë rrethimit.



Xhamia me dy kibla, në të cilën profeti që duke u falur kur Allahu e urdhëroi ta ndryshonte kiblën nga Jeruzalemi (Mesxhidu'l-aksa) në drejtim të Qabesë.



FARZET E HAXHIT

Gjatë haxhit është farz që:



- * të veshim rrobën e ihramit,
- * të bëjmë një ndalesë në Arafat
- * të bëjmë tavaf rreth Qabes

Veprimet që kryhen gjatë adhurimit të haxhit:

Përbushja në mënyrë sa më të plotë e haxhit arrihet me kryerjen e disa veprimeve. Ato janë ihrami, tavafi, saji, vakfe-ja, gjuajtja me gurë e shejtanit, prerja e kurbanit, qethja e flokëve.

1. Ihram

Ihram, do të thotë që personi, i cili e ka bërë njetin e haxhit, të qëndrojë larg nga veprimet dhe sjelljet që bëhen në jetën e përditshme, siç është për shembull veshja e rrobave të përshkuara me pe etj.


Rroba e ihramit për meshkujt përbëhet nga dy copa të bardha, të papërshkuara me pe, me të cilën ata mbulojnë trupin e tyre.

Nuk ka rëndësi se nga sa copa përbëhet rroba e ihramit për femrat, por ajo duhet të plotësojë kushtet e mbulimit të femrës myslimane.

Allahu (x.b.sh.) ka përcaktuar jo vetëm kufijtë e mikatit pranë të cilëve veshet ihrami, por gjithashtu edhe kufijtë e lejimeve (hallall) dhe ndalimeve (haram).

Kujdesi që ne tregojmë për të mos kapërcyer kufijtë e mikateve, duhet treguar edhe ndaj kufijve të vendosura nga Allahu në lejime (hallall) dhe ndalime (haram). Ne duhet të mjaftohemi me gjërat e lejuara (hallall) dhe të qëndrojmë larg gjërave të ndaluara (haram).

Bëjmë njetin dhe veshim rrobën e ihramit. Pas këtij momenti ne do të jemi të kujdesshëm ndaj ndalesave që fillojnë me veshjen e ihramit. E ndjejmë vetveten si të jemi mbështjellë me pëlburën e qefinit. Çdo moment ne duhet të jemi të gatshëm që të ballafaqohemi me çastin e vdekjes. Të gjithë ne jemi ngjeshur dhe veshur brenda një lloji ihrami, sepse të gjithë ne jemi të barabartë përpara Allahut.



Sipas fesë sonë islame, Meka rrethohet me kufijtë që quhen mikat. Përkisht pranë këtyre kufijve, haxhiu, është i detyruar të bëjë njetin e posaçëm për këtë adhurim dhe të veshë rrobën e ihramit.

Kufijtë fetarë që na ka mësuar profeti ynë Muhamed (a.s.) për të veshur ihramin (mikati) janë:

5 pika që quhen Dhulhulejfe, Xhuhfe, Dhatu Iruk, Karnu'l-menazil dhe Jelemlen. Myslimanët që nisen drejt Mekës për të kryer haxhin ose umrenë janë të detyruar që kur të mbërrijnë tek këta kufij të haxhit (mikati), të veshin ihramet dhe ashtu të kalojnë ato pika të paracaktuara.

Veprimet e ndaluara të kryhen pasi vishet ihrami janë:



Prerja e thonjve



Shkurtimi i mjekrës apo prerja e flokëve



Lyerja me erë të mirë



Këputja e çdo bime apo fruti brenda qytetit të Mekës dhe rrethinave të saj.



Veshja e rrobave të qepura



2. Tavaf

- ✍ Tavaf do të thotë të rrotullohemi shtatë herë përreth Qabes.
- ✍ Çdo rrotullim i plotë rreth Qabes quhet "shavt".



Si krijesa të bindura ndaj Allahut, planetët sillen përreth diellit, elektronet rreth bërthamës dhe engjëjt përreth Arshit të Zotit, duke çuar kështu në vend urdbrin e Tij. Edhe ne njerëzit e lartësojmë Allahun, Zotin tonë, duke i ardhur përreth Qabes.



3. Saj

Saj quhen shtatë vajtje-ardhjet ndërmjet kodrave Safa dhe Merve. Saji përbëhet nga shkuarja katër herë dhe ardhja tri herë mes dy kodrave në fjalë duke filluar nga kodra Safa për të përfunduar në kodrën Merve.




Zonja Haxhere ujin, që aq shumë e kërkoi mes kodrave Safa dhe Merve, e gjeti papritur nën këmbët e njoma të foshnjës Ismail. Edhe ne duhet të përpiqemi përberë e më shumë ta fitojmë kënaqësinë e Allabut dhe ta presim shpërblimin tonë vetëm prej Tij.



4. Vakfe

Akti i vakfe-s, që është njëri nga farzet e haxhit, përmbushet atëherë kur haxhiu, i veshur me ihram, qëndron brenda kufijve të Arafatit, nga koha e drekës deri në perëndimin e diellit të ditës së Arefe-së. Kjo quhet "vendndalimi (vakfe) Arafat".



Në ditën e kiametit njerëzit do të mbledhen të gjithë në fushën e mabsherit pasi të kenë dalë nga varret. Gjatë qëndrimit në Arafat ne përjetojmë pikërisht ndjesinë e tubimit në mabsber. Aty ne i përgjërobemi sypërlotur Allabut nga thellësia e zemrës Allabut që të na i falë mëkatet dhe gabimet tona.



Pas qëndrimit në Arafat shkohet për në Muzdelife, ku kalohet mbrëmja. Aty mbledhim edhe gurët e vegjël për të gjuajtur shejtanin me to. Pas namazit të sabahut ndajmë një kohë të shkurtër për t'u lutur. Kjo quhet "vend ndalimi (vakfe) në Muzdelife".



Zemrat e pastruara me pendim dhe lot ngazëlleben nga përmendja e emrave të Allabut. Haxhinjtë, të rrëmbyer nga këto ndjenja, mbledhin gurë të vegjël në Muzdelife për të gjuajtur me to shejtanët që përpiqen t'i nxjerrin nga udha e Allabut. Aty besimtari përkuqton Zotin dhe ndërgjegjësohet mbi rëndësinë e ndjekjes së urdrave të Tij.



5. Gjuajtja me gurë e shejtanit

Ditët e Bajramit të Kurbanit gjuhen me gurë tre shejtanët, i vogli, mesatari dhe i madhi.



Ne i shpallim luftë shejtanit, armikut tonë më të madh, duke e gjuajtur me gurë atë. Ne zotobemi pas kësaj dite se do të qëndrojmë larg shejtanit dhe nuk do t'i bindemi ctyjeve të tij.



6. Prejra e kurbanit të haxhit

Për haxhinjtë është vaxhib therja e kurbanit të falënderimit, ditën e bajramit, përpara se ata të heqin robën e ihramit.



Profeti Ibrahim, me qëllim zbatimin e urdbrit të Zotit, shkoi në vendin e quajtur Mina, që ta bënte kurban birin e tij, Ismailin. Të dy atë e birin bindën këtij urdbri të Zotit pa shfaqur asnjë sbenjë ngurrimi. I kënaqur me gatishmërinë e tyre Allahu i dërgoi një dash për ta bërë kurban në vend të Ismailit. Edhe ne e kryejmë haxbin duke iu bindur urdbrit të Allahut. Tani, prebet kurbanin për ta falënderuar Allahun që na ka besuar amanetin e mbajtjes së shpirtit dhe pasurisë sonë.



7. Shkurtimi i mjekrës, qethja e flokëve dhe zhveshja e ihramit

Gjëja e fundit që duhet të plotësojë haxhiu përpara se të zhvesh rrobën e ihramit është shkurtimi i mjekrës ose qethja e flokëve. Meshkujt mundën t'i shkurojnë flokët ose ta rruajnë kokën. Femrat mund të mjaftohen vetëm me prerjen e majave të flokëve.

Prerja e flokëve shënon fundin e disa ndalesave që i kushtëzojnë veshja e ihramit siç është p.sh. Iyerja me erë të mirë.

Edukimi ynë shpirtëror që zuri fill me ihramin merr fund me shkurtimin e flokëve ose të mjekrës. Pas këtij çasti ne duhet t'i zbatojmë në jetën tonë të përditshme sjelljet e lujshme që kemi fituar gjatë haxhit.




SI KRYHET HAXHI?

Haxhi kryhet në tre mënyra. Ne do të shpjegojmë këtu atë më të preferueshmin prej tyre dhe që quhet haxhi temettu. Në haxhin temettu haxhi kryhet pasi të kemi bërë umren më parë.



- 1
 - ☸ Veshim ihramin pranë mikatit dhe bëjmë nijetin për umre.
 - ✍ Përpara se të veshim ihramin presim thonjtë, flokët dhe pastrojmë trupin dhe më pas marrim abdest ose gusël.
 - ✍ Bëjmë nijetin, lexojmë telbijen dhe lutemi duke kënduar dua të ndryshme.



- 2
 - ☸ Me të mbërritur në Mekë, bëjmë tavaf rreth Qabes.
 - ✍ Pastaj falim dy rekatë namaz të tavafit.

Telbije

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ

“Lebbejk. All-llahumme Lebbejk. Lebbejke la sherike leke lebbejk. İnne'l-hamde ve'n-ni'mete leke ve'l-mulk. La sherike lek.”

Urdhëro, o Zot, urdhëro! Jam gati të çoj në vend urdhrin Tënd. Urdhëro o Ti i Vetmi që s'ke të ngjashëm. Urdhëro, o Zot! Lavdet të perkasin vetëm Ty. Begatitë dhe posedimi i tyre të perkasin vetëm Ty. Ti nuk ke të ngjashëm!



Kryejmë sajin ndërmjet Safasë dhe Merves

- 4
 - ☸ Pasi shkurtojme flokët ose rruajme kokën heqim rrobën e ihramit. Veshim rrobat tona të përditshme.
 - ✍ Deri ditën e Arefes, haxhinjtë e kalojnë kohën duke falur namaz dhe duke bërë tavafe.

- 5
 - ☸ Përpara se të nisemi për të shkuar në Arafat, aty ku ndodhemi, bëjmë nijetin e haxhit dhe e veshim përsëri rrobën e ihramit.



6 Ditën e Arefesë shkojmë në Arafat ku kryejmë vakfen.



- 7
- ☼ Me të perënduar dielli ditën e Arefesë, shkojmë për në Muzdelife ku kalojmë natën.
 - ✍ Në Muzdelife grumbullojmë gurë të vegjël me të cilët do të qëllojmë shejtanin.
 - ✍ Ditën e parë të bajramit të Kurbanit, para se të lind dielli, kryejmë vakfen në Muzdelife dhe prej aty shkojmë në Mina.



8 ☼ Në Mina qëllojmë shejtanin me gurë.




10 ☼ Qethemi dhe pastaj heqim rrobën e ihramit.

✍ Tani ne mund të veshim rrobat tona të përditshme.



9 ☼ Në Mina presim kurban.



11 Shkojmë në Qabe dhe kryejmë tavafin e vizitës i cili është një ndër farzet e haxhit.

13 Ditën e dytë, të tretë dhe të katërt të bajramit të kurbanit qëllojmë shejtanin me gurë.

Ditën që do të largohemi nga Meka kryejmë tavafin e përshëndetjes.

UMREJA

✍ Umre do të thotë të kryejmë tavafin dhe sajin të veshur me ihram, të shkurtojmë flokët dhe të heqim rrobën e ihramit.

📖 Meqenëse umreja ngjason me haxhin në pjesën më të madhe të veprimeve, ajo është quajtur edhe “haxhi i vogël”.

😊😊 Për personat që kanë mundësi financiare është sunet të shkojnë të paktën një herë në jetë në umre.

✍ Umreja nuk ka afat të caktuar kohor. Çdo ditë të vitit mund të shkojmë për umre. Por, është mekruh ta kryejmë umren ditët e Arefesë dhe të Bajramit të Kurbanit, pra ndërmjet datave 9 dhe 13 të muajit dhulhixhe, sepse në këto ditë kryhet haxhi.

Si kryhet umreja?

- ♦ Bëjmë nijetin e umresë dhe veshim ihramin pranë mikatit.
- ♦ Bëjmë tavaf rreth Qabes.
- ♦ Pas tavafit falim dy rekatë namaz.
- ♦ Bëjmë sajin ndërmjet kodrave Safa dhe Merve.
- ♦ Heqim ihramin pasi të kemi kryer sajin dhe të kemi shkurtuar flokët.

Në këtë mënyrë ne kemi përmbushur obligimin e umresë.

Allahu (xh.sh.) thotë:

“Plotësoni kryerjen e ditëve të haxhit dhe umresë për hir të Allahut...”

(Bekare 196)

Profeti ynë i dashur Muhamedi (a.s.) ka thënë:

“Adhurimi i umres i shlyen gjynahet që mund të jenë kryer që nga umreja e mëparshme.”

(Buhari, Umre 1)

Profeti ynë i dashur Muhamedi (a.s.) ka thënë:

“Umreja e kryer gjatë muajit të Ramazanit shpërblehet nga Allahu me aq sevape sa ato të një haxhi të pranuar.”

(Ibn Maxhe, Menasik, 45)





ÇFARË DHURATASH SOLLËT PREJ HAXHIT?

Arkitekti shpirtëror i Pakistanit, Muhamed Ikbali, vizitoi një ditë prej ditësh haxhijtë e sapokthyer nga Medineja. Ai u drejtoi atyre pyetjen e mëposhtme në të cilën shpalosej horizonti shpirtëror i një besimtari të vërtetë:

“Ju keni vizituar Medinën e Përndritshme! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu i bekuar i Medinës? Dhuratat materiale që na keni sjellë, taket, respihet dhe sexhadet pas ca kohësh do të vjetrohen dhe do të marrin fund. A na keni

sjellë nga Medineja dhuratat që nuk fishken kurrë dhe i gjallërojnë shpirtrat?

A na keni sjellë ndër të tjera cilësinë e bindjes dhe besnikërisë së Ebu Bekrit, drejtësi të Umerit, ndjenjë turpi dhe bujari të Uthmanit , klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit të Aliut? A do të arrini t’i falni botës islame, që sot përpëlitet mes mijëra hallesh, emocionet e shekullit të lumturisë?”

HAXHI I PROFETIT TONË MUHAMED (A.S.)

HAXHI I LAMTUMIRËS (10 DHULHIXHE TË VITIT HËNOR ??/ MARS 632 VITI DIELLOR)

Në jetën e tij profeti Muhamed (a.s.) ka shkuar vetëm një herë në haxh, në të cilin ai u ka treguar praktikisht sahabeve se si duhet kryer detyra e haxhit. Gjatë këtij haxhi të kryer në vitin e dhjetë hënor ai iu drejtua të pranishmëve në Arafat, Muzdelife dhe Mina me ligjërata të ndryshme. Nëpërmjet ligjëratave të mbajtura ai i shpalli publikisht të gjithë njerëzimit mesazhin universal të Islamit. Këto ligjërata që trajtuan të drejtat e njeriut, zënë një vend të rëndësishëm në histori. Gjatë fjalimit të lamtumirës profeti Muhamed (a.s.) iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: “O njerëz! Dëgjojini mirë këto që po ju them, sepse nuk e di a do të mund të takohemi sërish vitin tjetër”. Ai la të kuptohej se kishte ardhur koha të përshëndeteshin për të fundit herë në këtë jetë. Për këtë arsye ky fjalim i profetit tonë Muhamed u quajt “hutbeja e lamtumirës”, ndërsa haxhi që kreu u quajt “haxhi i lamtumirës”.

Në lidhje me mënyrën se si Profeti ynë i dashur e kreu haxhin e lamtumirës transmetohet:

Në muajin Dhulhixhe të vitit të dhjetë të hixhretit, Profeti ynë Muhamed nisi përgatitjet e duhura për të bërë haxhin dhe i njoftoi myslimanët se kishte ardhur koha të fillonin të përgatiteshin për të kryer të njëjtin obligim. Pas këtij komunikimi myslimanët që dëshiruan të shkonin së bashku me profetin drejt Mekës, vërshuan nga të katër anët e gadishullit arabik drejt Medinës për t’u bashkuar me karvanin e haxhit.

Kur Pejgamberi dhe sahabet që e shoqëronin falën dy rekate namaz kur mbërritën pranë mikatit. Pastaj ata veshën ihramet dhe filluan të recitonin telbijet. Në përputhje me urdhrin e Allahut, profeti ynë Muhamed gjatë udhëtimit drejt Mekës recitonte me zë të lartë shprehjen “lebejke...” e cila pasohej anekënd edhe nga haxhinjtë e tjerë.

Së bashku me personat e tjerë që bashkoeshin me ta rrugës për në Mekë, numri i hanxhinjve e kaloi shifrën njëqind mijë. Kur ata mbërritën në Meke, pas dhjetë ditë udhëtimi, kalendari shënonte

Nga ligjërata e lamtumirës

O njerëz!

Jeta, nderi dhe pasuria juaj janë të shenjta deri në ditën e takimit tuaj me Zotin, ashtu siç janë të shenjta për ju këto ditë, këto muaj dhe ky vend. Askush nuk ka të drejtë të vërë dorë mbi to.

Nga ligjërata e lamtumirës

O njerëz!

Jini të kujdesshëm ndaj të drejtave të bashkëshorteve tuaja. Kini frikë Allahun! Allahu ua ka besuar juve ato. Ashtu sikurse ju keni të drejtat tuaja ndaj grave, ashtu edhe ato kanë të drejtat e tyre ndaj jush.

datën 4 dhulhixhe. Profeti Muhamed çante përmes turmës së madhe të njerëzve, ndërsa qielli kumbonte nga thirrjet “Allahu ekber”.

Puna e parë që bëri profeti ynë Muhamed me të ardhur në Mekë qe tavafi rreth Qabes. Pasi kreu tavafin rreth Qabes profeti fali dy rekate namaz në vendin makamu’l-Ibrahim dhe më pas kreu sajin ndërmjet kodrave Safa dhe Merve. Qëndrimi i tij në Meke zgjati disa ditë. Me datën 8 të muajit dhulhixhe ai shkoi në Mina.

Një ditë më pas, ditën e Arefe-së, pasi kishte lindur dielli, profeti u nis për në Arafat. Në mesditë doli nga çadra e tij dhe i hipi devesë që quhej Kusva. Në mesin e luginës së Arafatit i mbajti një ligjëratë të pranishmëve, numri i të cilëve ishte afërsisht njëqind e njëzetë mijë. Ligjërata (hutbe) që mbajti profeti ynë Muhamed, në të cilën u trajtuan çështje të rëndësishme, i drejtohej jo vetëm myslimanëve të pranishëm, por edhe njerëzimit mbarë.

Në Arafat, Profeti Muhamed, fali namazin e mesditës së bashku me atë të ikindisë në kohën e drekës.

Me të perënduar dielli shkoi nga Arafati në Muzdelife, ku fali namazin e akshamit së bashku me atë të jacisë në kohën e kësaj të fundit. Atë mbrëmje e kaloi në Muzdelife.

Ditën e parë të bajramit të kurbanit, fali namazin e sabahut dhe u nis për në Mina para se të lindte dielli. Në Mina ai gjuajti shejtanin me gurë. Preu kurbanin dhe hoqi petkun e ihramit pasi shkurtoi flokët. Më pas ai shkoi në Mekë ku bëri tavafin e vizitës.

Ditët e tjera të Bajramit të kurbanit në Mina ai vazhdoi ritualin e gjuajtjes me gurë të shejtanit.

Ditën e katërt të bajramit ai shkoi në Medine pasi kreu tavafin e lamtumirës në Meke.

Nga ligjërata e lamtumirës

O njerëz!

Zoti juaj është një dhe që të gjithë ju keni një baba, Ademin, i cili u krijua nga dheu. Njeriu më i mirë dhe më i vyer tek Allahu është ai që ka frikë të bie në kundërshtim me urdhrat e Zotit. Dijeni mirë se, arabi nuk ka asnjë epërsi ndaj jo arabit, as jo arabi ndaj arabit, as i bardhi ndaj të ziut dhe as i ziu ndaj të bardhit. Epërsia qëndron vetëm në shkallën e devotshmërisë që keni. A ua komunikova siç duhet mesazhin hyjnor? Zoti im, ji dëshmitar!

Në këtë mënyrë profeti ynë Muhamed kreu detyrën e haxhit të urdhëruar nga Allahu duke u mësuar myslimanëve se çfarë veprimesh dhe aktesh fetare duhet të plotësonin gjatë këtij adhurimi.





Shenjat e kembeve dhe sandalet e profetit.

KËRKO E KËRKO, GJURMËN TË TA GJEJ...

Në gjetça gjurmën tënde, shumë të kem kërkuar
Me pluhurin e saj fytyrën kam për të fërkuar.
O Zot, mundësoma vetëm sytë t'ia shoh.
O Muhamed, zemra ime vetëm Ty të do!

Ab, në u dhëntë shpallja, udhës do të vibem
Zhytur në rërë të mbes rrugëve të Qabes.
Bukurinë hyjnore në ëndërr sa të sodis,
O Muhamed, zemra ime vetëm Ty të do!

Aliun dhe Hysenin, Hasanin më pastaj
Në zemër dashuri, në shpirt kam vetëm mall.
Të nesërmen ditë mahsberi, përpara gjyqit të Zotit
O Muhamed, zemra ime vetëm Ty të do!

Junusi me gjubë të lavdëron vetëm ty
Gojë më gojë shkon fjala për në zemra.
Kërko e kërko në të huajat dbera
O Muhamed, zemra ime të do vetëm Ty!

Junus Emre

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

Shënoni me shenjën (x) në njërën nga dy kutitë e mëposhtme, të saktën kur fjalia është e vërtetë dhe të gabuarën kur fjalia është jo e saktë.

1. Haxhi është vizita e Qabes dhe vendeve të shenjta përreth saj me qëllim kryerjen e një adhurimi fetar, në data të caktuara të vitit, pasi të kemi veshur petkat e ihramit. E SAKTË E GABUAR
2. Xhamia e themeluar brenda një territori të gjerë përreth Qabes quhet "Mesxhidu'l-haram" apo "Haremi i nderuar". E SAKTË E GABUAR
3. Rrotullimi shtatë herë rresht përreth Qabes quhet saj. E SAKTË E GABUAR
4. Rrotullimi një herë të vetme përreth Qabes quhet tavaf. E SAKTË E GABUAR
5. Petku i ihramit që vishet në haxh, na mëson se postet dhe rangjet në këtë botë janë të parëndësishme dhe se të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara Allahut. E SAKTË E GABUAR
6. Ndalimi dhe qëndrimi në Arafat na sjell ndërmend ditën kur do të dalim nga varret dhe do të mbliidhemi grupe-grupe në fushën e mahsherit. E SAKTË E GABUAR
7. Kufijtë që nuk kapërcehen pa veshur petkun e ihramit për të shkuar në haxh, quhen mikat. E SAKTË E GABUAR
8. Xhamia profetike ndodhet në qytetin e Medinës së Përndritshme. E SAKTË E GABUAR

Ta testojmë vetveten

1. Cila është faltorja e parë e ndërtuar mbi rruzullin tokësor?
 a) Mesxhidu'n-nebevi
 b) Mesxhidu'l-aksa
 c) Qabe
 d) Mesxhidu'l-kuba
2. Cili nga veprimet e mëposhtme është detyrim (farz) të kryhet gjatë haxhit?
 a) Rrotullimi (tavaf) rreth Qabes
 b) Ndalimi dhe qëndrimi (vakfe) në Muzdelife
 c) Gjuajtja me gurë e shejtanit
 d) Vizita e varrit të profetit Muhamed
3. Cila nga veprimet e mëposhtme nuk është e ndaluar të veprohet nga personi që ka veshur petkun e ihramit?
 a) Lyerja me erë të mirë
 b) Qethja e flokëve
 c) Gjumi
 d) Prerja e thonjve
4. Në cilën periudhë kohe duhet kryer umreja, sevapi i së cilës është i barabartë me sevapin e një haxhi?
 a) Në bajramin e kurbanit
 b) Në muajin Ramazan
 c) Në muajin Muharrem
 d) Në stinët e nxehta të vitit

5. Si quhet veprimi që kryhet në haxh duke u rrotulluar shtatë herë rreth Qabes?
- a) Vakfe b) Ihram
c) Saj d) Tavaf
6. Cila nga veprimet e mëposhtme nuk është detyrim (farz) të kryhet gjatë haxhit?
- a) Ihrami
b) Tavafi rreth Qabes
c) Vakfe në Muzdelife
d) Vakfe në Arafat
7. Si quhet haxhi që ka kryer profeti ynë Muhamedi?
- a) Haxh i detyruar (farz)
b) Haxh i lamtumirës
c) Haxh i madh
d) Hutbeja e lamtumirës
8. Si quhet adhurimi që kryhet përjashta datave të kryerjes së haxhit dhe përbëhet nga tavafi rreth Qabes dhe saji mes kodrave Safa dhe Merve duke qenë të veshur me petkun e ihramit?
- a) Umre b) Haxh
c) Tavaf d) Ihram
9. Cila nga kushtet e mëposhtme nuk na ndalon që ta kryejmë haxhin edhe po qe se nuk e plotësojmë atë?
- a) Të jetë mysliman.
b) Të jetë mirë psikikisht dhe të ketë mbërritur moshën e pubertetit.
c) Të ketë të drejtë të udhëtojë ku të dëshirojë.
d) Të jetë mbi moshën 40 vjeçare.
10. Si quhet vendi në Medine ku gjendet varri i bekuar profetit tonë Muhamed?
- a) Kopshti i dliër
b) Qabja e Madhërueshme
c) Mesxhid-ul Aksa
d) Guri që qëndron pezull (haxheru'l-muallaka)

Vendosni fjalët që gjenden mes kllapash në vendet e duhura të lëna të paplotësuara.

(Zemzem, pa gjynahe, në jetën time, ihram, makamu'l-Ibrahim, Qabja e Madhërueshme, Mina)

1. Guri i madh të cilin thuhet se profeti Ibrahim e ka përdorur në vend të skelës gjatë ndërtimit të Qabes apo si majën mbi të cilën ai u pat ngjitur me qëllim që t'u shpallte njerëzve detyrën e tyre të haxhit quhet
2. Vendi ku profeti Ibrahim e shpuri të birin Ismailin për ta bërë kurban quhet Kurbanet gjatë haxhit prehen po këtu.
3. Uji që buron brenda mesxhidu'l-haramit dhe përreth Qabes quhet
4. Petku i, të cilin jemi të detyruar që ta mbajmë të veshur gjatë kryerjes së haxhit, shpreh faktin se postet dhe rangjet e kësaj bote janë të parëndësishme dhe se ne jemi të gjithë të barabartë përpara Allahut.
5. Myslimanët që sillen rrotull rreth ndërtesës së bekuar të e adhurojnë Allahun e Lartësuar ashtu siç e adhurojnë Atë planetët që sillen përçark diellit dhe elektronet që sillen përçark bërthamës.
6. Profeti ynë ka thënë: "Ai që e viziton varrin tim është sikur të më ketë vizituar mua"
7. Njeriu që e kryen haxhin pa thënë asnjë fjalë të keqe dhe pa kryer asnjë gjynah të madh kthehet në shtëpinë e tij ashtu siç ka qenë ditën që e ka lindur nëna e tij"



KURBANI

SIMBOLI I DOREZIMIT NDAJ URDHRAVE HYJNORE

- ❁ *Përkufizimi i kurbanit*
- ❁ *Si pritet kurbanit në përputhje me rregullat e fesë?*
- ❁ *Çfarë përfitojmë nga sakrifikimi i kurbanit?*
- ❁ *Kurbani i mirënjohjes (adak)*
- ❁ *Kush duhet të presë kurban?*
- ❁ *Kurbani kur lind fëmijë (akika)*
- ❁ *Kafshët që mund të bëhen kurban*
- ❁ *Profeti ynë Muhamedi dhe kurbanit*



SPROVIMI I MIQESISE

Një natë prej netësh profeti Ibrahim pa në ëndërr sikur ishte duke e bërë kurban të birin, Ismailin. Në fillim nuk i dha rëndësi asaj, por kur ëndrrën filloi ta shihte disa netë me radhë, kuptoi se kjo qe një shpallje hyjnore që i komunikojë nëpërmjet ëndrrës. Allahu dëshironte që ai të bënte kurban birin e tij Ismailin.

Profeti Ibrahim djalin e tij konsideronte dhuratë nga Zoti. Tashmë prej tij kërkohej që ta bënte kurban djalin e tij të dashur i cili qe rritur dhe kishte hyrë në moshë të pubertetit. Nuk kishte asnjë dyshim se kjo qe një sprovë shumë e rëndë për profetin Ibrahim, që kishte mbërritur gradën shpirtërore të mikut të Allahut (halilull-Ilah).

Të nesërmen në mëngjes Ibrahim mori me vete Ismailin dhe atë e bir u nisën rrugës nga Meka për në Mina. Kur mbërritën në Mina, Ibrahim nisi t'i rrëfente Ismailit pak nga pak ëndrrën që kishte parë. Pasi i bëri të ditur se që të dy ishin vënë në një sprovë shumë të madhe nga ana e Allahut, Ibrahim i tha Ismailit:

“Biri im, kam parë ëndërr sikur isha duke të bërë kurban. Ç’ mendon ti rreth kësaj?” As shenja më e vogël e frikës dhe e shqetësimit nuk ishte shfaqur në zemrën e Ismailit që i kishte dëgjuar në qetësi ato që i kishte rrëfyer Ibrahim. A nuk është Allahu Ai që ta merr jetën, ashtu sikur se ta dhuron atë? Zotëruesi i jetëve të njerëzve, Allahu kërkonte prej tij të merrte jetën që Ai ia kishte dhuruar atij. I zhytur në këto mendime Ismaili i tha shkoqur të atit se ai do t'i bindej urdhrit të Allahut duke iu mbështetur caktimit hyjnor dhe duke iu bindur atij, pastaj shtoi këto fjalë:

“Babai im i dashur! Vepro atë që të është urdhëruar! Në dashtë Zoti, do të shohësh se unë do të duroj.”

Kjo përgjigje e Ismailit sa e gëzoi, aq edhe e preku thellë në zemër profetin Ibrahim. Sytë iu përplotën. Teksa shihte me dashuri birin e tij që zotëronte një besim aq të madh në caktimin hyjnor, Ibrahim falënderonte Allahun që i kishte falur një djalë të këtillë.

Ibrahim e shtriu përmbys të birin në tokë dhe u përgatit që të çonte në vend urdhrin e Allahut. Ndërsa shprehte “Bismilahir rahmanir rahim” për t'i mëshuar thikës dhe përsëriste fjalët “Zoti im, ja tek jam



duke e zbatuar urdhrin tënd”, dëgjoji një zë që vinte nga Allahu dhe i thoshte:

“O Ibrahim! Ti e tregove varësinë tënde ndaj urdhrit hyjnor duke çuar në vend atë që t’u urdhërua për të bërë nëpërmjet ëndrrës. Kjo që një sprovë e pastër. Ne po të dhurojmë një kafshë për kurban në vend të djalit tënd.” (Saffat, 102-107)

Ndërkohë engjëlli Xhebrail me urdhër të Allahut të Lartësuar i kishte sjellë Ibrahimit një dash nga xheneti. Teksa nga sytë i rridhnin lot gëzimi, Ibrahim i ngriti të birin nga toka, e mori në krah dhe e përqafoi fort. E falënderoi Allahun që ia

kishte dhuruar sërish të birin dhe pastaj bëri kurban dashin që engjëlli Xhebrail i kishte sjellë nga parajsa. Me këtë ngjarje Allahu ua tregoi edhe njëherë engjëjve dhe njerëzimit mbarë varësinë e Ibrahimit dhe anëtarëve të familjes së tij ndaj vendimit hyjnor dhe durimin e tyre. Kjo që një sprovë miqësie dhe afërsie. Profetët Ibrahim dhe Ismail iu bindën pa shprehur asnjë ngurrim urdhrit të Allahut dhe dolën të fituar nga kjo sprovë e rëndë.



ÇFARË ESHTË KURBANIT?

Çfarë është kurbanit?

✍️ Kurban quhet adhurimi fetar që konsiston në prerjen e kurbanit të kafshëve me veçori të përcaktuara fetarisht gjatë ditëve të bajramit.

😊😊😊 Prerja e kurbanit fetarisht është vaxhib.

📖 Rituali fetar i kurbanit ekzistonte edhe para shpalljes së fundit të besimit Islam nëpërmjet profetit Muhamed. Profeti Ibrahim në vend të djalit të tij, Ismailit, bëri kurban dashin që ia kishte dërguar Allahu me atë rast. Që prej kohës së profetit Ibrahim të gjithë profetët që erdhën pas tij, kanë prerë kurban dhe ia kanë mësuar këtë detyrë fetare edhe pjesëtarëve të bashkësive të tyre.

✍️ Vetë profeti ynë Muhamedi na ka mësuar se kur dhe si duhet kryer ky adhurim fetar. Detyrën e prerjes së kurbanit për njeriun që mund ta kryejë atë nuk e zëvendëson asnjë adhurim tjetër që do të kryhet me synim zëvendësimin e këtij riti fetar, siç është lëmosha (sadaka), namazi etj.

Kur prehet kurbanit?

Kurbanit mund të prehet ditën e parë, të dytë apo të tretë të bajramit të kurbanit. Ditën e tretë pasi të ketë perënduar dielli, nuk prehet kurban.

Allahu thotë:

“Fale namazin dhe preje kurbanin për hir të Zotit tënd.”

(Kevther 2)

Allahu thotë:

“Ne ia kemi mësuar adhurimin e kurbanit bashkësisë së çdo profeti, në mënyrë që ata ta përmendin emrin e Allahut teksa janë duke prerë kurban kafshët që ne ua kemi dhënë si begati.”

(Haxh 34)

Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Ai njeri që e ka mundësinë financiare, por nuk pranon të presë kurban, le të mos i afrohet xhamive tona.”

(Ibn Maxhe, Edahi, 2)





ÇFARE PERFITOJME DUKE PRERE KURBAN?

KURBANI



- * na afron me Allahun.
- * shton ndjenjën tonë të lidhjes dhe nënshtrimit ndaj urdhrave të Allahut.
- * na mëson shprehinë e ndarjes me të tjerët të begatave që na ka mundësuar Allahu.
- * forcon mes myslimanëve lidhjet e dashurisë, mbështetjes dhe ndihmës të ndërsjellët.

Allahu i do ata njerëz që i binden urdhrave të Tij me zemër të gëzuar dhe është i kënaqur me ata njerëz që i kryejnë adhurimet e tyre ndaj Tij. Edhe ne zbatojmë një prej urdhrave të Allahut kur presim kurban dhe kështu ne fitojmë kënaqësinë e Allahut, afrohemi më shumë me Të dhe na rritet tek Ai vlera jonë si besimtarë.

Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Një nga adhurimet më me vlerë që mund të kryejë njeriu ditët e bajramit të kurbanit me qëllim afrimin me Zotin, është prerja e kurbanit. Pa rënë në tokë ende gjaku i kurbanit të prerë, vlera e besimtarit dhe pozita e tij do të lartësohen tek Allahu. Prandaj u këshilloj që kurbanet t’i prisni me zemër të gëzuar.”

(Tirmidhi, Edahi, 1)




Kurbani na mëson shprehinë e ndarjes me të tjerët të begative që na ka mundësuar Allahu. Duke ua ndarë të varfërve një pjesë të mishit të kurbanit që kemi prerë ditëve të bajramit të kurbanit, ne i gëzojmë ata. Edhe ne personalisht ndjehemi të lumtur nga fakti që bëhemi shkak që të gëzohen zemrat e nevojtarëve në këtë botë dhe nga ana tjetër, fitojmë sevape që do të na shpërblehen me një jetë të lumtur në botën e përjetshme (ahiret).




Familja e profetit Muhamed kishte prerë një dele dhe me përjashtim të një shpatulle pjesën tjetër të mishit ia kishin shpërndarë nevojtarëve. Kur erdhi profeti dhe i pyeti se çfarë kishte mbetur nga mishi i deles që kishin therur, bashkëshortja e tij, Aisheja, iu përgjigj me fjalët: “Na ka mbetur vetëm një copë shpatull. Pas kësaj përgjigjeje profeti Muhamed i tha kështu Aishesë duke i përkujtuar sevapin që kishin në botën tjetër (ahiret): “Pse nuk thua se e gjitha na paska mbetur neve me përjashtim të një shpatulle.”

(Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 33)




Allahu është ai që na ka falur edhe jetën, edhe pasurinë tonë. Të gjitha begatitë vetëm atij i takojnë. Ndërsa jemi duke prerë kurban ne, ashtu sikur se ngjau dhe me profetin Ibrahim, mendojmë se të gjithë begatitë i përkasin vetëm Allahut dhe shprehemi me fjalë se ne i dorëzohemi me gjithë zemër urdhrave të Tij. Në këtë mënyrë kurban bën që ne të kapemi më shumë pas urdhrave të Allahut dhe të jemi të nënshtruar ndaj Tij.



Allahu thotë:

“O Ibrahim! Ti e tregove varësinë tënde ndaj urdhrave tanë duke zbatuar ç’të është urdhëruar nëpërmjet ëndrrës. Kjo ishte një provë e hapur për ty. Ne e zëvendësuar birin tënd me një kurban.”

(Saffat 105-107)



Kurbani është një mjet ndihme për të mbuluar nevojën e të varfërve me mish, të cilin ata nuk mund ta blejnë për shkak të pamundësisë ekonomike. Mendjemadhësia dhe zilia që mund të shkaktohen nga diferencimet e pasur - i varfër pakësohen, duke kontribuar kështu në realizimin e barazisë shoqërore. Vizitat dhe gostitjet e ndërsjella që bëhen gjatë bajramit të kurbanit, na afrojnë më shumë me njëri-tjetrin, duke e forcuar më shumë dashurinë, mbështetjen dhe ndihmesën mes nesh.



Allahu thotë:

“Hani vetë nga mishi i kurbaneve që prehen duke u përmendur emri i Allahut, por edhe shpërndajuni të varfërve për të ngrënë edhe ata nga ai mish...”

(Haxh 28)



Kush e ka të detyruar fetarisht që të presë kurban?

Çdo
mysliman

- * me gjendje të mirë psikike,
- * që ka mbushur moshën e pubertetit,
- * që është i lirë,
- * që gjendet në zonën ku jeton (pra, nuk është udhëtar) dhe
- * që fetarisht konsiderohet i kamur,

e ka vaxhib prerjen e
kurbanit



Kafshët që bëhen kurban:

- ✓ Delja, dashi, cjapi dhe dhia nga kafshët e imta;
- ✓ Gjedhi dhe deveja nga kafshët e mëdha.

Delja



që ka mbushur
moshën 1 vjeçe



bëhet kurban

për 1 person.

Dhia



që ka mbushur
moshën 1 vjeçe



bëhet kurban

për 1 person.

Gjedhi



që ka mbushur
moshën 2 vjeçe



bëhet kurban

për 1 deri në 7 persona.

Deve



që ka mbushur
moshën 5 vjeçe



bëhet kurban

për 1 deri në 7 persona.

Kafshët që do të bëhen kurban duhet të jenë

- ✓ Në gjendje shëndetësore të mirë,
- ✓ Dhe pa ndonjë të metë e cila na pengon që t'i bëjmë kurban si p.sh. të jenë të verbra apo me dhëmbë të rënë.

SI PRITET KURBANI?

- ☉ Kafsha që do të bëhet kurban duhet shpënë në thertore pa e lënduar.
- ☉ Ajo shtrihet përtokë mbi krahun e saj të majtë dhe e drejtuar nga kibla. I lidhen këmbët.
- ☉ Recitohen me zë tekbirët teshrik.
- ☉ Duke thënë “Bismilah, Allahu ekber!” pritet në fyt.

Fetarisht konsiderohet sunet të lexojmë këtë lutje, ndërsa presim kurbanin:

إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ
رَبِّ الْعَالَمِينَ

“...Pa dyshim, namazi im, kurbanin im, vdekja dhe jeta ime janë për Allahun, Zotin e botëve mbarë...!” 😊😊

Tekbiri teshrik është:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ
اللَّهُ أَكْبَرُ وَاللَّهُ الْحَمْدُ

“Allahu ekber, Allahu ekber, La ilahe il-lall-llahu vall-llahu ekber, Allahu ekber ve lil-lahi'l-hamd”

“Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi, Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, prandaj Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi dhe atij i takon lavdërimi.”

✍ Fetarisht konsiderohet më me vend që kurbanin ta presë personi që e ka blerë atë për llogari të tij. Ata që nuk mund ta presin me duart e tyre, mund t'i kërkojnë një myslimani tjetër që i di rregullat e prerjes së kurbanit, që ta

presë kurbanin në emrin e atij që e ka blerë atë. Në këtë rast, është sevap që i zoti i kurbanit të gjendet pranë kurbanit të tij, që po pritet dhe të lexojë lutje fetare.





Për çfarë duhet të tregojmë kujdes gjatë prerjes së kurbanit?



- ❖ Kurbanit duhet prerë nga njerëz që i dinë rregullat fetare të prerjes së kurbanit,
- ❖ Duhet të sillemi me butësi ndaj kafshës, që është duke u dërguar për t'u prerë si kurban,
- ❖ Po qe se është e mundur, kafshës për kurban duhet t'i lidhen sytë dhe këmbët,
- ❖ Thika që do të përdoret duhet të jetë e mprehur,
- ❖ Ambienti përreth nuk duhet ndotur.

Si ndahet mishi i kurbanit?

- ☉ Në përgjithësi mishi i kurbanit ndahet në tri pjesë.
 - Njëra prej këtyre tri pjesëve i shpërndahet të varfërve.
 - Njëra prej këtyre tri pjesëve i dhurohet të afërmëve, fqinjëve dhe mysafirëve.
 - Njëra prej këtyre tri pjesëve ruhet për nevojat e shtëpisë.
- ✍ Personi që pret kurbanin ka të drejtë që gjithë mishin e kurbanit që pret, t'ua ndajë të varfërve.

Çfarë bëhet me lëkurën e kurbanit?

- ☺ Lëkura e kurbanit, mund t'i jepet në formë ndihme financiare njëres prej kategorive që meritojnë të marrin zekat.
- ☺ Mund t'i jepet institucioneve fetare, bamirëse apo arsimore siç janë: xhamitë, shkollat apo shoqatat bamirëse.
- ☹ Nuk është e lejuar që lëkura e kurbanit t'i dhurohet vendeve që fetarisht vlerësohen të papërshtatshme.

KURBANI I ZOTIMIT ☺☺☺

✍ Kurbani i zotimit është kurban që kemi dhënë fjalën se do ta presim për kënaqësi të Allahut.

Prerja e këtij kurban fetarisht konsiderohet vaxhib.

Kurbani i zotimit është dy llojesh:

1. Kurbani i zotimit në varësi të një përfundimi në jetën e përditshme.

➡ Në rast se zotohemi në lidhje me diçka, fjala vjen “do të pres kurban në qoftë se më

shërohet im atë” jemi të detyruar fetarisht që ta presim këtë kurban në momentin që prindi shërohet.

2. Kurbani i zotimit që nuk varet nga asnjë përfundim në jetën e përditshme.

➡ Po qe se themi “do të pres një kurban për hir të Allahut” jemi të detyruar fetarisht që ta presim kurbanin që nga momenti që jemi betuar.

Cilët kafshë mund të priten si kurbanë të zotimit?

✓ Kafshët si: deleja, dashi, cjapi, dhia, gjedhi dhe deveja mund të priten si kurbanë të zotimit.

✗ Kafshët shtëpiake siç janë: pula, gjeli, pata etj., as mund të priten si kurbanë me rastin e festës së Bajramit të kurbanit dhe as si kurbanë të zotimit.

Si shpërndahet mishi i kurbanit të zotimit?

✓ Kafsha që pritet si kurban i zotimit duhet t'i shpërndahet tërësisht të varfërve.

✗ Personi që bën zotimin nuk mund të ha nga mishi i kurbanit të zotimit.

✗ Po kështu edhe pjesëtarët familjarë të personit që ka bërë zotimin, siç janë: babai, nëna,

fëmijët, gjyshi, gjyshja dhe nipat. Ata nuk mund të përdorin pjesë të kurbanit siç janë: lëkura dhe zorrët. Në rast se ata hanë nga mishi i këtij kurban, atëherë duhet t'u shpërndajnë të varfërve vlerën monetare të asaj që kanë konsumuar.

KURBANI ME RASTIN E LINDJES SE FEMIJES ☺☺

✍ Kurbani akika është kurban që pritet në shenjë falënderimi ndaj Allahut, kur në shtëpi lind fëmijë.

☺☺ Të presh kurban me rastin e lindjes së fëmijës fetarisht është sunet, pra, praktikë që e ka kryer profeti ynë, Muhamedi (a.s.).

📖 Afati për prerjen e kurbanit të akikës është prej ditës që lind fëmija deri sa të hyjë në moshën

e pubertetit. Por fetarisht është më e pëlqyer që ky kurban të pritet ditën e shtatë të lindjes së foshnjës.

✓ Kafshët, si: delja, dashi, cjapi, dhia, gjedhi dhe deveja mund të priten si kurban akika.

✓ Nga mishi i kurbanit akika mund të hanë edhe i zoti që e ka prerë kurbanin, edhe të afërmit e tij.

PROFETI YNE DHE KURBANIT



Profeti ynë Muhamedi i kushtonte shumë rëndësi adhurimit fetar të kurbanit. Ai priste kurbanë çdo vit pas vitit të emigrimit të tij nga Meka për në Medine dhe i nxiste edhe shokët e tij (sahabe) që të thernin kurbanë duke u thënë se “Asnjë njeri nuk mund të bëjë ndonjë vepër më të bukur se sa të presë kurban në qoftë se dëshiron t’i afrohet Zotit të tij ditët e Bajramit të kurbanit”. Ai personalisht e priste plot gëzim kurbanin.

Kurbanin e parë profeti Muhamed e preu vitin e dytë të hixhretit. Ditën e Bajramit të atij viti ai së bashku me shokët e tij (sahabe) shkuan së bashku në një vend faljeje (namazgjah) të hapur dhe të gjerë. Pasi falën namazin u mbajti të pranishmëve një ligjëratë (hutbe) në të cilën i urdhëroi myslimanët që të pritnin kurban. Ai personalisht preu dy kurbanë, një për veten e tij dhe tjetrin për umetin mysliman duke iu drejtuar Allahut në lidhje me kurbanin e dytë me këtë lutje: “Zoti im! Këtë kurban e pres në emër të atyre myslimanëve që nuk kanë mundësi financiare që të presin kurban sot.” Teksa kafshët e kurbanit i shtrinin përtokë, profeti Muhamet u lut me këto fjalë: “I ktheva sytë nga Ai që

krijoi qiejt edhe tokën. Unë nuk jam nga ata që i mveshin shok dhe ortak Allahut. Namazi im, të qënit tim rob ndaj Krijuesit, adhurimet e mia, jeta dhe vdekja ime i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve, që nuk ka të ngjashëm me të. Unë jam i pari mysliman. O Zoti im! Ky kurban është nga begatitë që na ke dhënë Ti dhe për hirin Tënd po e flijojmë. O zoti im, pranoi këta kurbanë që flijojnë për hirin tënd, Muhamedi dhe pasuesit e tij”. Pastaj Profeti tha: “Bismilah, Allahu ekber!” dhe preu kurbanin. (Tirmidhi, Edahi, 22)

Profeti ynë i dashur urdhëronte të sillemi mirë me të gjitha krijesat e Allahut. Atij nuk i pëlqente aspak që njeriu të sillej ashpër dhe pa dhembshuri apo ta torturonte kafshën e kurbanit.

Profeti ynë i dashur ka thënë:

“Allahu na ka urdhëruar që të sillemi mirë ndaj çdo krijese. Prandaj edhe kur të jeni të detyruar të vrisni një krijesë, vriteni atë pa i shkaktuar vuajtje. Kur ta prisni në fyt një kafshë, këtë bëjeni në formën më të lehtë që të mos i shkaktoni dhimbje të zgjatura asaj. Personi, që ka për ta kryer këtë punë, le ta mprehë mirë thikën në mënyrë që të mos i shkaktojë dhimbje të mëdha kafshës.”

(Muslim, Sajd, 57)

Një herë Profeti ynë Muhamedi (a.s.) pa një person që ishte duke prerë një dele. Personi në fjalë e kishte shtrirë përtokë kafshën e ngratë dhe po mprehte thikën përpara saj. I dërguari i Allahut, që nuk u pajtua aspak me këtë veprim të pandjeshëm dhe mizor të personit, iu drejtua atij me këto fjalë: “A dëshiron ta mbysësh disa herë këtë kafshë të gjorë?! A nuk mundesh ta mprehësh thikën para se ta shtrishë kafshën për tokë?”

(Hakim, Mustedrek, IV, 231, 233)

PYETJET



Të kontrollojmë njohuritë tona

Shënoni me shenjën (x) në njërën nga dy kutitë e mëposhtme, të saktën kur fjalia është e vërtetë dhe të gabuarën kur fjalia është jo e saktë.

- Kurbani theret me qëllim: afrimin ndaj Allahut dhe fitimin e kënaqësisë së Tij. E SAKTË E GABUAR
- Një mysliman duhet të presë të paktën një kurban gjatë gjithë jetës së tij. E SAKTË E GABUAR
- Delja dhe dhia mund të bëhen kurbanë vetëm për një person, ndërsa gjedhi dhe deveja për një deri në shtatë persona. E SAKTË E GABUAR
- Personi që pret kurbanin e zotimit, si dhe prindërit e tij, fëmijët dhe nipërit nuk mund të hanë nga mishi i atij kurbanit. E SAKTË E GABUAR
- Mishin e kurbanit duhet t'ia shpërndajmë të tërin të varfërve. E SAKTË E GABUAR

Le të testojmë vetveten

- Cili është vendimi fetar për prerjen e kurbanit në Bajramin e kurbanit?
 - Farz
 - Sunet
 - Vaxhib
 - Mubah
- Si quhen pejgamberët që u sprovuan nëpërmjet kurbanit?
 - Hz. Ibrahim - Hz. Is'hak
 - Hz. Davud - Hz. Sulejman
 - Hz. Jakup - Hz. Jusuf
 - Hz. Ibrahim - Hz. Ismail
- Cili nga veprimet e mëposhtme nuk është kusht për të prerë kurbanin?
 - Të jesh mysliman
 - Të jesh psikikisht i shëndoshë dhe në moshë të pubertetit.
 - Të jesh i shëndetshëm.
 - Të zotërosh sasinë e pasurisë të nisabit.
- Si quhet kurbanit që prehet në shenjë falënderimi kur lind fëmija?
 - Kurbani akika.
 - Kurbani i zotimit.
 - Kurbani i betimit.
 - Kurbani hedjit.
- Cila nga veprimet e mëposhtme nuk realizohet me therjen e kurbanit?
 - Na afron tek Allahu.
 - E organizojmë jetën tonë të përditshme.
 - Shton lidhjen tonë me urdhërat e Allahut dhe nënshtrimin tonë ndaj tyre.
 - Zhvillon tek ne shprehinë e ndarjes me të tjerët së të mirave materiale që na ka dhuruar Allahu.

Vendosni fjalët që gjenden mes kllapave në vendet e duhura.

(të pasur, Allahu, vierën e, tërësisht, devotshmëria juaj, mundim, i tretë, adhurimet e mia, e lejuar, sunet)

1. Kurbanin na përkujton se duhet të sakrifikojmë edhe pasuritë dhe jetën tonë për
2. "Nuk ka dyshim se namazi,, jeta dhe vdekja ime janë për Allahun Zotin e botëve."
3. Mishi i kurbanit që theret si zotim për diçka duhet t'i shpërndahej nevojtarëve
4. Kur të therni një kafshë priteni atë në mënyrën më të bukur, duke mos i shkaktuar asnjë mundim. Personi që ka për ta therrur kurbanin, le ta mprehë mirë thikën dhe të mos i shkaktojë kafshës"
5. As gjaku, as mishi i kurbaneve do të mbërrijën tek Allahu, por tek Ai do të mbërrijë vetëm"



PERGJIGJET E SAKTA TE PYETJEVE

Kapitulli i adhurimit

Të kontrollojmë njohuritë, fq. 17

1- Saktë 2- Gabim 3- Gabim 4- Saktë 5- Saktë

Të testojmë veten tonë, fq. 17

1- D 2- B 3- C 4- D 5- C

Plotësim boshllëqesh, fq. 18

1- Adhurimi im 2- Është adhurim 3- Sjelljet tona 4- Allahu 5- Te falënderojmë

Kapitulli detyrat dhe përgjegjësitë e Mukelefit

Të kontrollojmë njohuritë, fq. 27

1- Saktë 2- Gabim 3- Saktë 4- Saktë 5- Saktë

Të testojmë veten tonë, fq. 27

1- B 2- D 3- A 4- C 5- A

Plotësim boshllëqesh, fq. 28

1- Mukellef 2- Farz 3- Farz-i ajn 4- Farz-i kifaje 5- Vaxhib 6- Sunet-i muekkede
7- Mustehab 8- Mubah 9- Haram 10- Mekruh

Kapitulli i pastërtisë

Të kontrollojmë njohuritë, fq. 41

1- Saktë 2- Gabim 3- Saktë 4- Gabim 5- Saktë

Të testojmë veten tonë, fq. 41

1- A 2- A 3- C 4- D 5- A

Plotësim boshllëqesh, fq. 42

1- Gjysma 2- Pastër 3- Që pastrohen 4- Fëlliqësi 5- Papastërti

Kapitulli i abdestit

Të kontrollojmë njohuritë 1, fq. 66

1- Saktë 2- Gabim 3- Saktë 4- Gabim 5- Saktë

Të testojmë veten tonë 1, fq. 66

1- C 2- D 3- C 4- B 5- D

Plotësim boshllëqesh 1, fq. 67

1- Tri herë 2- Sunet 3- Misvak 4- Mekruh 5- Farz

Kapitulli i Gusulit

Të kontrollojmë njohuritë 2, fq. 67

1- Saktë 2- Saktë 3- Gabim 4- Gabim 5- Gabim

Të testojmë veten tonë 2, fq. 68

1- B 2- A 3- D 4- C 5- A

Vendosni në hapësirat boshe fjalët brenda kllapës 2 Sh: 68

1- Gojen dhe hundën 2- Farz 3- Sunet 4- Mekruh 5- Tejemum

Kapitulli i namazit

Të kontrollojmë njohuritë 1, fq. 122

1- Saktë 2- Gabim 3- Gabim 4- Saktë 5- Gabim 6- Saktë 7- Gabim 8- Gabim
9- Saktë 10- Saktë

Të kontrollojmë njohuritë 2, fq. 122

1- Gabim 2- Gabim 3- Gabim 4- Saktë 5- Gabim 6- Gabim 7- Saktë 8- Gabim
9- Gabim 10- Saktë

Të kontrollojmë njohuritë 3, fq. 123

1- Saktë 2- Saktë 3- Saktë 4- Gabim 5- Saktë

Të testojmë veten tonë 1, fq. 124

1- B 2- A 3- B 4- B 5- C 6- B 7- C 8- D 9- B 10- D 11- A
12- C 13- A 14- C 15- C

Të testojmë veten tonë 2, fq. 125

1- D 2- B 3- A 4- B 5- C 6- A 7- A 8- A 9- B 10- B

Të testojmë veten tonë 3, fq. 127

1- D 2- D 3- B 4- A 5- C 6- B 7- C 8- C 9- A 10- B

Vendosni në hapësirat boshe fjalët brenda kllapës 1 Sh: 128

1- Tehexhut 2- mbulimi i avretit 3- Drejtimi nga Kibla 4- Kiraet 5- Sexhde

Vendosni në hapësirat boshe fjalët brenda kllapës 2 Sh: 128

1- Djatht 2- Hutbe 3- Teshrik 4- Kifaje 5- Me shenjë 6- Gjynah 7- Sehiw 8- Tilavet

Kapitulli i agjërit

Të kontrollojmë njohuritë tona, fq. 155

1- Saktë 2- Saktë 3- Saktë 4- Gabim 5- Gabim 6-Gabim 7- Gabim 8- Saktë

Të testojmë vetveten, fq. 155

1- A 2-B 3-C 4- A 5- B 6- C 7- D 8- B 9- A

Vendosni fjalët që gjenden mes kllapave në vendet e duhura, fq. 156

1-mëshirë, falje 2- shëndet 3- gjastë dhjetë e një 4- kaza 5- zotim 6- i aftë, afet 7- rejjan

Kapitulli i zekatit

Të kontrollojmë njohuritë tona, fq. 185

Ata që zotërojnë sasinë e nisab-it fetarisht numërohet për i pasur

Një të dyzetën e arit apo argjendit me një fjalë tjetër ne japim si zekat 2.5 %

Një person nipave të tij nuk u jep zekat.

Ndërsa japim zekatin, nuk duhet të harrojmë se jemi duke kryer një adhurim fetar.

Institucioneve siç janë: xhamitë, shkollat, spitaleve dhe për punë të tjera bamirësie siç janë: rrugë, ura, kroje nuk u jepet zekat

Zekati, mundësitë ekonomike të të pasurve shërben si një urë lidhëse me të varfrit.

Një mysliman i pasur, një pjesë të pasurisë së tij quhet “zekat” dhënia personave që na ka urdhëruar feja jonë.

Dora që jep është më superiore sesa dora që merr.

Sasia e nisabit për arin është 80.18 gram.

Kufiri minimal i sasisë së sadakasë së fitrit është ushqimi për dy vakte i një njeriu në gjendje ekonomike të mesme apo vlera në lekë e këtyre ushqimeve.

Të testojmë vetveten, fq. 185

1- D 2- A 3- C 4- A 5- B 6- D 7- C 8- D

Vendosni fjalë që gjenden mes kllapash në vendet e duhura, fq. 186

1-që nuk lutet 2- në pasuritë e tyre 3- e një cope 4- e zemrës 5- pastron

Kapitulli i haxhit

Të kontrollojmë njohuritë tona, fq. 217

1- Saktë 2- Saktë 3- Gabim 4-Gabim 5- Saktë 6- Saktë 7- Saktë 8- Saktë

Të testojmë vetveten, fq. 217

1- C 2- A 3- C 4- B 5- D 6- C 7- B 8- A 9- D 10- A

Vendosni fjalë që gjenden mes kllapash në vendet e duhura, fq. 218

1-Makamu'l-Ibrahim 2- Mina 3- Zemzem 4- Ihram 5- Qabe 6- në jetën time 7- pa gjynahe

Kapitulli i Kurbanit

Të kontrollojmë njohuritë tona, fq. 231

1- Saktë 2- Gabim 3- Saktë 4- Saktë 5- Gabim

Të testojmë vetveten, fq. 231

1- C 2- D 3- C 4- A 5- B

Vendosni fjalë që gjenden mes kllapash në vendet e duhura, fq. 232

1-Allah 2- Adhurimet e mia 3- tërësisht 4- mundim 5- devotshmëria juaj

SURET DHE DUATË E NAMAZIT

Sureja el-Fatiha

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ❖ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ❖ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمِ ❖ مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ ❖
 إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ❖ اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ❖
 صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ❖

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

“El-hamdu lil-lahi rabbi’l-’alemin. Er-rahmanir-rahim. Maliki jeumid-din.

Ij-jake na’ebudu ve ij-jake neste’in. Ihdinas-sirata’l-mustekim. Siratal-ledhine en’amte alejhim, gajri’l-magdubi alejhim ve led-daal-lin. Amin.”

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
2. Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, 3. të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit,
4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit. 5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.
6. Udhëzona në rrugën e drejtë! 7. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!

Sureja el-Fil

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ ❖ أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضَلِيلٍ ❖
 وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ ❖ تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ ❖ فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ ❖

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

“Elem tera kejfe fe’ale Rabbuke bi as’habil-fil. E lem jexh’al kejdehum fi tadril.

Ver ersele alejhim tajran ebabil. Termihim bi hixharatim-min sixh-xhil.

Fexhe’alehum ke asfim-me’ kul.”

- Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?
 2. A nuk ua prishi atyre kurthin, 3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,
 4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur? 5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrenë.

Sureja el-Kurejsh

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
❖ لِإِيلَافِ قُرَيْشٍ ❖ إِيْلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ
❖ فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ ❖ الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rahim

“Li ilafi Kurajsh. Ilafihim rihletesh-shitai ves-sajf. Fel ja’budu Rabbe hadhel-bejt. El-ledhi et’amehum min xhu’in ve amenehum min hauf.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. (Shkatërrimin e njerzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh,
2. për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë.
3. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes),
4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.

Sureja el-Maun

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
❖ أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْإِيمَانِ ❖ فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْبَيْتِ
❖ وَلَا يُحِضُّ عَلَىٰ طَعَامِ الْمِسْكِينِ ❖ فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ ❖ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ
❖ الَّذِينَ هُمْ يُرْأُونَ ❖ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rahim

“E raejtel-ledhi jukedh-dhibu bid-din. Fe dhalikel-ledhi jedu’ul-jetim. Ve la jehuddu ala ta’amil miskin. Fe vejlul-lil musal-lin. El-ledhine hum an salatihim sahun. El-ledhine hum jura’un. Ve jemneunel maun.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?
2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimet
3. dhe nuk nxit që t’i jepet ushqim të varfrit.
4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,
5. janë të pakujdesshëm për namazet,
6. të cilët duan vetëm që të duken
7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.

Sureja el-Keuther

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ ❖ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحَرْ ❖ إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim
“Inna a’ëtajnakel-keuther. Fe sal-li li Rabbike ven-har. Inne shanieke huvel-ebter.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira,
2. andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!
3. Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë.

Sureja el-Kafirun

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ❖ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ❖ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ
وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ ❖ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ ❖ لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim
“Kul ja ejjuhel kafirun. La a’ëbudu ma ta’ëbudun. Ve la entum abidune ma a’ëbud. Ve la ene abidum ma abettum. Ve la entum abidune ma a’ëbud. Lekum dinukum ve lije diin.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Thuaj: “O ju mosbesimtarë!
2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni
3. dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.
4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni
5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!
6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”

Sureja el-Nasr

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ ❖ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا ❖
فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا ❖

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

“Idha xha’e nasrull-lahi vel fet’h. Ve ra’ejten-nase jed’hulune fi dinil-lahi efvaxha.
Fe sebbih bi hamdi Rabbike vestagfirhu innehu kane tevvaba.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)
2. dhe t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupegrupe,
3. atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.

Sureja el-Mesed

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ ❖ مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ ❖ سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ ❖
وَأَمْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ ❖ فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ ❖

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

“Tebbet jeda Ebi Lehebin ve tebb. Ma agna anhu maluhu ve ma keseb. Se jasla naran dhate Leheb. Vemra’etehu hammaletel-hatab. Fi xhidiha hablum mim mesed.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!
2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera.
3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,
4. po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,
5. në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme.

Sureja el-Ihlas

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ❖ اللَّهُ الصَّمَدُ ❖ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ❖ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ❖

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim
 “Kul huvall-llahu ehad. All-llahus-samed. Lem jelim ve lem juled.
 Ve lem jekul-lehu kufuven ehad.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!
2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.
3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.
4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”

Sureja el-Felek

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ❖ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ❖ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ❖
 وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ❖ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ❖

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim
 “Kul e’udhu bi Rabbil felek. Min sherri ma halek. Ve min sherri gasikin idha vekab.
 Ve min sherrin-neffathati fil ukad. Ve min sherri hasidin idha hased.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve,
2. Sundimtari i njerëzve,
3. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,
4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)
5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,
6. (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!”

Sureja el-Nas

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
﴿ قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴾ ﴿ مَلِكِ النَّاسِ ﴾ ﴿ إِلَهِنَا ﴾ ﴿ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ﴾
﴿ الَّذِي يُوسِّسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴾ ﴿ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ﴾

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

“Kul e’udhu bi Rabbin-nas. Melikin-nas. Ilahin nas. Min sherril vesvasil hannas. El-ledhi juvesvisu fi sudurin nas. Minel xhinneti ven nas..”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,
2. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar
3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri
4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)
5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë.”

Ajetul Kursi

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

“All-llahu laa ilahe il-la huve'l-hajjul-kajjum. La te`hudhuhu sinetun ve la neum. Lehu ma fis-semavati ve ma fi'l-Erd. Men dhel-ledhi jeshfe'u `indehu il-la bi idhnih. Ja`lemu ma bejne ejdiuhim ve ma halfehum, ve la juhitune bi shej'im min `ilmih i il-la bima shaa'e. Ves'i a kursij-juhus-semavati ve'l-Erd, ve la je'uuduhu hifdhuhuma ve huve'l-`alijju'l-`adhim.”

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?
Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiej dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!

Subhaneke

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ وَتَبَارَكَ اسْمُكَ وَتَعَالَى جَدُّكَ ❖ وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ ❖

“Subhanekell-llahumme ve bihamdike ve tebarake-smuke
ve te’ala xhedduke ve la ilahe gajruke.”

“Lavdërimi të takon Ty, o Zoti im! Ty të takon çdo falënderim! I lartësuar është emri Yt!
E paarritshme është madhëria Jote! Pos Teje s’ka zot tjetër”

Duaja e Kunitit

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْتَعِينُكَ وَنَسْتَغْفِرُكَ وَنَسْتَهْدِيكَ وَنُؤْمِنُ بِكَ وَنُتَوِّبُ إِلَيْكَ وَتَتَوَكَّلُ عَلَيْنَا
وَنُثْنِي عَلَيْكَ الْخَيْرَ كُلَّهُ نَشْكُرُكَ وَلَا نَكْفُرُكَ وَنَحْلَعُ وَنَتْرُكُ مَنْ يَفْجُرُكَ ❖
اللَّهُمَّ إِنَّاكَ نَعْبُدُ وَلَكَ نُصَلِّي وَنَسْجُدُ وَإِلَيْكَ نَسْعَا وَنَحْفِدُ نَرْجُو رَحْمَتَكَ وَنَخْشَا عَذَابَكَ
إِنَّ عَذَابَكَ بِالْكَفَّارِ مُلْحِقٌ ❖

“All-llahumme inna nesteinuke ve nestagfiruke ve nestehdike ve nu’minu bika ve netubu ilejke ve netevkkelu alejke ve nuthni alejkel hajra kul-lehu neshkuruke ve la nekfuruke ve nahle’u ve netruku men jefxhuruk.”

“All-llahumme ijijake na’budu ve leke nusal-li ve nesxhudu ve ilejke nes’a ve nahfidu nerxhu rahmeteke ve nahsha adhabeke, inne adhabeke bil kuffari mulhik.”

“O Zoti im, ne vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë, vetëm prej Teje falje kërkojmë, vetëm prej Teje udhëzim kërkojmë, vetëm Ty të besojmë, vetëm ndaj Teje kërkojmë ndjesë, vetëm në Ty mbështetemi, vetëm Ty për të gjitha të mirat të falënderojmë e lavdërojmë, vetëm Ty të falënderojmë e nuk të mohojmë dhe ne largohemi dhe e braktisim këdo që të përgënjeshton e të mohon Ty!”

“O Zoti im, ne vetëm Ty të adhurojmë, vetëm Ty të falemi, vetëm Ty të bëjmë sexhde, vetëm Ty të dëshirojmë dhe vetëm Ty të shërbejmë. Të lutemi për mëshirën Tënde e i frikohemi dënimit Tënd, se vërtet dënimi Yt do t’i kapë jobesimtarët!”

Et-tehijjatu

التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ ❖ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ
السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَائِ عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ ❖ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

“Ettehijjatu lil-lahi vessalavatu vettajjibatu, esselamu alejke ejjuhennebijju ve rahmetull-llahi ve berakatuhu, esselamu alejna ve ala ibadil-lahissalihin. Esh-hedu el-la ilahe il-lallah ve esh-hedu enne Muhammeden abduhu ve rasuluhu”.

“Nderimet më të mëdha i takojnë Allahut! Paqja dhe bekimi qofshin mbi ty, o i Dërguar! Mëshira dhe bekimi i Tij qofshin mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Allahut! Dëshmoj se vetëm Allahu është Zot dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij!”

Salavatet

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَخِيدٌ
اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَخِيدٌ

“All-llahumme sal-li ‘ala Muhammedin ve ‘ala ali Muhammed,
kema sal-lejte ‘ala Ibrahim ve ‘ala ali Ibrahim inneke hamidum-mexhid”.

“All-llahumme barik ‘ala Muhammedin ve ‘ala ali Muhammed,
kema barakte ‘ala Ibrahim ve ‘ala ali Ibrahim inneke hamidum-mexhid”.

“O Zoti im, nderoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e nderove Ibrahimin dhe familjen e tij!
Me të vërtetë, Ti je i lavdëruar dhe i lartësuar!”

“O Zoti im, bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij!
Me të vërtetë, Ti je i lavdëruar dhe i lartësuar!”

Rabbena atina

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

“Rabbena atina fid-dunja haseneten ve fil-ahirati haseneten
ve kina adhabennar”.

Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj
nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)


Mësoj adhurimet e mia



TASAVVUFI OSE
MISTIKA ISLAME
700 lekë / 5 €
300 Denar



QYTETËRIMI I VIRTYTEVE
700 lekë / 5 €
300 Denar




PERSONALITETI SHEMBULLOR
700 lekë / 5 €
300 Denar



OSMANËT
700 lekë / 5 €
300 Denar




BOTËKÛPTIMI ISLAM
400 lekë / 3 €
200 Denar



HZ. MUHAMMED MUSTAFA 1-2
1200 lekë / 10 €
600 Denar



VARGU I PROFETËVE 1-4
600 lekë / 5 €
300 Denar



FRYMËRA MËSHIRONJËSE
500 lekë / 4 €
200 Denar



ISLAMI, BESIMI
DHE ADHURIMI
300 lekë / 2.5 €
150 Denar



ENIGMA E DASHURISË
PËR ALLAHUN DHE PROFETIN
300 lekë / 2.5 €
150 Denar




MUHAMMED MUSTAFA
250 lekë / 2 €
120 Denar



FEJA IME E BUKUR 1
300 lekë / 2 €
120 Denar



FEJA IME E BUKUR 2
së shpejti...



**40 HADITHE
ME TREGIME PËR FEMIJË**
150 lekë / 1 €
60 Denar



**HAXHI IDEAL
DHE UMREJA**
200 lekë / 1 €
60 Denar



REVISTA ETIKA
150 lekë / 1 € / 60 Denar



MEDITIMI
250 lekë / 2 €
120 Denar




MERJEMJA
së shpejti...



**101 HAPA
NË EDUKIM**
së shpejti...




**FRYMËRA MËSHIRE
NGA MUHAMMEDI**
200 lekë / 2 €
120 Denar



PIKA ELIKSIRI
300 lekë / 2.5 €
150 Denar



FRYMA E FUNDIT
300 lekë / 2.5 €
150 Denar



**VAKËFI, DHURIMI
DHE SHËRBIMI**
400 lekë / 3 €
160 Denar

Mësoj adhurimet e mia

